



Bruksel, 8.11.2023  
DPP (2023) 692 final

## **DOKUMENT PUNE I PERSONELIT TË KOMISIONIT**

### **Raporti për Kosovën\* – 2023**

*Në përcjellje të dokumentit*

**Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin  
Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve**

**Komunikatë mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së 2023**

{KOM(2023) 690 final} - {DPP(2023) 690 final} - {DPP(2023) 691 final} -  
{DPP(2023) 693 final} - {DPP(2023) 694 final} - {DPP(2023) 695 final} -  
{DPP(2023) 696 final} - {DPP(2023) 697 final} - {DPP(2023) 698 final} -  
{DPP(2023) 699 final}

---

\* Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

## PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE</b> .....	<b>3</b>
1.1. KONTEKSTI .....	3
1.2. PËRMBLEDHJE E RAPORTIT.....	3
<b>2. BAZAT E PROCESIT TË ANËTARËSIMIT</b> .....	<b>7</b>
2.1. FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE DHE REFORMA NË ADMINISTRATËN PUBLIKE .....	7
2.1.1 <i>Demokracia</i> .....	7
2.1.2 <i>Reforma e administratës publike</i> .....	12
2.2. SUNDIMI I LIGJIT DHE TË DREJTAT THEMELORE .....	15
2.2.1. <i>Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore</i> .....	15
2.2.2 <i>Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria</i> .....	43
2.3. ZHVILLIMI EKONOMIK DHE KONKURRUESHMËRIA.....	61
2.3.1. <i>Ekzistenca e një ekonomie funksionale të tregu</i> .....	62
2.3.2. <i>Kapaciteti për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit</i> .....	70
2.4. PROKURIMI PUBLIK, STATISTIKAT DHE KONTROLLI FINANCIAR .....	75
<i>Kapitulli 5: Prokurimi publik</i> .....	75
<i>Kapitulli 18: Statistikat</i> .....	77
<i>Kapitulli 32: Kontrolli financiar</i> .....	79
<b>3. MARRËDHËNIET E FQINJËSISË SË MIRË DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL</b> .....	<b>82</b>
<b>4. NORMALIZIMI I MARRËDHËNIEVE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË</b> .....	<b>83</b>
<b>5. STANDARDET EVROPIANE</b> .....	<b>87</b>
GRUPIMI 2: TREGU I BRENDSHËM.....	87
<i>Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave</i> .....	87
<i>Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punëtorëve</i> .....	89
<i>Kapitulli 3: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve</i> .....	90
<i>Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit</i> .....	91
<i>Kapitulli 6: E drejta e kompanive</i> .....	93
<i>Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale</i> .....	94
<i>Kapitulli 8: Politikat e konkurrencës</i> .....	95
<i>Kapitulli 9: Shërbimet financiare</i> .....	97
<i>Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe siguria e produkteve</i> .....	98
GRUPIMI 3: KONKURRUESHMËRIA DHE RITJIA GJITHËPËRFSHIRËSE .....	101
<i>Kapitulli 10: Transformimi digjital dhe mediat</i> .....	101
<i>Kapitulli 16: Tatimet</i> .....	103
<i>Kapitulli 17: Politikat ekonomike dhe monetare</i> .....	104
<i>Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësimi</i> .....	106
<i>Kapitulli 20: Politika e ndërmarrjeve dhe ajo industriale</i> .....	108
<i>Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimet shkencore</i> .....	110
<i>Kapitulli 26: Arsimit dhe kultura</i> .....	111
<i>Kapitulli 29: Unioni Doganor</i> .....	114
GRUPIMI 4: AGJENDA E GJELBËR DHE LIDHJA E QËNDRUESHME.....	115
<i>Kapitulli 14: Politikat e transportit</i> .....	115
<i>Kapitulli 15: Energjia</i> .....	117
<i>Kapitulli 21: Rrjetet trans-evropiane</i> .....	120
<i>Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimi klimatik</i> .....	121
GRUPIMI 5: BURIMET, BUJQËSIA DHE KOHEZIONI.....	124
<i>Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural</i> .....	125
<i>Kapitulli 12: Siguria ushqimore, politika veterinare dhe fitosanitare</i> .....	126

<i>Kapitulli 13: Peshkataria dhe akuakultura</i> .....	127
<i>Kapitulli 22: Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore</i> .....	128
GRUPIMI 6: MARRËDHËNIET E JASHTME .....	129
<i>Kapitulli 30: Marrëdhëniet e jashtme</i> .....	129
SHTOJCA I – MARRËDHËNIET NDËRMJET BE-SË DHE KOSOVËS .....	131

## 1. HYRJJE

### 1.1. KONTEKSTI

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit BE-Kosovë është në fuqi nga prilli 2016. Kosova ka miratuar programin kombëtar të rishikuar për vitet 2023-2027 për integrim në BE. Kosova ka dorëzuar aplikimin për anëtarësim në BE në dhjetor 2022. Autoritetet mbeten të përkushtuara në rrugën evropiane të Kosovës.

Propozimi i Komisionit për heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës është miratuar nga Këshilli dhe Parlamenti Evropian, me miratimin e rregullores përkatëse më 9 mars 2023 në Këshill dhe më 18 prill 2023 në Parlamentin Evropian. Liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës është planifikuar të hyjë në fuqi më 1 janar 2024.

Dialogu i lehtësuar nga BE për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka vazhduar gjatë periudhës raportuese me takime të rregullta në nivel të kryenegociatorëve dhe udhëheqësve të lartë. Pas muajsh negociatash intensive dhe me mbështetjen e partnerëve kryesorë, Palët arritën një Marrëveshje për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënieve në Bruksel më 27 shkurt 2023 dhe ranë dakord për Aneksin e Zbatimit të saj në Ohër, Maqedoni të Veriut, më 18 mars 2023. Si Kosova ashtu edhe Serbia akoma nuk kanë filluar zbatimin e detyrimeve të tyre përkatëse që rrjedhin nga Marrëveshja, të cilat janë të detyrueshme për palët dhe janë pjesë e rrugës së tyre evropiane.

Kosova ka vazhduar të dënojë luftën e agresionit të Rosisë kundër Ukrainës dhe të mbështesë pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës. Qeveria ka vazhduar të miratojë pako masash kufizuese kundër Rosisë dhe Bjellorusisë, duke pasqyruar ato të vendosura nga BE dhe SHBA.

### 1.2. PËRMBLEDHJE E RAPORTIT<sup>1</sup>

Qeveria e drejtuar nga *Vetëvendosje* ende mban një shumicë solide në Kuvend dhe vazhdoi të shtyjë përpara agjendën e saj ambicioze të reformave drejt BE-së.

Megjithatë, mungesa e vazhdueshme e bashkëpunimit ndërpartiak dhe mosmarrëveshjet brenda shumicës rezultuan të ishin sfiduese për reformat. Për më tepër, deputetët e Kuvendit nga *Lista Srpska* bojkotuan punën e Kuvendit. Megjithatë, periudha raportuese dëshmoi arritje të rëndësishme legjislative, duke përfshirë reformën zgjedhore.

Në përgjithësi, Kosova ka mbetur e angazhuar në Dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja për **normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë**, por duhet të tregojë përkushtim më serioz, të investojë më shumë përpjekje dhe të bëjë kompromise për të çuar përpara procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë. Kosova duhet të mbajë zotimet e saj të Dialogut dhe të angazhohet për zbatimin e plotë të të gjitha marrëveshjeve të dala nga Dialogu dhe Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit dhe Aneksin e Zbatimit të saj. Kosova dhe Serbia pritet të angazhohen në mënyrë më konstruktive për të mundësuar që negociatat për

---

<sup>1</sup> Ky raport mbulon periudhën nga qershori 2022 deri në qershor 2023. Ai bazohet në të dhënat nga një sërë burimesh, duke përfshirë kontributet nga qeveria e Kosovës dhe shtetet anëtare të BE-së, raportet e Parlamentit Evropian dhe informacionet nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe joqeveritare. Gjithashtu përfshin rezultatet e vlerësimeve dhe indekseve krahasuese të nxjerra nga palët e tjera të interesit, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit.

Raporti përdor shkallët e mëposhtme të vlerësimit për të përshkruar gjendjen aktuale: faza e hershme, një nivel i caktuar i përgatitjes, i përgatitur mesatarisht, nivel i mirë i përgatitjes dhe i avancuar mirë. Për të përshkruar progresin e bërë gjatë periudhës së raportimit, raporti përdor shkallën e mëposhtme: kthim prapa, pa progres, progres i kufizuar, pak progres, progres i mirë dhe progres shumë i mirë. Aty ku është e përshtatshme, janë përdorur gjithashtu hapa të përkohshëm.

Marrëveshjen gjithëpërfshirëse të normalizimit ligjërish të detyrueshme të fillojnë dhe të tregojnë fleksibilitet për të arritur progres të shpejtë dhe konkret. Normalizimi i marrëdhënieve është kusht thelbësor në rrugën evropiane të të dyja palëve dhe të dyja rrezikojnë të humbasin mundësi të rëndësishme në mungesë të progresit.

Situata në veri të Kosovës është ndikuar nga disa kriza me intensitet të ndryshëm për një sërë çështjesh, duke kulmuar me sulmin e dhunshëm kundër Policisë së Kosovës më 24 shtator 2023, që përbën përshkallëzimin më të rëndë në vitet e fundit. Në kuadër të këtij sulmi u gjetën sasi të mëdha të armëve të vogla dhe të lehta (AVL).<sup>2</sup> BE pret që autorët të kapen dhe të sillen shpejt para drejtësisë dhe Serbia të bashkëpunojë plotësisht dhe të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm në këtë drejtim. Kriza të tjera gjatë periudhës raportuese u shkaktuan nga çështjet e lirisë së lëvizjes, veçanërisht ato të targave, pas vendimit të Qeverisë së Kosovës më 29 qershor 2022 për të zbatuar ri-regjistrimin e të gjitha automjeteve me targa të Kosovës. Kjo çoi në tensione në korrik të vitit 2022 dhe vazhdoi përmes ngritjes së bllokadave në rrugë dhe dorëheqjes kolektive të serbëve të Kosovës nga institucionet e Kosovës në nëntor 2022. Pas tërheqjes së serbëve të Kosovës nga institucionet e Kosovës, në katër komunat e veriut të Kosovës janë organizuar zgjedhje të pjesshme lokale. Të planifikuara fillimisht për dhjetor të vitit 2022 dhe më pas të shtyra për datën 23 prill 2023, zgjedhjet e pjesshme për kryetar të komunave dhe kuvende komunale u mbajtën në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës dhe u bënë përpjekje që ato të zhvillohen në mënyrë të qetë dhe të rregullt. Megjithatë, pavarësisht Marrëveshjes historike për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve të arritur në Bruksel më 27 shkurt dhe Aneksin e Zbatimit të saj të dakorduar në Ohër, Maqedonia të Veriut, më 18 mars 2023, dhe pavarësisht se Kosova ka vazhduar afatin për regjistrimin e kandidaturave për zgjedhjet e pjesshme lokale, jo të gjitha partitë dhe komunitetet e shfrytëzuan të drejtën e tyre demokratike për të marrë pjesë dhe për të votuar. Pjesëmarrja shumë e ulët (3.47% e votuesve), pas bojkotit të komunitetit serb të Kosovës, tregoi se këto zgjedhje nuk ofrojnë zgjidhje politike afatgjatë për këto komuna. Mbetet e domosdoshme që të krijohet situata ku serbët e Kosovës do të merrnin pjesë në mënyrë aktive në qeverisje lokale, polici dhe gjyqësor në veri të Kosovës. Zgjedhjet e parakohshme lokale duhet të mbahen sa më shpejt në të katër komunat, të organizuara në mënyrë plotësisht gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrjen e pakushtëzuar të serbëve të Kosovës.

Për shkak të mungesës së hapave vendimtarë për të depërshkallëzuar situatën, dhe në përputhje me deklaratën e 3 qershorit, BE-ja po zbaton një sërë masash kundër Kosovës, të cilat gjithashtu ndikojnë në mbështetjen financiare. Këto masa janë të përkohshme dhe mund të hiqen plotësisht, varësisht nga hapat e ndërmarrë për depërshkallëzimin e tensioneve në veri të Kosovës. Kosova ka ndërmarrë hapa në drejtimin e duhur, por ende ka më shumë për të bërë.

Në **reformën e administratës publike**, pasi që rekomandimet e vitit të kaluar nuk janë zbatuar mjaftueshëm. Legjislacioni i ri për zyrtarët publikë dhe pagat u miratua nga Kuvendi duke përdorur procedura të përshpejtuara. Ligji për pagat është aktualisht në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese. Ligji i ndryshuar për zyrtarët publik rrezikon të krijojë dhe përkeqësojë boshllëqet ekzistuese në kapacitetet administrative.

Kosova është ende në fazën e hershme të zhvillimit të një **sistemi gjyqësor** që funksionon mirë. Ka pasur progres të kufizuar gjatë periudhës raportuese. Mbetet nevoja për të forcuar mjetet ekzistuese që mbrojnë integritetin, llogaridhënien, pavarësinë dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë. Ministrja e Drejtësisë dhe krerët e institucioneve kryesore të sistemit të drejtësisë nënshkruan një Deklaratë të Angazhimit të Përbashkët dhe Planin e Veprimi për reformën në

---

<sup>2</sup> BE-ja dhe partnerët e Ballkanit Perëndimor u dakorduan në maj 2023 për të vazhduar përtej vitit 2024 me Udhërrëfyesin për kontrollin gjithëpërfshirës të armëve të vogla dhe të lehta në Ballkanin Perëndimor.

drejtësi. Nevojiten veprime të shpejta për të arritur rezultate të prekshme.

Kosova është në mes të një faze të hershme dhe njëfarë niveli të përgatitjes në **luftën kundër korrupsionit**. Është arritur progres i kufizuar gjatë periudhës raportuese dhe korrupsioni mbetet çështje shqetësuese. Ndërsa vitin e kaluar Kuvendi miratoi legjislacion të rëndësishëm kundër korrupsionit dhe korniza ligjore për konfiskimin penal është avancuar, mbetet shumë për të bërë për të zbatuar legjislacionin kundër korrupsionit. Pavarësisht përmirësimit në performancën e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, mjetet parandaluese kundër korrupsionit të përcaktuara në legjislacion ende nuk janë përdorur plotësisht. Kosova duhet të shtojë përpjekjet për të siguruar hetime më proaktive, vendime gjyqësore përfundimtare dhe konfiskim përfundimtar të pasurisë.

Kosova është në një fazë të hershme të luftës kundër **krimi i organizuar**. Është arritur progres i kufizuar në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të krimit të organizuar. Kosova ka miratuar një strukturë të re organizative policore dhe ka përmirësuar kapacitetet e inteligjencës dhe analizës. Operacionet e zbatimit të ligjit kundër krimit të organizuar kanë vazhduar. Përkundër kësaj, mjetet e fuqishme të parapara me Kodin Penal dhe Ligjin për kompetencat e zgjeruara të konfiskimit ende nuk janë shfrytëzuar plotësisht. Lufta kundër krimit të organizuar në veri të Kosovës vazhdon të jetë sfiduese.

Kosova ka mbetur aktive në luftën kundër terrorizmit dhe në luftimin dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Korniza ligjore kundër terrorizmit është pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-në dhe standardet ndërkombëtare. Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit ende nuk është ndryshuar. Autoritetet duhet të jenë më efektive në përpjekjet e tyre për të luftuar pastrimin e parave.

Korniza ligjorë garanton gjerësisht mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut në përputhje me standardet evropiane. Ndërsa kapaciteti për të monitoruar zbatimin e politikave dhe legjislacionit është përmirësuar, kërkohej përpjekje të mëtejshme për të zbatuar në mënyrë efektive të drejtat themelore. Institucioneve përkatëse duhet t'u ndahen më shumë burime njerëzore dhe financiare. Vazhduan përpjekjet për të përmirësuar barazinë gjinore, por Kosova duhet të forcojë më tej zbatimin e legjislacionit.

Kosova ka një kornizë ligjore të përcaktuar mirë për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë. Megjithatë, nevojiten veprime të mëtejshme rreth çështjeve të pazgjidhura siç janë mungesa e qasjes së barabartë në arsim dhe punësim, mosrespektimi i gjuhës dhe përfaqësimi i ulët në institucionet publike, duke përfshirë komunitetin rom dhe ashkali<sup>3</sup>.

Kosova ka njëfarë niveli të përgatitjes në lidhje me **lirinë e shprehjes**. Është arritur progres i kufizuar në adresimin e rekomandimeve të raportit të mëparshëm. Shqetësimet mbeten në lidhje me sulmet dhe kërcënimet fizike, fushatat e shpifjeve publike dhe gjuhën e urrejtjes. Veçanërisht shqetësuese është mungesa e lirisë së shprehjes në veri të Kosovës.

Autoritetet e Kosovës vazhduan të arrijnë progres në menaxhimin e **migrimit** dhe janë angazhuar me BE-në në zbatimin e Planit të Veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor të paraqitur në dhjetor të vitit 2022 nga Komisioni. Kapaciteti akomodues është rritur. Duhet të ndërmerren hapa për të harmonizuar më tej legjislacionin, përfshirë Ligjin për të huajt, me *acquis* Be-së dhe standardet ndërkombëtare.

Për sa i përket **kriteret ekonomike**, Kosova ka arritur njëfarë progresi dhe ndodhet në mes të një faze të hershme dhe një niveli të përgatitjes për zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale. Rimëkëmbja ekonomike e Kosovës u moderua ndjeshëm në vitin 2022. Kjo ishte kryesisht për

<sup>3</sup> Në përputhje me terminologjinë e institucioneve evropiane, termi ombrellë 'rom' përdoret këtu për t'iu referuar një numri grupesh të ndryshme, pa mohuar specifikat e këtyre grupeve.

shkak të zvogëlimit të investimeve dhe ngadalësimit të rritjes së konsumit të ekonomive familjare si pasojë e inflacionit të lartë, veçanërisht pas fillimit të luftës së agresionit të Rusisë kundër Ukrainës. Pavarësisht qëndrueshmërisë që ka demonstruar ekonomia gjatë krizave të fundit, sektori privat vazhdon të pengohet nga sfidat strukturore të kahershme, siç janë ekonomi informale e përhapur, shkalla e lartë e korrupsionit dhe në përgjithësi sundimi i dobët i ligjit. Rritja e madhe e të ardhurave për shkak të rritjes së çmimeve dhe numrit në rritje të njerëzve në punë formale, si dhe ekzekutimi tejet i ulët i shpenzimeve kapitale publike çoi në një buxhet pothuajse të balancuar me vitin 2022, ndërkohë që ra edhe shkalla e borxhit publik. Inflacioni u rrit në shifra dyshifrore për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë, ushqimeve dhe transportit, duke çuar në rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Sektori financiar mbeti i kapitalizuar mirë, i qëndrueshëm dhe kreditimi bankar vazhdoi të zgjerohej.

Kosova ka arritur progres të kufizuar dhe është në një fazë të hershme për sa i përket aftësisë për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut në BE. Sistemi arsimor nuk ofron njohuri të mjaftueshme për shkathhtësitë e nevojshme kyçe dhe nuk është në përputhje adekuate me nevojat e tregut të punës. Kosova ka bërë përpjekje për përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe rritjen e investimeve në burimet e ripërtëritshme, por furnizimi me energji i bazuar në thëngjill, i stërvjetëruar dhe jo i besueshëm mbetet shqetësim. Kosova ka arritur njëfarë progresi sa i përket digjitalizimit të ekonomisë.

Është arritur progres i kufizuar gjatë periudhës raportuese në fushat e prokurimit publik dhe kontrollit financiar. Sa i përket statistikave, ka pasur njëfarë progresi.

Sa i përket **marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimit rajonal**, Kosova vazhdoi të marrë pjesë në shumicën e forumeve rajonale. Kosova ka mbajtur në përgjithësi marrëdhënie të mira me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Nuk ka pasur asnjë ndryshim në marrëdhëniet zyrtare të Kosovës me Bosnjën dhe Hercegovinën, pasi që ky shtet nuk e njeh pavarësinë e Kosovës. Gjeorgjia, Moldavia dhe Ukraina nuk kanë marrëdhënie zyrtare me Kosovën, pasi nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.

Për sa i përket përafrimit me standardet evropiane, Kosova ka arritur njëfarë progresi në **grupimin 2, tregu i brendshëm** në lidhje me lëvizjen e lirë të mallrave, lirinë për të ofruar shërbime, lëvizjen e lirë të kapitaleve dhe të drejtën e pronësisë intelektuale. Ajo ka arritur progres të kufizuar në fushën e lirisë së lëvizjes për punëtorët, të drejtën e shoqërive, politikën e konkurrencës, shërbimet financiare dhe mbrojtjen e konsumatorëve dhe shëndetit.

Në **grupimin 3, konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse**, Kosova ka arritur njëfarë progresi në shumicën e fushave (dogana, sistemi tatimore, politikë sociale dhe të punësimit, arsim dhe kulturë), përveç transformimit digjital dhe mediave ku progresi ishte i kufizuar.

Në fushat e politikave që lidhen me **grupimin 4, Agjenda e Gjelbër dhe lidhja e qëndrueshme**, Kosova ka arritur njëfarë progresi në sektorin e energjisë (duke përfshirë miratimin e Strategjisë për Energji 2022-2031). Sa i përket transportit, mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, ka arritur vetëm progres të kufizuar.

Në **grupimi 5, burimet dhe bujqësia**, Kosova ka arritur progres të kufizuar në bujqësi dhe njëfarë progresi në politikën e sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare. Sa i përket peshkimit, nuk ka arritur asnjë progres.

Në lidhje me **marrëdhëniet e jashtme**, është arritur progres i kufizuar gjatë periudhës raportuese. Kosova ka arritur progres në zbatimin e planit të veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal, veçanërisht duke ratifikuar tri “marrëveshjet e procesit të Berlinit” për lëvizjen e lirë dhe njohjen reciproke të kualifikimeve. Megjithatë, qeveria vazhdon të bllokojë mekanizmat vendimmarrës në kudër të CEFTA-s për shkak të mosmarrëveshjeve rreth përfaqësimit të

Kosovës. Kosova ende nuk i ka ratifikuar protokollet shtesë të CEFTA-s për lehtësimin e tregtisë dhe tregtinë e shërbimeve. Përveç kësaj, me vendosjen e një ‘masa të përkohshme operative të sigurisë’ në qershor 2023 duke bllokuar hyrjen në Kosovë të mallrave dhe pakove postare serbe, Kosova duket se nuk është në përputhje me zotimet e saj sipas CEFTA-s. Masa bie gjithashtu ndesh me frymën e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Në përgjithësi, Kosova duhet të përmirësojë kapacitetet administrative koordinuese në të gjithë sektorët për të arritur zbatimin efektiv të *acquis* të BE-së.

## **2. BAZAT E PROCESIT TË ANËTARËSIMIT**

### **2.1. FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE DHE REFORMA NË ADMINISTRATËN PUBLIKE**

#### **2.1.1 Demokracia**

Qeveria e drejtuar nga *Vetëvendosje* ka vazhduar të majë një shumicë solide në Kuvend dhe të shtyjë përpara agjendën e saj ambicioze të reformës së BE-së.

Stabiliteti i përgjithshëm politik i Kosovës i dha qeverisë mundësi për të zbatuar reformat në lidhje me BE-në dhe për të miratuar legjislacionin e vonuar.. Megjithatë, mungesa e vazhdueshme e bashkëpunimit ndërpartiak dhe mosmarrëveshjet brenda shumicës rezultuan të ishin sfiduese për reformat. Pavarësisht kësaj, periudha raportuese dëshmoi arritje të rëndësishme legjislative. Shumica u dakordua me opozitën për të krijuar dy komisione *ad hoc* në Kuvend, duke përfshirë edhe atë për reformën zgjedhore. Rreth 104 akte ligjore ishin miratuar që nga qershori 2023; ku shumica prej tyre ishin prioritetete të avancuara të integritimit në BE.

Partitë opozitare mbështetën ligjet kyçe të ndërlidhura me BE-në në disa raste. Megjithatë, mosmarrëveshjet e thella mes shumicës dhe opozitës mbeten. Kuvendi shpeshherë nuk arriti të votonte propozimet legjislative për shkak të mungesës së kuorumit vendimmarrës, pavarësisht se qeveria mban shumicën në Kuvend. Mbledhjet e komisioneve të Kuvendit, seancat e kryesisë dhe ato plenare vazhduan të vuanin nga bojkotet e shpeshta dhe mungesa e kuorumit.

Pjesëmarrja e femrave në të gjitha nivelet e qeverisjes lokale dhe vendimmarrjes në institucione dhe parti politike është përmirësuar, por mbetet e ulët. Kosova duhet të zbatojë më tej Ligjin për Barazi Gjinore, i cili bën thirrje për barazi gjinore në jetën publike.

#### **Zgjedhjet**

Kosova ka arritur progres të rëndësishëm me reformën zgjedhore, pasi ka miratuar Ligjin për financimin e partive politike dhe Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme.. Korniza e re ligjor trajton rekomandimet e kahershme të Misioneve të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të BE-së. Ligji i ri për Komisionin e Pavarur për Media duhet të miratohet. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) duhet të zbatojë kornizën e re ligjore shumë përpara zgjedhjeve të ardhshme të përgjithshme. KQZ-së i nevojiten më shumë burime financiare dhe njerëzore për të kryer detyrat shtesë që rrjedhin nga korniza e re ligjore.

Pas tërheqjes së serbëve të Kosovës nga institucionet e Kosovës në nëntor të vitit 2022, në katër komunat e veriut të Kosovës janë organizuar zgjedhje të pjesshme lokale. Të planifikuara fillimisht për dhjetor të vitit 2022 dhe më pas të shtyra për datën 23 prill 2023, këto zgjedhje të pjesshme për kryetar të komunave dhe kuvende komunale u mbajtën në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës dhe u bënë përpjekje që ato të zhvillohen në mënyrë të qetë dhe të rregullt. Mirëpo, për shkak të pjesëmarrjes shumë të ulët (3.47% të votuesve), veçanërisht nga qytetarët serbë të Kosovës, këto zgjedhje nuk ofrojnë zgjidhje politike afatgjatë për këto



komuna. Zgjedhjet e parakohshme lokale duhet të mbahen sa më shpejt në të katër komunat, të organizuara në mënyrë plotësisht gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrjen e pakushtëzuar të serbëve të Kosovës.

Kosova ka arritur progres të rëndësishëm në adresimin e rekomandimeve të kahershme të Misioneve të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të BE-së (MVZ-të e BE-së). Komisioni *ad hoc* i Kuvendit për reformën zgjedhore ishte themeluar më 1 korrik 2022 dhe përfundoi me sukses punën më 5 prill 2023. Komisioni, i kryesuar nga partia më e madhe opozitare (PDK), në bashkëpunim me KQZ-në dhe palët e tjera të interesit, adresoi shumicën e rekomandimeve të MVZ-ve të BE-së dhe arriti të prezantojë një ligj konsensual për zgjedhjet e përgjithshme. Ai siguron një bazë adekuate për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rajonale. Ai paraqet përmirësime të rëndësishme në disa pjesë të procesit, duke përfshirë në lidhje me të drejtat e votimit, listat e votuesve, regjistrimin e partive politike, pavarësinë e KQZ-së, rregulloret e fushatës, votimin dhe numërimin, sistemin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore dhe siguron buxhet shtesë për partitë politike që tejkalojnë kuotën prej 30% të grave.

Paralelisht, KQZ ka përditësuar rregullat zgjedhore. Megjithatë, këto do të duhet të harmonizohen më tej me Ligjin e ri për zgjedhjet e përgjithshme. Në gusht të vitit 2022, Kuvendi miratoi Ligjin e ri për financimin e partive politike, i cili themeloi Zyrën e re për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike. Në dhjetor të vitit 2022, KQZ punësoni drejtorin e tij brenda afateve ligjore të përcaktuara në ligjin e ri.

Pas dorëheqjes masive të serbëve të Kosovës nga institucionet e Kosovës në nëntor të vitit 2022, në katër komunat e veriut janë organizuar zgjedhje të pjesshme lokale. Më 10 nëntor 2022, Presidentja e Kosovës caktoi datën 18 dhjetor si datë për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komunash në Mitrovicën Veriore, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok dhe datën 25 dhjetor 2022 si datë për zgjedhjet e pjesshme për Kuvendet Komunale të Zveçanit dhe Leposaviqit. Sikurse në dhjetor, situata e sigurisë në veri të Kosovës u përkeqësua dhe grupe të serbëve të Kosovës e bllokuan personelin e KQZ-së që të hyjë në dy zyrat e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve. Si rezultat, Presidentja i shtyu zgjedhjet deri më 23 prill 2023. një vendim që u mirëprit nga BE-ja pasi ka avancuar përpjekjet për të promovuar një situatë më të sigurt në veri të Kosovës.

Zgjedhjet u mbajtën më 23 prill në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës dhe ishin bërë përpjekje që ato të zhvillohen në mënyrë të qetë dhe të rregullt. Megjithatë, përkundër marrëveshjes për Aneksin e Zbatimit të Marrëveshjes për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënieve të arritur në Ohër më 18 mars 2023 dhe dhe zgjatjes nga Kosova të afatit për regjistrimin e kandidaturave për zgjedhjet lokale, jo të gjitha partitë dhe komunitetet shfrytëzuan e drejtën e tyre demokratike për të marrë pjesë dhe vetëm 3.47% e votuesve votuan. Partitë politike serbe të Kosovës nuk morën pjesë dhe *Lista Srpska* bëri thirrje që votuesit të mos dalin, që rezultoi në bojkotimin e zgjedhjeve në masë të madhe nga komuniteti serb i Kosovës. Nga 45 095 votues, vetëm 1 567 votuan. Përderisa legjislacioni i Kosovës nuk përcakton një prag për pjesëmarrjen e votuesve, pjesëmarrja shumë e ulët, veçanërisht në mesin e serbëve të Kosovës, tregon qartë se zgjedhjet nuk ofrojnë zgjidhje politike afatgjatë për këto komuna. Zgjedhjet e parakohshme lokale duhet të mbahen sa më shpejt në të katër komunat, të organizuara në mënyrë plotësisht gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrjen e pakushtëzuar të serbëve të Kosovës.

## **Kuvendi**

Gjatë periudhës raportuese, puna e Kuvendit vazhdoi të pengohej nga mungesa e kuorumit vendimmarrës dhe përpjekjet e kufizuara për të krijuar konsensus ndërpartiak. Kuvendi nuk ka

mundur të miratojë ligje dhe të bëjë emërimet e nevojshme në organet publike për periudha të gjata kohore. Bojkoti nga deputetët e *Lista Srpska* e bënë të pamundur miratimin e ligjeve në kategorinë e legjislacionit jetik. Mungesa e konsensusit politik për disa nga reformat kryesore dhe proceset legjislative ka vazhduar. Kuvendi duhet të paraqes masa dhe/ose ndëshkime për t'u siguruar që mund të kryejë rolin e tij. Për këtë qëllim, ai do të duhet gjithashtu të përmirësojë menaxhimin e tij të brendshëm, të miratojë një plan vjetor të punës dhe të vë në funksion një sistem votimi elektronik dhe një sistem elektronik të regjistrimit të pranisë. Përveç funksionit legjislativ, Kuvendi duhet të forcojë funksionin e tij mbikëqyrës. Më 8 qershor 2023, Kuvendi miratoi Ligjin e ri për zgjedhjet e përgjithshme. Ai gjithashtu arriti konsensus ndërpartiak me miratimin e shpejtë të tri marrëveshjeve të Procesit të Berlinit për lirinë e lëvizjes. Kuvendi ka vazhduar përdorimin e procedurave të shpejta/të përshpejtuara për miratimin e legjislacionit kyç. Numri i grave deputete mbetet i njëjtë, edhe pse për herë të parë gratë kryesojnë më shumë se gjysmën e komisioneve të Kuvendit.

Diskutimet mes shumicës qeverisëse dhe opozitës në Kuvend ishin të polarizuara dhe herë pas here të tensionuara. Disa deputetë përdorën gjuhë nxitëse kundër kundërshtarëve politikë, duke përfshirë stereotipizimin dhe gjuhën jo të ndjeshme në aspektin gjinor.

Kuvendi nuk ka arritur konsensus për shumë çështje, duke përfshirë politikën energjetike, rritjen e pagave në sektorin publik, grevat në sektorin e arsimit, strategjinë e sigurisë dhe politikën ekonomike. Përderisa Kuvendi mbetet forumi kryesor për dialog politik ndërmjet partive politike dhe përfaqësuesve joshumicë, janë bërë përpjekje të kufizuara për të krijuar konsensus për çështjet me interes të përgjithshëm. Debati politik duhet të drejtohet drejt diskutimeve thelbësore që çojnë në rezultate konsensuale dhe të qëndrueshme. Mungesa e kuorumit vendimmarrës, pavarësisht se qeveria ka shumicën në Kuvend, çoi në një numër të madh pikash në rendin e ditës dhe në zvarritjen për muaj të tërë të seancave parlamentare, duke shkaktuar vonesa në miratimin e reformave në lidhje me BE-në dhe në miratimin e emërimeve. Mungesa, mbërritja me vonesë dhe largimi i hershëm nga seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve janë bërë praktikë e zakonshme. Rregullores së re të Punës i mungojnë masat për shqiptim të gjobave financiare (ose të tjera) në rast mungese të pajustificuar në seancat parlamentare.

Më 7 nëntor 2022, 10 deputetë të *Lista Srpska* dhanë dorëheqje nga Kuvendi si pjesë e tërheqjes kolektive të serbëve të Kosovës nga institucionet e Kosovës. Më 17 nëntor, kandidatët e radhës morën mandatin e tyre. Nëntë deputetë nga *Lista Srpska*, një anëtar i Iniciativës Qytetare të opozitës serbe të Kosovës për 'Liri, Drejtësi, Mbijetesë' (SPO) dhe dy deputetë goranë dhe romë morën pjesë në seancën plenare të 6 prillit 2023 për të siguruar vazhdimin e mandateve të tyre, për të vazhduar më pas bojkotin e seancave plenare. Mungesa e disiplinës dhe interpretimi i lirshëm i përgjegjësive parlamentare janë bërë pengesë në rritje për funksionimin e Kuvendit dhe organeve të tij.

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi miratoi 104 ligje, 25 prej të cilave kanë të bëjnë me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Nga 104 ligjet e miratuara, 21 janë miratuar me procedurë të shpejtë. Këtu përfshiheshin ligjet thelbësore si Ligji për buxhetin e vitit 2023, Ligji për zyrtarët publikë dhe Ligji për pagat. Nuk pati përpjekje për të krijuar konsensus mbi pjesët kyçe të legjislacionit dhe partitë opozitare i kanë referuar një numër prej tyre në Gjykatën Kushtetuese. Më 23 shkurt 2023, Kuvendi miratoi me shpejtësi tri marrëveshje ndërkombëtare të arritura në Procesin e Berlinit. Këto mundësojnë lëvizjen e lirë me letërnjoftime dhe njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë dhe kualifikimeve profesionale në Ballkanin Perëndimor.

Kuvendi nuk ka arritur të bëjë emërimet me kohë në shumicën e organeve kyçe të pavarura. Si pasojë, ka disa vende zbrazëta në institucione të ndryshme dhe Kuvendi ka vazhduar shtyrjen e votimeve për emërimet.

Kuvendi duhet të forcojë funksionin e tij mbikëqyrës të ekzekutivit dhe të institucioneve të pavarura. Rregullorja e re e Punës përfshin procedura të avancuara të raportimit për trajtimin e raporteve vjetore të institucioneve të pavarura, por kjo nuk ka rezultuar në shqyrtimin me kohë të këtyre raporteve. Shumica e raporteve vjetore për vitin 2021 të institucioneve të pavarura janë shqyrtuar në muajt e parë të sesionit pranveror të vitit 2023 dhe shpesh pa debat përmbajtjesor.

Kuvendi ka bërë përpjekje të kufizuara për të adresuar mungesën e stafit të kualifikuar, veçanërisht në lidhje me çështjet e specializuara ligjore dhe gjinore. Ai mbetet e varur nga ekspertët e jashtëm dhe mbështetja e donatorëve ndërkombëtarë.

## Qeverisja

Kosova ka arritur progres në zbatimin e reformave që ndërlidhën me BE-në: Kosova ka miratuar Programi Kombëtar integrim në BE ka vazhduar me zbatimin e planit të veprimit për Agjenda e Reformës Evropiane (ERA) II. Në dhjetor të vitit 2022, Kosova dorëzoi kërkesën për anëtarësim në BE. Për të ndjekur reformat që ndërlidhen me BE-në në një mënyrë më efikase dhe të qëndrueshme, është thelbësore që qeveria të sigurojë mbështetje ndërpartiake, të rrisë koordinimin ndërmjet departamenteve dhe të decentralizojë vendimmarrjen tek ministrinë e linjës për të zbatuar politikën nën përgjegjësinë e tyre.

Më 31 mars 2023, qeveria miratoi **Programin Kombëtar për Integrimin në BE 2023-2027** të rishikuar, i cili pastaj u miratua nga Kuvendi më 15 qershor 2023. Kosova ka vazhduar të zbatojë Planin e Veprimit për ERA II.

Edhe pse strukturat për **koordinim** ndër-institucional lidhur me integrimin evropian janë funksionale, kapacitetet e dobëta administrative ndikuan në agjendën e reformave të BE-së dhe aktivitetet integruese. Numri i pozitave kyçe në sektorin publik që funksionojnë me ushtrues detyre është shqetësues. Sfidë tjetër është mungesa e një organi të përhershëm koordinues ndërministror në nivel ekspertësh. Kjo rezulton në pronësi të kufizuar politike të agjendës së BE-së në ministrinë e linjës dhe mungesë të caktimit të prioritetëve dhe ndërveprimin e reformave. Nevojiten më shumë përpjekje për të rritur besimin dhe për të forcuar koordinimin ndërmjet nivelit politik dhe atij teknik.

Sa i përket **pushtetit vendor**, mbeten pabarazitë ndërmjet komunave në performancën dhe ofrimin e shërbimeve. Me rritjen e buxhetit të përgjithshëm për vitin 2023, granti i përgjithshëm për komunat u zgjerua për 15% (100 milionë euro). Megjithatë, komunat e udhëhequra nga kryetarët e partive opozitare kanë ngritur shqetësimin se fondet për investime kapitale të ministrive të linjës nuk ndahen gjithmonë sipas kritereve objektive. Në korrik të vitit 2022, Kuvendi miratoi Ligjin për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale, një instrument i rëndësishëm për të promovuar konkurrencën ndërmjet komunave në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe për të nxitur transparencën. Mbikëqyrja efektive e organeve legjislativë komunale mbi organet ekzekutive komunale mbetet sfidë. Komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet qeverisë dhe komunave ka nevojë për përmirësim. Sa i përket praktikave të auditimit, është arritur progres drejt mbikëqyrjes më efektive dhe qeverisjes transparente. Komunat nuk përdorin mjaftueshëm mekanizmat ekzistues të bashkëpunimit ndërkomunal.

Përfaqësimi i grave në pozitat e larta qeveritare u rrit, por mbetet i pabarabartë. Ato mbeten të nën-përfaqësuara në organet lokale vendimmarrëse, dhe nevojiten masa afirmative për të siguruar përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në ekzekutivin lokal. Tri parti politike (*Vetëvendosje*, PDK dhe LDK) kanë ndërmarrë masa për të rritur pjesëmarrjen e grave në partitë e tyre.

## Shoqëria Civile

Në përgjithësi, shoqëria civile funksionon në një mjedis të favorshëm. Shoqëria civile vazhdon të marrë pjesë aktive në konsultimet publike dhe të kontribuojë në proceset e politikëbërjes dhe monitorimit. Përpjekjet e autoriteteve publike për të përfshirë publikun në proceset vendimmarrëse janë të mirëseardhura dhe duhet të rriten më tej. Qeveria duhet të sigurojë që çdo proces i konsultimit publik të përmbushë standardet, parimet dhe procedurat minimale të përcaktuara nga rregullorja përkatëse. Përpjekjet për të rritur transparencën dhe llogaridhënien e financimit publik ndaj organizatave të shoqërisë civile duhet të vazhdojnë.

Një shoqëri civile e fuqizuar është komponent kyç i çdo sistemi demokratik dhe vazhdon të njihet si e tillë nga institucionet publike. Shoqëria civile mbetet një partner i rëndësishëm në kuadër të përgatitjes së Kosovës për anëtarësim në BE, pasi ajo kontribuon në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e reformave që ndërlidhën me BE-në dhe merr pjesë në platformat e dialogut të politikave të Stabilizim-Asociimit. Roli i saj në promovimin e ndryshimeve sociale, ndërtimin e besimit dhe promovimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve të shumta të interesit është i njohur gjerësisht. Edhe shoqëria civile luan rol kritik në avokimin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, barazinë gjinore dhe të drejtat e personave që u përkasin komuniteteve joshumicë.

Këshilli për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile nuk është takuar që nga viti 2022 (kur miratoi Rregulloren e re të Punës). Përveç disa përparimeve në procesin e konsultimit publik, nuk ka pasur zhvillime të rëndësishme në zbatimin e strategjisë 2019-2023 për bashkëpunim me shoqërinë civile.

Qeveria ka bërë disa përpjekje për të përfshirë shoqërinë civile në vendimmarrje. Në vitin 2022, platforma online për konsultime publike është përmirësuar me veçori që lehtësojnë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara. Shumica e akteve legjislativë të miratuara nga qeveria ishin dorëzuar për konsultim publik. Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të), palët e interesit dhe publiku u angazhuan pothuajse katër herë më shumë në konsultime publike në nivel qendror sesa në vitin 2021. Në të njëjtën kohë, zbatimi i disa standardeve, parimeve dhe procedurave të përcaktuara në Standardet Minimale për Konsultim Publik vazhdoi të mbetet prapa. Konsultimet publike në përgjithësi kryhen në nivel qendror, me shkrim dhe në formë elektronike përmes platformës online. Rekomandohet të rritet përdorimi i formave të tjera të konsultimit publik. Administratat lokale nuk i përdorin në mënyrë të mjaftueshme këta mekanizma.

Zbatimi i Rregullores për financimin publik të OJQ-ve është duke u përmirësuar gradualisht. Pavarësisht se është përfshirë në agjendën legjislativë të vitit 2022, ndryshimet në Rregullore nuk janë iniciuar. Platforma online është përmirësuar me vizualizimin e të dhënave bazuar në ofruesit, përfituesit dhe territorin e zbatimit dhe tani është e lidhur me Platformën e Mbështetjes së Donatorëve për Shoqërinë Civile. Kosova do të përfitonte nga rritja e transparencës dhe llogaridhënies për financimin publik të OJQ-ve. Nevojiten më shumë përpjekje për të përditësuar regjistrin e OSHC-ve dhe për të siguruar që sistemi elektronik i organizatave joqeveritare të Kosovës të jetë plotësisht i besueshëm.

Në vitin 2022, qeveria inicioi procesin sektorial të vlerësimit të rrezikut të financimit të terrorizmit për organizatat jofitimprurëse, duke përfshirë shoqërinë civile. Kjo punë duhet të përfshihet në rishikimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit. Qëllimi është të hiqet barra e panevojshme e raportimit për OSHC-të, të lehtësohen masat e tepërta të kontrollit ndaj OSHC-ve me rrezik të ulët, të hiqen kufizimet për donacionet në para të gatshme dhe të hiqen barrierat për qasje në shërbime bankare ose financiare. Regjimi tatimor për OSHC-të konsiderohet se përmbush pjesërisht standardet përkatëse sipas vlerësimit bazë të Asistencës Teknike të BE-së për Organizatat e Shoqërisë Civile (TACSO) 2021.

Mjedisi për vullnetarizëm duhet të përmirësohet, duke përfshirë krijimin e një kornize të

përshtatshme legjislativ, në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe shpërndarjen e burimeve financiare dhe njerëzore për programet e vullnetarizmit për të rinjtë.

### 2.1.2 Reforma e administratës publike

Kosova ka **një nivel të përgatitjes** dhe nuk ka arritur **asnjë progres** lidhje me reformën e administratës publike gjatë periudhës raportuese. Mbikëqyrja e zbatimit të kornizës legjislative për reformën e administratës publike (PAR) në ministritë e linjës është ende joefektive. Kjo është përkundër miratimit të një kornize të re strategjike si për RAP-in ashtu edhe për menaxhimin e financave publike. Legjislacioni i ri për zyrtarët publikë dhe pagat u miratua nga Kuvendi duke përdorur procedura të përsheptuara. Të dy ligjet u dërguan për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, e cila i shpalli si jokushtetuese disa nene të Ligjit për Zyrtarët Publikë. Ligji i ndryshuar për Zyrtarët Publik rrezikon të krijojë dhe përkeqësojë boshllëqet ekzistuese në kapacitetet administrative. Është arritur njëfarë progresi me harmonizimin e ligjeve sektoriale me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative dhe në digjitalizimin e shërbimeve publike. Megjithatë, ritmi i përgjithshëm i reformave të administratës publike mbeti i pamjaftueshëm për të dhënë rezultate të prekshme në periudhën raportuese.

Megjithatë rekomandimet e vitit të kaluar nuk janë zbatuar mjaftueshëm, ato mbeten gjerësisht të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet:

- të përmirësojë funksionimin dhe llogaridhënien e administratës publike, duke përfshirë racionalizimin e agjencive dhe futjen e menaxhimit të performancës në agjenci; për këtë qëllim, duhet të forcohen kapacitetet administrative, të plotësohen vendet e lira të punës të hapura me rregull dhe në përputhje me parimin e rekrutimit të bazuar në merita, dhe të ndryshohet Ligji i ri për zyrtarët publikë në përputhje me parimet e një administrate publike moderne;
- të sigurojë funksionimin efikas të sistemit të ri të pagave duke zbatuar Ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura dhe të finalizojë proceset lidhur me: (i) rregullimin e organizimit të brendshëm të organeve publike, (ii) klasifikimin e vendeve të punës; dhe (iii) sistematizimin e pozitave në nivel qendror sipas përshkrimeve të vendeve të punës;
- të përmirësojë sigurinë ligjore, reduktimin e barrës administrative dhe rritjen e numrit të shërbimeve elektronike në administratën publike për bizneset dhe publikun.

#### Korniza strategjike për reformën e administratës publike

Gjatë vitit të kaluar, Kosova ka konsoliduar kornizën strategjike për RAP duke miratuar strategjinë e re të RAP-it (2022-2027) dhe planin e veprimit për zbatimin e saj. Këshilli Ministror për RAP, i cili është mekanizmi kryesor mbikëqyrës dhe koordinues për reformën e administratës publike në nivel politik, në përgjithësi mbledhet vetëm një herë në vit për të miratuar raportet vjetore sipas kornizës strategjike të RAP-it. Ky mekanizëm është joefektiv në sigurimin e koordinimit ndërmjet organeve kryesore për të drejtuar procesin e RAP-it. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) udhëheq reformat në nivelin teknik. Megjithatë, MPB-ja dhe ministritë e linjës kanë kapacitete të kufizuara për të mbikëqyrur në mënyrë efektive, për të analizuar të dhënat në mënyrë të bazuar në fakte dhe për të menaxhuar proceset e reformës. Është miratuar raporti i monitorimit të zbatimit të PAR-it për vitin 2022. Platforma e bazuar në internet për monitorimin e RAP-it është ndërtuar dhe testuar, por ende nuk funksionon në mënyrë efektive.

#### Zhvillimi dhe koordinimi i politikave

Lidhur me **sistemin e politikëbërjes**, qeveria miratoi Strategjinë dhe Kombëtar për Zhvillim dhe Planin e Veprimit 2023-2029 (SKZH/PKZH), e cila përcakton prioritetet afatgjata dhe afatshkurtra, duke mbuluar aktivitetet në një bazë të përhershme trevjeçare. Nuk ka lidhje të qarta ndërmjet PPZH/SKZH-së dhe strategjive sektoriale dhe planeve të tyre përkatëse të veprimit, ose me kuadrin afatmesëm të shpenzimeve. Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS) është përgjegjëse për planifikimin, monitorimin dhe raportimin rreth strategjive si dhe vlerësimin e ndikimit të paraparë. Kapacitetet e ZPS-së duhet të forcohen më tej.

Kosova ka arritur progres të kufizuar në **integrimin gjinor, si dhe në zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në fakte**. Rregullorja e Punës e Qeverisë është ende në konsultim. Ekzistojnë procedura për vlerësimin e ndikimit rregullator; megjithatë, zbatimi mbetet i dobët. Institucionet publike duhet të nxisin pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse. Përkundër faktit se pothuajse të gjitha projektligjet primare dhe dokumentet e politikave publikohen rregullisht në ueb portalin qeveritar, konsultimet publike dhe përfshirja e publikut në agjendat e reformave mbeten të kufizuara dhe duhen përmirësuar. Përfshirja e shoqërisë civile, palëve të interesit dhe publikut në politikat e qeverisë dhe proceset e zhvillimit legjislativ mbetet e kufizuar.

### Menaxhimi i Financave Publike

Strategjia e re për menaxhimin e financave publike (MFP) (2022-2026) u miratua në dhjetor të vitit 2022. Raporti i monitorimit të MPF-së për vitin 2022 u miratua në korrik 2023. Është miratuar koncepti i ligjit të ri për MFP dhe llogaridhënie dhe është duke vazhduar puna përgatitore legjislative. Ligji i ri duhet të parashohë një lidhje më të mirë ndërmjet planifikimit të politikave dhe procesit të buxhetimit në periudhën vjetore dhe afatmesme. Një hap i parë ishte integrimi i prioriteteve të politikave afatmesme në kornizën afatmesme të shpenzimeve të miratuar në prill 2023. Në përgjithësi, sistemi i klasifikimit të buxhetit të Kosovës për financat publike mbetet në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Rreziqet fiskale të përfshira në detyrimet kontingjente, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, janë ende një dobësi dhe këto rreziqe nuk identifikohen në mënyrë sistematike. Kosova ka nevojë për të përmirësuar planifikimin dhe shpenzimin e investimeve kapitale duke përmirësuar zbatimin e **investimeve publike afatgjata** nëpërmjet një vlerësimi të qartë të kostove dhe përfitimeve si bazë për vendimet e investimeve. Duhet të sigurohet një lidhje më e mirë ndërmjet programit të investimeve publike dhe Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës, si dhe forcimi i mëtutjeshëm i besueshmërisë dhe saktësisë së planeve afatmesme buxhetore të të hyrave dhe shpenzimeve. Sistemet buxhetore duhet të përfshijnë objektiva drejt barazisë gjinore dhe tregues të të dhënave të ndara sipas gjinisë me objektiva specifike.

Sa i përket **prokurimit publik**, kontrollet e menaxhimit të kontratave dhe zotimeve mbeten të dobëta. Platforma e prokurimit elektronik e qeverisë nuk është ende e lidhur me sistemin informativ për menaxhimin financiar në Thesar. Në lidhje me **transparencën e buxhetit**, buxhetet miqësore ndaj qytetarëve dhe raportet e zbatimit të buxhetit publikohen rregullisht (*shih kapitujt për prokurimin publik, tatimin, doganën dhe kontrollin financiar*).

### Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore

Ligji për zyrtarët publikë i vitit 2020 parashih **punësimin, avancimin dhe shkarkimin e bazuar në merita**, por nuk është zbatuar në mënyrë efektive. Në veçanti, mungon një sistem i centralizuar për punësim të bazuar në merita për kategorinë profesionale. Gjithashtu, sektori publik nuk ka arritur të plotësojë vendet e lira në mënyrë efektive ose në kohë, duke rezultuar në dobësi të mëdha në kapacitetet administrative. Përdorimi më masë të gjerë i pozitave të ushtruesit të detyrës në shërbimin civil, veçanërisht në nivelet e larta drejtuese, si dhe

procedurat joefektive të rekrutimit të jashtëm për drejtuesit e lartë kanë dëmton cilësinë e menaxhimit në institucione. Ligji për zyrtarët publikë u ndryshua në fund të vitit 2022, duke sjellë ndryshime thelbësore sistematike. Për rrjedhojë, ligji i rishikuar u pezullua në pritje të shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese, e cila konstatoi se disa nga dispozitat ishin jokushtetuese. Ka ndryshime të tjera, të cilat, nëse zbatohen, rrezikojnë dobësimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative të shërbimit civil. Veçanërisht futja e propozuar e mandateve me afat të caktuar në të gjitha nivelet drejtuese e vë në rrezik stabilitetin dhe profesionalizimin e shërbimit civil.

Gratë mbeten të nën-përfaqësuara në pozitat e nivelit të lartë në shërbimin civil. Duhet të merren masa për të rritur numrin e grave në pozita të larta në përputhje me Ligjin për barazi gjinore.

Kapaciteti i MPB-së për të menaxhuar zbatimin e një **politike të menaxhimit të burimeve njerëzore** në të gjithë administratën publike nuk është ngritur. Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (DMPZ), së bashku me njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucioneve, duhet: (i) të përmirësojnë koordinimin e tyre; (ii) të sigurojnë trajnime të rregullta; (iii) të promovojnë transferimin e njohurive; dhe (iv) të shpërndajnë/promovojnë mjete metodologjike. Sistemi i mbledhjes së të dhënave përmes sistemit të informacionit të menaxhimit të brendshëm të burimeve njerëzore (MBNJ) mbulon modulet për kategoritë e nëpunësve civilë, punësimin, kompensimin dhe avancimin. Megjithatë, ky mjet nuk përdoret në mënyrë efektive nga shërbimi civil për të monitoruar performancën e MBNJ-së dhe sistemi ka nevojë për përditësim dhe përmirësim të mëtejshëm. Transparenca në MBNJ-së duhet të përmirësohet, megjithëse publiku mund të ketë disa informacione përmes një faqeje të internetit të dedikuar për aplikime dhe takime. Avancimi në finalizimin e rregulloreve për organizimin e brendshme të institucioneve shtetërore - përfshirë ministritë - dhe harmonizimi me Ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (LOFASHAP) ka qenë i ngadalshëm. Kjo ka dobësuar më tej menaxhimin dhe planifikimin e burimeve njerëzore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në mënyrë efektive po e ushtron mandatin e tij për vendosjen e ankesave dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit në lidhje me shërbimin civil. Ndryshimet e planifikuara në ligjin që rregullon këshillin kufizojnë disa nga kompetencat e Bordit për të shqyrtuar dhe vendosur për ankesat dhe nuk garantojnë pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe parimet që rregullojnë shërbimin civil.

Ligji i ri për pagat ndihmoi në përcaktimin e një **strukture** më të qartë dhe transparente të **kompensimit** për të gjithë punonjësit publikë. Megjithatë, Ligji për pagat është aktualisht në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese. Disa nivele pagash nuk bazohen në vlerësim të plotë të kërkesave për punë për shkak të vonësve në finalizimin e klasifikimit të vendeve të punës dhe riorganizimit të pozitave sipas kategorive të punës. Si rrjedhojë, pa kushtet e duhura për menaxhimin e burimeve njerëzore, ligji i ri, edhe nëse zbatohet, rrezikon të mos sigurojë një sistem të drejtë kompensimi.

Nuk ekziston një qasje sistematike ndaj **zhvillim profesional** të nëpunësve civilë. Trajnimi si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal varet kryesisht nga mbështetja e donatorëve. Pavarësisht udhëzimeve praktike për vlerësimin e performancës së nëpunësve civilë dhe trajnimeve të ofruara për DMZP-në dhe njësitë e MBNJ-së, sistemi për menaxhimin e performancës mbetet joefektiv. Një program i trajnimit të detyrueshëm i përcaktuar me Ligjin për zyrtarët publikë për të gjithë nëpunësit civilë është zhvilluar në vitin 2022, por ende nuk është zbatuar.

Sfidë mbetet **integriteti në shërbimin publik**. Disa institucioneve ende ju mungojnë planet e integritetit dhe zbatimi i këtyre planeve është joefektiv. Ligji për konfliktin e interesit dhe ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve duhet të zbatohen në mënyrë koherente dhe efikase në të gjithë administratën publike.

#### Llogaridhënia e administratës

Zbatimi i LOFASHAP-së mbetet i ngadaltë, ku kapaciteti i MPB-së për të udhëhequr dhe drejtuar procesin e zbatimit është ende joefektiv. Nuk ka linja të qarta të llogaridhënies menaxheriale dhe asnjë delegim të qartë të kompetencave ndërmjet ministrive dhe organeve vartëse. Si rezultat, ka shumë agjenci ekzekutive në varësi të Kuvendit ose të ministrive të linjës, por pa procedura të qarta raportimi. Janë miratuar Ligji për racionalizimin dhe vendosjen e linjave llogaridhëse të agjencive të pavarura (vala e parë) dhe Ligji për racionalizimin dhe vendosjen e linjave llogaridhëse të agjencive ekzekutive (vala e dytë). Përveç kësaj, qeveria ka miratuar një metodologji për racionalizimin e agjencive, e cila duhet të mbështesë llogaridhënien dhe mbikëqyrjen e organeve në varësi të ekzekutivit. Sistemi për menaxhimin e performancës së agjencive nuk është vendosur për shkak të vonësës në finalizimin e strukturës organizative të ministrive të linjës.

Rekomandimet nga mekanizmat e mbikëqyrjes ende implementohen dobët. Sfidë mbetet disponueshmëria dhe sigurimi i informacionit dhe dokumenteve nga institucionet publike. Aktualisht, sistemi për ofrimin e qasjes në këto informacione dhe këto dokumente nuk funksionon mirë.

Korniza legjislative që rregullon qasjen në drejtësinë administrative është duke u rishikuar në përputhje me praktikat ndërkombëtare, dhe qasja në drejtësi ka vazhduar të jetë joefikase për shkak të vonësave në shqyrtimin e rasteve nga gjykata themelore dhe gjykata e apelit në Prishtinë. Legjislacioni i fragmentuar ndikon në përgjegjësinë e autoriteteve publike në rastet e keqberjes dhe **të drejtës për të kërkuar dëmshpërblim**.

#### Ofrimi i shërbimeve për bizneset dhe publikun

Programi për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative (2022-2027) është duke u zbatuar. Është hartuar një listë e shërbimeve publike në nivel qendror dhe lokal së bashku me analizat se si këto shërbime do të digjitalizohen. Është arritur njëfarë progresi me miratimin e një ligji omnibus nga Kuvendi që mbulon harmonizimin e ligjeve specifike sektoriale me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative. Përveç kësaj, qeveria miratoi një plan të veprimit për të harmonizuar dhe përafruar më tej ligjet specifike sektoriale me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative.

Portali qeveritar e-Kosovo përmirësoi më tej ofrimin e shërbimeve online për publikun duke përfshirë më shumë shërbime në katalogun elektronik. Megjithatë, cilësia dhe besueshmëria e të dhënave në këtë portal mbetet sfidë. Menaxhimi i strukturave teknike për qeverisjen elektronike është ende i varur nga mbështetja e donatorëve. Për të thjeshtuar dhe digjitalizuar shërbimet publike, duhet të krijohen procese dhe sisteme efikase të qeverisjes elektronike për të garantuar konsistencë në hartimin dhe mirëmbajtjen e zgjidhjeve digjitale dhe për të garantuar ndërveprimin, qëndrueshmërinë dhe sigurinë e këtyre zgjidhjeve. Draft strategjia për qeverisje elektronike ende nuk është miratuar. Pasi që reformat në këtë fushat janë të përgjithshme dhe prekin të gjitha fushat e administratës publike, nevojitet ngritja e një mekanizmi koordinues ndër-institucional nën drejtimin e Zyrës së Kryeministrit.

## **2.2. SUNDIMI I LIGJIT DHE TË DREJTAT THEMELORE**

### **2.2.1. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore**



Vlerat themeluese të BE-së përfshijnë sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Një sistem gjyqësor efektiv (i pavarur, me cilësi të lartë dhe efikas) dhe lufta efektive kundër korrupsionit janë të një rëndësie të jashtëzakonshme, siç është respektimi i të drejtave themelore në ligj dhe në praktikë.

Kosova gjendet **ndërmjet një faze të hershme dhe njëfarë niveli të përgatitjes** për zbatimin e *acquis* të BE-së dhe standardeve evropiane në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore. Është arritur **progres i kufizuar** në këtë fushë. Janë vërejtur disa përmirësime në funksionimin e gjyqësorit, si dhe në hetimin dhe ndjekjen penale në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë. Duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të forcuar lirinë e shprehjes.

### Funksionimi i gjyqësorit

Kosova është në **fazën e hershme** të zhvillimit të një sistemi gjyqësor që funksionon mirë. Gjatë periudhës raportuese, Kosova ka arritur **progres të kufizuar**, pavarësisht rritjes së raportit të seancave gjyqësore produktive, ritmit më të shpejtë të caktimit të seancave gjyqësore dhe përmirësimeve në rekrutimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Situata e burimeve njerëzore dhe organizimi i administratës në tërë gjyqësorin mbetet e prekur nga joefikasiteti. Është krijuar Sistemi Kombëtar Qendror i Evidencës Penale dhe është i qasshëm në internet që nga dhjetori 2022, duke i mundësuar publikut të marrë certifikatat e evidencës penale online. Vendimi i qeverisë për uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe ligji pasues për pagat ngritën shqetësime në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit. Në mars 2023, Ministria e Drejtësisë dhe krerët e institucioneve kryesore të sistemit të drejtësisë nënshkruan një deklaratë të angazhimit të përbashkët për reformat në drejtësi, duke pasqyruar çështjet më të rëndësishme të reformës që duhen trajtuar. Nevojiten veprime të shpejta për të arritur rezultate të prekshme. Në shtator të vitit 2022, qeveria i dorëzoi Kuvendit dosjen lidhur me kontrollin e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili krijoi një komisioni *ad hoc* për të finalizuar ndryshimet kushtetuese dhe legjislacionin përkatës për kontrollin e integritetit të posteve të larta brenda sistemit të drejtësisë, në përputhje me Opinionin e Komisionit të Venecias të qershorit të vitit 2022. Kosova duhet të sigurojë që Komisioni i Venecias të rikonsultohet gjatë gjithë procesit të finalizimit të projekt ndryshimeve kushtetuese dhe legjislacionit përkatës lidhur me reformën në drejtësi. Është thelbësore që reforma në drejtësi të fokusohet në forcimin e mjeteve ekzistuese për të mbrojtur integritetin, llogaridhënien, pavarësinë dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë, në përputhje me rekomandimet e Opinionit të Komisionit të Venecias dhe standardet përkatëse evropiane. Kosova duhet të sigurojë që udhëzimet e Komisionit të Venecias për ndryshimet në Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës të inkorporohen në mënyrë të duhur në ligjin e ri. Përpjekjet duhet të vazhdojnë për të përdorur plotësisht Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve, për të promovuar më tej mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe për të siguruar të dhëna statistikore të besueshme. Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë përmbushur vetëm pjesërisht dhe për këtë arsye mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

- të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga deklarata e angazhimit të përbashkët e nënshkruar nga krerët e institucioneve të sistemit të drejtësisë, me fokus të veçantë në përmirësimin e integritetit, llogaridhënies dhe efikasitetit të gjyqësorit;
- të shtojë e përpjekjeve për të zvogëluar numrin e lëndëve të grumbulluara, bazuar në një plan të qartë të veprimit me auditime dhe kontroll të brendshëm të mbështetur nga strategjia për digjitalizim. Për këtë qëllim, Kosova duhet të reformojë administratën e gjykatës dhe prokurorisë dhe të forcojë funksionet e menaxhimit në gjyqësor dhe prokurori për të siguruar shfrytëzim efikas të burimeve;

→ të përmirësojë kapacitetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për të trajtuar rastet e dhunës me bazë gjinore në përputhje me ligjet, strategjinë 2022-2026 kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe Protokollin e ri të Shtetit për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale.

### Dokumentet strategjike

Strategjia për sundimin e ligjit dhe plani i veprimit vazhdojnë të zbatohen me ritme të ngadalta. Megjithatë, raporti vjetor i zbatimit i prillit 2023 theksoi një sërë zhvillimesh pozitive, duke përfshirë: krijimin e Gjykatës Komerciale; rritjen në rekrutimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve; avancimin i Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve në përputhje me kërkesat e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ); caktimin automatik të çështjeve tek gjyqtarët; dhe forcimin e ndihmës juridike falas. Sa i përket rreziqeve, raporti përmend mungesën e prioriteteve të realizimit të aktiviteteve dhe mungesën e kapaciteteve, buxhetit dhe bashkëpunimit ndër-institucional.

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) përditësojnë rregullisht **planet strategjike**, dhe përcaktojnë objektivat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial përkatësisht. Të dy Këshillat miratuan planet vjetore të veprimit. Gjatë periudhës së mëparshme raportuese, KGJK miratoi planin strategjik për zgjidhjen efikase të rasteve të korrupsionit dhe krimin të organizuar, strategjinë e komunikimit për periudhën 2022-2024 si dhe planin strategjik për qasje në drejtësi për periudhën 2022-2025. Po ashtu ka themeluar një komision që synon të mbikëqyrë zbatimin e strategjisë së tij për rastet e korrupsionit. KPK ka miratuar planin strategjik 2022-2024 të sistemit prokurorial. Sistemi prokurorial kërkon një reformë urgjente të strukturës së administrimit dhe menaxhimit. Kosova duhet të shtojë përpjekjet e saj për të siguruar koordinimin e duhur të donatorëve në lidhje me mbështetjen për sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Në mars 2023, deklarata e angazhimit të përbashkët dhe plani i veprimit për reformat në drejtësi ishin nënshkruar nga Ministria e Drejtësisë, KGJK, KPK, Gjykata Supreme dhe ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. Planin e veprimit parashikon një sërë vlerësimesh dhe rishikimesh legislative për të përmirësuar sistemet e vlerësimit të performancës, sanksionet disiplinore, rekrutimet dhe emërimet, kontrollet e integritetit, statusin, zhvillimin profesional dhe deklarinimin e pasurisë. Janë formuar grupe punuese për të mbuluar secilën nga këto fusha.

### Organet drejtuese

KGJK dhe KPK janë organet kryesore përgjegjëse për sigurimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit dhe për menaxhimin e sistemit gjyqësor dhe karrierës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Përbërja e tyre dhe procedurat e emërimit janë kryesisht në përputhje me standardet evropiane.

Më 23 qershor 2022, Kuvendi miratoi ndryshimet në Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, duke synuar uljen e korporatizimit, për shembull, duke ndryshuar përbërjen e vetë Këshillit. Komisioni i Venecias dha dy opinione për draftet, të cilat Kuvendi i adresoi para miratimit të ndryshimeve në draft. Një numër deputetësh i kanë dorëzuar për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese ndryshimet e miratuara në korrik të vitit 2022. Më 24 mars 2023, Gjykata Kushtetuese mori vendim duke e shpallur tërësisht të pavlefshëm ligjin ndryshues. Gjykata konstatoi se ligji cenonte pavarësinë kushtetuese të KPK-së në disa aspekte, si dhe parimet e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit dhe ekuilibrit ndërmjet organeve kushtetuese. Pas vendimit, ligji është në rishikim. Kosova duhet të sigurojë që udhëzimet e Komisionit të Venecias për ndryshimet në Ligjin për KPK-në të inkorporohen në mënyrë të duhur.

Emërimi i Kryeprokurorit të Shtetit është në pritje që nga prilli i vitit 2022 dhe është i vonuar. BE-ja dhe akterët tjerë ndërkombëtarë, si dhe shoqëria civile, shprehën publikisht zhgënjimin për mungesën e drejtësisë, transparencës dhe parimeve të meritës në procesin e përzgjedhjes. Procedurat e stërzgjatura kanë shkaktuar një gjendje paqartësie, e cila ul funksionimin e

institucioneve. Kuvendi duhet të shtojë përpjekjet për të siguruar emërimin më kohë të anëtarëve të Këshillit, pasi ka vonesa të vazhdueshme. Këshillat duhet të përdorin statistikën në dispozicion për analiza dhe zhvillim të politikave.

Dorëheqjet masive të zyrtarëve serbë të Kosovës nga institucionet publike në nëntor të vitit 2022 përfshinin edhe dorëheqjet e gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ serb të Kosovës që punonin në veri të Kosovës. KGJK dhe KPK vendosën të shtyjnë çdo vendim për dorëheqjet e tilla, në pritje të zhvillimeve të tjera. Në të njëjtën kohë, të dy Këshillat morën masa për të siguruar procedimin e lëndëve, veçanërisht të atyre që kërkojnë veprim urgjent. Kosova duhet vazhdimisht të sigurojë që procedurat gjyqësore të jenë të qasshme në të gjitha gjuhët zyrtare, siç kërkohet në Kushtetutë. Janë punësuar përkthyes të tjerë gjyqësorë dhe KGJK është në proces të zhvillimit të një platforme për centralizimin e përkthimeve në gjykata. Megjithatë, nevojiten më shumë përpjekje për të adresuar mungesën e përkthyesve të kualifikuar, duke pasur për qëllim reduktimin e numrit të lëndëve të grumbulluara. Qasja në aktgjykimet dhe vendimet e nxjerra nga gjykatat serbe në Kosovë nga viti 1999 e deri në integrimin e gjyqtarëve serbë në tetor të vitit 2017 mbetet sfiduese.

### Pavarësia dhe paanshmëria

Kushtetuta dhe korniza ligjor në fuqi përcaktojnë parimet e **pavarësinë dhe paanshmërinë**. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të siguruar respektimin e këtyre parimeve në praktikë dhe për të mbrojtur në mënyrë efektive sistemin gjyqësor nga presioni dhe ndërhyrjet e panevojshme. Këshillat duhet të sigurojnë reagim të menjëhershëm në të gjitha rastet e ndërhyrjeve të supozuara të padrejta. Vendimi i qeverisë i nëntorit të vitit 2022 për uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe Ligji për pagat, me të njëjtin efekt, ngritën shqetësime për pavarësinë e gjyqësorit.

Korniza rregullator parasheh **caktimin e rastësishëm të shumicës së lëndëve** nëpërmjet sistemit informativ për menaxhimin e lëndëve, me përjashtim të lëndëve të Gjykatës Komerciale të sapokrijuar, të cilat nuk janë përfshirë ende. Në praktikë, është vërejtur përmirësim. Megjithatë, një numër i lëndëve mbeten të caktuara në mënyrë manuale, duke krijuar shqetësime. Kjo ndodh veçanërisht kur gjyqtari nuk është në dispozicion ose kur ka ndryshim të juridiksionit të gjykatës. Kryetarët e gjykatave duhet të ndjekin rregullin që çdo devijim nga caktimi i rastësishëm i lëndëve duhet të justifikohet shprehimisht dhe të dokumentohet në mënyrë transparente. Trajtimi me kohë i disa rasteve të profilit të lartë dhe të ndjeshëm mbetet sfidë. Kjo është për shkak të përdorimit të shtyrjeve të gjata, mekanizmave të papërshtatshëm për të shmangur stërzgjatjen e rasteve, mungesës së mjeteve juridike efektive kur kohëzgjatja e gjykimeve shkon përtej një kohe të arsyeshme dhe menaxhimit të pamjaftueshëm të rasteve.

Gjatë periudhës raportuese, tre prokurorë dhe një gjyqtar kërkuan mbrojtje të afërt nga policia. Pas vlerësimit të rrezikut, vetëm një prokurori iu ofrua mbrojtje.

### Llogaridhënia

Derisa **kodet e etikës** pasi gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët janë në dispozicion, autoritetet duhet të sigurojnë vazhdimisht zbatimin efektiv të tyre. Etika profesionale është pjesë e programit të trajnimit fillestar për gjyqtarët, prokurorët dhe stafin mbështetës.

KGJK themeloi Komitetin Këshillëdhënës për Etikën Gjyqësore dhe miratoi një rregullore për procedurat disiplinore kundër anëtarëve të KGJK-së. Të dy Këshillat vazhdojnë të zhvillojnë **procedura disiplinore** kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Këshillat duhet të sigurojnë procedura strikte dhe efikase në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe masat mbrojtëse të nevojshme procedurale. Ndërkohë që po bëhen përpjekje, nevojitet më shumë punë për të siguruar zbatimin e qëndrueshëm dhe efektiv të procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për shembull, strategjia e komunikimit e KPK-së dhe KGJK-së për procedurat duhet të përmirësohet

më tej, duhet të forcohet trajnimi dhe Ligji për përgjegjësitë disiplinore duhet të ndryshohet, për të mundësuar specializimin e mëtejshëm të organeve hetimore. Gjatë periudhës raportuese, KGJK ka krijuar një bazë elektronike të të dhënave për të regjistruar të gjitha ankesat dhe kërkesat për fillimin e hetimeve disiplinore siç kërkohet me ligj.

Sipas ligjit, gjyqtarët dhe prokurorët janë të detyruar që **deklarojnë pasurinë e tyre** dhe dhuratat e marra, dhe të raportojnë për çdo **konflikt** të mundshëm të **interesit** në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Në vitin 2022, të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët kanë dorëzuar më kohë deklaratat vjetore të pasurisë (*shih luftën kundër korrupsionit*).

Pas Opinionit të Komisionit të Venecias të qershorit të vitit 2022 për Koncept Dokumentin për zhvillimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë së Kosovës, në shtator të vitit 2022, qeveria ia dorëzoi Kuvendit përgjegjësinë për udhëheqjen e procesit dhe shkresat përkatëse. Shkresat përmbajnë, ndër të tjera, projekt ndryshimet kushtetuese dhe një projektligj për kontrollin e integritetit. Në dhjetor të vitit 2022, Kuvendi themeloi një komision ad hoc i cili finalizoi ndryshimet kushtetuese. Përfaqësuesit e *Lista Srpska* nuk marrin pjesë në këtë komision, pasi vazhdojnë të bojkotojnë punimet e Kuvendit. Në mars, Kryetari i Kuvendit ia ka dorëzuar Gjykatës Kushtetuese për shqyrtim ndryshimet kushtetuese. Kosova duhet të përafrohet plotësisht me rekomandimet e Komisionit të Venecias, duke përfshirë nevojën për të shqyrtuar masa të mëtejshme alternative në vend të vetingut në shkallë të gjerë. Këto duhet të përfshijnë, nëpërmjet ndryshimeve legjislative, krijimin e “njësive verifikuese” brenda Këshillave, përdorimin më aktiv të deklaratave të pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve, sigurimin e kryerjes së kontrolleve të duhura dhe që parregullsitë në deklarin e pasurisë të sjellin përfundimisht masa disiplinore domethënëse. Mund të vendosen gjithashtu kontrolle të integritetit për institucionet e nivelit të lartë gjyqësor (në veçanti Këshillat). Këta janë shembuj të masave të mundshme që mund të forcojnë në mënyrë efektive pavarësinë dhe llogaridhënien e sistemit gjyqësor përmes ndryshimeve të synuara legjislative. Kosova duhet të vazhdojë dialogun në fazat e ardhshme të reformës së paraparë në drejtësi, si me Komisionin e Venecias (duke përfshirë rikonsultimin për çdo ndryshim kushtetues dhe legjislativ në lidhje me kontrollin e integritetit), ashtu edhe me Komisionin Evropian. Duhet të vazhdojnë gjithashtu edhe konsultimet me të gjitha palët e brendshme përkatës të interesit. Përfundimisht, çdo reformë që synon përmirësimin e cilësisë dhe pavarësisë së sistemit duhet të përfshijë masa zbutëse për të parandaluar çdo përkeqësim të efikasitetit në tërë sistemin gjyqësor.

### Profesionalizmi dhe kompetenca

Këshillat organizojnë në mënyrë të pavarur **procedurat e rekrutimit për gjyqtarët dhe prokurorët**, në bazë të kriterëve të bazuara në merita. Kandidatët e suksesshëm emërohen nga Presidenti i Republikës për një mandat fillestar trevjeçar, në bazë të propozimeve të Këshillave. Gjatë periudhës raportuese, KGJK ka iniciuar procesin e rekrutimit për 84 gjyqtarë, duke përfshirë 12 pozita për komunitetin serb të Kosovës. Presidentja ka dekretuar 77 gjyqtarë, nga të cilët 3 janë serbë të Kosovës dhe 2 boshnjakë. Nga pozitat e rezervuara për komunitetin serb, 5 pozita mbeten të paplotësuara. Në qershor 2023, Presidentja emëroi Kryetarin e Gjykatës Supreme. KGJK ka rekrutuar një numër të konsiderueshëm të bashkëpunëtorëve profesionalë për të mbështetur punën në Gjykatat Themelore dhe ka certifikuar 1 401 ekspertë gjyqësorë. Çdo iniciativë në këtë drejtim duhet të koordinohet siç duhet ndërmjet institucioneve përkatëse. Gjatë periudhës raportuese, KPK ka iniciuar 2 procese të rekrutimit për prokurorë të rinj, të cilat rezultuan me emërimin e 29 kandidatëve nga Presidentja. Procesi i përgjithshëm i emërimit dhe riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve pas mandatit fillestar të tyre duhet të jetë në përputhje të plotë me parimet kushtetuese të funksionimit të pavarur të gjyqësorit dhe sistemit prokurorial.

Këshillat duhet të bëjnë **vlerësimet e performancës** së prokurorëve dhe gjyqtarëve me mandat të përhershëm çdo 3 vjet. Të dy Këshillat kanë bërë përpjekje për të rregulluar procesin e vlerësimit

të performancës ndër vite. Pavarësisht kësaj, problemet vazhdojnë të ekzistojnë, duke përfshirë nevojën për të përmirësuar zbatimin e kornizës rregullatore dhe për të rritur llogaridhënien menaxheriale. Nevojiten veprime të mëtejshme për të adresuar performancën e dobët nga gjyqtarët dhe prokurorët. Të dy Këshillat duhet të sigurojnë vlerësime të drejta dhe objektive të performancës bazuar në kriteret e qarta.

Një numër i rasteve të femicidit ngritën çështje në lidhje me rolin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajtimin e rasteve të **dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore**. Pasi që ishin përhapur akuza për dështim në mbrojtjen e viktimave dhe mungesën e llogaridhënies së akterëve të drejtësisë, Ministria e Drejtësisë propozoi ndryshime në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale. Megjithatë, këto ndryshime duhet të sigurojnë masa mbrojtëse të duhura për të dyshuarit apo të dënuarit për kryerje të dhunës në familje dhe veprave të dhunës me bazë gjinore. Trajtimi, ndjekja penale dhe gjykimi i rasteve është ende i papërshtatshëm. Janë emëruar prokurorë dhe gjyqtarë të specializuar, por mungesa e burimeve njerëzore ngadalëson caktimin e prioritetëve. Kohëzgjatja e rasteve që nga angazhimi deri në momentin e nxjerrjes së aktgjykimit është ende e gjatë. Përveç kësaj, viktimat shpesh nuk përfaqësohen. Gjyqtarët dhe prokurorët kanë nevojë për trajnime të mëtejshme për të kuptuar rolin e tyre dhe për të marrë përgjegjësitë. Në një vendim historik, në mars 2023, Gjykata Kushtetuese konfirmoi dështimin e institucioneve shtetërore në mbrojtjen e një viktime të dhunës në familje.

### Cilësia e drejtësisë

Akademia e Drejtësisë është përgjegjëse për ofrimin e **trajnitimit** fillestar dhe gjatë shërbimit për të gjithë profesionistët ligjorë. Buxheti i Akademisë është i pamjaftueshëm, gjë që ndikon në cilësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe cilësinë e trajnimeve. Buxheti total i ndarë për iniciativat e trajnitimit në Akademi në vitin 2022 arriti në 687 156 euro (buxheti për banor ishte 0,39 euro, duke u rritur nga 0,30 euro në vitin 2020). Ligji për Akademinë u ndryshua në vitin 2022, duke adresuar çështjen e pavarësisë dhe mbikëqyrjes së Akademisë. Nevojitet trajnim i mëtejshëm në shërbim për etikën, integritetin dhe aftësitë profesionale, veçanërisht në menaxhim, TIK/administrim dhe analizën e jurisprudencës/praktikës gjyqësore. Linjat e mbikëqyrjes dhe raportimit të Akademisë duhet të forcohen në përputhje me praktikën më të mira evropiane.

Në përgjithësi, niveli i **profesionalizmit dhe kompetencës**, veçanërisht i prokurorëve, ka vazhduar të mbetet çështje shqetësuese, pavarësisht përpjekjeve për të rritur trajnimin në dispozicion.

Sa i përket **jurisprudencës**, Kosova ka arritur progres të mëtejshëm në obligimin ligjor për të gjitha gjykatat që të publikojnë vendimet e tyre në një ueb portal të qasshëm dhe të kërkueshëm brenda 60 ditëve. Ndonëse ka pasur përmirësime në publikimin e aktgjyqimeve, publikimi i tyre më kohë dhe në mënyrë të konsistente do të ketë nevojë për auditim dhe kontroll të brendshëm të përmirësuar. Përveç kësaj, edhe pse versionet në gjuhën shqipe janë të publikuara, jo të gjitha gjykatat respektojnë kërkesat e Ligjit për gjuhët për t'i publikuar ato në të dyja gjuhët zyrtare. KGJK ka miratuar publikimin e vendimeve të kryetarëve të gjykatave lidhur me ankesat ndaj gjyqtarëve nga ana e publikut, si dhe publikimin e raporteve të rregullta për punën e gjyqtarëve. Prokuroritë publikojnë brenda 24 orëve informata relevante për aktakuzat në faqen e internetit të Prokurorit të Shtetit. Akademia e Drejtësisë mban një bazë të të dhënave të legjislacionit, komenteve dhe materialeve të tjera ligjore të qasshme për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët.

Në vitin 2022, Kosova kishte 443 pozita të gjyqtarëve me normë të plotë (155 gra dhe 288 burra), 24.4 për 100 000 banorë dhe 198 pozita të prokurorëve me normë të plotë (82 gra dhe 116 burra), 10.9 për 100 000 banorë. Sipas Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), mesatarja evropiane është 22.2 dhe 11.8 prokurorë për 100 000 banorë. Kosova ende ka një përqindje të ulët të gjyqtarëve dhe prokurorëve **femra** në krahasim me shumicën e vendeve të tjera

evropiane. Gjykata Funktionale, funksionale që nga gushti i vitit 2022, tashmë ka 18 gjyqtarë të emëruar, siç ishte planifikuar t'i ketë në total. Në korrik të vitit 2022, 6 754 lëndë u transferuan në dhomat e shkallës së parë të Gjykatës Komerciale dhe 1 342 lëndë në dhomën e shkallës së dytë.

Numri i **bashkëpunëtorëve profesional** në të gjitha gjykatat e Kosovës u rrit ndjeshëm në vitin 2022, duke përfshirë një numër të madh të bashkëpunëtorëve femra. Numri i personelit ligjor dhe administrativ që ndihmon drejtpërdrejt gjyqtarët dhe prokurorët mbetet sfidë sa i përket efikasitetit dhe cilësisë së stafit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore. Planifikimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore duhet të fokusohet në cilësinë e stafit ligjor dhe administrativ e jo thjesht në numrin e madh të tyre. Një numër konkursesha kanë mbetur të paplotësuara pasi Kuvendi nuk miratoi kërkesën e plotë të buxhetit të gjyqësorit për vitin 2023.

**Buxheti i miratuar për gjyqësorin** për vitin 2022 ishte rreth 48.9 milionë euro (një rritje prej 15.6% nga viti 2021), ekuivalent me 27 euro për banor. 17.9 milionë euro shtesë u ndanë për shërbimin sprovues dhe shërbimin korrektues.

Për **mjetet e drejtësisë elektronike**, Sistemi Informativ i Menaxhimit të Lëndëve (SMIL) zbatohet pothuajse në të gjitha gjykatat, përfshirë Gjykatën Supreme, duke rezultuar në përmirësimin e efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës. Sistemi ende nuk është vendosur në Gjykatën Komerciale të sapokrijuar<sup>4</sup>. Disa gjykata ende aplikojnë një regjistër manual të lëndëve, edhe pse vetëm për qëllime të brendshme dhe jo si sistem paralel i regjistrimit të lëndëve. Librat manual të regjistrimit nuk ndahen më dhe përfundimisht do të eliminohen. SMIL-i është planifikuar të qëndrojë në një fazë tranzicioni deri në maj të vitit 2025, dhe qëllimi përfundimtar është që të sigurohet përdorimin optimal i sistemit në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë. KGJK është në proces të zhvillimit të sistemit elektronik të dosjeve për gjyqtarë.

Për prokurorinë, zbatimi i SMIL-it mbetet sfidë. Përderisa zyrtarisht, të gjitha Prokuroritë Themelore përdorin SMIL-in, disa raste ende trajtohen në mënyrë manuale. Bazuar në një vendim të marsit 2023, KPK ka prezantuar një metodologji të re të TIK/menaxhimit për të eliminuar trajtimin manual të lëndëve. Përdorimi i vazhdueshëm i sistemit duhet të inkurajohet nga menaxhmenti për të siguruar që sistemi të zbatohet në mënyrë sistematike dhe që të dhënat e futura janë të sakta. Kjo është e një rëndësie të veçantë për të siguruar besueshmërinë e të dhënave statistikore të marra automatikisht lidhur me performancën e gjyqësorit dhe prokurorisë (në përputhje me rekomandimet dhe metodologjinë e CEPEJ). Stafi administrativ ka nevojë për trajnime të mëtejshme për të siguruar përdorim të qëndrueshëm dhe saktësi të të dhënave.

Si një hap pozitiv, Sistemi Qendror i Evidencës Penale (SQEP) u krijua dhe është i qasshëm online që nga dhjetori 2022, duke i mundur publikut të aplikojë dhe të marrë certifikatat e evidencës penale online. Megjithatë, KGJK-ja dhe gjykatat duhet të sigurojnë qëndrueshmërinë e sistemit, duke përfshirë verifikimin e të dhënave të futura në SMIL, në mënyrë që vetëm të dhënat e verifikuara dhe të plota rreth dënimeve të futën në SQEP. Pasi të përmirësohet cilësia e të dhënave, të dy sistemet e TI-së do të bëhen të ndërveprueshme. Përderisa Ligji për SQEP është ende në Kuvend, SQEP funksionon në bazë të një rregulloreje që rrjedh nga Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Ekziston një mekanizëm gjurmues për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar, i cili aktualisht përfshin 88 raste. (*Shih pjesën për luftën kundër korrupsionit*)

**Sistemi i ndërmjetësimit** zbatohet nga KGJK dhe KPK dhe funksionon që nga viti 2008. Ende ka nevojë për një sistem monitorimi dhe vlerësimi për të vlerësuar ndikimin e përgjithshëm të shërbimeve të ndërmjetësimit, procedurat e caktimit dhe pranimit të lëndëve, si dhe ndikimin në

<sup>4</sup> SMIL-i është në përdorim në të tri nivelet e sistemit gjyqësor (Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme). Një nga karakteristikat kryesore të sistemit është caktimi automatik i lëndëve tek gjyqtarët, bazuar në kriteret e paracaktuara të miratuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës më 29 janar 2020. KGJK ka ndryshuar kriteret dhe ka futur kriteret e reja, të cilat aplikohen që nga 15 shkurti 2023.

reduktimin e lëndëve të pazgjidhura dhe të grumbulluara. Të dy Këshillat kanë miratuar rregullore dhe protokolle të brendshme për të mbështetur sistemin e ndërmjetësimit, por kanë vështirësi në ndarjen e buxhetit të duhur. Në vitin 2022, Gjykatat Themelore referuan 5 887 lëndë për ndërmjetësim dhe zgjidhën 2 426 lëndë, numër pak më i ulët se në vitin 2021 (3 119 lëndë të referuara për ndërmjetësim dhe 2 472 lëndë të zgjidhura).

Në vitin 2022, Prokuroria e Shtetit dhe prokuroritë kanë zgjidhur 1 769 lëndë duke përdorur procedura alternative, një rënie në krahasim me vitin 2021 (2 153). Numri i ndërmjetësuesve të licencuar mbeti i njëjtë, 190 (67 gra, 123 burra), prej të cilëve 14 ishin nga komunat me shumicë serbe. Sistemi i ndërmjetësimit ka nevojë për fuqizim; kjo mund të arrihet përmes zbatimit të plotë të Ligjit për ndërmjetësim dhe ndarjes së një buxheti të mjaftueshëm. Ministria e Drejtësisë ka miratuar dy udhëzime administrative për përmirësimin e sistemit të profesioneve të lira dhe rritjen e efikasitetit të përgjithshëm të sistemit gjyqësor. KGJK ka publikuar një protokoll për referimin e rasteve përkatëse civile për ndërmjetësim.

### Efikasiteti

Efikasiteti i sistemit gjyqësor është përmirësuar pak. Në vitin 2022, gjykatat e shkallës së parë për çështje civile/tregtare, administrative dhe penale kanë pranuar 63 229 lëndë të reja dhe shkalla e zgjidhjes ishte 76,06% (nga 70% në 2021). Gjatë vitit 2022, Gjykata Supreme ka pranuar 1 425 lëndë të reja, ndërsa gjykata ka zgjidhur 1 630 lëndë ose 114% (99% në vitin 2021). Gjatë vitit 2022, Gjykata e Apelit ka pranuar 13 075 lëndë të reja dhe ka zgjidhur 11 588 lëndë ose 88% (71% në vitin 2021). Nga 220 raste të parashtruar në Gjykatën Kushtetuese në vitin 2022 dhe 145 raste të bartura nga 2 vitet e fundit, Gjykata vendosi në 184 raste. Më sfidues është numri i rasteve të vjetra (të pazgjidhura për më shumë se tri vite). Në fillim të vitit 2022, ishin 49 110 raste të tilla, ndërsa në fund të vitit 2022 numri ishte 58 240. Sa i përket numrit të çështjeve civile, tregtare, administrative dhe të tjera të pazgjidhura (në shkallë të parë), gjatë vitit 2022, kanë mbetur të pazgjidhura 144 014 lëndë ose 8 lëndë për 100 banorë (nga 7 për 100 banorë në vitin 2021). Për numrin e çështjeve civile, tregtare, administrative dhe të tjera të pazgjidhura në ankim për 100 banorë, gjatë vitit 2022, ka pasur 15 050 lëndë ose 0.8 lëndë për 100 banorë (i ngjashëm me vitin 2021).

Në prill të vitit 2023, KGJK ka miratuar një rregullore për standardet e punës së gjyqtarëve, me qëllim të rritjes së efikasitetit. Kapaciteti i gjyqësorit dhe prokurorisë për të trajtuar me kohë lëndët mbetet i kufizuar, veçanërisht në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, me të pandehur të shumtë dhe prova komplekse. Shtyrjet e gjykatës mund të shmangeshin nëse trupat gjykues do të ishin më këmbëngulës në përdorimin e mjeteve për të sanksionuar të pandehurit dhe palët e tjera për mungesë të pajustificuara nga seancat. Megjithatë, ka një rritje të vazhdueshme të përqindjes së seancave gjyqësore produktive (seancat e mbajtura sipas programit dhe ku është bërë përparim drejt gjykimit) dhe një ritëm i rritur në caktimin e seancave gjyqësore.

Koha për marrjen e aktgjykimeve (d.m.th koha mesatare nga paraqitja e një çështjeje gjyqësore deri në marrjen e një vendimi) mbetet shkak për shqetësim pasi ajo në përgjithësi është shumë e gjatë. Në vitin 2022, koha e zgjidhjes ishte 1 396 ditë për çështjet civile në shkallën e parë/të dytë, dhe 953 ditë për çështjet administrative në shkallën e parë/të dytë (në vitin 2021, shifrat ishin 1 339 përkatësisht 426 ditë). Koha mesatare për zgjidhjen e lëndëve penale në Departamentin e Përgjithshëm ishte 673 ditë, ndërsa për Departamentin e Krimeve Penale koha mesatare ishte 740 ditë. Për Departamentin Special, shifra ishte 1 037 ditë.

Këto vonesa në procedura, në kombinim me preferencën për paraburgim ndaj masave alternative, kanë çuar sërish në raste shumë **të gjata të paraburgimit**. Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit vazhdoi të pranonte ankesa kundër gjykatave dhe prokurorëve me pretendime për vonesa të pajustificueshme në procedurat gjyqësore. Autoritetet duhet të konsiderojnë vënien në funksion

mjeteve juridike efektive gjyqësore për të adresuar vonesat e tilla, duke përfshirë kompensimin. Autoritetet gjithashtu duhet të sigurojnë përcjelljen e duhur nga menaxhmenti të afateve, duke përfshirë reagimin ndaj vonesave me veprime të duhura dhe në kohë nga menaxhmenti.

Për të përmirësuar më tej cilësinë dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor, gjyqtarët, prokurorët dhe stafi mbështetës duhet të përdorin plotësisht SMIL-in dhe trajnimet përkatëse. Përveç kësaj, monitorimi dhe vlerësimi i aktiviteteve të gjykatave dhe plotësimi i nevojave të sistemit gjyqësor me fonde adekuate dhe burime njerëzore të kualifikuara duhet të kenë prioritet. Kodi i rishikuar i Procedurës Penale, i cili ka hyrë në fuqi në shkurt 2023, trajton mangësitë në procedurat penale që kanë ulur efikasitetin e sistemit të drejtësisë. Kodi mundëson seanca gjyqësore online në rrethana të jashtëzakonshme/objektive (epidemi dhe fatkeqësi natyrore) dhe kodifikon praktikën që lejon palët të bien dakord për marrjen në konsideratë të dëshmimeve të mëparshme të lexuara në procesverbal. **Politika ndëshkimore** për krimin të organizuar dhe korrupsion vazhdoi të ishte e paqëndrueshme. Gjykatat ende nuk po zbatojnë sistematikisht udhëzimet rreth dënimeve të Gjykatës Supreme të vitit 2018, edhe pse Gjykata ka krijuar një komision për të monitoruar zbatimin e tyre.

KGJK ka hartuar dhe nxjerrë raporte të avancuara statistikore duke përdorur SMIL-in. Këto raporte përfshijnë treguesit e CEPEJ për matjen dhe vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe gjykatave. Ato ofrojnë një gamë të gjerë të dhënash, duke përfshirë numrin e lëndëve të pazgjidhura, moshën e lëndëve të pazgjidhura, numrin e lëndëve të zgjidhura, kohëzgjatjen e procedurave dhe numrin e seancave të mbajtura për lëndët e zgjidhura. Për të arritur rezultatet e besueshme, duhen përpjekje të vazhdueshme për të prodhuar dhe analizuar **sisteme statistikore** të besueshme, si dhe për të përdorur të gjeturat për qëllime të menaxhimit dhe hartimit të politikave.

#### Trajtimi i brendshëm i rasteve të krimeve të luftës

Qeveria ka paraqitur masa për të forcuar mekanizmat e brendshëm institucionalë që merren me krimet e luftës. Ndryshimet në Kodin e ri të Procedurës Penale për procedurën në fuqi për gjykimin në mungesë për krimet e luftës janë në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias.

Kosova vazhdoi të zbatojë strategjinë e saj për krimet e luftës, edhe pse me rezultate të kufizuara duke pasur parasysh mungesën e burimeve dhe mungesën e bashkëpunimit efektiv ndërkombëtar dhe rajonal. Në 2022, Policia e Kosovës ka arrestuar 5 persona të dyshuar për krime të luftës dhe ka filluar 19 hetime të reja. Numri i rasteve të ndërlidhura me krimet e luftës të gjykuara gjatë vitit 2022 ishte 15. Nga këto raste, shumica e vendimeve më vonë ose u kthyen për rigjykim ose u modifikuan ndjeshëm në apel. Mbeten pengesa të konsiderueshme në gjykimin e duhur të rasteve të krimeve të luftës. Më gjerësisht, shqetësimet mbeten për gatishmërinë për t'i mbajtur përgjegjës ish-pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në rastet e krimeve të luftës.

Gjatë periudhës raportuese, Policia e Kosovës ka arrestuar pesë persona të dyshuar për krime të luftës. Gjykata përkatëse kishte marrë vendim për caktimin e masës së paraburgimit kundër pesë të dyshuarve. Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) ka filluar hetimet kundër 62 personave, ka zgjeruar hetimet kundër 39 personave dhe ka rifilluar hetimet ndaj 71 personave. Janë zgjidhur shtatë raste. Gjithashtu, PSRK-ja ka ngritur aktakuzë kundër katër personave për krime të luftës, ndërsa tre janë dënuar në bazë të aktakuzave të ngritura para vitit 2022.

Përkundër rritjes së numrit të prokurorëve të caktuar (nga tre në katër), Departamenti i Krimeve të Luftës në Prokurorinë Speciale vazhdon të ballafaqohet me ngarkesë të madhe me punë. Mbi 1 000 raste të krimeve të luftës janë të pazgjidhura, kryesisht të trashëguara nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në vitin 2018. Ekziston nevoja për trajnim të vazhdueshëm dhe staf mbështetës, veçanërisht për bashkëpunimin ndërmjet policisë dhe prokurorisë. Ndiham e ndërsjellë juridike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në rastet e krimeve të luftës mbetet e vështirë. Bashkëpunimi me Mekanizmin e Mbetur Ndërkombëtar të OKB-së për



Tribunalet Penale në Hagë është i mirë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar kanë vazhduar të hetojnë dhe ndjekin penalisht shkeljet e së drejtës ndërkombëtare. Gjatë periudhës raportuese, kanë përfunduar përgatitje për procedurë paraprake në dy raste dhe kanë filluar procedurat gjyqësore, duke përfshirë rastin kundër ish-Presidentit të Kosovës dhe një rast tjetër që përfshin një ish-pjesëtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në një rast tjetër, Dhomat shpallën fajtor një ish-anëtar për torturë, ndalim arbitrar dhe vrasje dhe e dënuan me 26 vite burgim. Vendimi u ankimua. Është thelbësore që institucionet e Kosovës të ofrojnë bashkëpunim të plotë me Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe Dhomat e Specializuara, duke u mundësuar atyre të përmbushin mandatin e tyre në pavarësi të plotë, pa asnjë ndërhyrje nga jashtë. Kosova ka krijuar një fond që u jep ndihmë juridike të akuzuarve në Dhomat e Specializuara të Kosovës, si dhe mbështetje financiare për familjet e tyre, pa asnjë dëshmi për nevoja financiare. Megjithatë, deri më tani nuk është ofruar asnjë mbështetje financiare për viktimat të cilat janë konstatuar nga Dhomat e Specializuara të Kosovës se kanë vuajtur si pasojë e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit. Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë lëshuar urdhrin e parë për dëmshpërblimin e viktimave. Prandaj, nuk është e qartë se si do të kompensohen viktimat në mungesë të fondeve nga të akuzuarit apo një fondi nga Kosova për këtë qëllim. Është thelbësore që Kosova ta adresojë këtë pabarazi të trajtimit.

Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Konfliktit ka vazhduar punë në tij. Që nga fillimi i procesit në shkurt të vitit 2018, ky Komision ka pranuar 1 939 kërkesa. Prej tyre, statusi u është njohur 1 473 parashtruesve të kërkesave (1 402 gra dhe 71 burra), ndërsa 283 kërkesa janë refuzuar (247 gra dhe 36 burra). Gjatë periudhës raportuese, Komisioni ka pranuar 249 kërkesa: 356 parashtruesve të kërkesave iu është njohur statusi (332 gra dhe 24 burra) ndërsa 50 kërkesa ishin refuzuar (43 gra dhe shtatë burra). Që nga shkurti 2023, Komisioni nuk ka mundur të pranojë kërkesa të reja për shkak të afatit të përcaktuar me ligj. Ndonëse qeveria ka miratuar kërkesën për shtyrjen e afatit dhe draftin përkatës, që nga marsi 2023, ai është ende në pritje të miratimit nga Kuvendi. Projektligji i miratuar nga Qeveria e Kosovës parashikon vazhdimin e mandatit të Komisionit edhe për 3 vite, pavarësisht ankesave të shoqërisë civile që kërkojnë mandat të pacaktuar. Afati kohor i ligjit përjashton prapë ata që kanë pësuar dhunë seksuale që ndërlidhet me konfliktin pas 20 qershorit 1999. Qeveria caktoi 14 prillin si ditë përkujtimore për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës, në njohje të dhimbjes dhe vuajtjes së tyre.

Fati i pazgjidhur i **personave të pagjetur** që u zhdukën gjatë konflikteve të viteve 1990<sup>ta</sup> mbetet çështje kyçe për t'u zgjidhur në Ballkanin Perëndimor. Autoritetet e Kosovës kanë kryer 16 zhvarrosje dhe kanë identifikuar zyrtarisht 6 persona në vitin 2022. Deri në prillin e vitit 2023, ende kishte 1 621 persona të pagjetur si rezultat i konfliktit.

Miratimi i **strategjisë së drejtësisë tranzicionale** është ende në pritje. Kuvendi ka miratuar Ligjin për themelimin e Institutit për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. Kjo iniciativë ka zëvendësuar iniciativën për komisionin e së vërtetës dhe pajtimit. Komisioni Qeveritar për Persona të Pagjetur, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, mori rolin udhëheqës në grupin punues për ndryshimin e Ligjit për Persona të Zhdukur. Shoqëria civile mbetet e angazhuar në mënyrë aktive në iniciativat e kërkimit të së vërtetës, pajtimit dhe përkujtimit.

Në kontekstin e Dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja, palët kanë rënë dakord dhe kanë miratuar një deklaratë të përbashkët për personat e pagjetur në një takim të nivelit të lartë në Bruksel më 2 maj 2023, duke u zotuar për të përmirësuar përpjekjet e përbashkëta të Kosovës dhe Serbisë për zgjidhjen e rasteve të mbetura të personave të pagjetur nga konflikti i Kosovës. Puna është duke vazhduar për krijimin e Komisionit të Përbashkët që do të monitorojë zbatimin e kësaj Deklarate. Gjatë periudhës raportuese, në Kosovë janë realizuar një numër **operacionesh dhe zhvarrosjesh**

**në terren.** Katër prej tyre përfshinin pjesëmarrjen e ekspertëve mjekoligjor nga Serbia, që është një zhvillim pozitiv. Që nga prilli i vitit 2021, nuk ka pasur asnjë seancë të Grupit Punues për Personat e Pagjetur të Beogradit dhe Prishtinës të udhëhequr nga KNKK, pasi që delegacioni i Kosovës refuzon të mbajë takime derisa delegacioni i Serbisë të ndryshojë kryesuesin. Megjithatë, nivelet më të ulëta të mekanizmit (nëngrupi punues për çështjet mjekoligjore, ekipi analitik dhe një takim për trupat e pidentifikuar) kanë vazhduar të punojnë në raste dhe lokacione specifike. Të dy delegacionet e Kosovës dhe të Serbisë kanë treguar interes për rifillimin e gërmimeve në kompleksin e minierës Stavalj në verën e vitit 2023. Nga qershori i vitit 2022 deri në mars 2023, përpjekjet e kombinuara të EULEX-it dhe ekspertëve vendorë mjekoligjorë rezultuan në 34 operacione në terren dhe 12 zhvarrosje. U gjetën rreth 12 grupe mbetjesh, që përfaqësojnë një minimum prej 12 individësh. U identifikuan tetë persona, nga të cilët tre ishin në listën e personave të pagjetur. Gjithsej 21 individë iu dorëzuan familjeve dhe 74 mostra të ADN-së u dërguan për analizë.

### **Lufta kundër korrupsionit**

Kosova është **ndërmjet një faze të hershme dhe njëfarë niveli të përgatitjes** në luftën kundër korrupsionit. Gjatë periudhës raportuese, Kosova ka arritur **progres të kufizuar**. Kosova miratoi kornizën të re rregullative për auditimin e partive politike dhe financimit të fushatave. Mbetet shumë për të bërë për të zbatuar legjislacionin kundër korrupsionit të miratuar së fundmi, duke përfshirë Ligjin për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Ligjin për deklarimin e pasurisë dhe legjislacionin për partitë politike dhe financimin e fushatave. Korniza ligjore për konfiskim penal është mjaft e avancuar, duke përfshirë Ligjin për kompetencat e zgjeruara të konfiskimit. Megjithatë, ligji vazhdon të mbetet kryesisht i pazbatuar dhe vlera e pasurisë së konfiskuar përfundimisht mbetet e ulët. Projektligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificuar, i cili synon të vë në funksion një sistem të konfiskimit jo të bazuar në dënim, është në pritje në Gjykatën Kushtetuese. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të zhvilluar hetime më proaktive, marrë vendime gjyqësore përfundimtare dhe bërë konfiskimin përfundimtar të pasurisë. Dënimet plotësuese që ndalojnë ushtrimin e funksioneve publike ose të profesioneve të tjera, veçanërisht për ata që janë dënuar për vepra të ndërlidhura me korrupsionin, nuk zbatohen mjaftueshëm. Përkundër përmirësimit të performancës së Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, mjetet parandaluese kundër korrupsionit të përcaktuara në legjislacion nuk janë zbatuar ende plotësisht, veçanërisht miratimi i planeve të integritetit në institucionet publike, ‘vërtetimi’ i legjislacionit, vlerësimet e rrezikut, dhe përdorimi praktik i procedurave të sinjalizimit në sektorin publik dhe privat. Në përgjithësi, korrupsioni mbetet çështje shqetësuese serioze. Ekziston nevoja për një përgjigje të fuqishme të drejtësisë penale ndaj rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë. Në këtë drejtim, shkarkimi i Shefit të Njësisë Speciale Hetimore të Policisë e Kosovës është shkak për shqetësim, duke dërguar një sinjal negativ për përkushtimin e Kosovës për të luftuar korrupsionin. Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë përmbushur vetëm pjesërisht dhe për këtë arsye mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

- të forcojë më tej kapacitetet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në aspektin e stafit dhe ekspertizës, për të siguruar që ajo të mund të kryejë me efektivitet mandatin e saj; institucionet përkatëse duhet të miratojnë dhe zbatojnë planet e integritetit dhe procedurat e brendshme të sinjalizuesve (përfshirë sektorin privat);
- të forcojë më tej efikasitetin e regjimit të konfiskimit penal; të promovojë shfrytëzimin sistematik të konfiskimit të zgjeruar dhe ‘të rregullt’ përmes ndjekjes penale dhe policisë; të rrisë nivelin e specializimit dhe ekspertizës në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë; të krijojë fondin e konfiskimit;

→ të forcojë më tej zbatimin e ligjit dhe ndjekjen penale, si dhe bashkëpunimin multidisiplinar dhe qasjen e bazuar në objektiva për të siguruar hetime proaktive dhe për të luftuar në mënyrë efektive rastet e korrupsionit të nivelit të lartë; të kryejë në mënyrë sistematike hetime financiare gjatë hetimeve penale; të garantojë sigurinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

### Historiku

Kosova vazhdoi të bëjë përpjekje në historikun e saj të **hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve** në luftën kundër korrupsionit. Megjithatë, më shumë vullnet politik dhe burime janë të nevojshme, veçanërisht për të trajtuar korrupsionin e nivelit të lartë. Këto përpjekje duhet të vazhdojnë dhe Komisioni do të vazhdojë të monitorojë zhvillimin. Deri në fund të periudhës raportuese, mekanizmi i historikut për liberalizimin e vizave, i krijuar në vitin 2015 për të monitoruar dhe koordinuar **rastet e korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar**, përfshinte gjithsej 88 raste. Deri në atë kohë, kishte 75 aktakuza: 33 raste të krimin të organizuar (që përfshijnë 320 individë) dhe 42 raste të korrupsionit (që përfshijnë 310 individë). Nga këto raste, 22 raste përfunduan me dënime/shfajësime të pjesshme, duke çuar në dënimin e 22 personave për vepra të ndërlidhura me korrupsionin dhe 66 për vepra të ndërlidhura me krimin e organizuar. Aktualisht, mekanizmi i historikut përfshin vetëm rastet e përzgjedhura në kontekstin standardeve të liberalizimit të vizave. Megjithatë, në të ardhmen pritet që historiku të mbulojë të gjitha rastet e nivelit të lartë që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Gjatë vitit 2022, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka trajtuar rreth 619 raste nën hetim paraprak për dyshime për vepra të ndërlidhura me korrupsionin. Prej këtyre rasteve, 267 kallëzime i janë dorëzuar prokurorisë dhe policisë për fillimin e procedurave penale, përfshirë 4 raste të deleguara në institucionet tjera (Inspektoratin Policor, Inspektoratin Mjekësor dhe Inspektoratin e Arsimit). Gjithashtu, 6 raste janë transferuar tek organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore. Janë pushuar 267 lëndë, ndërsa 65 janë në vazhdim.

Në vitin 2022, 4 687 nga 4 748 zyrtarë (98,72%) të obliguar të dorëzojnë rregullisht **deklaratat vjetore të pasurisë** e kanë bërë me kohë, ndërsa 61 (ose 1.28%) zyrtarë nuk e kanë respektuar afatin (51 zyrtarë kanë deklaruar pasurinë pas afatit dhe 11 nuk kanë deklaruar fare). Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka kryer procedurën e kontrollit të plotë të pasurisë për 973 zyrtarë. Kontrollat janë bërë kryesisht me përzgjedhje të rastësishme, por për 41 zyrtarë kjo është bërë bazuar në informacionet e vetë Agjencisë apo raportet nga anëtarët e publikut. Si rezultat i kontrollit të plotë të pasurisë, rreth 180 zyrtarë janë duke u hetuar për deklaram të rremë ose për mosdeklaram të pasurisë. 178 raste janë referuar në prokurori dhe polici për hetime të mëtejshme. Në vitin 2022, ka pasur 38 vendime gjyqësore, nga të cilat 37 dënime dhe vetëm një lirim nga akuzat. Mangësitë në sistemin e deklaramit dhe vlerësimit të origjinës së pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë vazhdojnë. Stafi i Agjencisë, burimet e TI-së dhe kapacitetet trajnuese duhet të rriten. Një sistem deklarami elektronik hyri në funksionim, duke thjeshtuar procesin e deklaramit dhe dorëzimit dhe duke rritur transparencën dhe saktësinë në monitorim dhe verifikim. Duhet të forcohet bashkëpunimi dhe shkëmbimi i të dhënave me policinë, administratën tatimore, Njësinë e Inteligjencës Financiare, regjistrin kadastral dhe autoritetet komunale.

Në vitin 2022, Agjencia ka trajtuar 233 raste të dyshimit për **konflikte të interesit**. Numri i kërkesave të institucioneve të dorëzuara në Agjenci për këshilla dhe opinione për konfliktin e interesit është dyfishuar nga një vit më parë. Agjencia ka dhënë këshilla dhe mendime në 129 raste. Konflikti i interesit është evituar në 49 raste, ndërsa 34 raste kanë rezultuar me

mosekzistencë të konfliktit, një rast është përcjellë në gjykatën kompetente dhe 4 raste janë referuar për hetim paraprak.

Në vitin 2022, Agjencia ka trajtuar 218 raste që kanë të bëjnë me monitorimin dhe parandalimin e korrupsionit në aktivitetet e prokurimit publik. Këto kanë rezultuar me 211 mendime, prej të cilave 162 mendime janë respektuar ndërsa 49 jo. Rreth 33 raste janë dorëzuar për hetime paraprake dhe 7 raste janë pushuar.

Pavarësisht kornizës ekzistuese ligjore mjaft të avancuar, **konfiskimi pasurisë** së fituar nga vepra penale mbetet i ulët. Edhe pse Ligji i vitit 2019 për kompetencat e zgjeruara të konfiskimit është në fuqi, ai nuk po zbatohet në mënyrë konsistente. Në prokurori janë caktuar koordinatore lokalë për çështjet e konfiskimit. Konfiskimi si mjet për të shënjestruar interesat ekonomike të organizatave kriminale mbetet i pashfrytëzuar nga prokurorët, të cilët mbeten hallka më e dobët në këtë drejtim. Konfiskimin e pasurisë së fituar nga vepra penale duhet të bëhet një prioritet strategjik në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit të nivelit të lartë në vend.

Në vitin 2022, vlera e pasurisë së ngrirë, të sequestruar dhe të konfiskuar arriti në rreth 21.4 milionë euro (14 milionë euro në vitin 2021) ndërsa vlera e pasurisë së konfiskuar përfundimtare ishte rreth 670 000 euro (770 000 euro në vitin 2021). Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sequestruar dhe të Konfiskuar (duke trajtuar më shumë se 1.5 milionë euro në pasuri të ndryshme në vitin 2022) vazhdon të luftojë për të menaxhuar pasuritë në portofolin e saj. Kjo është pjesërisht për shkak të moslejimit të gjykatave për shitjen e parashikuar të pasurisë në pritje të procedurave dhe pjesërisht për shkak të strukturës së Agjencisë. Vlera e pasurisë së shitur në vitin 2022 ishte rreth 36 000 euro, që është më pak se në vitin 2021 (rreth 52 000 euro). Qeveria ka miratuar konceptin dokumentin për krijimin e fondit të konfiskimit, i cili do të ndajë një pjesë të fondeve të konfiskuara pjesërisht për zbatimin e ligjit, prokurorinë dhe gjykatat dhe një pjesë tjetër për projektet sociale.

Kosova ka miratuar kornizën të re rregullatore për **auditimin e partive politike dhe financimit** të fushatave. Qëllimi i kornizës është të sigurojë raportim të plotë, shpalosje në kohë, mbikëqyrje kuptimplotë dhe llogaridhënie për parregullsitë. Kompetenca për kryerjen e auditimit u zhvendos nga Kuvendi në Zyrën e sapokrijuar për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike në kuadër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Kjo zyrë ka pavarësi operative në kryerjen e monitorimit dhe kontrollit financiar të subjekteve politike. Ajo ka kompetenca për të marrë raporte financiare vjetore dhe raporte të financimit të fushatave, të punësojë auditorë të jashtëm për të kryer auditimin dhe të nxjerrë raporte vjetore që përbëjnë bazën për ndarjen e fondeve publike nga Kuvendin për subjektet politike. Gjatë periudhës raportuese, Kryetari i KQZ-së emëroi Drejtorin e Zyrës. Në vitet e fundit, Kuvendi nuk ka kryer rregullisht auditime dhe KQZ-ja vendosi sanksione selektive, të cilat rezultuan në mbikëqyrje jo të plotë të financimit të fushatave. Ekziston një ndërgjegjësimit i kufizuar dhe respektim i rregullave të financimit të fushatave. Shumica e subjekteve politike nuk kanë vendosur rregulla të kontrollit të brendshëm financiar dhe burime të shumta të të hyrave dhe shpenzimeve mbeten të pa raportuara.

### Korniza institucionale

Koordinimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional ndërmjet institucioneve për parandalimin e korrupsionit dhe agjencive të zbatimit të ligjit është thelbësor për zbatimin e legjislacionit kundër korrupsionit.

### *Masat parandaluese*

Kompetencat e **Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit** përfshijnë verifikimin dhe

kontrollin e deklaratave të pasurisë dhe dhuratave, që kanë të bëjnë me sinjalizimin dhe parandalimin e konfliktit të interesit. Ligji për riorganizimin e kompetencave të ish-Agjencisë kundër Korrupsionit u miratua në korrik të vitit 2022 me qëllim të forcimit të mandatit të saj. Konkretisht, Agjencia ka kompetenca për të zbatuar mjetet e tilla si korrigjimi i korrupsionit, vlerësimi i rrezikut të korrupsionit dhe planet e integritetit në institucionet publike, të cilat duhet të miratohen pa vonesë. Agjencia ka gjithashtu kompetenca për të iniciuar hetime administrative dhe për të vendosur sanksione. Performanca e saj në përgjithësi ka pasqyruar progres pasi që ajo u bë funksionale dhe kreu një numër në rritje të inspektimeve. Agjencia gjithashtu ka lansuar një fushatë ndërgjegjësimi për mandatin dhe kompetencat e saj. Megjithatë, është thelbësore të forcohet kapaciteti njerëzor dhe ekspertiza dhe të rritet buxheti i saj në mënyrë që të përmbushë plotësisht dhe në mënyrë efektive mandatin dhe të përmbushë kompetencat e reja, duke përfshirë kontrollimin e deklaratave të pasurisë dhe zbatimin e mjeteve të reja parandaluese kundër korrupsionit.

Ekziston nevojë e vazhdueshme për të promovuar hartimin dhe miratimin e **planeve të integritetit në shërbimin publik** si mjet për parandalimin e korrupsionit dhe sigurimin e disiplinës, përfshirë edhe në nivel komunal. Sipas ligjit të ri për Agjencinë, organet e administratës qendrore, agjencitë e pavarura dhe autoritetet komunale duhet të miratojnë planet e integritetit dhe të emërojnë zyrtarin përgjegjës për menaxhimin e përgatitjes dhe zbatimit të planit të integritetit. Kjo duhet të zbatohet pa vonesë.

#### *Zbatimi i ligjit*

Kosova ka **institucionet funksionale të specializuara** për të luftuar korrupsionin, përfshirë Koordinatorin Nacional për Luftimin e Krimeve Ekonomike në sistemin prokurorial, Departamentin kundër Korrupsionit dhe Krimin Financiar në Prokurorinë e Speciale dhe drejtorinë përkatëse të policisë. Autoritetet e zbatimit të ligjit do të përfitonin nga burime shtesë për të përmirësuar kapacitetin e tyre operacional për të kryer hetime komplekse. Bashkëpunimi ndërmjet policë dhe prokurorisë duhet të forcohet për të siguruar hetime proaktive dhe për të zbatuar një qasje të përbashkët të bazuar në objektiva për luftimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë. Hetimet financiare duhet të fillohen sistematikisht dhe paralelisht me hetimin kryesor. Përdorimi i masave të posaçme hetimore, kur është e zbatueshme, duhet të forcohet. Masat dhe mekanizmat për të siguruar mbrojtjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga ndërhyrja dhe presioni duhet të zbatohen në mënyrë efektive.

Ka shqetësime se dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksioneve publike apo profesioneve të tjera (siç parashikohet në Kodin Penal dhe Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale) nuk zbatohet, veçanërisht për ata që janë dënuar për vepra të korrupsionit. Ka mospërputhje dhe mungesë të praktikës së standardizuar në përmbardim dhe personelit (stafit administrativ, gjyqtarëve apo prokurorëve) i mungon vullneti apo kuptimi i konceptit të dënimeve plotësuese dhe i përgjegjësive të tyre gjatë zbatimit të këtyre dënimeve.

Njësia Speciale Hetimore e Policisë së Kosovës, si pasardhëse e Task Forcës Speciale Kundër Korrupsionit e shfuqizuar në vitin 2020, ka vazhduar të funksionojë me të njëjtin zinxhir komandues dhe me mandat të përkohshëm ligjor. Qeveria duhet të sigurojë strukturën e saj të qëndrueshme ligjore dhe organizative, si dhe të bashkëpunojë në mënyrë efektive me shërbimin prokurorial. Reforma e vazhdueshme e strukturës organizative të policisë duhet të sigurojë që Njësia Speciale Hetimore të ketë kapacitete të mjaftueshme hetimore për të përmbushur në mënyrë efikase funksionet e saj. Shefi i Njesisë u shkarkua nga kjo detyrë për t'u emëruar në një post tjetër këtë vit. Ky ndryshim është shkak për shqetësim. Është thelbësore që të ruhet integriteti i hetimeve në vazhdim dhe që kapacitetet hetuese të Policisë së Kosovës për luftën kundër korrupsionit të jenë të pavarura dhe të paanshme.

Pas restrukturimit të Prokurorisë Speciale në vitin 2020, kapacitetet e saj u rritën me rekrutimin e prokurorëve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe përkthyesve. Është thelbësore të rritet niveli i specializimit dhe ekspertizës për ndjekjen penale të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimeve financiare. Në vitin 2022, numri i përgjithshëm i aktakuzave ishte 236 (147 në vitin 2021), ndërsa numri i përgjithshëm i vendimeve dënuese ishte 29 (122 në vitin 2021). Ligji i ri për Prokurorinë Speciale është në pritje në Kuvend. Ligji sqaron fushëveprimin e juridiksionit ndërmjet Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë Themelore për gjykimin e hetimeve dhe ndjekjes penale.

Departamentet speciale në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe në Gjykatën e Apelit, të cilat trajtojnë të gjitha rastet e Prokurorisë Speciale, kanë zgjidhur 85 lëndë në vitin 2022 (42 lëndë nga Gjykata Themelore dhe 43 nga Gjykata e Apelit) dhe 45 lëndë shtesë në vitin 2023 (25 lëndë nga Gjykata Themelore dhe 20 lëndë nga Gjykata e Apelit).

### Korniza ligjore

Për shkak të çështjeve që ndërlidhën me statusin, Kosova nuk është palë e konventave ndërkombëtare kundër korrupsionit siç është Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit dhe Konventa Penale për Korrupsionin e Këshillit të Evropës. Megjithatë, legjislacioni i Kosovës në përgjithësi është i harmonizuar me këto instrumente dhe në përputhje me standardet relevante evropiane.

Në korrik të vitit 2022, Kosova miratoi **legjislacionin e ri kundër korrupsionit**: Kodin e Ri të Procedurës Penale, Ligjin për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Ligjin për Deklarimin e Pasurisë. Ligji i ri për Kodin e Procedurës Penale synon forcimin e procedurave penale. Korniza ligjore kundër korrupsionit parashikon, ndër risitë e tjera, pezullimin nga detyra të zyrtarëve si masë parandaluese në rast të pengimit të procedurave. Ligji i ri për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit forcon mandatin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në zbatimin e Ligjit për Deklarimin e Pasurisë, Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Agjencisë i janë dhënë mjete të reja për parandalimin e korrupsionit; këto përfshijnë vërtetimin e korrupsionit, vlerësimin e rrezikut të korrupsionit dhe monitorimin e planeve të integritetit në institucione. Ligji i ri për deklarimin e pasurisë shton kategori të reja të zyrtarëve publikë të detyruar të deklarojnë pasurinë. Ai gjithashtu përfshin informacione dhe të dhëna më të plota të pasurisë që duhet të deklarohen nga zyrtarët, rrit numrin e zyrtarëve nën kontrollin e plotë të Agjencisë dhe vë në funksion një sistem online për deklarimin e pasurisë. Zbatimi efektiv mbetet kryesisht i përcaktuar.

Korniza ligjore për **konfiskim** penal mbetet mjaft e avancuar. Projektligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificuar, i cili synon të vë në funksion një sistem të konfiskimit jo të bazuar në dënim, është në pritje në Gjykatën Kushtetuese. Një sistem i tillë i avancuar kërkon garanci të qarta kundër keqpërdorimeve dhe abuzimeve të mundshme dhe duhet të respektojë parimet e parapara me Kushtetutë dhe të drejtat themelore. Për më tepër, sistemi i tillë nuk duhet të zëvendësojë apo minojë zbatimin e kornizës ligjor ekzistues për konfiskimin penal, duke përfshirë Ligjin për kompetencat e zgjeruara të konfiskimit.

Korniza ligjore për parandalimin e **pastrimit të parave** ende nuk zbatohet në masë të duhur. Ndonëse ligji nuk kërkon vërtetimin e veprës penale bazë për të mbajtur dënimin, shumë prokurorë dhe gjyqtarë vazhdojnë të konsiderojnë veprën penale bazë si pjesë thelbësore të veprave penale të pastrimit të parave. Si rezultat, shumë raste të pavarura të pastrimit të parave hedhen poshtë ose nga prokuroria ose nga gjykata. Legjislacioni për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit duhet të harmonizohet plotësisht me Direktivat 4 dhe 5 të BE-së dhe rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar (*shih gjithashtu*

*Kapitulini 4 për lëvizjen e lirë të kapitalit dhe seksionin për krimin e organizuar).*

Korniza ligjore për **parandalimin e konfliktit të interesit** është në fuqi që nga viti 2018, por ajo duhet të zbatohet plotësisht. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit vazhdon të përpiqet të identifikojë zyrtarët që mbajnë pozita të shumta në shkelje të ligjit. Kosova nuk ka legjislacion specifik për lobim.

Ligji për **mbrojtjen e sinjalizuesve** synon të harmonizojë kornizën kombëtar me legjislacionin e BE-së. Legjislacioni zbatues që përcakton procedurën për pranimin dhe trajtimin e rasteve sinjalizimit është në fuqi. Duhet ende të zbatohen mekanizma të forcuar sinjalizues dhe kërkesa për mbrojtje në sektorin publik dhe privat.

Kuvendi miratoi ndryshimet në **kornizën ligjore për partitë politike dhe financimin e fushatave zgjedhore** në përputhje me Opinionin e Komisionit të Venecias. Këto duhet të zbatohen menjëherë për të siguruar financim më të përgjegjshëm, transparent dhe të zbatueshëm për partitë dhe fushatat. Një element i mbetur që mungon në ligj është kërkesa për raportim të ndërmjetëm të të ardhurave dhe shpenzimeve të kandidatëve gjatë periudhës së fushatës.

#### Korniza strategjike

Strategjia për sundimin e ligjit dhe plani i veprimit përfshijnë masa specifike që synojnë përmirësimin e kornizës institucionale kundër korrupsionit, si dhe sistemin e deklarimit të pasurisë dhe rregulloret për pranimin e dhuratave. Që nga viti 2018, Kosova nuk ka në fuqi një strategji kundër korrupsionit. Qeveria krijoi një grup punues për të hartuar strategjinë dhe planin e veprimit kundër korrupsionit. Këshilli Gjyqësor miratoi planin strategjik 2022-2025 për zgjidhjen efikase të rasteve të korrupsionit dhe krimin të organizuar.

#### **Të drejtat themelore**

Në përgjithësi, korniza ligjorë garanton mbrojtjen e të drejtave themelore dhe është në përputhje me standardet evropiane. Gjatë periudhës raportuese, Kosova ka miratuar Ligjin për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës dhe ka krijuar një protokoll për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale. Kapaciteti i autoriteteve për të monitoruar zbatimin e politikave dhe legjislacionit për të drejtat themelore është përmirësuar dhe shkalla e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit është rritur. Kuvendi miratoi Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore. Pavarësisht këtyre zhvillimeve pozitive, nevojiten përpjekje shtesë për të zbatuar në mënyrë efektive të drejtat themelore. Kapaciteti i qeverisë për të përmirësuar dhe mbikëqyrur çështjet e të drejtave themelore kërkon përmirësime të mëtejshme, duke përfshirë koordinimin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe komuniteteve joshumicë, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Çështjet e të drejtave themelore duhet të jenë të pranishme në nivel më të lartë në agjendën politike dhe, si rrjedhojë, duhet të ndahen më shumë burime njerëzore dhe financiare për institucionet relevante. Kosova duhet të vazhdojë përpjekjet e saj për të siguruar qasje të barabartë të personave me aftësi të kufizuara në institucione, shërbime cilësore, punësim dhe arsim. Duhet të bëhen më shumë përpjekje për zbatimin e procesit të verifikimit të diplomave universitare nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut dhe shtrirjen e këtij procesi në diplomat e shkollës së mesme, për të siguruar respektimin e të dy gjuhëve zyrtare dhe për të siguruar që kuota e përfaqësimit për të gjitha komunitetet joshumicë të respektohet në institucionet publike. Nuk ka pasur progres në zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për Manastirin e Deçanit.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë përmbushur vetëm pjesërisht dhe për këtë arsye mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

→ të përforcojë mbrojtjen e të drejtave civile dhe themelore të grave duke miratuar Kodin

Civil, duke zbatuar Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe duke fuqizuar zbatimin e Ligjit për barazi gjinore dhe strategjinë për dhunën me bazë gjinore;

- të forcojë mbrojtjen e të drejtave të fëmijës duke miratuar të gjitha aktet nënligjore të Ligjit për mbrojtja e fëmijëve si çështje urgjente dhe forcimin e kapaciteteve për zbatimin e ligjit;
- të përmirësojë zbatimin e legjislacionit për të drejtat e komuniteteve joshumicë, të miratojë strategjinë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve, të miratojë ligjin për trashëgiminë kulturore dhe ligjin për liritë fetare, të rivendosë marrëdhëniet me Kishën Ortodokse Serbe dhe të zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese për Manastirin e Deçanit.

**Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut** janë pjesë përbërëse e kornizës ligjore të Kosovës dhe janë drejtpërdrejt të zbatueshme, siç parashihet në Kushtetutë. Kosova vazhdoi të harmonizojë legjislacionin e saj me këto instrumente dhe vazhdoi praktikën e saj të raportimit ad hoc. Zbatimi i legjislacionit për të drejtat e njeriut si dhe mbikëqyrja dhe koordinimi i mekanizmave ekzistues të të drejtave të njeriut mbeten sfidë. Në përgjithësi, çështjet e të drejtave të njeriut ende nuk zënë vend lart në agjendën politike të qeverisë.

Programi 2021-2025 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe plani i tij i veprimit janë instrumentet kryesore të të drejtave të njeriut. Dy mekanizmat kryesorë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të programit janë: (i) Grupi Koordinues Ndërinstitucional për të Drejtat e Njeriut i udhëhequr nga Zëvendëskryeministri për Çështje të Pakicave dhe të Drejtave të Njeriut; dhe (ii) Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZQM/ZKM). Në mars 2023, ZQM/ZKM nxori disa raporte monitoruese, duke përfshirë zbatimin e programit të të drejtave të njeriut. Është vërejtur njëfarë progresi në zbatim, ku aktivitetet pa progres kanë të bëjnë kryesisht me shëndetin, mirëqenien dhe mbrojtjen e mjedisit. Për më tepër, korniza e treguesve të të drejtave të njeriut u zhvillua për herë të parë për çdo të drejtë të detyrueshme të përcaktuar në Kushtetutë dhe në aktet ligjore detyruese ndërkombëtare.

Grupi Koordinues Ndërinstitucional i Qeverisë për të Drejtat e Njeriut mbajti mbledhjen e tij konstituive në qershor të vitit 2022, por u takua vetëm edhe një herë në qershor 2023. Synimet e ZKM-së për Çështje të Pakicave dhe të Drejtave të Njeriut, Komisionit të Kuvendit për të Drejtat e Njeriut dhe Këshillit për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut në kuadër të Presidencës, janë të zbatojnë në mënyrë efektive dhe të racionalizojnë politikat dhe legjislacionin për të drejtat e njeriut. Në praktikë, duket të ketë sinergji të pamjaftueshme mes tyre. ZQM/ZKM ishte aktive në përpyetje për të përmbushur mandatin e saj të gjerë, por vazhdimisht i mungojnë burimet e duhura njerëzore, financiare dhe administrative, ndërsa performanca e saj mbetet e varur nga mbështetja e donatorëve. Kuvendi duhet të marrë një rol më proaktiv në mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për të drejtat e njeriut.

Institucioni i Avokatit të Popullit vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në **promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut**. Gjatë periudhës raportuese është krijuar një sistem elektronik për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të tij, si dhe një ekip i përbashkët për koordinimin dhe monitorimin e tyre. Kjo e fundit përfshin ZQM/ZKM-në, Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Agjencinë për Barazi Gjinore. Pas një vonese të gjatë, procesi për përzgjedhjen e zëvendësit të pestë të Avokatit të Popullit nga komunitetet joshumicë u finalizua në qershor. Parlamenti gjithashtu miratoi përfundimisht raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2021 në janar 2023. Për të shmangur vonesa të tilla, nevojiten paraqitje më sistematike të shqyrtimit të raporteve vjetore dhe përzgjedhjes së deputetëve në Kuvend. Ndonëse institucioni ka zgjeruar në mënyrë progresive përgjegjësitë e tij, atij nuk i janë siguruar burime të përshtatshme financiare dhe njerëzore. Megjithatë, Avokati i Popullit ende gëzon besim të gjerë publik. Në vitin 2022, Avokati i Popullit ka pranuar 1 595 ankesa, prej të cilave 672 janë hapur për hetim, që është nivel i krahasueshëm me vitin paraprak. Institucioni ka nxjerrë 646



rekomandime. Shkalla totale e zbatimit qëndron në 23%, ndërsa 46% e rekomandimeve të nxjerra në vitin 2021 ishin zbatuar në fund të vitit 2022. Kjo tregon një përgjegjshmëri të shtuar nga ana e institucioneve të Kosovës, e cila duhet të forcohet edhe më tej. Institucioni ka marrë një qasje proaktive për adresimin e ankesave të banorëve të veriut të Kosovës në lidhje me shpronësimin e tokës në pronësi private.

Autoritetet e Kosovës vazhdojnë të tregojnë përkushtim për parandalimin **torturës dhe keqtrajtim**. Mekanizmi Parandalues Kombëtar (MKP) funksionon nën ombrellën e Institucionit të Avokatit të Popullit. Në vitin 2022, Mekanizmi Parandalues Kombëtar ka kryer 62 vizita të paparalajmëruara në vendet e paraburgimit, përfshirë institucionet psikiatrike dhe të kujdesit social (i njëjti numër si në vitin 2021) dhe ka publikuar 8 raporte. Në përgjithësi, ai ka adresuar 38 rekomandime tek autoritetet (kundrejt 11 në vitin 2021); 10 tashmë ishin zbatuar plotësisht ose pjesërisht. MPK ka pasur bashkëpunim shumë të mirë me institucionet e vizituara, por ka raportuar një rast ku i është refuzuar qasja. Nuk u raportua për asnjë rast torture apo keqtrajtimi të të burgosurve gjatë periudhës raportuese. Ka pasur raportime për keqtrajtime të pretenduara gjatë arrestimit të katër serbëve të Kosovës në lidhje me përfshirjen e tyre të pretenduar në ngjarjet e dhunshme të 29 majit në Zveçan.. Inspektorati Policor ka regjistruar 14 raste të dyshuara të keqtrajtimin nga zyrtarët policorë (11 në vitin paraprak); të gjitha rastet i janë referuar prokurorisë. Një zyrtar policor ishte arrestuar dhe pezulluar nga puna. Avokati i Popullit pranoi 6 ankesa kundër zyrtarëve policor të Kosovës për përdorim të tepruar të forcës; çka çoi në hapjen e 3 hetimeve.

Ndonëse **sistemi i burgjeve** vazhdon të përputhet gjerësisht me rregullat standarde minimale të OKB-së për trajtimin e të burgosurve dhe me rregullat evropiane të burgjeve, ka ende disa sfida. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të mbrojtur të drejtat e të burgosurve, veçanërisht në mesin grave dhe vajzave dhe grupeve jo-shumicë. Ligji për Shërbimin Korrektues dhe Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale janë miratuar në korrik të vitit 2022. Sipas këtij të fundit, zyrtari për të drejtat e të burgosurve në kuadër të Zyrës për të Drejtat e Njeriut të Ministrisë së Drejtësisë ka për detyrë të monitorojë mbrojtjen e tyre. Një numër rregulloresh ende nuk janë miratuar për të siguruar zbatimin e këtyre ligjeve. Instituti për trajtimin e personave (të burgosurve) me nevoja të veçanta është themeluar në ambientet e qendrës korrektuese në Dubravë. Disa poste drejtuese në Shërbimin Korrektues mbetën të zbrazëta ose me ushtrues detyre, duke penguar funksionimin e këtij shërbimi. Gjatë periudhës raportuese janë vendosur gjithsej 3 163 masa alternative ndaj paraburgimit, rreth gjysma e të cilave për të mitur. Asnjë mbipopullim i objekteve ekzistuese nuk është raportuar nga MKP. Përpjekjet për të përmirësuar programet e trajtimit të drogës dhe shërbimet mjekësore në burgje janë në vazhdim. Marrëveshja për transferimin e të burgosurve nga Danimarka në Kosovë është në pritje të ratifikimit në Kuvendin e Kosovës.

Sa i përket **mbrojtjes së të dhënave personale**, ligjet në fuqi janë gjerësisht në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Direktivën për Zbatimin e Ligjit. Agjencia për Informim dhe Privatësi mbikëqyr zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Ligjit për qasje në dokumente publike. Agjencia është treguar e pavarur dhe ka vazhduar të përmirësojë kapacitetet e saj. Ajo ka forcuar më tej kornizën ligjor duke miratuar rregullore dhe udhëzime për organizimin, sistemin dhe procedurën operative për kontrollorët dhe inspektimet. Edhe pse e kufizuar nga burimet buxhetore dhe njerëzore të kufizuara, Agjencia filloi të trajtojë ankesat për qasje në dokumente publike dhe për mbrojtjen e të dhënave në mënyrë të pavarur dhe efikase. Gjatë periudhës raportuese, Agjencia ka kryer 44 inspektime me vetë iniciativë dhe 51 inspektime në bazë të ankesave, si dhe ka nxjerrë 66 vendime për shkelje të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, duke ruajtur standarde të ngjashme me vitin paraprak. Ajo ka shqiptuar 8 gjoha. Sfidat mbeten lidhur me zbatimin e

vendimeve të Agjencisë nga institucionet publike dhe private. Lidhur me **qasjen në informacion**, legjislacioni është gjerësisht në përputhje me standardet e BE-së. Agjencia duhet të rrisë kapacitetin e saj për të monitoruar nivelet e transparencës në institucionet publike. Në vitin 2022, Agjencia raportoi se institucionet publike kanë pranuar gjithsej 4 481 kërkesa për qasje në dokumente publike (7 561 në vitin 2021). Prej tyre, 154 u refuzuan (95 në vitin 2021).

Në lidhje me **lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë**, ka dispozita ligjore, kryesisht në Kushtetutë dhe Ligjin për liritë fetare, që synojnë të promovojnë tolerancën fetare dhe të parashikojnë ndarjen e komuniteteve fetare nga autoritetet publike. Projektligji i ri për lirinë fetare iu nënshtrua konsultimit dhe u shqyrtua nga Komisioni i Venecias. Pritet të adresojë një boshllëk të rëndësishëm duke mundësuar regjistrimin e komuniteteve fetare si subjekte juridike. Megjithatë, ndërsa qeveria e miratoi projektligjin në janar 2023, ai mbetet në pritje në Kuvend. Marrëdhëniet ndërmjet qeverisë dhe Kishës Ortodokse Serbe mbetën të dobëta. Ky vit shënoi përvjetorin e shtatë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese që konfirmoi të drejtat pronësore të Manastirit Visoki Deçani të Kishës Ortodokse Serbe mbi një pjesë të tokës që rrethon manastirin. Vendimi ende nuk është zbatuar dhe kjo duhet të bëhet pa vonesa të mëtejshme.

Kuvendi i Kosovës miratoi një përkufizim pune të antisemitizmit, siç përcaktohet nga Aleanca Ndërkombëtare për Përkujtimin e Holokaustit. Komuniteti hebre nuk ka sinagogë. Megjithatë, ndërtimi i Qendrës Kulturore Hebraike në Prizren filloi në vitin 2022 me mbështetjen e qeverisë. Duhet të bëhen përpjekje për të promovuar kujtimin, edukimin dhe kërkimin për Holokaustin.

---

## Liria e shprehjes

Mjedisi mediatik në Kosovë mbetet i gjallë dhe pluralist, dhe korniza ligjore është kryesisht në përputhje me standardet evropiane. Në këtë fushë Kosova ka **një nivel të përgatitjes**. Është arritur progres i kufizuar në adresimin e rekomandimeve të raportit të mëparshëm. Shqetësimet mbeten në lidhje me sulmet dhe kërcënimet fizike, fushatat e shpifjeve publike dhe gjuhën e urrejtjes ndaj gazetarëve. Jo të gjitha kërcënimet ndaj gazetarëve dhe mediave raportohen tek autoritetet, megjithëse viti 2022 ka shënuar një rritje të lehtë të numrit të rasteve të raportuara. Veçanërisht shqetësuese është liria e shprehjes në veri të Kosovës, duke përfshirë edhe autocensurën dhe sigurinë e gazetarëve dhe profesionistëve të mediave. Nuk ka pasur progres në ndryshimin e Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës apo në ndryshimin e Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media për ta harmonizuar atë me Direktivën e BE-së për Shërbimet Mediale Audiovizuale. Ky proces duhet të jetë transparent dhe gjithëpërfshirës, me përfshirjen e akterëve të mediave dhe shoqërisë civile. Mungesa e vetëqëndrueshmërisë financiare i bën mediat të cenueshme ndaj interesave politike dhe të biznesit. Kjo përforcohet më tej nga mungesa e informacionit dhe e të dhënave për përfituesin përfundimtar të pronësisë së mediave – dispozitat për këtë ende nuk janë të përfshira në ligj. Vendimi për tërheqjen e licencës së biznesit të një transmetuesi të madh privat ka ngritur shqetësime serioze. Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk janë përmbushur dhe për këtë arsye mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

→ të përmirësojë bashkëpunimin institucional dhe reagimin e institucioneve kryesore ndaj sulmeve kundër gazetarëve dhe formave të tjera të presionit të panevojshëm, duke përfshirë rritjen e kapacitetit të organeve prokuroriale, gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit për të trajtuar çështjet në lidhje me të drejtën e lirisë së shprehjes dhe informimit;

- të rishikojë Ligjin për Radiotelevizionin për të siguruar financim të qëndrueshëm duke ruajtur pavarësinë e tij; të rishikojë Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media për të përditësuar kompetencat e tij, duke përfshirë mediat audiovizuale në përputhje me Direktivën për Shërbimet Mediale Audiovizuale;
- të rrisë disponueshmërinë e të dhënave për tregun audivizuel, veçanërisht për pronësinë e mediave.

### Frikësimi i gazetarëve

Në vitin 2022, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) raportoi 33 raste të frikësimit, kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të mediave, një rritje krahasuar me 29 raste të raportuara në vitin 2021. Prej tyre, 19 raste janë klasifikuar si kërcënime dhe ngacmime ndaj personave fizikë (gazetarëve), tetë janë sulme fizike dhe gjashtë janë sulme ndaj mediave, organizatave mediatike dhe/ose shoqatave të gazetarëve. Më shumë se gjysma e rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve kishin në shënjestër gazetarët femra. Gjatë periudhës raportuese, Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Rënda ka regjistruar 32 raste të sulmeve fizike ndaj gazetarëve, ku 12 raste janë cilësuar si kanosje, shtatë raste si sulm, një lëndim trupor dhe një zjarrvënie. Statistikat e Këshillit Prokurorial të Kosovës tregojnë se 14 raste të nxitjes së sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve janë në vazhdim e sipër, me nëntë raste të zgjidhura. Në disa raste, zyrtarët publikë, duke përfshirë zyrtarë të nivelit të lartë, bënë deklarata nënçmuese dhe shpifje dhe përdorën gjuhë frikësuese kundër gazetarëve.

Me vendosjen e bllokadave në rrugë dhe rritjen e tensionit politik në veri të Kosovës, ndodhën një sërë sulmesh që shënjëstronin profesionistët dhe gazetarët e mediave në gjuhën shqipe. AGK dhe shoqatat e gazetarëve i dënuan sulmet dhe i bënë thirrje Policisë së Kosovës, KFOR-it dhe EULEX-it që të ofrojnë siguri për gazetarët dhe profesionistët e mediave. Ata gjithashtu bënë thirrje për hetime të shpejta dhe të plota. Gjatë muajve maj dhe qershor 2023, u regjistruan një numër i paprecedentë sulmesh ndaj gazetarëve dhe profesionistëve të mediave. AGK raporti mbi 30 sulme, duke përfshirë sulme fizike, dëmtime të pajisjeve dhe automjeteve.

Gjatë periudhës raportuese, AGK ka raportuar një rast të padisë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) të ngritur nga një personazh publik kundër gazetarëve. Trajtimi i rasteve mbetet i ngadaltë dhe për rastet e gjykuara janë shqiptuar dënime të buta. AGK avokon që baza e të dhënave të rasteve të krimit të përfshijë referencë për profesionin e viktimave në mënyrë që të mund të identifikohen rastet kundër gazetarëve. Autoritetet prokuroriale dhe gjyqësore të Kosovës ndërmorën masa për adresimin e krimeve kundër gazetarëve duke emëruar prokurorë dhe gjyqtarë të specializuar. Ato kanë vendosur si objektiv mbledhjen e statistikave dhe priorizimin e këtyre rasteve në planin strategjik 2022-2024 për sistemin prokurorial.

### Mjedisi legjislativ

Korniza ligjore e Kosovës garanton lirinë e mediave dhe lirinë e shprehjes. Në përgjithësi, ligjet përkatëse janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kosova renditet e 61<sup>ta</sup> në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit 2022, 17 vende më lart se një vit më parë.

Nuk janë ndërmarrë hapa drejt miratimit të projektligjit për transmetuesin publik/Radiotelevizionin e Kosovës (RTK) i propozuar në vitin 2018. Po kështu, projektligji për Komisionin e Pavarur për Media, i harmonizuar me Direktivën e BE-së për Shërbimet Mediale Audiovizuale të vitit 2018, është ende në pritje në Kuvend. Ligji për mbrojtjen e burimeve të gazetarëve ende nuk është përafëruar me standardet evropiane. Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve synon të harmonizohet me *acquis* të BE-së por mekanizmat e sinjalizimit dhe kërkesat e mbrojtjes ende duhet të forcohen dhe zbatohen në mënyrë efektive.

Pavarësisht përmirësimeve në zbatimin e ligjeve që kanë të bëjnë me qasjen në dokumente

publike, gazetarët ende hasin në disa pengesa, veçanërisht për shkak të vonesave ose mohimit të qasjes nga institucionet publike, duke përfshirë edhe qeverinë. Vazhdon mosrespektimi i gjuhës nga institucionet publike dhe komunikimi i tyre me mediat vendore vazhdon të jetë shqetësues, sidomos për mediat në gjuhën serbe. Disa media lokale raportojnë herë pas here se disa parti politike dhe institucione publike përfshihen në përzgjedhje diskriminuese kur ftojnë media në ngjarjet e tyre zyrtare. Institucionet publike nuk ofrojnë vazhdimisht informata relevante dhe të plota në gjuhët zyrtare. Shkeljet e ligjit për gjuhët zyrtare janë vërejtur edhe në disa raste të tjera, siç është dështimi i një agjencie mediatike publike për të transmetuar konferencën për shtyp të anëtarëve të qeverisë në gjuhën serbe. Kuvendi ka vazhduar të mos ofrojë përkthim në gjuhën serbe gjatë seancave plenare.

#### Zbatimi i legjisllacionit/institucionet

Zbatimi i legjisllacionit ekzistues mbetet i pamjaftueshëm. Gjatë periudhës raportuese, Komisioni i Pavarur për Media (KPM) ishte kryesisht jofunksional për shkak të mungesës së kuorunit, duke përfshirë në Bordin Për Ankesa të Mediave. Bordi i KPM-së nuk ka funksionuar që nga marsi i vitit 2021, pasi njërit prej anëtarëve i ka skaduar mandati dhe Kuvendi nuk ka arritur të emërojë një anëtar të ri deri në maj të vitit 2023. Këshilli i Mediave të Shkruara është efektiv në zbatimin e Kodit të Mediave për mediat online.

#### Transmetuesi i shërbimit publik

Bordi i Radio Televizionit të Kosovës (RTK) nuk është i përfshirë në procesin e rishikimit legjislativ për projektligjin për RTK-në. Ndarja buxhetore e RTK-së mbeti nën shumën e përcaktuar me ligj në Ligjin për ndarjet buxhetore, duke e shtyrë RTK-në të vlerësojë mundësitë për financim me pjesëmarrje dhe një riororganizim të strukturës së tij të brendshme. Shoqëria civile dhe partitë politike opozitare kritikuan emërimin e Drejtorit të RTK-së të kanaleve në gjuhën shqipe për shkak të lidhjeve të dyshuara me partinë në pushtet. Për më tepër, komuniteti artistik dhe shoqëria civile e konsideruan nënshkrimin e një kontrate ndërmjet RTK-së dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit si të pafavorshme për pavarësinë editoriale të RTK-së.

#### Faktorët ekonomikë

Spektori i mediave në Kosovë vuan nga mungesa e transparencës në pronësi dhe financim dhe mungesa e vetëqëndrueshmërisë financiare, duke e bërë atë të cenueshëm ndaj ndikimit politik dhe presionit financiar. Transmetuesi publik financohet nga buxheti publik, ndërsa mediat private mbështeten në reklamat si mjetet e tyre kryesore të të ardhurave. Reklamat nga qeveria në mediat private nuk lejohet më. Mediat e regjistruara si OJQ vazhduan të marrin mbështetje nga donatorët. Mediat joshumicë në Kosovë mbështeten në projekte afatshkurtra dhe në mbështetjen e donatorëve. Mungesa e të dhënave për tregun e reklamave dhe strukturat e pronësisë së mediave, veçanërisht të mediave online, mbetet shqetësuese. Ka mungesë transparence në pjesën e tregut të mediave, ku disa media kryesore publikojnë sondazhe individuale të shikueshmërisë me mospërputhje të konsiderueshme në rezultatet përkatëse. Në qershor, Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës pezulloi licencën e biznesit Klan Kosova, një prej mediave kryesore private. Një veprim i tillë mund të ketë ndikim negativ në gjendjen e lirisë së mediave në Kosovë.

#### Interneti

Nuk ka legjisllacion kufizues për funksionimin e mediave online ose për lirinë e shprehjes në internet, dhe nuk është vërejtur asnjë kufizim gjatë periudhës raportuese. Kosova duhet të konsiderojë zhvillimin e një strategjie për internet më të mirë për fëmijët, duke përfshirë lehtësimin e zbulimit dhe reagimit ndaj abuzimit seksual të fëmijëve në internet. Progres i lehtë

është shënuar me miratimin e Udhëzimit Administrativ që përcakton masat për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet pornografike dhe përmbajtjet e tjera të papërshtatshme. Kërcënimet në internet dhe ngacmimet seksuale ndaj grave dhe vajzave janë mjaftë të përhapura, pa asnjë mekanizëm parandalimi apo korrigjim.

#### Organizatat profesionale dhe kushtet e punës

Gazetarët në mediat private vazhdojnë të punojnë me kontrata afatshkurtra, ose pa kontrata, ndryshe nga gazetarët e mediave të shërbimit publik, të cilët gëzojnë kontrata më të gjata. Mungesa e sigurisë profesionale dhe situata relativisht e pasigurt e punësimit dhe gjendja ekonomike e gazetarëve krijojnë kushte për abuzime dhe kufizime. Sipas AGK-së, ndonëse nuk ka të dhëna për kontrata apo paga diskriminuese ndaj grave, ato që punojnë në sektorin privat ende përballen me pengesa në gëzimin e të drejtave të tyre, përfshirë pushimin e lehonisë. Për më tepër, gratë kanë më pak qasje në pozita drejtuese sesa burrat. Në sektorin privat nuk ka organ përfaqësues të sindikatave për gazetarët, ndërkohë që transmetuesi publik është e vetmja media që ka sindikatë.

AGK është organizatë joqeveritare që ka për mision promovimin, inkurajimin dhe përmirësimin e gazetarisë cilësore dhe të hapur në Kosovë, si dhe përmirësimin e pozitës së gazetarëve në përgjithësi në shoqërinë kosovare. Shoqata ka kontribuar në programin Journalists-in-Residence në Kosovë, sipas të cilit Kosova ofroi një hapësirë të sigurt për 20 gazetarë ukrainas, shumica prej tyre gra. Në dhjetor të vitit 2022, programi u zgjerua pas vendimit të miratuar nga qeveria për të pritur edhe gazetarë nga Afganistani. Aktualisht Kosova po strehon 14 gazetarë ukrainas dhe gjashtë afganë.

#### Liria e shprehjes artistike

Liria e krijimtarisë artistike garantohet me Kushtetutë. Nuk ka asnjë rast kufizimi në asnjë formë të shprehjes artistike të raportuar gjatë periudhës raportuese.

*(Shih gjithashtu Kapitullin 10 për transformimin digjital dhe mediat)*

-----  
-----

**Liria e tubimit dhe e organizimit** garantohet me Kushtetutë dhe respektohet përgjithësisht. Gjatë periudhës raportuese ka hyrë në fuqi Ligji për tubimet publike, me qëllim garantimin e së drejtës për organizim dhe pjesëmarrje në ngjarje publike. Asnjë rast i përdorimit joadekuat të forcës nuk është raportuar nga Inspektorati Policor. Zyrtarët policor janë trajnuar për zbatimin e detyrave policore gjatë grumbullimeve dhe përdorimin e forcës. Parada e Krenarisë LGBTIQ u mbajt në qershor të vitit 2022 në Prishtinë pa asnjë incident të raportuar.

Çështjet e **të drejtave të punës dhe sindikatave** mbulohen më tej në *Kapitulli 19 për të drejtat sociale dhe punësimin*.

Sa i përket të drejtave pronësore, në dhjetor të vitit 2022, Kuvendi miratoi ndryshimet në Ligjin për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës. Autoritetet duhet të sigurojnë zbatimin e shpejtë. Për shkak të disa mangësive në sektorin e pronës në Kosovë, duke përfshirë paqartësitë në legjislacion dhe zbatimin e paqëndrueshëm të të drejtave, zbatimi i vendimeve gjyqësore (duke përfshirë edhe nga Gjykata Kushtetuese) mbetet problem. Kjo ndodhë veçanërisht në rastet pronësore të ndërlidhura me konfliktin. Procedurat e stërzgjatura gjyqësore në çështjet civile, veçanërisht në lidhje me pronën, mbeten çështje shqetësuese.

Pronësia e grave mbi pronën është rritur. Masa afirmative që ndihmon zbatimin e legjislacionit të pronësisë në favor të grave u vazhdua edhe për një vit; kjo masë ka sjellë një rritje të regjistrimit të grave si pronare të pronave, nga 1 505 prona të regjistruara në vitin 2021 në 6

951 në vitin 2022. Vetëm 19.2% e pronave janë të regjistruara në emër të dy bashkëshortëve.

Në vitin 2022, institucionet vazhduan të marrin masa për mbrojtjen e të drejtave pronësore të komuniteteve në situata të cenueshme, personave të zhvendosur dhe grave. Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës ka kryer 25 dëbime, nga gjithsej 27 kërkesa për dëbim. Mjeti juridik për demolimin e objekteve pa leje nuk është përdorur pasi nuk ka pasur kërkesa nga palët e interesuara. Nga 33 raste në ndërmjetësim gjatë vitit 2022, 10 kanë përfunduar me sukses në tremujorin e parë të vitit 2023. Në qershor 2023, Drejtori dhe Zëvendësdrejtori i Agjencisë u emëruan nga Kuvendi i Kosovës. Transaksionet mashtruese të pronave dhe bartjet e paligjshme të pronësisë së pronave që u përkasin kryesisht personave të zhvendosur mbesin shqetësim.

Ka pasur progres të kufizuar në çështjen e më shumë se 350 052 ndërtesave të ndërtuara pa leje. Rregullimi i vendbanimeve informale në shkallë të gjerë, banorët e të cilave kryesisht i përkasin komuniteteve të ndjeshëm e të marginalizuara, vazhdon të pengohet nga mungesa e vullnetit politik për të adresuar këtë çështje. Qeveria mori gjashtë vendime për shpronësim në komunat veriore të Kosovës. Serbët e Kosovës ngritën shqetësime për mënyrën se si janë kryer procedurat e shpronësimit dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat e ligjit në fuqi për shpronësimin e pronës së paluajtshme. Është thelbësore që qeveria të bëjë përpjekje për të siguruar që aktivitetet e shpronësimit të jenë në përputhje me ligjin, që të ndiqet procesi i duhur dhe që të drejtat pronësore të pronarëve dhe mbajtësve të interesit të respektohen plotësisht.

Ligji për **mbrojtjen nga diskriminimi** është gjerësisht në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, por zbatimi i tij mbetet i kufizuar, duke përfshirë mungesën e kapaciteteve institucionale. Kjo ndikoi, ndër të tjera, në të drejtat lidhur me punësimin, arsimin, qasjen në shërbime sociale dhe lirinë e lëvizjes. Zbatimi i pabarabartë i legjislacionit për gjuhët zyrtare vazhdon të rezultojë në qasje të pabarabartë në shërbime publike, drejtësi dhe punësim. Institucioni i Avokatit të Popullit është organi i barazisë përgjegjës për promovimin, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë pa diskriminim. Gjatë periudhës raportuese, ka pranuar 164 ankesa individuale për diskriminim të pretenduar; janë referuar për hetim 101 raste. Në shkurt 2023, Zyra për Çështje Ligjore, së bashku me Zyrën për Qeverisje të Mirë, iniciuan një vlerësim aktual të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi. Qëllimi është të identifikohen boshllëqet institucionale, ligjore dhe funksionale në lidhje me zbatimin e tij. Gjithashtu, Zyra për Çështje Ligjore ka lansuar Platformën Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian, me qëllim të lehtësimit të raportimit të rasteve të diskriminimit. Në vitin e parë të saj, u raportuan 23 raste.

Mbledhja e statistikave gjyqësore për rastet e diskriminimit është sfidë për shkak të identifikimit dhe kategorizimit të papërshtatshëm. Gjatë periudhës raportuese, gjykatat kanë marrë vendim për disa raste të diskriminimit, duke përfshirë rastet e diskriminimit në bazë të gjinisë dhe aftësisë së kufizuar. Është thelbësore të ndërtohen më tej kapacitetet e profesionistëve ligjorë për të diskutuar dhe gjykuar rastet e diskriminimit. Zbatimi i politikës kundër ngacimit seksual në administratën publike po përballet me sfida për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit të zyrtarëve dhe mungesës së mekanizmave të ankimit. Sa i përket krimit të urrejtjes, ndonëse Këshilli Prokurorial i Kosovës mban një mekanizëm përcjellës, mbledhja e të dhënave mbetet e pamjaftueshme. Gjuha e urrejtjes kundër personave në situata të ndjeshme, duke përfshirë komunitetet LGBTIQ dhe jo-shumicë vazhdon, veçanërisht në mediat sociale.

Sa i përket rasteve të diskriminimit, krimit të urrejtjes apo gjuhës së urrejtjes që shënjëstron personat që u përkasin komuniteteve joshumicë, Policia e Kosovës ka raportuar 12 raste të mundshme ndëretnike që i përkasin periudhës raportuese. Në tetor të viti 2022, një ish-ministër i qeverisë u dënua me një vit burg për nxitje të urrejtjes etnike, përçarjes ose mostolerancës.

Legjislacioni dhe mekanizmat institucionalë për **barazi gjinore** janë gjerësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Pavarësisht përpjekjeve për të forcuar zbatimin e këtyre mekanizmave, gratë vazhdojnë të përballen me diskriminim në administratë publike (*shih seksionin e administratës publike*), tregun e punës (*shih funksionimin e ekonomisë*), qasjen në financa, pronësi të pronës (*shih seksionin e pronës*) dhe trajtimin nga sistemi i drejtësisë (*shih seksionin për drejtësi/sundim të ligjit*).

Institucionet e Kosovës bënë disa përpjekje për ta vendosur barazinë gjinore më lart në agjendën e tyre politike. Presidentja organizoi Forumin e parë për Gratë në Paqe dhe Siguri dhe krijoi një grup punues për barazi gjinore në kuadër të Këshillit për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut për të analizuar harmonizimin e ligjeve me Ligjin për barazi gjinore. Masat e qeverisë për të përmirësuar fuqizimin ekonomik të grave kanë rritur numrin e grave që kanë hapur llogari bankare për të marrë shtesa për fëmijë.

Agjencia për Barazi Gjinore vazhdon të luajë rol kyç në avancimin e barazisë gjinore. Ajo publikoi me vonesë të gjatë raportin e parë të monitorimit për planin e veprimit për barazi gjinore 2020-2021. Koordinimi me zyrtarët për barazi gjinore në ministri dhe komuna është përmirësuar, megjithëse rolet dhe përgjegjësitë e tyre ende nuk janë harmonizuar. Ngritja e kapaciteteve për barazi gjinore duhet të zgjerohet për të siguruar që të gjithë nëpunësit civilë të përmbushin përgjegjësitë e tyre në këtë drejtim, veçanërisht ata në pozita drejtuese. Shoqëria civile vazhdoi të luante rol kritik në avancimin e barazisë gjinore. Ajo kontribuon në përmirësimin e legjislacionit, monitoron zbatimin e politikave, ofron shërbime, ndihmon viktimat e dhunës dhe rrit ndërgjegjësimin, duke reflektuar nevojën që autoritetet të rrisin më tej angazhimin e tyre në këto fusha.

Dhuna në familje vazhdon të jetë forma më e shpikatur e dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Është krijuar drejtoria e policisë për parandalimin dhe hetimin e dhunës në familje. Zbatimi mbetet i pamjaftueshëm pavarësisht përpjekjeve institucionale, përkundër që korniza ligjore dhe institucionale në këtë fushë është kryesisht në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Kosova duhet të ketë prioritet zbatimin e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore, duke përfshirë edhe miratimin e akteve nënligjore përkatëse. Ka pasur progres të kufizuar në parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje, mbrojtjen dhe ri-integrimin e viktimave dhe rehabilitimin e kryerësve të dhunës. Raportimi i dhunës në familje është rritur, ndonëse rastet ende nuk trajtohen në mënyrë adekuate (*shih gjyqësori*). Numri i përgjithshëm i rasteve të raportuara gjatë periudhës raportuese vazhdoi të rritet (2 710 në vitin 2022, kundrejt 2 456 në vitin 2021). Rastet e spikatura të dhunimeve dhe femicideve shkaktuan zemërim publik.

Format e tjera të dhunës ndaj grave vazhduan. Gratë në jetën publike, përfshirë edhe deputetet, vazhdojnë të gjykohen dhe të stereotipizohen. Ngacmimet seksuale, turpërimi i trupit dhe sulmet e tjera verbale vazhdojnë, por reagimet nga zyrtarët publikë, institucionet, shoqëria civile dhe organizatat e të drejtave të grave vazhdojnë të kontribuojnë për ta bërë seksizmin më pak të pranueshëm. Zbatimi i politikës së qeverisë të dhjetorit të vitit 2020 kundër ngacmimit seksual në administratën publike mbetet sfidë, me njohuri të kufizuara të politikës brenda institucioneve.

Ministria e Drejtësisë ka vazhduar me përpjekjet e saj për t'i dhënë vizibilitet këtij fenomeni dhe për të trajtuar mangësitë institucionale dhe ligjore. Veprimi i fundit i qeverisë përfshin propozimin për të ndryshuar legjislacionin penal për të mbrojtur viktimat dhe për të rritur dënimet për kryerësit. Pozita e Koordinatorit kundër Dhunës në Familje ka mbetur e zbrazët që nga shtatori 2022. Ky emërim është thelbësor për mbikëqyrjen dhe monitorimin e strategjisë dhe planit të veprimit 2022 kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Në dhjetor të vitit 2022, Ministria e Drejtësisë miratoi Protokollin Shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës me

bazë gjinore, i cili përcakton përgjegjësitë për çdo institucion. Kjo duhet të zbatohet shpejt.

Në vitin 2023, qeveria rriti fondet e ndara për strehimoret për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe i dorëzoi fondet me kohë. Megjithatë, mbështetja financiare është ende e pamjaftueshme. Nevojitet një linjë buxhetore shumëvjeçare në buxhetin e Kosovës dhe zotime të financimit nga komunat. Funksionimi i mekanizmave komunalë koordinues për dhunën në familje është ende i parregulluar.

Lidhur me **të drejtat e fëmijëve**, korniza ligjore e Kosovës është kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, por zbatimi mbetet i kufizuar. Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve ofron këshilla dhe koordinon politikat shtetërore për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijëve në të gjitha fushat. Zbatimi i Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve është vonuar. Nga 17 pjesë të legjislacionit zbatues të planifikuar, vetëm 6 janë publikuar në Fletoren Zyrtare. Sipas udhëzimeve administrative që dalin nga ligji, u krijua Këshilli për të Drejtat e Fëmijëve, duke e bërë atë mekanizmin më të lartë profesional në nivel qendror që koordinon punën për zbatimin e ligjit. Ekipet për të drejtat e fëmijëve janë themeluar në 14 komuna. Mbledhja sistematike e të dhënave të besueshme dhe të krahasueshme të ndara sipas moshës dhe gjinisë do të kontribuojë në zhvillimin e prioriteteve të politikave të bazuara në prova dhe do të sigurojë mbrojtje efektive të fëmijëve.

Institucioni i Avokatit të Popullit vazhdoi të fuqizojë departamentin e tij për mbrojtjen e fëmijëve; për këtë qëllim finalizoi një program për raportimin, mbrojtjen dhe monitorimin e të drejtave të fëmijëve. Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit ka pranuar 80 ankesa, prej të cilave 20 janë vlerësuar si të papranueshme dhe 60 ankesa janë referuar për hetim. Duhet të miratohet legjislacioni i mëposhtëm: (i) Kodi Civil, i cili përfshin mes qëllimeve të tij rregullimin e koncepteve ligjore dhe sqarimin e dispozitave për trajtimin e fëmijëve në situata shumë të ndjeshme; dhe (ii) projektligji për financat e pushtetit vendor, i cili ka një grant specifik për shërbimet sociale që do të mundësojë zbatimin më të mirë të ligjit për mbrojtjen e fëmijëve.

Fëmijëve me aftësi të kufizuara u mungon qasja e duhur në arsim. Në një përpjekje të rëndësishme për të adresuar këtë sfidë, 100 asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta dhe tre përkthyes të gjuhës së shenjave u punësuan gjatë periudhës raportuese. Tetëdhjetë drejtorë të shkollave të mesme profesionale, 25 arsimtarë të shkollave profesionale dhe 18 arsimtarë të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta janë trajnuar për arsimin gjithëpërfshirës. Autoritetet gjithashtu duhet të bëjnë më shumë përpjekje për të arritur tek fëmijët me aftësi të kufizuara që mbetën jashtë sistemit arsimor dhe për të zgjeruar shërbimet sociale dhe mjekësore të bazuara në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke përfshirë rritjen e mbështetjes financiare.

Nuk u ndërmor asnjë hap për miratimin e Kodit Civil, i cili do të mundësonte mbështetjen e personave në kujdestari deri në moshën 26 vjeçare, në vend të asaj 18 vjeçare. Ka mungesë të shërbimeve cilësore dhe programeve të dedikuara për parandalimin dhe ri-integrimin e fëmijëve viktime të abuzimit me drogën. Të dhënat zyrtare janë të paplota. Shërbimet për trajtimin e fëmijëve që përdorin drogë në sistemin shëndetësor publik janë joekzistuese. Ligji i ri për edukimin në fëmijërinë e hershme mbetet pezull. Gjatë viteve, autoritetet nuk kanë arritur të trajtojnë problemet që lidhen me fëmijët në rrugë, përfshirë kërkim lëmshëm e fëmijëve. Martesat e fëmijëve, martesat e hershme dhe të detyruara mbeten çështje veçanërisht në mesin e komuniteteve rom dhe ashkali. Ndërsa Ligji për mbrojtjen e fëmijëve synon të parandalojë dhunën fizike ndaj fëmijëve, ai mbetet shqetësim në shoqëri. Për më tepër, nuk ka familje birësuese të krijuara për të siguruar kujdesin e fëmijëve në konflikt me ligjin, pavarësisht nga dispozitat ligjore në fuqi për ta adresuar këtë. Një strategji gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e fëmijëve është e nevojshme për të përshpejtuar de-institucionalizimin dhe



kalimin drejt shërbimeve cilësore të kujdesit me bazë në familje dhe në komunitet, duke përfshirë fokusin adekuat në përgatitjen e fëmijëve për të lënë kujdesin. Ndërsa Ligji për mbrojtjen e fëmijëve synon të parandalojë dhunën fizike ndaj fëmijëve, ai mbetet shqetësim në shoqëri.

**Personave me aftësi të kufizuara** iu mungon qasja në kujdes shëndetësor, rehabilitim, shërbime sociale, arsim dhe pajisje ndihmëse si dhe infrastrukturë fizike. Ka një boshllëk të qartë në harmonizimin e ligjeve dhe politikave me Konventat e rëndësishme të OKB-së dhe *acquis* të BE-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Udhëzimi administrativ për qasjen e personave me aftësi të kufizuara është në fuqi, por nuk po zbatohet. Diskriminimi i drejtpërdrejtë ndaj personave me aftësi të kufizuara është vërtetuar përmes një vendimi gjyqësor. Pesë persona me aftësi të kufizuara kanë ngritur padi kundër institucioneve të ndryshme në Kosovë bazuar në Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi. Në vitin 2022, vendimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës konfirmoi diskriminimin në një rast. Në përgjithësi, shërbimet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara duhet të përmirësohen, duke përfshirë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara. Punësimi i personave me aftësi të kufizuara mbetet sfidë e madhe. Zbatimi i ligjit për statusin dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara është sfidë, ndërsa projektligji i ri mbetet pezull. Shoqëria civile ka shprehur shqetësimin për komisionin e vlerësimit mjekësor për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Qeveria shpalli vitin 2022 si vit të personave me aftësi të kufizuara. Në këtë kontekst, ajo ka filluar me disa iniciativa për të rritur qasjen në institucionet qendrore dhe lokale dhe në dokumentet ligjore dhe administrative. Qeveria nxori edhe një raport për progresin e planit të veprimit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Në dhjetor të vitit 2022, qeveria i kërkoi Kuvendit të inkorporojë Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në instrumentin e drejtpërdrejtë të zbatueshëm të të drejtave të njeriut të Kushtetutës.

Në lidhje me **të drejtat e personave lesbikë, homoseksualë, biseksualë, transgjinorë, interseksualë dhe homo (LGBTIQ)**, Kushtetuta mbron nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual ose gjinisë. Nuk mund të raportohet asnjë ndryshim domethënës në lidhje me ndërgjegjësimin e publikut dhe pranimin e personave LGBTIQ. Projekt Kodi Civil, i cili përfshin dispozita për partneritete civile për partnerët e të njëjtës gjini, ende nuk u miratua nga Kuvendi. Mbeten shqetësimet se diskutimet rreth bashkimeve të të njëjtës gjini nxisin gjuhë homofobike nga personalitet publike, personalitetet politike dhe organet e mediave. Plani i punës 2019-maj 2022 i Grupit Këshillues dhe Koordinues për të Drejtat e Komunitetit LGBTIQ ka skaduar. Shoqëria civile raporton mungesë të përmirësimit të qëndrimeve ndaj personave LGBTIQ. Shërbimet sociale të dedikuara ofrohen ekskluzivisht nga OJQ-të, të cilat raportojnë një rritje të shkallës së vetëvrasjeve në mesin e personave LGBTIQ dhe një rritje të rasteve të dhunës në familje. Nuk ka pasur progres në ndërtimin e planifikuar të një strehimoreje për viktimat LGBTIQ të dhunës në familje apo refuzimit familjar në komunën e Prishtinës. Sa i përket njohjes ligjore të gjinisë, procesi i ndryshimit të Ligjit për gjendjen civile mbetet pezull. Nevojitet trajnim i mëtejshëm për zyrtarët e zbatimit të ligjit, veçanërisht lidhur me të drejtat transgjinore, kualifikimin e krimeve të urrejtjes dhe viktimizimin dytësor.

**Të drejtat procedurale** të personave të dyshuar për krime dhe të drejtat e viktimave të krimit janë të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj. Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale kanë hyrë në fuqi në shkurt 2023, duke adresuar mangësitë në procedurën penale. Reformat përfshijnë një test me strikt për Gjykatën e Apelit në kthimin e çështjeve në rigjykim; lejen për gjykime në mungesë në lidhje me të gjitha llojet e veprave penale; dhe zgjerimin e sistemit të emërimit sipas detyrës zyrtare. Efekti i këtyre reformave do të varet nga interpretimi dhe zbatimi i tyre. Disa nga çështjet e mbetura shqetësuese janë proceset gjyqësore të vonuara dhe

të stërzgjatura që rrezikojnë të drejtën për një gjykim të drejtë, duke përfshirë rastet e dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore; mungesa e përkthyesve/interpretëve profesional dhe standardet me cilësi të ulët të përkthimit; përdorimi i tepruar i paraburgimit dhe konsiderimi i pamjaftueshëm i masave të tjera për sigurimin e pranisë së të pandehurve. Sa i përket të drejtave të viktimave, mbetet i pamjaftueshëm sigurimi i informacionit ligjor për viktimat e krimeve për të drejtat e tyre dhe për ndihmën dhe përfaqësimin profesional gjatë procedurave penale. Pavarësisht shtrirjes së ndihmës juridike falas për të gjitha gratë viktimat të dhunës me bazë gjinore, shumë pak nga to janë të përfaqësuara në proceset gjyqësore. Niveli i ofrimit të ndihmës juridike (si për viktimat ashtu edhe për të dyshuarit/të akuzuarit), ndonëse i përmirësuar, mbetet i joadekuat për shkak të legjislacionit kontradiktor, mungesës së ndërjegjësimit të publikut dhe sistemeve të ndryshme për ofrimin e ndihmës juridike falas. Buxheti i ndarë për ndihmë juridike në vitin 2022 ishte 1 877 134 euro, me një rritje prej 9.4% krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, buxheti i zbatuar në vitin 2022 ishte 1 692 393 euro, i ngjashëm me vitin 2021 (1 686 056 euro). Problem mbetet mungesa e një sistemi të sigurimit të cilësisë së ndihmës juridike falas. Nga 1 595 ankesa të pranuar nga Avokati i Popullit në vitin 2022, 472 kishin të bënin me të drejtën për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme. Zyrtarët për mbrojtje dhe ndihmë duhet të ofrojnë shërbime më cilësore për viktimat. Numri i kërkesave për programin e kompensimit të viktimave të krimit ishte i njëjtë me vitin 2021. Në vitin 2022, numri i përgjithshëm i kërkesave për kompensim ishte 53, me një të bartur nga viti 2021. Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit miratoi 27 prej këtyre kërkesave, me vlerë të përgjithshme prej 99 106 euro. Një zhvillim pozitiv për t'u theksuar është rritja e buxhetit të vitit 2023 në 148 000 euro, nga 78 000 euro në vitin 2022.

Kosova ka një kornizë ligjore të përcaktuar mirë për mbrojtjen e **të drejtave të komuniteteve** në nivel qendror dhe lokal. Këshilli Konsultativ për Komunitete në Zyrën e Presidentes, Zyra e Komisionerit për Gjuhët dhe Këshilltari për Komunitete i Kryeministrit vazhduan punën e tyre për të adresuar shqetësimet e tyre më urgjente. Këto përfshijnë qasjen e barabartë në arsim, punësim, mungesën e respektimit të gjuhës, përfaqësimin e tyre në institucionet e nivelit lokal dhe qendror, promovimin e identitetit kulturor dhe qasjen në mirëqenien sociale. Që nga nëntori i vitit 2022, Këshilli Konsultativ për Komunitete ka anëtarë të rinj të emëruar për mandatin e ardhshëm dyvjeçar: qeveria emëroi tre anëtarë në Këshill, që është një hap pozitiv. Gjatë periudhës raportuese, përfaqësues nga institucionet qendrore kryen një sërë vizitash në komunitetet joshumicë, duke u fokusuar në komunikimin me shoqërinë civile dhe sektorin e biznesit. Në të njëjtën kohë, mbeten sfida lidhur me koordinimin institucional ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes dhe financimin e pamjaftueshëm të mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve. Iniciativave që synojnë adresimin e problemeve konkrete u mungon angazhimi politik dhe kryesisht drejtohen nga donatorët. Për më tepër, shqetësimet e sigurisë, qasja e pabarabartë në arsim, punësim dhe mirëqenie sociale, qasja në pronat e uzurpuara dhe mosrespektimi i Ligjit për gjuhët mbeten gjerësisht të paadresuara. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar gjithëpërfshirje për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë.

Strategjia për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre 2023-2027 është në pritje. Për më tepër, emërimi i ministrit të ri serb të Kosovës për Komunitete dhe Kthim më 1 dhjetor 2022 ngriti pikëpyetje në lidhje me pajtueshmërinë e këtij emërimi me Kushtetutën. Nëse i emëruari nuk është anëtar i zgjedhur i Kuvendit, Kushtetuta kërkon miratimin zyrtar nga shumica e deputetëve serbë të Kosovës.

Janë ndërmarrë hapa për emërimin e drejtorit të ri të Zyrës për Çështje të Komuniteteve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit; përkundër kësaj, posti ka mbetur i zbrazët që nga shkurti i vitit 2021. Për herë të parë që nga viti 2019, në maj qeveria rimblodhi Grupin Punues Teknik

për zbatimin e rekomandimeve të Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Pakicat Kombëtare.

Institucioneve të Kosovës ende u mungojnë kapacitetet për të siguruar zbatimin adekuat të Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Mungesa e përkthimit të faqeve zyrtare të internetit të institucioneve të nivelit qendror dhe lokal në të dyja gjuhët zyrtare pengon qasjen e barabartë në informacion. Mospërputhja ndërmjet përkthimeve në gjuhën shqipe dhe serbe të legjislacionit dhe numri i kufizuar i përkthyesve, duke përfshirë edhe gjykatat, kufizon qasjen e barabartë në drejtësi për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë. Grupi i punës, i përbërë nga përfaqësues të Zyrës së Kryeministrit si dhe partnerë ndërkombëtarë, u krijua për të udhëhequr punën përgatitore për ngritjen e njësisë për përkthim, harmonizim dhe kontroll gjuhësor. Deri në fund të majit 2023, grupi i punës kishte mbajtur tri takime.

Programi i Studimeve Ballkanike i Fakultetit Filologjik të Universitetit të Prishtinës është i vetmi program arsimor i ofruar nga sistemi arsimor i Kosovës në të dyja gjuhët zyrtare. Programit i mungon përkrahja dhe promovimi konkret nga institucionet e Kosovës për të adresuar shkallën e ulët të regjistrimit (nën 15 studentë).

Ndërprerja në vitin 2021 e punës së Komisionit për verifikimin e diplomave universitare të marra nga Universiteti (i drejtuar nga Serbia) në Mitrovicën e Veriut vazhdoi të ndikojë tek të diplomuarit nga ky universitet dhe të pengojë qasjen e tyre në punësim. Përveç kësaj, mungesa e njohjes së diplomave të shkollës së mesme të marra nga sistemi arsimor i drejtuar nga Serbia, i kombinuar me qasje të kufizuar në punësim dhe një situatë të keqe ekonomike, e përkeqëson migrimin e të rinjve nga komunitetet joshumicë jashtë Kosovës. Në shkurt të vitit 2023, qeveria e Kosovës nxori një vendim për rithemelimin e Komisionit, i cili deri në mes të majit mbajti tetë takime procedurale. Deri më 21 qershor, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit kishte pranuar 44 aplikacione, prej të cilave asnjë nuk ishte verifikuar ende.

Incidentet ndëretnike të sigurisë dhe potencialisht të motivuara etnikisht vazhdojnë të ndikojnë negativisht në perceptimin e mbrojtjes dhe sigurisë në mesin e komuniteteve joshumicë. Edhe pse numri i incidenteve potencialisht të motivuara etnikisht që prekin komunitetet joshumicë në vitin 2022 vazhdoi trendin e tij afatgjatë në rënie, perceptimi i sigurisë në mesin e disa komuniteteve jo-shumicë është përkeqësuar, veçanërisht në komunitetin serb të Kosovës.

Në përgjithësi, marrëdhëniet ndërmjet qeverisë dhe **komunitetit serb të Kosovës** janë përkeqësuar ndjeshëm. Pas një sërë krizash, serbët e Kosovës dhanë dorëheqje nga pozitat e tyre në institucionet e Kosovës në nëntor të vitit 2022 dhe më pas shumë prej tyre nënshkruan kontrata punësimi me qeverinë serbe. Kosova dhe Serbia duhet të kenë prioritet mundësimin e kthimit të shpejtë të serbëve të Kosovës në institucionet e Kosovës. Për më tepër, Kosova duhet të bëjë përpjekje shtesë për të ndërtuar besimin me këtë komunitet. Shpronësimet e tokave private në veri të Kosovës dhe prania e shtuar e njërive speciale policore në veri kanë krijuar pakënaqësi të gjerë në mesin e popullatës lokale serbe të Kosovës, kanë ndikuar negativisht në besimin e popullatës serbe të Kosovës në institucionet e Kosovës dhe kanë ndikuar negativisht në dialog.

Në vitin 2022, kthimi dhe ri-integrimi vullnetar i **refugjatëve dhe personave të zhvendosur** vazhdoi të shënojë një trend të lehtë të rënies. Sipas Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë, 204 persona u kthyen, krahasuar me 368 në vitin 2021. Është arritur njëfarë progresi, ku Ministria për Komunitete dhe Kthim ka finalizuar dhe vënë në funksion sistemin e menaxhimit të rasteve të kthimit që përbëhet nga një bazë e të dhënave për kthimet dhe komisioni për ankesa.

Në vitin 2022, Kosova miratoi strategjinë për avancimin e të drejtave të komunitetit **romë dhe ashkali** 2022-2026 dhe planin e veprimit 2022-2024. Kuvendi Komunal në Prizren njëzëri

votoi për t'i dhënë gjuhës rome statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në nivel komunal, që do të thotë se gjuha rome është gjuhë në përdorim zyrtar në nivel komunal në dy komuna të Kosovës. Po ashtu, Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, në bashkëpunim me projektin Drejtësia Sociale për Romë, Ashkali dhe Egjiptian, ka lansuar Platformën Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi për Komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian, të cilën anëtarët e këtyre komuniteteve mund ta përdorin për të denoncuar aktet e diskriminimit. Megjithatë, ligji kundër diskriminimit mbetet kryesisht joefektiv në luftimin e anti-ciganizmit. Sfidë mbetet situata e banimit për shkak të kushteve jo të mira të jetesës dhe mungesës së dokumenteve pronësore. Komunitat në Kosovë kanë bërë progres në përfshirjen e vendbanimeve, banorët e të cilave kryesisht i përkasin komuniteteve të marginalizuara në planet e tyre zhvillimore urbane. Megjithatë, nevojitet më shumë vullnet politik për të rritur nivelin e investimeve dhe ndërtimin e infrastrukturës në këto vendbanime. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të transformuar punën e padeklaruar në mesin romëve për të zbatuar objektivin e Deklaratës së Poznanit për punësimin. Qeveria krijoi një ekip ndër-institucional për të promovuar punësimin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, të udhëhequr nga Zyra për Qeverisje të Mirë.

Në lidhje me **të drejtat kulturore**, nuk ka pasur zhvillime në lidhje me miratimin e Ligjit të ri për trashëgiminë kulturore. Marrëdhëniet ndërmjet qeverisë dhe Kishës Ortodokse Serbe dëshmuar një përkeqësim të mëtejshëm pas incidentit të 26 dhjetorit 2022 kur Patriarkut iu mohua hyrja në Kosovë. Mosbesimi i ndërsjellë dhe faktorët e ndërlikuar për shkak të tensioneve politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk kanë ofruar një mjedis të favorshëm që Këshilli Zbatues dhe Monitorues të rifillojë punën e tij, e cila ishte pezulluar që nga nëntori i vitit 2021. Për më tepër, nuk ka pasur zbatim të 'marrëveshjes' të dakorduar më parë për gjetjen e zgjidhjes së punimeve në rrugën në zonën e posaçme mbrojtëse të Manastirit të Deçanit. Përpjekjet drejt ri-funksionalizimit të Këshillit Zbatues dhe Monitorues duhet të merret si çështje me prioritet. Kosova duhet të kompletojë legjislacionin në fushën e trashëgimisë kulturore duke finalizuar dhe miratuar Ligjin përkatës për trashëgiminë kulturore.

### 2.2.2 Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria

Kosova është **ndërmjet një faze të hershme dhe njëfarë niveli të përgatitjes** në këtë fushë. Është arritur **progres i kufizuar**. Përmirësimet e mëparshme në legjislacionin për luftën kundër krimit të organizuar nuk kanë dhënë ende rezultate të prekshme. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të siguruar hetime më proaktive, marrë vendime gjyqësore përfundimtare dhe bërë konfiskimin përfundimtar të pasurisë. Kosova ka avancuar në fushën e luftimit të terrorizmit dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm duke arritur progres në zbatimin e marrëveshjes dypalëshe për luftën kundër terrorizmit me Komisionin Evropian. Po ashtu është arritur progres në menaxhimin e migrimit pasi u rrit kapaciteti akomodues për migrantët. Kosova ka kapacitet për të akomoduar një fluks migrimi deri në 2 000 persona. Sa i përket politikës së saj të azilit, Kosova duhet të sigurojë që refugjatët të përfshihen në skemat e mbrojtjes sociale. Kosova duhet të zhvillojë një fushatë informuese për të drejtat dhe obligimet lidhur me statusin e udhëtimit pa viza, për të parandaluar keqpërdorimet e mundshme. Në fushën e drogës, Kosova ende nuk e ka miratuar strategjinë e re dhe planin e veprimit për drogën, për të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar kapacitetin operacional të observatorit të saj kombëtar të drogës dhe për të krijuar një sistem të paralajmërimit të hershëm. Meqenëse rekomandimet e vitit të kaluar janë zbatuar vetëm pjesërisht, ato mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

- të vazhdojë të forcojë kapacitetin e Prokurorisë Speciale dhe të përmirësojë më tej hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të krimit të organizuar të profilit të lartë;
- të krijojë Qendrën Kombëtare për Luftimin e Terrorizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm, ose të forcojë Zyrën e Koordinatorit Nacional për LT/LEDH me burime adekuate financiare

dhe njerëzore dhe të sigurojë praktikën e rregullt të kryerjes së vlerësimeve të përbashkëta të kërcënimeve;

- të zbatojë Planin të Veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor duke: përmirësuar më tej qeverisjen e migrimit, koordinimin dhe monitorimin e politikave; forcimin e kapaciteteve për mbledhjen dhe analizën e të dhënave; forcimin e mëtejshëm të sistemit të azilit; duke ndryshuar Ligji për të huajt në përputhje me standardet e BE-së.

### **Lufta kundër krimit të organizuar**

Kosova është në **fazën e hershme** në luftën kundër krimit të organizuar dhe ka arritur **progres të kufizuar** në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të krimit të organizuar. Kosova duhet t'i shfrytëzojë më mirë mjetet ekzistuese të fuqishme të parapara me Kodin Penal dhe Ligjin për kompetencat e zgjeruara të konfiskimit. Kanë vazhduar operacionet e zbatimit të ligjit kundër krimit të organizuar; megjithatë, përpjekjet për hartimin dhe shënjestrimin e strukturave të krimit të organizuar duhet të intensifikohen më tej. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të siguruar hetime proaktive, marrë vendime gjyqësore përfundimtare dhe bërë konfiskimin përfundimtar të pasurisë. Pavarësia operationale e agjencive të zbatimit të ligjit duhet të sigurohet. Lufta kundër krimit të organizuar në veri të Kosovës vazhdon të jetë sfiduese, për shkak edhe të dorëheqjes së zyrtarëve serbë të Kosovës nga institucionet publike në vitin 2022. Në adresimin e kësaj çështje, autoritetet duhet të vazhdojnë të respektojnë rreptësisht të gjitha standardet përkatëse të sundimit të ligjit.

Kosova ka zbatuar pjesërisht rekomandimet e vitit 2022, kryesisht në lidhje me trajnimin dhe ngritjen e vetëdijes për legjislacionin e ri. Ajo ka miratuar një strukturë të re organizative policore dhe ka përmirësuar kapacitetet e inteligjencës dhe analizës. Bashkëpunimi me Europolin dhe Eurojustin ka avancuar më tej. Ligji i ri për zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare të shënjestruara duhet të jetë mjet efektiv në luftimin e krimit të organizuar. Përveç rekomandimeve për konfiskimin e pasurisë kriminale (shih seksionin për luftën kundër korrupsionit), në vitin e ardhshëm Kosova në veçanti duhet:

- të zbatojë në mënyrë efektive strukturën e re organizative të policisë dhe të vazhdojë zbatimin e qasjeve të policimit në bashkësi dhe të drejtuar nga inteligjenca si modele themelore të punës policore;
- të shënjestrojë dhe të hartëzojë në mënyrë proaktive dhe të përbashkët grupet e organizuara kriminale dhe të vazhdojë të kryejë në mënyrë sistematike hetime financiare në të gjitha fazat e hetimeve penale për të gjitha rastet serioze të krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe të fillojë hetimet e pavarura për pastrimin e parave;
- të shtojë përpjekjeve për të parandaluar dhe luftuar rrjetet kriminale të përfshira në kontrabandën e migrantëve dhe trafikimin e qenieve njerëzore, si dhe identifikimi dhe referimi i viktimave në shërbimet e asistencës; të sigurojë qëndrueshmëri financiare të strehimoreve dhe asistencë për viktimat e trafikimit.

### Struktura institucionale dhe harmonizimi ligjor

Policia e Kosovës ka 437 zyrtarë policorë për 100 000 banorë, krahasuar me mesataren e BE-së prej 335.3 për 100 000 banorë (Eurostat, 2019-2021); 85% e zyrtarëve policor janë meshkuj dhe 15% janë femra. Në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike kanë diplomuar gjithsej 446 kadetë, përfshirë 53 femra. Gjatë periudhës raportuese, 578 zyrtarë policor serbë të Kosovës nga veriu i Kosovës dhanë dorëheqje nga Policia e Kosovës pas vendimit të përfaqësuesve politikë serbë të Kosovës për të braktisur institucionet e Kosovës në katër komunat veriore. Kjo krijoi një vakum sigurie dhe kushte të favorshme për krimin e organizuar në veri të Kosovës. Për të adresuar situatën, Policia e Kosovës ka zhvendosur përkohësisht zyrtarët policor shqiptarë të Kosovës nga

Mitrovica e Jugut për të plotësuar pozitat e lira. Po ashtu, Policia e Kosovës ka bërë dy thirrje të ndara për të rekrutuar zyrtarë policor joshumicë në Drejtorinë Rajonale të Policisë së Mitrovicës Veriore. Në procesin e parë të rekrutimit, nga 145 aplikacione të pranuar (116 meshkuj dhe 29 femra), u regjistruan 73 kandidatë joshumicë (57 meshkuj dhe 16 femra), duke përfshirë 43 serbë të Kosovës (36 meshkuj dhe 7 femra). Në procesin e dytë të rekrutimit, i cili u mbyll më 30 maj 2023, nga 205 aplikacione të pranuar (167 meshkuj dhe 38 femra), 87 (69 meshkuj dhe 18 femra) ishin nga serbët e Kosovës. Përbërja e policisë duhet të pasqyrojë përbërjen etnike të katër komunave. Është shqetësuese dorëheqja e disa kadetëve të policisë të angazhuar rishtazi nga komunitetet joshumicë pas frikësimit të tyre.

Prokuroria Speciale, Departamenti Special i Gjykatës Themelore dhe Gjykata e Apelit në Prishtinë janë institucionet kryesore të përfshira në luftën kundër krimit të organizuar. Rreth 15 staf shtesë mbështetës u punësuan në Prokurorinë Speciale në vitin 2022. Rritja e stafit deri më tani nuk ka pasur ndikim të konsiderueshëm në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të krimit të organizuar të profilit të lartë.

Në mars të vitit 2023, Kryeministri emëroi Drejtorin e ri të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, pas një procesi transparent dhe konkurrues të rekrutimit. Në të njëjtin muaj, Ministri i Punëve të Brendshme dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës miratuan strukturën e re organizative të policisë dhe themeluan një grup punues për të mbikëqyrur zbatimin e strukturës së re. Për të emëruar zyrtarë policor të kualifikuar, procesi duhet të jetë transparent, i paanshëm dhe meritokratik dhe kërkon angazhim nga drejtuesit e policisë. Struktura e re e policisë është e organizuar rreth tri shtyllave kryesore: operacionet, hetimet dhe policia kufitare dhe promovon dy koncepte kryesore: policimin në bashkësi dhe policimin e drejtuar nga inteligjenca. Departamenti i Hetimeve të Policisë, përgjegjës për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e krimit të organizuar dhe veprave që ndërlidhën me korrupsionin, është ristrukturuar gjithashtu. Drejtoria e Inteligjencës dhe Analizës është shndërruar në një departament të veçantë, me zyra të veçanta. Përveç kësaj, Divizioni i Hetimit të Krimit përfshin drejtoritë për krimet kibernetike dhe krimet e luftës.

Grupet punuese vazhduan monitorimin e zbatimit të dokumenteve strategjike të policisë, duke përfshirë planin strategjik të zhvillimit 2021-2025, qasjen e integruar të policisë së udhëhequr nga inteligjenca, strategjinë e policimit në bashkësi dhe planin e veprimit 2021-2025. Në korrik 2023, grupi i dytë i detyrave dhe koordinimit të nivelit strategjik identifikoi prioritetet kyçe bazuar në raportin vjetor të vlerësimit strategjik të krimit. Ministria e Punëve të Brendshme duhet të marrë parasysh gjetjet e analizës së vlerësimit të rrezikut nga policia të ndërtesave qeveritare, dhe në përputhje me rrethanat, të shmang angazhimin e zyrtarëve policorë nga detyrat që nuk janë detyra kryesore të shërbimit policor.

Policia Kufitare e Kosovës, administrata e Doganave të Kosovës, Njësia për Inteligjencë Financiare dhe Administrata Tatimore mbeten përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e qarkullimit të brendshëm dhe ndërkufitar/kufitar të mallrave, materialeve dhe kapitalit që mund të përfshihen në çfarëdo forme të krimit të organizuar. Administrata e Doganave të Kosovës dhe Njësia e Inteligjencës Financiare vazhduan të performojnë mirë. Zyra e Rikuperimit të Pasurisë (“Njësia për Hetimin e Pasurisë” sipas strukturës së re organizative të policisë), e cila mbetet funksionale, vazhdoi të pranonte kërkesa të kufizuara për rikuperim të pasurisë. Autoritetet duhet të mbështesin dhe përshpejtojnë transferimin e Zyrës së Rikuperimit të Pasurisë në Prokurorinë e Shtetit dhe të caktojnë staf të dedikuar nga prokuroria, policia, Njësia e Inteligjencës Financiare, Doganat dhe Administrata Tatimore. Sistemi Informativ i Policisë është avancuar dhe është lidhur me baza të tjera të të dhënave të zbatimit të ligjit. Legjislacioni zbatues rregullon nivelet e qasjes në Sistemin Informativ të Policisë dhe siguron harmonizim të plotë ndërmjet bazave të ndryshme të të dhënave.

Procesi i riorganizimit të brendshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil ka vazhduar të ngecë gjatë periudhës raportuese. Vonesa ka pasur në rishikimin e Ligjit për Agjencinë e Regjistrimit Civil, i cili mbetet në pritje. Agjencia funksionon pa plan strategjik për të drejtuar vizionin e saj për zhvillim dhe modernizim, apo për t'u përafuar me procesin e reformës së administratës publike. Prej më shumë se 2 vite, një ushtrues detyre i Drejtorit të Përgjithshëm drejton Agjencinë e Regjistrimit Civil. Zyra Kombëtare e Auditimit konstatoi se Agjencia e Regjistrimit Civil ende nuk ka krijuar një kornizë të rrezikut të qeverisjes së TI-së dhe pajtueshmërisë për të garantuar vazhdimësi në funksionimin e sistemeve të saj të informacionit. Sistemet aktuale nuk garantojnë konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e mjaftueshme të të dhënave. Për shkak të problemeve në zinxhirin e furnizimit, për mbi 4 muaj, në gjysmën e dytë të vitit 2022, dokumentet/pasaportat personale kanë mundur të lëshoheshin vetëm në raste emergjente. Duhet të ndërmerren hapa urgjent për të siguruar ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve thelbësore për qytetarët.

Lidhur me **kornizën strategjike kryesore**, strategjia sektoriale e sundimit të ligjit përbëhet nga plani strategjik i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe strategjive të tjera përkatëse për kontrollin e armëve, ekonominë informale, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, luftimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore dhe sigurinë kibernetike. Të gjitha institucionet përkatëse duhet të bashkëpunojnë për zbatimin e këtyre dokumenteve strategjike në mënyrë efektive. Strategjitë dhe planet e veprimit 2018-2022 kundër narkotikëve dhe krimit të organizuar në Kosovë kanë skaduar. Autoritetet duhet të vlerësojnë zbatimin e strategjive të mëparshme të skaduar dhe të miratojnë dokumentet strategjike dhe planet e tyre përkatëse të veprimit për periudhën në vijim. Përveç raportit vjetor të vlerësimit strategjik të krimit, Policia e Kosovës përgatit një raport të vlerësimit të krimit të rëndë dhe të organizuar çdo 3 vite.

**Korniza ligjore** për luftën kundër krimit të organizuar është gjerësisht e përafuar me *acquis* të BE-së. Për arsyet që ndërlidhen me statusin, Kosova nuk është palë e konventave ndërkombëtare për luftën kundër krimit të organizuar, siç është Konventa e OKB-së për krimin transnacional dhe të organizuar (konventa e Palermos), por ende i zbaton këto parime ndërkombëtare në **legjislacionin e saj penal**.

**Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit** duhet të ndryshohet për të qenë plotësisht në përputhje me Direktivat 4 dhe 5 të BE-së për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit dhe me standardet ndërkombëtare në zhvillim. Qeveria duhet të rishikojë legjislacionin për të siguruar përputhjen e plotë të saj me këto direktiva dhe rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF). Kuvendi miratoi Ligjin për zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare të shënjestruara. Kosova ka arritur progres në forcimin e regjimit të rikuperimit të pasurisë, pasi ka miratuar një koncept dokument për krijimin fondit të konfiskimit. Në vitin 2022, Kuvendi miratoi Ligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificuar, duke futur konceptin e pasurimit të paligjshëm në sistemin juridik vendor dhe duke ofruar bazën për themelimin e Byrosë për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në opozitë ka parashtruar kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së ligjit në Gjykatën Kushtetuese. Për të rritur transparencën e personave juridikë dhe marrëveshjeve, qeveria miratoi një koncept dokument për regjistrin e pronësisë përfutuese, duke adresuar mangësitë e identifikuar nga vlerësimi i Këshillit të Evropës i vitit 2018 kundër pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit (PPP/LFT) dhe duke trazuar rrugën për ndryshime legjislative.

Në zbatimin e Ligjit për përgjimin e komunikimeve elektronike, kapacitetet e përmirësuara të përgjimit dhe prokurimi i pajisjeve teknike rezultuan në decentralizimin e qendrave të monitorimit në drejtoritë e tjera të policisë rajonale. Legjislacioni për **krimin kibernetik** në përgjithësi është

në përputhje me *acquis* të BE-së. Policia e Kosovës ka avancuar njësinë e saj për luftimin e krimeve kibernetike në drejtori për luftimin e krimeve kibernetike dhe do të mundësojë rritjen e numrit të hetuesve të krimeve kibernetik në përputhje me strukturën e saj organizative të miratuar rishtazi. **Legjislacioni për trafikimin e qenieve njerëzore** është në përputhje të gjerë me *acquis* përkatës të BE-së, por zbatimi ka mbetur i kufizuar. Në maj të vitit 2023, Ministria e Punëve të Brendshme miratoi Udhëzimin Administrativ për Bazën e të Dhënave për Viktimat e Trafikimit me Qenie Njerëzore. Kodi i ri i Procedurës Penale, i cili hyri në fuqi në shkurt 2023, e për afroi më tej legjislacionin e Kosovës me *acquis* përkatës të BE-së lidhur me aspektet procedurale të veprave penale të trafikimit. Strategjia dhe plani i veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2022-2026 po zbatohen pa probleme. Në nëntor të vitit 2022, Ministria e Drejtësisë miratoi Protokollin Shtetëror për trajtimin e rasteve të **dhunës seksuale**, duke përcaktuar përgjegjësitë e çdo institucioni përkatës.

### Implementimi dhe kapaciteti zbatues

Autoritetet e Kosovës vazhdojnë të raportojnë për numrin e përgjithshëm të aktakuzave dhe dënimeve për akuzën e ‘krimit të organizuar’ siç përcaktohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Krimin e Organizuar Transnacional. Gjatë vitit 2022, janë iniciuar 25 raste të reja (19 raste në vitin 2021) dhe janë dënuar 16 persona.

Lidhur me **historikun** e liberalizimit të vizave në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar të nivelit të lartë, shih seksionin për luftën kundër korrupsionit.

Në lidhje me **rastet e ndërlidhura me krimin e organizuar dhe rastet krimeve të rënda** aktualisht të papërfshira në historikun e sipërpërmendur, gjatë vitit 2022, 50 raste që ndërlidhen me trafikimin e qenieve njerëzore ku përfshihen 70 persona janë iniciuar (70 në vitin 2021), dhe prokuroria ka ngritur aktakuza kundër 42 personave (45 aktakuza janë ngritur në vitin 2021). Në vitin 2022, u dënuan 14 persona (3 në vitin 2021). Gjithashtu, në vitin 2021, janë akuzuar 3 persona (23 në vitin 2020) për trafik të paligjshëm të armëve të zjarrit; nuk kishte vendime gjyqësore (3 persona të dënuar në vitin 2021). Për pastrim të parave, ndaj 2 personave ishin ngritur aktakuza në vitin 2022 (9 në vitin 2021) dhe 3 person ishin dënuar (1 në vitin 2021). Policia dhe prokuroria duhet të vazhdojnë të përdorin në mënyrë aktive të gjitha kompetencat që kanë në dispozicion për të shënjestruar rrjetet kriminale dhe bazën e tyre të mbështetjes ekonomike. Politika e dënimit mbetet e paqëndrueshme (shih seksionin për gjyqësorin). Numri i ulët i pasurisë kriminale të konfiskuara është ende shqetësim primar (shih seksionin për luftën kundër korrupsionit). Institucionet e përfshira në luftën kundër krimit të organizuar duhet të krijojnë dhe përdorin ekipe hetimore të përbashkëta shumëdisiplinore, aty ku është e mundur.

Policia e Kosovës ka kapacitet dhe aftësi bazë për të luftuar krimin e organizuar në Kosovë. Megjithatë, hetimet e krimit të organizuar mbeten të prekshme ndaj korrupsionit dhe ndërhyrjeve të panevojshme. Kjo çështje duhet të trajtohet me më shumë masa parandaluese kundër korrupsionit, siç janë trajnimet efikase të integritetit dhe etikës, si dhe hetimet disiplinore dhe penale. Ndryshimet në strukturën organizative të Policisë së Kosovës synojnë të zbatojnë planet e integritetit të policisë duke krijuar një Sektor të ri për Integritet nën Zëvendësdrejtorin e ri të Përgjithshëm. Ministria e Punëve të Brendshme, siç është paraparë me Ligjin për Inspektoratin Policor, duhet të miratojë një plan për zbatimin e rekomandimeve të Inspektoratit Policor. Deri më tani kjo ende nuk është bërë. Gjatë vitit 2022, Inspektorati Policor ka hetuar 257 zyrtarë, që ka rezultuar me suspendimin e 164 zyrtarëve policorë; plotësimi i vendeve të zbrazëta që rezultojnë është i ngadalshëm. Trendi pozitiv i **operacioneve të suksesshme policore** në shënjestrimin e krimit të organizuar vazhdoi gjatë periudhës raportuese, duke përfshirë gjithashtu bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndërkufitar. Në vitin 2022, policia shkatërroi 34 grupe të krimit të organizuar (49 në vitin 2021), një rënie prej 30% në vitin 2021. Arsyet kryesore për uljen janë



të dyfishta: rritja e ricaktimit të policisë në detyra operacionale në veri, veçanërisht gjatë pjesës së dytë të vitit 2022, dhe fokusimi i hetimeve në raste më komplekse. Operacionet kundër grupeve të krimit të organizuar rezultuan në një sërë arrestimesh dhe konfiskim paraprak të pasurisë, të cilat duhet të ndiqen nga prokuroria dhe gjyqësori. Lufta kundër strukturave të krimit të organizuar duhet të intensifikohet. Hetimet duhet të jenë më proaktive dhe grupet kriminale duhet të shënjestrohen në mënyrë adekuate. Policia duhet të synojë grupet dhe strukturat kriminale në vend të llojeve të vetme të krimit. Struktura e re organizative e policisë është një përmirësim në këtë drejtim.

Njësia Speciale Hetimore e Policisë së Kosovës ka vazhduar të luajë rol thelbësor në hetimin e rasteve të korrupsionit të profilit të lartë. Në vitin 2022, Njësia Speciale Hetimore trajtoi 98 raste të korrupsionit, 46 prej të cilave ishin të profilit të lartë. Prokuroria ka pranuar 6 kallëzime penale. Janë ngritur katër aktakuza dhe janë mbyllur 13 raste. Qeveria duhet të sigurojë që Njësia Speciale Hetimore e policisë, pasardhësi i Task Forcës së shfuqizuar kundër Korrupsionit, të ketë një strukturë të shëndoshë ligjore dhe organizative (shih seksionin për luftën kundër korrupsionit).

Kosova ka bërë disa hapa për të përmirësuar zbatimin e qasjeve të **policimit të drejtuar nga inteligjenca dhe policimit në bashkësi**. Në strukturën e re organizative, Policia e Kosovës ka fuqizuar strukturat e saj të inteligjencës, si në nivel qendror ashtu edhe në atë rajonal. Për këtë qëllim, e ka ngritur Drejtorinë për Inteligjencë dhe Analizë në një departament policor të pavarur dhe ka shtuar një divizion të ri për policimin në bashkësi. Gjatë vitit 2022, Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë ka pranuar 11 250 raporte informative (37,55% rritje në vitin 2021) dhe ka shpërndarë 3 965 raporte të inteligjencës (27,16% rritje në vitin 2021). Zyrtarët e dedikuar për policim në bashkësi brenda sektorëve janë integruar në strukturën organizative. Aktivitetet informuese janë planifikuar për të ndërtuar besimin me komunitetet. Policia gjatë vitit 2022 ka realizuar një pilot projekt të titulluar “Njiheni me policinë tuaj”, i cili do të zbatohet në mbarë Kosovën. Megjithatë, zbatimi i policimit të drejtuar nga inteligjenca mbetet përgjithësisht i dobët pasi strukturat dhe sistemet nuk janë ende plotësisht të krijuara. Sipas strukturës së re organizative të policisë, policia duhet të ndërmarrë veprimet e mëposhtme: të krijojë më tej strukturat e inteligjencës në nivel rajonal dhe qendror; të vazhdojë rekrutimin dhe trajnimin e analistëve të dedikuar; dhe të funksionalizojë plotësisht grupin koordinues të detyrave strategjike në nivel të lartë drejtues dhe grupin koordinues të detyrave taktike në nivel rajonal. Ka nevojë për trajnime më të specializuara dhe gjatë shërbimit për të gjitha institucionet e përfshira në luftimin e rasteve më komplekse të krimit të organizuar. Policia dhe Prokuroria Speciale duhet të bashkëpunojnë ngushtë për të zhvilluar strategji për zhvillim më të mirë të hetimeve dhe të kenë një ndarje të qartë të përgjegjësi. Policia duhet të krijojë një zyrë të verifikimit për masat e posaçme hetimore për të shqyrtuar kërkesat e hetuesve për masa të posaçme nga prokuroria. Kjo do të mundësonte një qasje të përbashkët të bazuar në objektiv për të përmirësuar zbulimin proaktiv të pasurisë së paligjshme dhe të fituar me vepër penale.

Është vendosur bashkëpunim i mirë me Interpolin dhe Europolin. Kosova rregullisht shkëmben informacione me Interpolin përmes Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Në mars 2023, bashkëpunimi ndërmjet Europolit dhe Policisë së Kosovës u përmirësua më tej me vendosjen e një Zyrtari Ndërlidhës të Kosovës në selinë e Europolit në Hagë. Aplikacionin e Rrjetit të Sigurt të Shkëmbimit të Informacionit (SIENA) është funksional. Policia e Kosovës bashkëpunon mirë me shërbimet policore në shtetet anëtare të BE-së, duke përfshirë ekipet e përbashkëta të hetimit dhe shkëmbimin e informacionit për çështjet civile dhe penale. Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, Policia e Kosovës ka regjistruar 19 hetime dhe 2 operacione të përbashkëta. Policia ka nënshkruar 103 marrëveshje për bashkëpunim ndërkombëtar policor, duke përfshirë 11 shtete anëtare të BE-së, pesë agjenci të BE-së dhe shtete të tjera dhe organizata ndërkombëtare. Policia e Kosovës

shkëmben reciprokisht oficerët ndërlidhës me shtatë shtete partnere. Që nga dhjetori i vitit 2020, Kosova dhe Eurojust kanë krijuar bashkëpunim përmes emërimit të dy pikave të kontaktit. Kosova i është bashkuar projektit Eurojust WB CRIM JUST për të rritur nivelin e ndërveprimit dhe integritimit ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në fushën e drejtësisë penale.

Policia e Kosovës është duke punuar për të përmirësuar trajtimin e rasteve të **dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore**. Ajo ka përditësuar procedurën standarde të veprimit për adresimin e rasteve të dhunës në familje dhe ka përmirësuar kapacitetet e zyrtarëve policor për të trajtuar rastet, për të bërë vlerësime të rrezikut dhe për të ngritur dhoma të intervistimit të përshtatshme për viktimat. Megjithatë, trajtimi i rasteve është ende i mangët. Dështimi për të mbrojtur viktimat, duke përfshirë hedhjen poshtë të kallëzimeve penale, zbulimin e identitetit, intervistimin joadekuat dhe urdhrat e moszbatimit të urdhrave për mbrojtjes, ishte raportuar në disa raste të rënda të dhunimeve dhe vrasjeve nga partnerët intimë. Duhet bërë më shumë për të siguruar që zyrtarët policor të Kosovës të kuptojnë rolin e tyre në rastet e dhunës në familje në përputhje me ligjet ekzistuese, strategjitë dhe Protokollin e ri të Shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore.

Zbatimi efektiv i mekanizmave për mbrojtjen e dëshmitarëve vazhdon të përballet me sfida, pasi që pak dëshmitarë të mundshëm kanë besim të mjaftueshëm në mundësinë e institucioneve të Kosovës për t'i mbajtur ata të sigurt. Policia e Kosovës merr pjesë në platformën e Europolit për mbrojtjen e dëshmitarëve. Prokurorët dhe gjyqtarët kanë nevojë për trajnime se si të mbrojnë dëshmitarët në mënyrë efektive.

Lufta kundër **pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit** nuk po jep rezultatet e pritura. Në vitin 2022, kishte një dënim të formës së prerë për pastrim të parave. Nevojiten më shumë përpjekje për të arritur një nivel të konsiderueshëm të hetimeve proaktive, vendime gjyqësore përfundimtare dhe konfiskim përfundimtar të pasurisë. Duhet të forcohen kapacitetet e policisë dhe prokurorisë. Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit shpesh nuk ndiqen penalisht si një krim më vete. Ekziston një nevojë urgjente për të nxitur kuptimin e zgjeruar të prokurorëve dhe gjyqtarëve të konceptit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe për të ngritur specializimin e tyre në këtë fushë. Hetimet financiare ende nuk fillohen sistematikisht në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe nuk përdoren në kontekstin e një qasjeje më të gjerë për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin e nivelit të lartë. Vlerësimet e fundit ose të vazhdueshme të rrezikut sektorial u mundësojnë autoriteteve kompetente të zhvillojnë kuptimin e tyre për fushat me rrezik të lartë në disa sektorë, duke përfshirë pasuritë e paluajtshme, organizatat jofitimprurëse, ndërtimtarinë dhe lojërat e fatit. Niveli i të kuptuarit të llojeve të ndryshme të institucioneve financiare dhe bizneseve dhe profesioneve jofinanciare të përcaktuara në këtë fushë ndryshon ndjeshëm. Arritja e nivelit të konsiderueshëm të efektivitetit do të kërkojë trajnime dhe shtrirje të synuar. Në vitin 2022, Njësia e Inteligjencës Financiare pranoi 947 raporte të transaksioneve të dyshimta (deri në 3% në vitin 2021). Në total, janë konfiskuar 2 077 995 euro pasuri. Në përgjithësi, ndonëse efikasiteti i hetimeve financiare është përmirësuar në nivel policor, ato ende nuk kryhen sistematikisht paralelisht me hetimet/procedurat penale. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet agjencive duhet të përmirësohet ndjeshëm. Miratimi i procedurës standarde të veprimit të policisë për të centralizuar të gjitha aspektet e hetimeve financiare në përputhje me rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF) ende nuk ka dhënë rezultate konkrete.

Pavarësisht progresit, përfshirja e grupeve të organizuara dhe të armatosura në **trafikun e armëve** mbetet shqetësim serioz. Kosova po zbaton strategjinë e saj në këtë fushë dhe Ligjin për legalizimin dhe dorëzimin e armëve, municionit dhe mjeteve shpërthyes. Policia e Kosovës gjatë vitit 2022 ka konfiskuar 1 473 armë zjarri (1 280 në vitin 2021) dhe 29 903 copë municioni të kalibrave të ndryshëm (42 031 në vitin 2021) Autoritetet duhet të përshpejtojnë përpjekjet drejt hartimit të ndryshimeve në ligjet kryesore, aktet nënligjore dhe strategjinë për armët e zjarrit,

municionet dhe eksplozivët, më qëllim të arritjes së harmonizimit me direktivat dhe rregulloret kryesore të BE-së për armët e zjarrit. Pika kontaktuese për armët e zjarrit të Kosovës vazhdon të funksionojë si praktikë e mirë në rajon dhe laborator i saj balistik është i pajisur mirë. Kosova ka vazhduar të ketë nivelin më të lartë të harmonizimit në rajon me dispozitat e Protokollit të OKB-së për Armët e Zjarrit.

Kosova mbetet vend i origjinës, transitit dhe destinacionit për viktimat e **trafikimit të qenieve njerëzore**, veçanërisht për shfrytëzim seksual. Gjatët vitit 2022, Policia e Kosovës ka identifikuar 22 viktima të trafikimit, prej të cilave 21 ishin vajza dhe gra dhe një burrë, ku 14 viktima ishin të moshës nën 18 vjeçare dhe 8 mbi moshën 18 vjeçare. Viktimave iu ofruan shërbime të mbrojtjes dhe mbështetjes nga njësitë përkatëse të policisë, OJQ-të e licencuara dhe shërbimet e mbrojtjes sociale. Autoritetet kanë ndërmarrë përpjekje të koordinuara për të parandaluar dhe rritur ndërgjegjësimin për këtë çështje. Veprimet përfshijnë përmirësimin e procedurës së identifikimit, duke filluar nga identifikimi i viktimës deri te ri-integrimi afatgjatë, dhe rritjen e efikasitetit në ndjekjen penale të atyre që drejtojnë trafikimin e qenieve njerëzore. Megjithatë, ka ende shumë hapësirë për zhvillim për të pasur një kuptim më të mirë të fushës dhe kushteve në të cilat po ndodh trafikimi i qenieve njerëzore, duke përfshirë mënyrën se si ai ndërlihet me eksploatimin në punë. Nevojitet një fokus i fuqishëm në mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e vendeve të punës, veçanërisht në sektorin privat. Përveç kësaj, nevojitet më shumë punë për të forcuar kapacitetet institucionale për të zbatuar legjislacionin ekzistues (përfshirë ndjekjen penale), strukturat dhe mekanizmat për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore.

**Kontrabanda e cigareve dhe duhanit** është një shqetësim në rritje. Kosova është vend kyç tranziti për kontrabandën e cigareve të falsifikuara, si dhe për produktet e duhanit të prodhuara në mënyrë legale por të transportuara në mënyrë të paligjshme përmes vendeve fqinje në Ballkanin Perëndimor.

Gjatë vitit 2022, ka pasur 54 raste (37 në vitin 2021) të **krimeve kibernetike**. Kundër një personi është ngritur aktakuzë por nuk ka pasur aktgjykim të formës së prerë dhe një hetim është pushuar. Sektori i Policisë së Kosovës për Hetimin e Krimeve Kibernetike ka iniciuar 8 raste për veprën e keqpërdorimit të fëmijëve në pornografi dhe 8 kallëzime penale janë ngritur ndaj 8 personave. Kosova duhet të adresojë disa çështje, siç është disponueshmëria e kufizuar e trajnimeve për krimet kibernetike për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar dhe ata që merren me provat elektronike.

Sipas marrëveshjes së punës të vitit 2017 me Agjencinë e BE-së për Trajnime për Zbatimin e Ligjit (CEPOL), Kosova luan rol aktiv në një sërë aktivitetesh të Agjencisë. Kosova ka qasje të plotë në Programin e Shkëmbimit CEPOL dhe sistemin e saj elektronik të mësimin. Rekomandohet që autoritetet e Kosovës, me ndihmën e CEPOL-it, të hartojnë, përgatisin dhe organizojnë trajnime të synuara për të trajtuar luftimin e terrorizmit nga këndvështrimi i mbrojtjes, parandalimit dhe reagimit, si temë me prioritet e trajnimit.

Kosova merr pjesë në Platformën Multidisiplinare Evropiane kundër Kërcënimeve Kriminale (EMPACT). Në vitin 2022, Kosova ka marrë pjesë në 22 veprime operative në 3 nga 15 planet e veprimit operativ të EMPACT. Në gjysmën e parë të vitit 2023, Kosova ka marrë pjesë në 9 aksione operative. Në vitin 2022, Kosova emëroi Koordinatorin Nacional për EMPACT, Drejtorin e Policisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe vazhdoi të marrë pjesë në Ditët e Përbashkët të Veprimit të EMPACT. Kosova gjithashtu ka vazhduar të bashkëpunojë me shërbimet policore të BE-së përmes Rrjetit Evropian të Ekipeve të Kërkimit Aktiv të të Arratisurve, në të cilin ka statusin e vëzhguesit.

## **Bashkëpunimi në fushën e drogës**

## Struktura institucionale dhe harmonizimi ligjor

Strategji kombëtare për drogat që përfshin periudhën 2018-2022 ka skaduar dhe deri më tani nuk është miratuar ndonjë strategji apo plan i ri i veprimit. Korniza legislative për të luftuar trajtimin dhe trafikimin e paligjshëm të barnave narkotike bazohet në Ligjin e vitit 2007 për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët dhe në Kodin Penal. Projektligji i rishikuar më gjithëpërfshirës i përafuar me legjislacionin më të fundit të BE-së ende nuk është miratuar.

Ekziston një mekanizëm koordinues për të parandaluar dhe luftuar trafikun e drogës dhe përdorimin e paligjshëm të prekursorëve. Ndërsa Observatori Kombëtar i Drogës është krijuar që nga gushti i vitit 2018, ai ka qenë pa udhëheqës që nga dhjetori i vitit 2018. Me vetëm një punonjës me orar të plotë, observatorit i mungojnë burimet e nevojshme njerëzore për të përmbushur rolin e tij dhe mbetet joefektiv. Në mars të vitit 2023, Ministria e Punëve të Brendshme miratoi Rregulloren e re për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, e cila parashikon një Observator të Drogës në kuadër të Sekretariatit të Strategjive. Sistemi i paralajmërimit të hershëm për substancat e reja psikoaktive ende nuk është krijuar. Ministria miratoi rregulloren e brendshme për organizimin e Observatorit Kombëtar të Drogës dhe sistemin e paralajmërimit të hershëm, i cili siguron mbështetjen e duhur njerëzore dhe financiare, por stafi shtesë ende nuk është rekrutuar. Pavarësisht progresit të përgjithshëm në mbledhjen e të dhënave, mbeten vështirësi në lidhje me mbledhjen e qëndrueshme dhe rutinore të të dhënave të ndërlidhura me drogën. Në mungesë të një sistemi funksional të informacionit shëndetësor, krijimi i një regjistri të trajtimit të drogës nuk është prioritet.

## Implementimi dhe kapaciteti zbatues

Kosova vazhdon të jetë vend ruajtje edhe tranziti i drogave narkotike dhe derivateve të tyre. Konfiskimet e drogës vazhduan të rriteshin: rreth 662 kg marihuanë, 246 kg heroinë, 4 kg kokainë dhe 24 500 bimë kanabis u kapën në vitin 2022. Gjatë vitit 2022, Policia e Kosovës ka regjistruar 808 raste të reja të ndërlidhura me drogën (726 në vitin 2021), ka arrestuar 1 039 të dyshuar dhe ka ngritur 532 kallëzime penale kundër 791 të dyshuarve. Nga të gjitha rastet, 271 janë akuzuar për trafik droge, 505 për posedim pa leje dhe 32 për kultivim. Ka dispozita për ruajtjen e sigurt të drogës së konfiskuar në pritje të shkatërrimit.

Grupet e krimit të organizuar vazhdojnë të luajnë një rol dominues në trafikun në shkallë të gjerë të drogës dhe shpërndarjen e mëvonshme në BE. Rrugët e trafikut të drogës në Ballkanin Perëndimor përbëjnë një sfidë të madhe. Agjencitë kosovare të zbatimit të ligjit vazhdojnë të angazhohen në operacione të suksesshme për shënjestrimin e drogës, në bashkëpunim me shtetet anëtare të BE-së. Objektet e kultivimit të kanabisit në hapësira të brendshme dhe të jashtme në shkallë industriale janë identifikuar në disa vende të rajonit, përfshirë Kosovën. Gjatë periudhës raportuese, janë kryer disa operacione të suksesshme kundër laboratorëve të kultivimit të drogës, duke përfshirë edhe veriun e Kosovës. Agjencitë e zbatimit të ligjit dhe prokuroria duhet të shtojnë më tej të kuptuarit e tregut të drogës përmes punës analitike. Bashkëpunimi ndër-institucional dhe shkëmbimi i informacionit në luftën kundër trafikut të drogës në zinxhirin e sektorit të drejtësisë duhet të përmirësohet më tej. Shërbimi prokurorial vazhdon të mos ketë staf të mjaftueshëm dhe të trajnuar sa duhet për të trajtuar me efikasitet veprat që ndërlidhën me drogën. Rritja e bashkëpunimit, koordinimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit në rajonin e Ballkanit Perëndimor është parësor dhe duhet të përmirësohet. Kosova ka një linjë telefonike 24 orëshe për abuzimin me drogën dhe ofron trajtim të varësisë dhe terapi me metadon. Bashkëpunimi me Qendrën Evropiane për Monitorimin e Drogës dhe Varësinë nga Drogat mbetet i kënaqshëm.

## **Lufta kundër terrorizmit**

## Struktura institucionale dhe harmonizimi ligjor

Një varg **institucionesh** mbeten aktive dhe të përfshira në luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, dhe në trajtimin e ri-integrimit të luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer dhe familjeve të tyre. Ministri i Punëve të Brendshme vepron si Koordinator Nacional për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftimin e Terrorizmit. Ky pozitë synon të përmirësojë koordinimin ndërinstytucional, të monitorojë dhe raportojë për zbatimin e politikave, aktiviteteve dhe veprimeve të tjera dhe të shërbejë si pikë e kontaktit. Megjithatë, duke pasur parasysh natyrën e detyrave të tjera të ministrit, fokusi në këtë çështje është i kufizuar.

**Korniza ligjore** e Kosovës ë luftimin e terrorizmit është pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-në dhe standardet ndërkombëtare. Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit duhet të ndryshohet në mënyrë që të jetë plotësisht në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare (shih seksionin për luftën kundër krimit të organizuar dhe për lëvizjen e lirë të kapitalit). Kosova ka miratuar Ligjin për zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare të shënjestruara. Legjislacioni për mbrojtjen e infrastrukturës kritike mbetet në fuqi; miratimi i legjislacionit zbatues është në pritje, gjithashtu ka nevojë për kapacitete të përshtatshme për zbatimin e legjislacionit.

Kosova ka një strategji dhe plan të veprimi kundër terrorizmit (2018-2023) në përputhje me strategjinë kundër terrorizmit të BE-së. strategji dhe plan i veprimit kundër ekstremizmit të dhunshëm (2015-2020) skadoi në fund të vitit 2020 dhe Koordinatori Nacional vendosi të bashkojë të dy strategjitë në një. Strategjia e re kombëtare 2023-2028 dhe plani i veprimit për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit u miratuan në qershor 2023. BE e ka mbështetur Kosovën në këtë proces të rishikimit përmes Mbështetjes së Politikave të Rrjetit të Ndërgjegjësimit ndaj Radikalizmit. Qendra e Përbashkët e Vlerësimit të Kërcënimeve, duke përfshirë sistemin e vlerësimit, ende nuk është krijuar; Në gjysmën e dytë të vitit 2022, Policia e Kosovës dhe Agjencia e Kosovës për Inteligjencë nxorën analizën e dytë të përbashkët të vlerësimit të kërcënimeve si pjesë e analizës së situatës për strategjinë e re për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit. Ekziston nevoja për të përmirësuar koordinimin e donatorëve dhe për të krijuar një mekanizëm më të strukturuar. Autoritetet e Kosovës vazhdojnë të zbatojnë Marrëveshjen Zbatuese dypalëshe me BE-në për Planin e Përbashkët të Veprimit kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor. Kosova ka dorëzuar raportin e saj të pestë të zbatimit në shkurt të vitit 2023.

## Implementimi dhe kapaciteti zbatues

Kosova vazhdoi të luftojë kërcënimin nga terrorizmi. Në vitin 2022, janë ngritur 7 aktakuza dhe janë dënuar 6 persona. Hetimet kanë përfunduar në 12 raste ndaj 43 të dyshuarve. Është e nevojshme konsistencë më e madhe e praktikave të dënimit, për veprat që lidhen me terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Funkcionimi i Departamentit Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe në Gjykatën e Apelit ka kontribuar në trajtimin më efektiv të rasteve të terrorizmit. Aktualisht, 19 të burgosur për krime të ndërlidhura me terrorizmin ndodhen në burgjet në Kosovë, me 5 të dënuar, 5 në paraburgim në burgun e sigurisë së lartë dhe 9 të dënuar në qendrën korrektuese të Dubravës. Gjatë vitit 2022, janë liruar 11 persona, nga të cilët 4 me kusht, 3 me lirim të parakohshëm dhe 3 pas vuajtjes së dënimit. Në periudhën janar-qershor 2023, 5 të burgosur të dënuar për krime që ndërlidhën me terrorizmin u liruan. Dënimet për krime të terrorizmit për luftëtarët e huaj terrorist ishin relativisht të buta (dënimi mesatar ishte 3.6 vite). Ministria e Punëve të Brendshme mori masa në lidhje me lirin me kusht për të garantuar që paneli për lirim me kusht t'i kushtojë më shumë rëndësi edhe aspekteve të sigurisë kur merret me të burgosurit që dalin nga burgju me nivel më të lartë të radikalizmit. Deri më tani, ka pasur disa raste të recidivizmit në mesin e të dënuarve për vepra të ndërlidhura me terrorizmin.

Përkundër përpjekjeve të konsiderueshme, disa sfide në luftimin e terrorizmit dhe parandalimin

dhe luftimin e **ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit** mbeten. Rritja e incidenteve të dhunshme të ekstremizmit fetar në familje dhe ndikimi i formave të tjera të ekstremizmit është shqetësues. Ideologjia militante selafiste, lëvizjet në rritje etnonacionale dhe të ekstremit të djathtë në rajon<sup>5</sup>, përfshirë Kosovën, mbeten kërcënim. Kërcënimet e rreme me bomba kundër institucioneve publike u shfaqën gjatë periudhës raportuese, duke përfshirë edhe aeroportin. Pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve të Kosovës për të përmirësuar situatën, ka një sërë faktorësh shtytës dhe tërheqës për radikalizmin, duke përfshirë varfërinë, perceptimin e korrupsionit, mungesën e kapaciteteve institucionale dhe situatën politike. Autoritetet e Kosovës duhet të balancojnë përpjekjet për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm në të gjitha format e tij përmes masave rehabilituese dhe ri-integruese. Është e rëndësishme që vazhdimisht të rishikohen strategjitë ekzistuese, planet e veprimit dhe programet e ri-integrimit dhe rehabilitimit.

Autoritetet e Kosovës kanë marrë rol udhëheqës në **rehabilitimin dhe ri-integrimin** e të kthyerve nga konfliktet e huaja; për këtë qëllim, kanë riatdhesuar një numër të madh kosovarësh dhe ju kanë ofruar mbështetje psikosociale dhe iniciativa për ri-integrim ekonomik. Që nga fillimi i luftës civile në Siri në vitin 2012, janë kthyer 257 kosovarë (133 burra, 39 gra, 85 fëmijë), 106 kanë vdekur dhe 83 kanë mbetur në Lindjen e Mesme (35 burra, 8 gra, 40 fëmijë). Pas operacionit të kthimit në maj të vitit 2022, nuk ka pasur zhvillime të mëtejshme për riatdhesimin e individëve të mbetur nga rajoni. Divizioni për Ri-integrim i Ministrisë së Punëve të Brendshme ka nevojë për burime të përshtatshme financiare dhe njerëzore. Autoritetet duhet të vazhdojnë të nivelin e sigurisë në procesin e rehabilitimit dhe ri-integrimit dhe parandalimin e punës së ekstremizmit të dhunshëm, duke siguruar njëkohësisht zbutjen e rrezikut. Sa i përket planifikimit dhe zbatimit të proceseve të rehabilitimit dhe ri-integrimit, Kosova duhet të krijojë mekanizma multidisiplinar në nivel lokal. Ekziston nevoja për t'u fokusuar më shumë në edukimin, trajnimin dhe gatishmërinë e praktikuesve vendore që merren me të kthyerit. Koordinatori Nacional për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftimin e Terrorizmit duhet të luajë rol të zgjeruar në mbikëqyrjen e procesit të rehabilitimit dhe ri-integrimit, duke përfshirë lidhjen me komunat. Gjatë periudhës raportuese, Ministria e Punëve të Brendshme ka pilotuar mekanizma multidisiplinar në komunën e Hanit të Elezit për trajtimin e rasteve të luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer, familjeve të tyre dhe individëve të tjerë të rrezikuar nga radikalizmi. Këta mekanizma duhet të forcohen më tej. Shoqëria civile luan rol të rëndësishëm në përpjekjet rehabilituese dhe ri-integruese në komunitetet lokale. Ligji për Shërbimin Korrektues të Kosovës formalisht themeloi Njësinë e Inteligjencës dhe Njësinë për Menaxhimin e Ekstremizmit në kuadër të Shërbimit Korrektues, duke kontribuar kështu në përmirësimin e koordinimit kur kemi të bëjmë me të burgosurit ekstremistë dhe terroristë. Megjithatë, programet e de-radikalizmit dhe largimit nga aktivitetet ekstremiste brenda sistemit korrektues duhet të intensifikohen në mënyrë të konsiderueshme. Autoritetet duhet të intensifikojnë trajnimin specifik, duke përfshirë Shërbimin Sprovues të Kosovës, i cili duhet të zhvillojë programe për terroristët e dënuar që lirohen pas vuajtjes së dënimit.

Autoritetet e Kosovës duhet të përmirësojnë kapacitetin e tyre për të trajtuar përmbajtjen terroriste në internet, duke përfshirë rritjen e përpjekjeve për të referuar përmbajtjen terroriste te ofruesit e internetit, si dhe duke përmirësuar përpjekjet për të fuqizuar shoqërinë civile në zhvillimin e narrativave kundërshtuese efektive.

### **Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale**

Për arsytet që ndërlidhen statusin, Kosova nuk është palë në shumicën e traktateve shumëpalëshe që rregullojnë bashkëpunimin e ndërsjellë gjyqësor, por zbaton në mënyrë të

njëanshme standardet e traktateve të njohura ndërkombëtarisht. Bashkëpunimi me Europoli dhe Eurojustin ka avancuar më tej. Gjatë periudhës raportuese, Kosova nuk ka aplikuar për t'u bërë palë në ndonjë traktat apo organizatë shumëpalëshe në fushën e bashkëpunimit gjyqësor. Dy traktate të reja bilaterale për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet civile kanë hyrë në fuqi dhe Kosova ka ndërmarrë hapa për të lidhur traktate dypalëshe shtesë.

Korniza ligjor për bashkëpunim gjyqësor në çështjet civile është e konsoliduar dhe e harmonizuar plotësisht me *acquis* të BE-së. Bashkëpunimi me vendet me të cilat Kosova nuk ka marrëveshje bilaterale bazohet në parimin e reciprocitetit dhe mirëkuptimit. Gjatë periudhës raportuese, Kosova ka adresuar 269 kërkesa për çështje civile tek shtetet anëtare të BE-së dhe ka marrë 344 përgjigje. Ka pranuar 372 kërkesa nga shtetet anëtare të BE-së dhe ka dhënë 382 përgjigje.

Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar i Kosovës në çështjet penale bazohet në Ligjin për bashkëpunim juridik në çështjet penale dhe në 40 traktate bilaterale. Gjatë periudhës raportuese, Kosova ka bërë 142 kërkesa në çështjet penale dhe ka marrë 178 përgjigje. Gjatë periudhës së njëjtë, ka pranuar 365 kërkesa dhe ka dhënë 325 përgjigje. Gjithashtu, 11 persona janë ekstraduar nga shtetet anëtare të BE-së në Kosovë dhe 7 persona nga Kosova në shtetet anëtare të BE-së.

Në vitin 2022, autoritetet e Kosovës nuk ndërmorën asnjë veprim për të bashkëpunuar me Zyrën e Prokurorit Publik Evropian.

Procedurat e vitit 2015 për bashkëpunimin e ndërsjellë ligjor të miratuara ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës përbëjnë bazën për bashkëpunim gjyqësor ndërmjet autoriteteve të tyre gjyqësore. Shumica e vendeve që nuk e njohin Kosovën kanë pranuar vullnetarisht rolin lehtësues të Përfaqësuesit Special të BE-së (PSBE) në transmetimin e kërkesave gjyqësore (përfshirë ato që kanë të bëjnë me ekstradimin). Megjithatë, mungesa e bashkëpunimit nga disa shtete jo-njohëse ka rezultuar në raste të mosndëshkimit. Që nga fundi i gushtit 2022, Kosova nuk ka marrë asnjë kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike apo përgjigje të ngjashme nga Serbia.

### **Migrimi i ligjshëm dhe i parregullt**

Kosova ka mobilizuar burime shtesë për të përshtatur planin ekzistues emergjent për menaxhimin e flukseve të përziera të migrimit. Migrantët e bllokuar jashtë qendrave të pranimit u përballën me sfida të veçanta, pasi mbeten të parregjistruar.

Kosova është angazhuar me BE-në për zbatimin e Planit të Veprimit të BE-së për Migracionin, të paraqitur nga Komisioni në dhjetor të vitit 2022. Duhet të vazhdohet me zbatimin e të gjitha pjesëve të Planit të Veprimit.

Kosova merr pjesë në Partneritetin Operacional kundër Kontrabandës Rajonale me Ballkanin Perëndimor të lansuar në takimin ministror BE-Ballkani Perëndimore të Ministrave të Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme më 3 nëntor 2022 për të mbështetur zbatimin e ligjit dhe bashkëpunimin gjyqësor kundër rrjeteve kriminale të kontrabandës dhe për të rritur kapacitetet e menaxhimit të kufirit.

### **Struktura institucionale dhe harmonizimi ligjor**

**Institucionet** që merren me migrimin në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Policinë Kufitare mbeten efektive. Duhet të rritet kapaciteti i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Aktualisht, Departamenti ka 34 punonjës, ndërsa struktura organizative parashikon një staf prej 52 punonjësish. Njëri nga zëvendësministrat është Koordinator Nacional kundër Trafikimit dhe Koordinator Nacional për

Migracion. Autoritetet duhet të reflektojnë për krijimin e një pozite të përhershëm për të sjellë më shumë stabilitet në këtë rol.

Në shtator të vitit 2022, qeveria ristrukturoi Autoritetin Qeveritar për Migracion. Forumi me shumë palë të interesit mbetet një platformë e rëndësishme ku të gjitha palët përkatës të interesit bashkëpunojnë për çështjet që lidhen me migracionin.

**Korniza ligjore** në përgjithësi është në përputhje me *acquis* të BE-së. Duhet të ndërmerren hapa për të harmonizuar më tej legjislacionin, përfshirë Ligjin për të huajt, me *acquis* Be-së dhe standardet ndërkombëtare. Rekomandohet që Kosova të harmonizojë legjislacionin me Direktivën 2008/115/EC (Direktiva për Kthime), të përfshijë një kategori të mbrojtjes humanitare dhe të vazhdojë periudhën e kthimit vullnetar.

Kosova ka marrëveshje **ripranimi** me 24 shtete, duke përfshirë 20 shtete anëtare të BE-së dhe anëtare të zonës Shengen. Gjatë periudhës raportuese, Kosova nuk ka nënshkruar ndonjë marrëveshje të re ripranimi. Nuk ka marrëveshje ripranimi me BE-në si tërësi. Gjatë vitit 2022, qeveria miratoi nismat për të lidhur marrëveshje të reja ripranimi me 14 vende: Letoninë, Lituaninë, Portugalinë, Poloninë, Irlandën, Mbretërinë e Bashkuar, Pakistanin, Bregun e Fildishtë, Shtetet e Bashkuara, Jordaninë, Egjiptin, Libinë, Çadin dhe Australinë.

**Strategjia për migracion 2021-2025** dhe plani i veprimit reflekton prioritetet në programin e qeverisë për të njëjtën periudhë. Strategjia dhe plani i veprimit marrin parasysh detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit si dhe nga iniciativat evropiane dhe globale siç janë Pakti i BE-së për Migrim dhe Azilin dhe Pakti Global për Migrimin e Sigurt, të Rregullt dhe të Organizuar. Strategjia e re plotëson të gjitha kërkesat, duke përfshirë përcaktimin e bazave, buxhetimin e qartë dhe përcaktimin e vlerave të synuara. Çështje e ndërlidhura me **diasporën** nuk përfshihet në strategjinë për migracion, në vend të kësaj, ato do të jenë pjesë e strategjisë së ardhshme të diasporës. Ky është hapi i parë drejt zhvillimit të një strategjie gjithëpërfshirëse që mbulon të gjitha fushat përkatëse të politikave, koordinimin dhe zbatimin. Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion ka përgatitur raportin e parë gjashtëmujor mbi zbatimin e strategjisë për migracion.

#### Implementimi dhe kapaciteti zbatues

Në vitin 2022, numri i migrantëve të regjistruar ra nga 1 487 në 957. Në periudhën janar-dhjetor 2022 kishte 469 migrantë të peregjistruar. Shumica e migrantëve janë burra beqarë, me një numër të kufizuar të nënash vetëushqyese, familjes dhe fëmijësh.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2023, në Kosovë janë regjistruar 308 migrantë të rinj: Prej tyre 222 kanë aplikuar për 15 ditë mbrojtje ndërkombëtare dhe janë akomoduar në qendrën e pritjes së përkohshme në Vranidoll, ndërsa 86 kanë aplikuar për azil dhe janë akomoduar në qendrën e azilit në Magurë. 134 të evakuuar nga Afganistani janë ende të pranishëm në bazën amerikane në Kosovë. Janë 71 migrantë të peregjistruar brenda Kosovës që banojnë jashtë qendrave të rregullta të pritjes.

Matrica e përcjelljes së zhvendosjes e Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) mbetet një mekanizëm i rëndësishëm për monitorimin e lëvizjeve brenda dhe jashtë Kosovës dhe si e tillë ndihmon autoritetet të zhvillojnë politika të bazuara në prova dhe t'u ofrojnë migrantëve shërbime adekuate të mbrojtjes. Kosova ka kapacitet të kufizuar për të menaxhuar mobilitetin e fuqisë punëtore në dhe nga Kosova. Ekziston nevoja për të krijuar dhe siguruar qasje në rrugë të sigurt dhe të rregullta të migrimin, dhe për të punuar me partneritetet për mobilitet të aftësive. Kjo gjithashtu do të krijojë një mjedis të favorshëm për migrimin rrethor.

Migrantët që hyjnë në Kosovë mund të aplikojnë për azil ose të përdorin 15 ditë për të vendosur nëse do të aplikojnë për azil apo do të largohen. Pas 15 ditësh, nëse nuk kanë aplikuar për azil



dhe nuk largohen, ose nuk kanë aplikuar për ndihmë për kthimin vullnetar, ata mund t'i nënshtrohen kthimit të detyruar. Meqenëse nuk ekzistojnë alternativa ndaj paraburgimit, ata mund t'i nënshtrohen paraburgimit.

Autoritetet zgjeruan kapacitetet akomoduese, të cilat aktualisht janë të mjaftueshme. Ekzistojnë tri qendra të pritjes, me kapacitet aktual deri në 600 persona (Magure, 100 persona; Vranidoll, 200 persona; Kampi Belvedere, 300 persona, të cilat mund të zgjerohen deri në 2 200 persona). Qendra e rinovuar e pritjes së përkohshme në Vranidoll, e cila mund të presë deri në 70 persona, u hap në qershor të vitit 2022. Mesatarja e qëndrimit të një migranti në qendrën e azilit në Magure është 20 ditë, 6 ditë në qendrën e pritjes së përkohshme të migrantëve në Vranidoll dhe 90-120 ditë në qendrën e mbajtjes për të huajt në Vranidoll.

Ndërsa të drejtat themelore përgjithësisht respektohen, shërbimet e ofruara në qendra duhet të përmirësohen, duke përfshirë ndihmën mjekësore, mbështetjen psikologjike dhe shërbimet e përkthimit. Duhet të merren masa për të rritur sigurinë për azilkërkesit në objekte, veçanërisht për të parandaluar dhunën me bazë gjinore. Ofrimi i kujdesit dhe sigurisë së duhur për grupet më të ndjeshme të migrantëve mbetet sfidë. Kosova duhet të rrisë dhe forcojë më tej kapacitetet e autoriteteve për të evidentuar migrimin e parregullt dhe për të ofruar shërbime cilësore mbrojtëse. Në vitin 2022, qeveria miratoi udhëzimet për parandalimin, menaxhimin e rrezikut dhe reagimin ndaj dhunës me bazë gjinore në kontekstin e migrimit të përzier.

Në vitin 2022, 20 emigrantë u ndaluan në qendrën e mbajtjes për të huajt. Paraburgimi duhet të zbatohet vetëm si mjete i fundit, në përputhje me *acquis* të BE-së. Krijimi i alternativave të qëndrueshme ndaj paraburgimit për migrantët e parregullt mbetet prioritet. IOM-i, me financim nga BE-ja, ofroi mbështetje thelbësore për migrantët në qendrën e mbajtjes për të huajt. Kushtet duhet të përmirësohen për t'u përshtatur me standardet ndërkombëtare dhe të të drejtave të njeriut. Në 5 muajt e parë të vitit 2023, 9 të huaj të pranishëm në Kosovë janë kthyer në vendin e tyre të origjinës sipas marrëveshjeve të ripranimit, një e treta e tyre me forcë, vullnetarisht ose përmes kanaleve vullnetare të IOM-it.

Pavarësisht përpjekjeve të qeverisë, rrjetet transnacionale të kontrabandës vazhduan të lehtësojnë lëvizjet dytësore të migrantëve të parregullt nga pikat e hyrjes përgjatë rrugës së Ballkanit Perëndimor. Gjatë periudhës raportuese, Policia Kufitare e Kosovës ka kapur 869 migrantë që kanë hyrë në mënyrë të parregullt. Ata gjithashtu iniciuan 24 raste të kontrabandës së migrantëve (krahasuar me 27 në periudhën e mëparshme raportuese) që përfshinin 44 persona (57 në periudhën e mëparshme raportuese). Janë ngritur 26 aktakuza dhe janë marrë 13 aktgjykime dënuese. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2023, 4 persona u arrestuan për përfshirje në kontrabandën e migrantëve.

Boshllëqet mbeten në zbatimin e ligjeve, kryesisht për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet agjencive qeveritare. Kapaciteti i policisë kufitare në fushën e migracionit të ndjeshëm ndaj mbrojtjes duhet të forcohet më tej. Nevojiten përkthyes të kualifikuar për t'i shërbyer si qendrave të azilit dhe mbajtjes, ashtu edhe policisë kufitare. Mungesa e pajisjeve biometrike dhe interpoerabiliteti i të dhënave ndikon në efikasitetin e regjistrimit fillestar dhe përpunimin e mëtejshëm. Në përgjithësi, ekziston nevoja për një koordinim më të mirë ndërinstytucional, duke përfshirë edhe komunat. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të vendosur një sistem të përgjegjshëm ndaj gjinisë.

Kosova ka forcuar sistemet e saj të brendshme dhe ndërinstucionale për menaxhimin e migrimit, duke përfshirë edhe ato për statistikat e migrimit. Kjo duhet të mundësojë analiza krahasuese dhe rajonale të tendencave të migrimit. Nisma Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI) krijoi një grup të përhershëm punues për statistikat e migrimit për të mbledhur, përpunuar dhe shpërndarë të dhënat e migrimit përmes platformës rajonale për

shkëmbimin e të dhënave të migrimit në rajon.

Sipas Eurostatit, numri i qytetarëve të Kosovës të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufijtë e jashtëm të BE-së ishte 1 795 në vitin 2022 (1 650 në vitin 2021), dhe numri i atyre që u konstatuan se ishin të pranishëm ilegalisht ishte 3 960 në vitin 2022 (3 545 në vitin 2021). Numri i qytetarëve të Kosovës të urdhëruar të largohen nga BE-ja u rrit pak nga 3 740 në vitin 2021 në 3 930 në vitin 2022. 1 380 persona u kthyen në një vend të tretë në vitin 2022.

Marrëveshjet e ripranimit me shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e lidhura me Shengenin po zbatohen në mënyrë të kënaqshme. Numri i përgjithshëm i personave të ripranuar në vitin 2022 ishte 613, nga të cilët 536 me dhunë (87%), 13 vullnetarisht (2%) dhe 64 përmes kanaleve vullnetare të IOM-it (10%), duke shënuar një rënie krahasuar me vitin 2021. Shumica e të ripranuarve janë në grupmoshat 35-64 (266 ose 43.4%) dhe 18-34 (242 ose 39.5%). Ndër të ripranuarit me forcë në vitin 2022, 470 (87.6%) ishin meshkuj, ndërsa 66 (12.3%) ishin femra. Sipas të dhënave të IOM-it, nga personat e ripranuar vullnetarisht në vitin 2022, 41 (64%) ishin meshkuj dhe 23 (36%) femra. Për vitin 2023, deri në maj gjithsej 209 persona ishin ripranuar në Kosovë, 174 (83.25%) me forcë, 15 (7.18%) vullnetarisht dhe 20 (9.57%) vullnetarisht përmes kanaleve të IOM-it.

Shkalla e kthimit të qytetarëve të Kosovës të urdhëruar të largohen nga territori i BE-së ishte 58% në vitin 2018, 41% në vitin 2019, 29% në vitin 2020 dhe 39% në vitin 2021. Ndërsa statistikatat tregojnë një rënie të shkallës së kthimit ndërmjet vitit 2018 dhe 2020, shtetet anëtare të BE-së kanë konfirmuar se autoritetet e Kosovës vazhdojnë të bashkëpunojnë mirë lidhur me ripranimin. Numri i kosovarëve të urdhëruar të largohen nga BE-ja u rrit pak nga 3 740 në vitin 2021 në 3 930 në vitin 2022, sipas Eurostatit. 1 380 persona janë kthyer pas urdhrorit për t'u larguar në vitin 2022 (35.1%).

Numri i kërkesave për azil të bëra nga qytetarët e Kosovës si në vendet e BE-së ashtu edhe në vendet e Shengenit ka rënë në mënyrë të vazhdueshme, nga kulmi prej 73 210 në vitin 2015 në 1 515 në vitin 2020 dhe 1 600 në vitin 2021, duke u rritur në 2 445 në vitin 2022. Numri i përgjithshëm i qytetarëve të Kosovës të ripranuar ka rënë nga 18 789 në vitin 2015 në 625 (512 të detyruar dhe 113 vullnetarë) në vitin 2020 dhe 849 (710 të detyruar dhe 139 vullnetarë) në vitin 2021.

Në përgjithësi, ekziston nevojja për një koordinim më të mirë ndërinstitucional, duke përfshirë edhe komunitat, si dhe përmirësimin e monitorimit dhe vlerësimit sistematik. U themelua një mekanizëm referues dhe funksionon përmes qendrës së pritjes për personat e riadhesuar. Një manual për identifikimin dhe avancimin e referimit të rasteve të ndjeshme dhe trajnime për vlerësimin e nevojave iu siguroa zyrtarëve qendror dhe lokalë të ri-integrimit.

Në gusht të vitit 2021, Kosova filloi përkohësisht të strehojë të evakuuarit/refugjatët të ndërlidhur me SHBA-në dhe NATO-n nga Afganistani, bazuar në vendimin e qeverisë së Kosovës për t'u ofruar atyre mbrojtje të përkohshme për një vit. Ata janë strehuar në dy objekte të hapura në Kosovë me kuptimin se do të zhvendosen më tej në Shtetet e Bashkuara nën një regjim vizash specifik ose në shtete anëtare të NATO-s që janë zotuar për t'i pranuar ata. Që nga janari 2023, janë regjistruar 158 largime dhe 134 persona janë të pranishëm në Kampin Bondsteel.

## **Azili**

### Struktura institucionale dhe harmonizimi ligjor

Në mars të viti 2022, Agjencia e BE-së për Azil dhe Kosova miratuan dhe filluan zbatimin e udhërrëfyesit dypalësh për bashkëpunim (2022-2024).

Korniza ligjore dhe institucionale e Kosovës për azil është kryesisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Korniza ligjore e Kosovës parasheh qasje në territor dhe respekton parimin e moskthimit. Refugjatët duhet të përfshihen në skemat e mbrojtjes sociale. Sektorë të caktuar të sistemit kërkojnë fuqizim të mëtejshëm në përputhje me udhërrëfyesin e dakorduar me EUAA.

Krijimi i një sistemi hyrjeje plotësisht efektiv dhe të ndjeshëm ndaj mbrojtjes kërkon dispozita të qarta ligjore. Këto duhet të përfshijnë identifikimin, ekzaminimin dhe referimin e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare dhe atyre me nevoja specifike. Ligji i ri për të huajt është një mundësi për të dhënë përkufizime të qarta; ai duhet gjithashtu të përcaktojë dispozita për integrimin e lehtësuar.

### Implementimi dhe kapaciteti zbatues

Kosova vazhdon të jetë një rrugë tranziti për shumicën e njerëzve që arrijnë me lëvizje të përziera. Kapaciteti i kufizuar në aspektin e pajisjeve biometrike dhe mungesa e ndërveprimit të të dhënave ndikojnë në efikasitetin e regjistrimit dhe procesimin e mëtejshëm të kërkesave për azil. Për të përmbushur mandatin e saj, Policia Kufitare ka nevojë për pajisje adekuate dhe më shumë ekspertizë.

Ministria e Punëve të Brendshme Divizioni për Azil/Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion përbëhet nga 3 zyrtarë që trajtojnë rastet e azilit. Autoritetet duhet të konsiderojnë përshpejtimin e procesit të punësimit të stafit të ri.

Në vitin 2022, Kosova regjistroi 550 kërkesa për azil, një trend i ngjashëm me vitin 2021 (578). Deri në maj 2023, ishin regjistruar 73 kërkesa për azil. Gjatë vitit 2022, Kosova u ka dhënë mbrojtje 25 personave. Deri në maj 2023, mbrojtja u ishte dhënë 13 personave.

Shumica e kërkesave për azil pezullohen, pasi parashtruesit e kërkesave zhduken pa përfunduar procedurën (52 nga 73 që nga maji 2023). Rastet e dhunës me bazë gjinore mbetën institucionalisht të pambikëqyrura për shkak të mungesës së sistemeve të duhura të reagimit. Praktika aktuale e lëshimit të një “Certifikate për strehim në Qendrën e Pritjes së Përkohshme të Emigrantëve” që mundëson të drejtat e akomodimit për 15 ditë, pa dhënë asnjë status ligjor gjatë kësaj periudhe, nuk është në përputhje me *acquis* të BE-së në këtë fushë.

**Sistemi i integritetit** është në një fazë të hershme të zhvillimit. Kosova ka arritur njëfarë progresi në rritjen e stafit dhe ndërtimin e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe udhëzimeve të reja procedurale. Lidhur me mbrojtjen e fëmijëve, forcimi i procedurave për të miturit e pashoqëruar, duke përfshirë përcaktimin e moshës, kujdestarinë ligjore dhe komunikimin, mbetet thelbësor.

Ministria e Punëve të Brendshme ka kontraktuar kompani për të ofruar shërbime të përkthimit; përveç kësaj, Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët ofron mbështetje për përkthim. Në kuadër të nismës rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë, Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion përfiton nga shkëmbimi i përkthyesve të gjuhëve të rralla ndërmjet shteteve anëtare të MARRI-it. Investimi në forcimin e mëtejshëm të cilësisë së përcaktimit të statusit të refugjatit kërkohet për të siguruar që zyrtarët për azil të jenë në gjendje të kryejnë vlerësimin cilësor të kërkesave për azil. Në gusht të vitit 2022, Ministria e Punëve të Brendshme lidhi një memorandum mirëkuptimi me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas për ofrimin e ndihmës juridike falas për të huajt.

Në gusht të vitit 2022, qendra e pritjes së përkohshme të migrantëve, e cila pret edhe azilkërkuarit, përmirësoi kushtet e saj të pritjes sa i përket kapaciteteve akomoduese. E drejta për t'u akomoduar në qendër dhe qasja në shërbime ofrohet për 15 ditë, të cilat mund të zgjaten sipas gjykimit të autoriteteve. Përveç kësaj, regjistrimi i azilkërkuarve ende kryhet jashtë qendrës pa profilizimin dhe referimin e duhur.

Buxheti për integrimin e refugjatëve në Kosovë është planifikuar sipas ligjit për buxhetin vjetor për Departamentin për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në vitin 2023, buxheti është 1 381 395 euro.

Në tetor të vitit 2022, Kosova miratoi udhëzimet për qasjen e të huajve në trajnime profesionale dhe punësim. Autoritetet vazhdojnë të ofrojnë mbështetje efektive atyre që u është dhënë mbrojtje ndërkombëtare duke ofruar qira për strehim, kurse gjuhësore dhe kurse integrimi për 2 vite. Kjo periudhë mund të vazhdohet rast pas rasti.

Që nga gusht i vitit 2021, Kosova ka filluar përkohësisht të strehojë të evakuuarit/refugjatët të ndërlidhur me SHBA-në dhe NATO-n nga Afganistani, bazuar në vendimin e qeverisë së Kosovës për t'u ofruar atyre mbrojtje të përkohshme për një vit. Ata janë strehuar në dy objekte të hapura në Kosovë me kuptimin se do të zhvendosen më tej në Shtetet e Bashkuara nën një regjim vizash specifik ose në shtete anëtare të NATO-s që janë zotuar për t'i pranuar ata. Që nga janari 2023, janë regjistruar 158 largime dhe 134 të evakuuar/refugjatë janë të pranishëm në Kampin Bondsteel.

Autoritetet kanë konfirmuar gatishmërinë e tyre për të prituri deri në 5 000 qytetarë ukrainas, duke siguruar qëndrim të përkohshëm për arsye humanitare. Kosova gjithashtu ka strehuar 14 gazetarë ukrainas me status të përkohshëm, përfshirë akomodimin dhe punësimin në Asociacionin e Gazetarëve. Gjashtë shtetasve ukrainas iu dha mbrojtje shtesë.

## **Politika e vizave**

Kosova ende nuk e ka harmonizuar plotësisht legjislacionin e saj me politikën e vizave të BE-së. Kosova mundëson udhëtim pa viza për udhëtarët e 110 shteteve me pasaporta të zakonshme për 90 ditë brenda një periudhe gjashtëmujore, duke përfshirë 22 shtete që nuk kanë regjim pa viza me zonën Shengen. Mbjatësit e pasaportave të 89 shteteve duhet të marrin vizë para se të hyjnë, 4 prej të cilave gëzojnë udhëtim pa viza në zonën Shengen. Autoritetet lëshuese të vizave kanë kapacitet për të mbledhur në mënyrë digjitale identifikuesit biometrikë nga aplikantët për vizë, megjithëse pajisjet kanë nevojë për përmirësim. Të gjitha vizat e dhëna dhe refuzimet janë të regjistruara në sistemin informativ të vizave. 16 konsullatat e Kosovës nëpër botë mund të lëshojnë viza.

Kosova vazhdon të përmbushë standardet e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave. Më 18 prill 2023, Parlamenti Evropian miratoi marrëveshjen me Këshillin lidhur me propozimin e Komisionit që u mundëson mbajtësve të pasaportave të Kosovës të udhëtojnë në BE pa viza. Bazuar në këtë, që nga 1 janari 2024, mbajtësit e pasaportave nga Kosovës do të mund të udhëtojnë në BE pa viza deri në 90 ditë në çdo periudhë 180 ditore. Gjatë procesit, autoritetet e Kosovës treguan përkushtim për të adresuar të gjitha çështjet e ngritura nga BE-ja.

Kosova duhet të zhvillojë një fushatë informuese për të drejtat dhe obligimet lidhur me statusin e udhëtimit pa viza për të parandaluar keqpërdorimet e mundshme.

## **Shengeni dhe kufijtë e jashtëm**

### Struktura institucionale dhe harmonizimi ligjor

Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar është një mjet i rëndësishëm për të menaxhuar në mënyrë efektive sigurinë e kufijve të Kosovës. Qendra ka një dhomë operative dhe koordinuese. Kjo e fundit monitoron të gjitha aktivitetet në pikat kufitare dhe të përbashkëta të kalimit përmes televizionit me qark të mbyllur, koordinon shkëmbimin në kohë reale të informacionit ndërmjet autoriteteve kufitare në të gjitha nivelet dhe trajton thirrjet nga publiku. Qendra ka një Njësi të Përbashkët të Inteligjencës, Analizës së Rrezikut dhe Kërcënimeve, e cila mbledh, analizon dhe shpërndan informacion nga dhe tek autoritetet kufitare. Që nga 1

qershori i viti 2022, Qendra gjithashtu është bazë e Njesisë së Informacionit të Pasagjerëve, e cila skanon informacionin paraprak të pasagjerëve dhe të dhënat e emrave të pasagjerëve. Procedurat standarde të veprimit duhet të zhvillohen më tej.

Korniza legislative për menaxhimin e kufijve të Kosovës është kryesisht në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. Ligji për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror dhe Ligji për bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit janë rregullatorët kryesor në këtë fushë. Kosova ka në fuqi strategjinë e menaxhimit të integruar të kufirit (MIK) 2020-2025 dhe planin e veprimit 2020-2023; këto janë rishikuar në shkurt 2023. Bordi ekzekutiv përkatës shqyrton zbatimin çdo tre muaj.

### Implementimi dhe kapaciteti zbatues

Departamenti i Policisë Kufitare të Kosovës është i gatshëm t'i kryejë detyrat dhe obligimet e tij ditore përkundër situatës aktuale operative, veçanërisht në pjesën veriore të Kosovës dhe sfidave të vazhdueshme në ndryshim të burimeve njerëzore për shkak të dorëheqjes së zyrtarëve policor serbë të Kosovës. Detyrat operative janë lehtësuar nga transferimet e brendshme dhe masat e tjera kompensuese. Numri i personelit në të gjitha njësitë e Policisë Kufitare në veri të Kosovës nuk pasqyron përbërjen e popullsisë lokale, në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit. Përgjegjësitë për detyrat e sigurisë kufitare janë të ndara ndërmjet tri drejtorive rajonale kufitare (Perëndim, Lindje dhe Veri) dhe policisë së aeroportit të Prishtinës. Të gjitha drejtoritë rajonale kanë njësitë e reagimit të shpejtë përgjegjëse për mbështetjen e stacioneve të vëzhgimit kufitar. Policia Kufitare e Kosovës nuk ka njësi apo kapacitete speciale, edhe pse ekipet e reagimit të shpejtë janë të trajnuar dhe të pajisur mirë për të adresuar situata sfiduese në zonën kufitare. Bazuar në analizën e rrezikut, Policia Kufitare ka krijuar katër baza shtesë në veri të Kosovës.

Performanca e Policisë Kufitare dhe njohuritë e saj për procedurat kufitare janë përmirësuar. Statistikat tregojnë rritje të efektivitetit në disa fusha të krimit ndërkufitar. Për shembull, në vitin 2022, Kosova arrestoi 61 persona të përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore në 37 raste dhe shkatërroi 4 grupe të organizuara. Zhvillimi i infrastrukturës, pajisjeve dhe metodave taktike, veçanërisht në zonat e gjelbra kufitare, do të rriste kapacitetin e të gjithë sistemit të sigurisë kufitare dhe do ta afronte atë me standardet e BE-së. Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës është i lidhur me të gjitha pikat e kalimit kufitar. Infrastruktura në pikat e kalimit kufitar është përmirësuar dhe sistemi i menaxhimit kufitar vazhdon të funksionojë në mënyrë të kënaqshme. Megjithatë, disa nga objektet kanë nevojë për rinovim. Mungesa e qasjes së drejtpërdrejtë online në disa baza të të dhënave ndërkombëtare është pengesë për punën efektive të parandalimit të krimit.

Marrëveshja e punës e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës me Agjencinë Evropiane të Kufirit dhe Rojës Bregdetare (FRONTEX) mundëson bashkëpunim të ngushtë për migrimin e parregullt, krimet ndërkufitare, sigurinë kufitare dhe menaxhimin e përgjithshëm të kufirit. Bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Frontex-it është i mirë dhe po përmirësohet. Frontex është duke vendosur zyrtarë në disa pika të kalimit kufitar në Kosovë, bazuar në planet operative të dakorduara reciprokisht (p.sh. pikat e koordinimit të projektit). Agjencia ofron mbështetje të tjera në lidhje me menaxhimin e kufirit, siç janë udhëzimet për krijimin e qendre kombëtare të koordinimit, në përputhje me *acquis* BE-së. Kosova merr pjesë në rrjetin e analizës së rrezikut të Ballkanit Perëndimor (WB RAN) dhe në një numër organizimesh të tjera rajonale të organizuara nga Frontex.

Bashkëpunimi me të gjithë fqinjët është i mirë, përveç Serbisë. Policia Kufitare ka caktuar pika kontaktuese për bashkëpunim ndërkombëtar. Marrëveshjet e përbashkëta të patrullimit me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi janë në fuqi dhe aktivitetet e përbashkëta

zhvillohen rregullisht. Bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit policor në fuqi, ekzistojnë qendra të përbashkëta të bashkëpunimit policor me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Kosova merr pjesë në Qendrën e Përbashkët të Bashkëpunimit Policor trepalësh (Kosovë, Shqipëri, Mal të Zi) me seli në Plavë të Malit të Zi.

Pikat e Përbashkëta të Përkohshme të Kalimit Kufitar (PPK) ndërmjet Kosovës dhe Serbisë vazhdojnë të jenë funksionale. Vetëm dy nga gjashtë PPK-të e përhershme janë themeluar (Merdare dhe Mutivodë). Serbia ende nuk ka krijuar PPK të përhershme për pritje në anën e saj (Jarinje/Rudnicë, Konçul-Dheu i Bardhë dhe Depçe/Muçibabë), gjë që çoi në pezullimin e fondeve të BE-së për këtë projekt në korrik të vitit 2018. Përveç kësaj, Serbia duhet të angazhohet në mënyrë konstruktive për të mundësuar ndërtimin e PPK-së së tretë të organizuar nga Kosova në veri të Kosovës në Tabavije/Bërnjak. Nga Serbia nevojiten përpjekje shtesë për mbylljen e rrugëve dhe rrugëve anësore ilegale për të siguruar përdorimin ekskluziv të pikave të kalimit zyrtar për mallrat dhe personat që hyjnë ose dalin nga Kosova.

Në vitin 2022, u zhvilluan dy operacione specifike të ndërlidhura me korrupsionin, duke rezultuar në hetimin e 70 personave të dyshuar për ryshfet. Sipas Inspektoratit Policor të Kosovës, këto operacione kanë pasur efekt parandalues. Veprime të tilla parandaluese, në bashkëpunim me autoritetet e MIK-ut, në lidhje me rastet e mundshme të korrupsionit, vazhdojnë të zhvillohen.

Kosova ka arritur progres në zbatimin e planit zhvillimor të rishikuar të Qendrës Kombëtare për Menaxhim Kufitar 2020-2025. Megjithatë, ka ende nevojë për një vlerësim më të mirë strategjik dhe analiza të rreziqeve të ndërlidhura me kufirin, dhe për bashkëpunim më të mirë me autoritetet e tjera kufitare. Efektiviteti i një bashkëpunimi të tillë ndikohet nga mungesa e lidhjes, për çështjet e statusit, me rrjete të rëndësishme ndërkombëtare siç është I-24/7 e Interpolit.

### **Falsifikimi i euros (aspektet e së drejtës penale)**

Kodi Penal i Kosovës i vitit 2019 është gjerësisht në përputhje me *acquis* të BE-së për luftimin e valutës së falsifikuar. Kosova ka autoritete dhe procedura kompetente për t'u marrë me paratë e falsifikuara. Megjithatë, Kodi Penal do të duhet të përafrohet më tej me Direktivën e BE-së për mbrojtjen e euros dhe valutave të tjera nga falsifikimi.

Agjencia për Forenzikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme bën analiza teknike të parave të falsifikuara (përfshirë kartëmonedhat dhe monedhat në euro) në përputhje me standardet ndërkombëtare. Agjencia ka lidhur marrëveshje me Komisionin Evropian për shkëmbimin, ndihmën dhe trajnimin për mbrojtjen e euros nga falsifikimi (programi Pericles 2020).

Ndërmjet qershorit dhe dhjetorit të vitit 2022, policia ka iniciuar 433 raste me vlerë të përgjithshme prej 54 333 euro dhe janë ndaluar 10 persona. Ndërmjet janarit dhe marsit 2023, policia ka iniciuar 275 raste me vlerë prej 44 731 euro. Dy persona janë ndaluar.

*(Shih Kapitullin 32 për kontrollin financiar).*

## **2.3. ZHVILLIMI EKONOMIK DHE KONKURRUESHMËRIA**

<i>Table 7.1:</i>	<b>2014-19</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>
<b>Kosovo - Key economic figures</b>	average			
<b>GDP per capita</b> (% of EU-27 in PPS)	24	25	27	27
<b>Real GDP growth</b>	4.6	-5.3	10.7	3.5
<b>Economic activity rate of the population aged 15-64</b> (%), total	40.4	38.3	39.3	38.6
<i>female</i>	19.6	20.8	22.0	22.0
<i>male</i>	60.9	56.0	56.6	55.5
<b>Unemployment rate of the population aged 15-64</b> (%), total	30.3	25.9	20.7	12.6
<i>female</i>	30.6	32.3	25.0	16.5
<i>male</i>	24.4	23.5	19.0	11.0
<b>Employment of the population aged 15-64</b> (annual growth %)	1.4	-4.4	10.4	5.4
<b>Nominal wages</b> (annual growth %)	3.6	-2.3	3.9	7.6
<b>Consumer price index</b> (annual growth %)	0.9	0.2	3.3	11.6
<b>Exchange rate against EUR*</b>	1.0	1.0	1.0	1.0
<b>Current account balance</b> (% of GDP)	-7.1	-7.0	-8.7	-10.5
<b>Net foreign direct investment, FDI</b> (% of GDP)	3.2	4.2	4.0	6.7
<b>General government balance</b> (% of GDP)	-2.0	-7.6	-1.2	-0.5
<b>General government debt</b> (% of GDP)	14.9	22.4	21.5	19.9

\* The euro is used as a de facto domestic currency

Source: Kosovo statistics, World Bank and IMF

*Në përputhje me konkluzionet e Këshillit Evropian në Kopenhagë në qershor të vitit 1993, anëtarësimi në BE kërkon ekzistencën e një ekonomie funksionale të tregut dhe kapacitetit për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit.*

### 2.3.1. Ekzistenca e një ekonomie funksionale të tregu

Kosova është **ndërmjet një faze të hershme dhe një niveli të përgatitjes** dhe ka arritur **njëfarë progresi** në zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale.

Rimëkëmbja ekonomike e Kosovës u moderua ndjeshëm në vitin 2022 pasi që investimet u tkurren dhe rritja e konsumit familjar u ngadalësua për shkak të inflacionit të lartë, i cili u rrit në numra dyshifrorë si pasojë e rritjes së çmimeve të energjisë, ushqimeve dhe transportit. Lufta e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës pati kryesisht efekte indirekte, nëpërmjet çmimeve më të larta të importit dhe pasigurisë. I mbështetur nga rritja e lartë e të ardhurave dhe ekzekutimi tejet i ulët i shpenzimeve kapitale publike, buxheti total ishte afër bilancit në vitin 2022 dhe shkalla e borxhit publik ra. Megjithatë, baza e investitorëve për borxhin e qeverisë mbetet e ngushtë. Përfitimet sociale mbeten dobët të shënjestruara. Kuvendi miratoi ligjin e ri për pagën minimale, i cili përjashtoi nivelin e pensioneve të veteranëve të luftës nga paga minimale. Performanca financiare e ndërmarrjeve publike paraqet rrezik fiskal. Deficiti i llogarisë rrjedhëse u rrit ndjeshëm si pasojë e rritjeve të mëdha të çmimeve të importit të energjisë. Sektori financiar mbeti i kapitalizuar mirë, i qëndrueshëm dhe kreditimi bankar vazhdoi të zgjerohej në terma nominal. Megjithatë, kërkohet vigjilencë e qëndrueshme mbikëqyrëse në kontekstin e ngadalësimit të rritjes ekonomike, shtrëngimit të kushteve financiare dhe rritjes së shpejtë të kredive hipotekore për ekonomitë familjare. Ekonomia mbeti e qëndrueshme gjatë krizave të fundit, por sektori privat vazhdon të pengohet nga sfidat e kahershme strukturore, siç janë ekonomi informale e përhapur, shkalla e lartë e korrupsionit dhe në përgjithësi sundimi i dobët i ligjit Mjedisi i biznesit është përmirësuar deri në një masë. Formalizimi i tregut të punës vazhdoi, por pjesëmarrja në tregun e punës dhe shkalla e punësimit, veçanërisht tek gratë dhe të rinjtë,

mbetet shumë e ulët, ndërsa papunësia mbetet e lartë.

Rekomandimet e vitit të kaluar janë adresuar pjesërisht dhe mbeten të vlefshme. Për të përmirësuar funksionimin e ekonomisë së tregut, Kosova duhet në veçanti:

- të vazhdojë të zbusë ndikimin e krizës energjetike përmes masave mbështetëse të synuara mirë dhe të përkohshme nëse është e nevojshme, duke respektuar kufirin e deficitit të rregullave fiskale prej 2% të BPV-së;
- të sigurojë përputhjen me kufirin ligjor për pensionet e veteranëve të luftës dhe me rregullin e llogarisë së pagave, dhe të ndër marrë një rishikim të shpenzimeve tatimore, duke përcaktuar sasinë e të ardhurave të harruara nga të gjitha përjashtimet, normat preferenciale dhe regjimet e veçanta;
- të përmirësojë cilësisë e shpenzimeve publike duke reformuar sistemin e sigurimeve sociale dhe duke adresuar dobësitë në menaxhimin e investimeve publike;
- të zbatojë masa përkatëse për mjedisin e biznesit, veçanërisht në luftën kundër ekonomisë informale dhe thjeshtimin dhe digjitalizimin e licencave dhe lejeve.


### Qeverisja ekonomike

**Politikat ekonomike të Kosovës janë fokusuar në ofrimin e mbështetjes së politikave për të zbutur ndikimin e çmimeve më të larta të energjisë dhe për të ristrukturuar rezervat fiskale** Në vitin 2022, qeveria ka ndarë dhe ekzekutuar rreth 316 milionë euro (3.5% e BPV-së) për mbështetje të përkohshme të familjeve dhe firmave të prekura, si dhe bonuse dhe subvencione për paga dhe pensione për sektorët e energjisë dhe bujqësisë. Buxheti për vitin 2023 përfshin një alokim për raste të paparashikuara në vlerë prej 3.5% të BPV-së, nga të cilat 2.7% e BPV-së është alokim i përgjithshëm, i cili ul transparencën fiskale. Ka pasur progres të kufizuar në përmirësimin e planifikimit, përzgjedhjes dhe menaxhimit të investimeve publike, dhe buxheti i kapitalit publik është ekzekutuar shumë më pak se sa ishte parashikuar. Qeveria mori vendime të kujdesshme fiskale duke refuzuar propozimin për tërheqjen e më shumë fondeve nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPS). Kuvendi miratoi ligjin e ri për pagën minimale, i cili përjashtoi nivelin e pensioneve të veteranëve të luftës nga paga minimale. Ligji i ri për pagat e sektorit publik, i kombinuar me vlerën e përshtatshme të koeficientit të pagave të vendosur nga qeveria, siguron që llogaritë e pagave publike të mos e kalojnë kufirin ligjor. Më 25 maj, Bordi Ekzekutiv i FMN-së miratoi një marrëveshje paraprake 24-mujore në vlerë prej 100 milionë euro për Kosovën dhe një mbështetje prej 78 milionë eurosh nga Instrumenti i sapokrijuar i FMN-së për Stabilitet dhe Qëndrueshmëri, që do të përdoret për investime në energji të ripërtëritshme dhe eficiencës të energjisë.

**Udhëzimet e politikave, të miratuara bashkërisht në Dialogun Ekonomik dhe Financiar të majit të vitit 2022 ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, janë zbatuar pjesërisht.** Të ardhurat tatimore u rritën fuqishëm si pasojë e inflacionit të lartë dhe reduktimit të ekonomisë informale, por pati pak progres në rishikimin e përjashtimeve tatimore. Mbikëqyrja financiare e ndërmarrjeve publike (NP) është përmirësuar, por puna për krijimin e një organi të mbikëqyrjes fiskale nuk ka avancuar. Për periudhën 2023-2025, Programi i Reformës Ekonomike të Kosovës (PRE) synon të mbajë financa publike të qëndrueshme dhe të jetë në përputhje me rregullat fiskale, duke mbështetur rimëkëmbjen ekonomike kryesisht përmes shpenzimeve më të larta kapitale.

### Stabiliteti makroekonomik






**Rimëkëmbja ekonomike e Kosovës u moderua ndjeshëm në vitin 2022 për shkak të pasojave nga lufta e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës.** Rritja reale e BPV-së u lehtësua dukshëm nga 10.7% në vitin 2021 në 3.5% në vitin 2022, që është nën normën mesatare të rritjes së BPV-së para pandemisë (2015-2019) prej rreth 5%. Faktorët kryesorë për ngadalësimin ekonomik ishin rënia e formimit të kapitalit fiks bruto dhe ngadalësimi i rritjes së

konsumit privat. Rritja më e ngadaltë e konsumit privat ishte për shkak të inflacionit të lartë dhe rënies si pasojë e të ardhurave reale të disponueshme, si dhe rënies së moderuar të flukseve neto të remitancave si pjesë e BPV-së. Megjithatë, konsumi i ekonomive familjare mbeti një nga shtytësit kryesorë të rritjes, falë masave të mbështetjes së qeverisë dhe kreditimit më të lartë nga bankat. Për më tepër, rritja e fuqishme e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve, së bashku me ngadalësimin e theksuar të rritjes së importeve reale, rezultuan në kontribut pozitiv të eksporteve neto në rritjen e BPV-së. Rritja ekonomike u përshpejtua lehtësisht në 3.9% nga viti në vit në tremujorin e parë të 2023, nga 3.6% në 3 muajt e mëparshëm. Pavarësisht disa përmirësimeve graduale, mungesa e diversifikimit ekonomik, varësia e lartë nga importi dhe furnizimi jo i besueshëm me energji e bëjnë Kosovën të ndjeshme ndaj goditjeve negative të jashtme. BPV i Kosovës për kokë banori mbetet më e ulëta në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke qëndruar në 27% të mesatares së BE-së në vitin 2022.

**Goditja negative e kushteve të tregtisë ka çuar në një përkeqësim të konsiderueshëm të bilancit të llogarisë rrjedhëse.** Deficiti i llogarisë rrjedhëse u zgjerua ndjeshëm në 10.5% të BPV-së në vitin 2022, nga 8.7% në vitin 2021. Një faktor kyç ishte rritja e deficitit tregtar të mallrave nga bilanci i energjisë, i cili tejkaloi rikthimin e vazhdueshëm të eksporteve të shërbimeve, duke rezultuar në rritje të deficitit të përgjithshëm tregtar në 32.5% të BPV-së, nga 31.8% një vit më parë. Të ndikuara nga ngadalësimi ekonomik në BE, remitancat u ulën në 13.7% të BPV-së në vitin 2022, nga 14.5% në vitin 2021, ndërsa suficiti i të ardhurave primare ra në 1% të BPV-së, nga 1.9% një vit më parë. Eksportet dhe remitancat e mëtejshme të shërbimeve jozyrtare u reflektuan nga gabime dhe lëshime të mëdha në bilancin e pagesave (ekuivalente me 2.7% të BPV-së) në vitin 2022. Mesatarja lëvizëse e katër tremujorëve të deficitit të llogarisë rrjedhëse u ngushtua në 9.2% të BPV-së në tremujorin e parë të 2023.

**Flukset hyrëse neto të investimeve të huaja direkte (IHD) u rritën fuqishëm në 6.7% të BPV-së në vitin 2022, duke mbuluar rreth dy të tretat e deficitit të llogarisë rrjedhëse.**

Shtytësit kryesorë për rritjen prej 88% nga viti në vit ishin investimet e vazhdueshme nga diaspora në sektorin e pasurive të paluajtshme, si dhe flukset më të larta hyrëse në miniera dhe gurëthyes, aktivitetet financiare dhe të sigurimit, si dhe në prodhimi. Në vitin 2021, Kosova emetoi bonot e saj të para të diasporës në vlerë totale prej 10.4 milion euro, shumica prej tyre bono 5-vjeçare, në përpjekje për të shfrytëzuar burime shtesë të financimit.




Përndryshe, Kosova vazhdon të mos jetë pjesëmarrëse në tregjet ndërkombëtare të borxhit. Mesatarja lëvizëse e katër tremujorëve të flukseve neto të IHD-ve u rrit lehtë në 7% të BPV-së

në tremujorin e parë të vitit 2023, ndërkohë që rezervat zyrtare arritën në 2.3 muaj importe të mallrave dhe shërbimeve.

**Pas arritjes së kulmit në vitin 2022, inflacioni vjetor filloi të bjerë gradualisht që nga tremujori i fundit i atij viti.** Inflacioni mesatar vjetor i çmimeve të konsumit u përshpejtua ndjeshëm në 11.6% në vitin 2022, nga 3.3% në vitin 2021. Shtytësit kryesorë ishin rritja e çmimeve të energjisë, ushqimeve dhe transportit. Megjithatë, në muajt e fundit të vitit inflacioni filloi të zbutet, duke arritur një mesatare prej 10.1% nga viti në vit në tremujorin e parë të 2023 dhe duke u ulur më tej në 2.4% në korrik, si pasojë e ngadalësimit gradual të çmimeve globale të mallrave. Shumica e çmimeve të energjisë janë të rregulluara në Kosovë. Pas një kërkesë të KEDS-it, kompania kosovare e shpërndarjes së energjisë, në fillim të dhjetorit të vitit 2022, Zyra e Rregullatorit për Energji ka rritur tarifën e energjisë elektrike për 15.4% për të gjitha kategoritë e konsumatorëve në fund të marsit 2023. Qeveria ka vazhduar me subvencionimin e tarifave për familjet dhe bizneset që konsumojnë deri në 800 Kwh.

**Konsolidimi fiskal vazhdoi në vitin 2022 me një reduktim të mëtejshëm të deficitit kryesor si pasojë e rritjes së lartë të të ardhurave dhe realizimit të ulët të programit të investimeve**



**kapitale.** Deficiti total buxhetor ra në 0.5% të BPV-së në vitin 2022 (nga 1.2% e BPV-së në 2021), që korrespondon me një suficit prej 0.2% të BPV-së sipas përkufizimit të rregullit fiskal<sup>6</sup>. Depozitat e qeverisë ranë pak në 3.5% të BPV-së, nga gati 4% në vitin 2021. Rënia e deficitit qeveritar erdhi kryesisht nga një rritje më e lartë se ajo e parashikuar e të ardhurave buxhetore, e cila u rrit për gati 14% nga viti në vit, si pasojë e inflacionit të lartë dhe përfitimeve nga

formalizimi. Të ardhurat tatimore u rritën për 14.3%, ku të ardhurat nga tatime direkte dhe indirekte që u rritën në mënyrë të shëndetshme përkatësisht për 21% dhe 12% në vitin 2022. Shpenzimet publike u rritën për 10.5% nga viti në vit. Rritja më e madhe është shënuar në kategorinë e transfereve dhe subvencioneve (26.3% nga viti në vit), e nxitur kryesisht nga subvencionet e energjisë. Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme rrjedhëse ishte përafërsisht në përputhje me planin e rishikuar buxhetor. Pagat dhe mëditjet shënuan rënie vjetore prej 2.2%, ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime u rritën për 9.4%. Shpenzimet kapitale praktikisht ngjeshën me vitin 2021 dhe arritën vetëm rreth 60% të ndarjes së buxhetit të rishikuar, të ndikuara nga kapaciteti i dobët i menaxhimit të investimeve publike dhe çmimet më të larta të prodhimeve, të cilat kanë çuar në rritje të kostove të projekteve.

**Bazuar në përmirësimin e bilancit buxhetor dhe rritjes së lartë nominale të BPV-së në vitin 2022, raporti i borxhit publik ndaj BPV-së ra, por baza e investitorëve vendor për borxhin qeveritar mbetet e ngushtë.** Raporti i borxhit publik ra në 19.9% të rishikuar në fund të vitit 2022 dhe më tej në 17.3% në qershor 2023. Këto shifra nuk përfshijnë detyrimin për shtetin nga tërheqjet e patatueshme të ndërlidhura me COVID-19 të 10% të kursimeve pensionale nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës, të cilat qeveria premtoi se do t'i

<sup>6</sup> Rregulla fiskale vendos një kufi mbi deficitin fiskal prej 2% të BPV-së së parashikuar, duke përjashtuar projektet kapitale të financuara nga të ardhurat e privatizimit dhe donatorët ('klauzola e investimeve'). Ky përjashtim për investimet e financuara nga donatorët mund të përdoret deri në vitin 2025, me kusht që shkalla e borxhit publik të mbetet nën 30% të BPV-së. Një rregull tjetër thekson se rritja në llogaritë e pagave publike nuk mund të tejkalojë rritjen nominale të BPV-së. Depozitat qeveritare të përdorura si rezerva fiskale janë të detyruara ligjërisht të qëndrojnë në 4.5% të BPV-së për sa kohë që qeveria përdor të ardhurat e privatizimit. Rregulla e borxhit parashikon që borxhi publik dhe i garantuar publikisht nuk mund të tejkalojë 40% të BPV-së.

rimbursonte nga viti 2023.<sup>7</sup> Borxhi i brendshëm, i cili mbahet nga një bazë të ngushtë investitorësh, u rrit vetëm për 0.5% në terma nominalë në vitin 2022. Në mars 2023, pjesa e borxhit të brendshëm të mbajtur nga TKPK u rrit në 49%, nga 44% në vitin 2021, ndërsa Banka Qendrore e Kosovës dhe bankat komerciale mbajnë 20% përkatësisht 24% të borxhit të brendshëm. Në mungesë të një vlerësimi të pavarur kreditor dhe qasjes shumë të kufizuar në tregjet ndërkombëtare të bonove, financimi i huaj është siguruar nga donatorët ndërkombëtarë. Borxhi i jashtëm u rrit për 11.2% në vitin 2022. Këtu përfshihen kreditë nga Banka Botërore (60.1 milionë euro), Banka Evropiane e Investimeve (23.8 milionë euro), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (14.5 milionë euro) dhe Banka e Këshillit të Evropës (10.8 milionë euro). Ligji i ri për borxhin publik dhe garancitë shtetërore, që përaftron kornizën ligjore me standardet dhe praktikën ndërkombëtare të BE-së, u miratua në fund të vitit 2022, dhe aktet nënligjore do të rishikohen dhe miratohen deri në fund të vitit 2023. Sipas këtij ligji të ri, përkufizimi i borxhit publik do të përfshijë edhe borxhin e emetuar në emër të komunave. Ligji rregullon huamarrjen e komunave (përfshirë autorizimin për të marrë hua), kërkesat e raportimit dhe kufijtë e borxhit.

**Progresi me menaxhimin e investimeve publike dhe adresimin e rreziqeve fiskale ka qenë i përzier.** Shpenzimet kapitale publike të buxhetuara pritet të rriten për 3.6% të BPV-së krahasuar me rezultatin e vitit 2022, pavarësisht kapaciteteve të dobëta planifikuese dhe zbatuese dhe të realizimit të ulët në vazhdimësi të buxhetit kapital në vitet e mëparshme. Janë marrë disa hapa për të zhbllokuar zbatimin e projekteve, duke përfshirë shpronësimet e paguara të tokës dhe vënien në funksion të bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit përsëri në tremujorin e dytë të vitit 2022. Për më tepër, Ligji për mbështetjen e punëve publike, i miratuar në fund të vitit 2022, kompenson kontraktorët deri në mesin e vitit 2023 për kosto më të larta të projektit që vijnë nga inflacioni shumë i lartë. Zbatimi i ligjit për pagat e zyrtarëve publikë pritet të rrisë llogarinë e pagave për 11.1% në vitin 2023. Kjo është më e ulët se rritja nominale e BPV-së në vitin 2021, që do të thotë se rregulli i llogarisë së pagave po respektohet. Çështja e tejkallimit të përsëritur të shpenzimeve për pensionet e veteranëve të luftës nuk është zgjidhur për shkak të mungesës së riklasifikimit të përfituesve. Buxheti për vitin 2023 përfshin përsëri një alokim të madh të përgjithshëm, i cili ul transparencën fiskale dhe planifikimin e buxhetit nëse nuk është i justifikuar si pjesë e një kornize konkrete të vlerësimi të rrezikut. Analiza e rrezikut fiskal të ndërmarrjeve kryesore publike në kornizën afatmesme të shpenzimeve (KASH), buxhetin vjetor dhe PRE është zgjeruar përtej NP-ve të mbikëqyruara nga Ministria e Ekonomisë. Megjithatë, analiza është e kufizuar në NP me rrezik të lartë, duke përjashtuar kompanitë e tjera. Zbatimi i Udhërrëfyesit të Energjisë i arritur më 21 qershor 2022 ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja për të adresuar çështjet e faturimit të energjisë elektrike në katër komuna në veri të Kosovës ende nuk ka ecur përpara. Rreziqet fiskale në lidhje me faturimin dhe pagesën e faturave mbeten. Në vitin 2022, detyrimet financiare të KOSTT-it, operatorit kosovar të transmisionit, për humbjet e shkaktuara nga energjia e konsumuar (por e papaguar) në atë pjesë të Kosovës arritën në 63 milionë euro.

**Pas 2 vitesh konsolidimi të konsiderueshëm fiskal, impulsi i fuqishëm fiskal i planifikuar në vitin 2023 është i përshtatshëm.** Në vitin 2022, qeveria miratoi paketa të përkohshme mbështetëse që ndihmuan në zbutjen e ndikimit të krizës energjetike, duke përfshirë subvencionet e energjisë dhe transferet për familjet dhe firmat e prekura. Megjithatë, masat mund të kishin qenë të drejtuar më mirë dhe më transparente. Të ardhurat buxhetore mbështeten në një bazë të ngushtë tatimore, kryesisht nga taksat indirekte, të dobësuara nga përjashtime të shumta tatimore, norma tatimore preferenciale dhe regjime të veçanta, ndërkohë që shpenzimet

<sup>7</sup> FMN-ja vlerëson se detyrimi ndaj Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës në vitin 2020 ishte 1.8% e BPV-së.

publike rëndohen nga transferet specifike të bazuara në kategori, duke lënë pak hapësirë për përfitime të vlerësuar sipas kriterëve dhe politika të punësimit. Buxheti i vitit 2023 parashikon një stimul të fuqishëm fiskal, i cili është kryesisht i përshtatshëm pas 2 viteve të konsolidimit të konsiderueshëm fiskal. Kjo do të zbatohet kryesisht përmes rritjes së shpenzimeve publike për paga dhe investime. Megjithatë, ekziston rreziku që kjo e fundit të përballet me kufizime për shkak të menaxhimit të dobët të investimeve publike.

### Funksionimi i tregjeve të produkteve

#### *Mjedisi i biznesit*

**Hendeku ndërmjet firmave të reja të regjistruara dhe të mbyllura është zgjeruar gjatë 5 viteve të fundit.** Diferenca ndërmjet firmave të reja (11 049) dhe firmave të mbyllura (1 775) u zgjerua në 9 274 në vitin 2022, nga 8 066 në vitin 2018, kryesisht për shkak të numrit më të madh të kompanive të reja të regjistruara.

**Është arritur njëfarë progresi në përmirësimin e mjedisit të biznesit.** Në korrik të vitit 2022, qeveria miratoi koncept dokumentin për Regjistrin e Pronarëve Përfitues. Gjykata Komerciale u bë plotësisht funksionale në gusht të vitit 2022, e cila pritet të rrisë efikasitetin e sistemit gjyqësor në zgjidhjen e kontesteve tregtare, por gjykata ende përballet me numër të madh lëndëve të grumbulluara. Në shtator të vitit 2022, qeveria miratoi një program të përmirësuar për të zvogëluar dhe parandaluar barrën administrative për qytetarët dhe bizneset. Platforma e-Kosova ka rritur numrin e shërbimeve në dispozicion përmes platformës nga 21 në vitin 2021 në 140 në vitin 2023. Në tetor të vitit 2022, qeveria miratoi koncept dokumentin për shoqëritë tregtare dhe aktet nënligjore për Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve. Në nëntor të vitit 2022, u finalizua vlerësimi i përputhshmërisë së bazës së të dhënave të agjencisë me kërkesat e Sistemit të Ndërlidhjes së Regjistrimit të Biznesit (BRIS). Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), detyra e së cilës është të mbështesë bizneset e huaja dhe vendore duke përfshirë NVM-të, të promovojë eksportet dhe të tërheqë investime të huaja direkte, i mungojnë kapacitetet dhe burimet për të ushtruar mandatin e saj të gjerë, ndërsa ristrukturimi dhe reforma e saj janë vonuar shumë. Për këtë arsye, në janar qeveria miratoi Ligjin për investime të qëndrueshme, i cili është në pritje të miratimit në Kuvend. Qëllimi i tij është të rregullojë mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të qëndrueshme. Ligji parashikon gjithashtu zëvendësimin e KIESA-s me një agjenci të re, e cila do të lehtësonte investimet e huaja dhe do t'i raportonte drejtpërdrejt zyrës së kryeministrit.

**Pavarësisht një lloj progresi në reduktimin e ekonomisë informale, ajo ende përbën më shumë se 30% të BPV-së.** Përpjekjet për formalizim nga qeveria, Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe administrata doganore kanë dhënë frytet e tyre, duke kontribuar me rreth 35% të ndryshimit kumulativ në të hyrat tatimore në vitet 2020-2022.<sup>8</sup> Subvencionet e qeverisë për punonjësit e regjistruar për të zbutur ndikimin negativ të pandemisë COVID-19 tek ekonomitë familjare dhe firmat ndihmuan në zhvendosjen e më shumë punonjësve nga sektori informal në atë formal. Rritja e kërkesës për punë në kohën e rimëkëmbjes ekonomike kontribuoi në rritjen e numrit të punonjësve formalë. Gjatë periudhës raportuese, Sekretariati i Grupit Punues Qeveritarë për zbatimin e Strategjisë Kombëtare 2019-2023 për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Informale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimin Financiar, publikoi një raport që mbulon gjysmën e parë të vitit 2022, i cili nxori në pah se vetëm 50% e veprimeve të planifikuara u zbatuan. Plani i dytë i veprimit që mbulon periudhën 2022-2023 është miratuar në vitin 2022, ndërsa Sekretariati ka filluar hartimin e strategjisë së re kombëtare për periudhën 2024-2028. Për të luftuar korrupsionin, në vitin 2022 u miratuan një sërë ligjesh të reja për luftimin e korrupsionit. Këto synojnë forcimin e procedurave penale, agjencinë për

<sup>8</sup> Raporti i Vëndit i FMN-së nr. 23/55, janar 2023.

parandalimin e korrupsionit dhe deklarimin e pasurisë. Sipas indeksit të perceptimit të korrupsionit nga Transparency International, Kosova ka përmirësuar rezultatin e saj të indeksit në vitin 2022, duke u renditur në vendin e 84 nga 180 shtete, që është 3 pozita më të larta se në vitin 2021.

#### *Ndikimi i shtetit në tregjet e produkteve*

**Korniza e politikës për ndihmë shtetërore është në fazën e hershme të zhvillimit.** Kornizës aktuale i mungon një qasje koherente për ndihmën shtetërore, si dhe një strategji gjithëpërfshirëse dhe vlerësimet e kostos dhe përfitimit për ndihmën dhe subvencionet e dhëna. Në periudhën raportuese, Departamenti për Ndihmë Shtetërore zhvilloi një sistem monitorimi online për ndihmën shtetërore. Trajnimi i stafit kompetent për regjistrimin dhe monitorimin e ndihmës shtetërore në sistem është në vazhdim e sipër. Komisioni për Ndihmë Shtetërore ende nuk është emëruar nga Kuvendi dhe mbetet pa kuorum vendimmarrës. Në vitin 2022, në kontekstin e çmimeve më të larta të energjisë dhe të kulturave bujqësore në mes të luftës së agresionit të Ruisë kundër Ukrainës, rreth 1% e BPV-së u nda për subvencione për firmat që operojnë në sektorët e bujqësisë dhe energjisë.

#### *Privatizimi dhe ristrukturimi*

**Kosova ka ndërmarrë hapa të mëtejshëm për krijimin e fondit sovran.** Në qershor të vitit 2022, qeveria miratoi një koncept dokument për fondin sovran dhe në mars 2023 filloi konsultimin publik për projektligjin për krijimin e tij. Fondi sovran pritet të marrë përsipër ndërmarrjet shoqërore<sup>9</sup> dhe asetet e menaxhuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), si dhe disa ndërmarrje publike të menaxhuara nga Ministria e Ekonomisë pas përmirësimit të performancës së tyre financiare. Megjithatë, krijimi i fondit nuk do të jetë i mjaftueshëm për të adresuar çështjet e kahershme të performancës dhe menaxhimit të dobët financiar, të cilat reflektojnë dobësi në qeverisje korporative dhe mbikëqyrjen e ndërmarrjeve publike. Në qershor 2023, qeveria miratoi projektligjin për fondin sovran, i cili do të diskutohet në Kuvend. Gjatë periudhës raportuese, AKP ka iniciuar procedurat e likuidimit për 3 ndërmarrje shoqërore. Në procedurë të likuidimit janë gjithsej 582 ndërmarrje shoqërore. Procesi i shkarkimit dhe emërimit të anëtarëve të rinj të bordit të ndërmarrjeve publike ka vazhduar, me më shumë gra të emëruara.

#### Funksionimi i tregut financiar

##### *Stabiliteti financiar*

**Sektori financiar tregoi qëndrueshmëri mes sfidave të vazhdueshme.** Sektori bankar me pronësi kryesisht të huaj përbën 68.4% të aktiveve të sistemit financiar, të pasuara nga fondet pensionale, institucionet mikrofinanciare dhe kompanitë e sigurimit me 24.5% përkatësisht 4.1% dhe 2.7%. Rentabiliteti i sektorit bankar shënoi përmirësim në terma nominalë, ku raporti mesatar i kthimit në kapital u ngrit në 20.6% në vitin 2022, nga 17.6% në vitin 2021, dhe u rrit më tej në 21.1% në korrik. Në fund të vitit 2022, niveli i kredive jopërfomuese qëndroi në nivel historikisht të ulët prej 2% dhe mbeti i pandryshuar në fund të marsit 2023, i mbështetur pjesërisht nga efekti emërues i rritjes së lartë të kredisë nominale. Sektori bankar duhet të monitorohet me kujdes për shkak të rreziqeve të konsiderueshme nga perspektiva më e dobët ekonomike, rritja e çmimeve të mallrave dhe remitancave më të ulëta se sa pritej. Për më tepër, duke qenë se kreditë e reja hipotekare për ekonomitë familjare kanë shënuar rritje relativisht të madhe, duket e përshtatshme të forcohet mbikëqyrja e tregut të banesave. Raporti e kapitalit rregullator të bankave ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik qëndroi në 14% në vitin 2022 dhe u rrit në 15.3% në korrik, duke tejkalluar lehtësisht minimumin rregullator prej 12%. Bankat

<sup>9</sup> Pronësia e ndërmarrjeve shoqërore konsiderohej si pronë e përbashkët shoqërore në ish-Jugosllavi.

kanë vazhduar të financohen nga depozitat, kryesisht nga ekonomitë familjare. Raporti ndërmjet kredive dhe depozitave u rrit në 78.3% në vitin 2022, nga 76.5% në vitin 2021 dhe u rrit më tej në 81.1% në mars. Në vitin 2022, fitimi neto i institucioneve mikrofinanciare u rrit në 17.2 milionë euro, nga 14.1 në vitin 2021. Fitimi neto i sektorit të sigurimeve ra për 44% në bazë vjetore, duke reflektuar rritjen e shpenzimeve operative, përkatësisht koston e blerjes së mallrave dhe shërbimeve, shpenzimet administrative dhe kërkesat për dëmet e shkaktuara.

### *Qasja në financa*


**Kredidhënia për sektorin privat ka vazhduar të zgjerohet edhe në vitin 2022.** E nxitur nga kredidhënia për biznese dhe ekonomi familjare, rritja e kredive bankare u përshpejtua në një mesatare prej 17.4% në vitin 2022 nga 11.2% një vit më parë, para se të ngadalësohej në 15% nga viti në vit në tremujorin e parë të 2023. Norma mesatare e interesit për kreditë u rrit në 6.3% në vitin 2022, nga 5.8% në vitin 2021 dhe mbeti në 6.3% në mars, duke reflektuar kushte më të shtrënguara të financimit në eurozonë. Rritja mesatare e depozitave u ul në 10.8% në vitin 2022, nga 13.8% një vit më parë, para se të rritej në 16.3% nga viti në vit në tremujorin e parë të 2023. Kreditë e reja për bizneset me fokus investimet u rritën për 9.6% në vitin 2022. Përkundër disa iniciativave të reja të ndërmarra nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, mungesa e kredive lehtësisht të qasshme dhe të përballueshme vazhdon të jetë pengesë për rritjen e NVM-ve. Kjo është pjesërisht për shkak të pabarazisë ekzistuese ndërmjet vlerës së tregut të kolateralit dhe vlerës së tij të caktuar ligjërisht të marrë parasysh nga bankat. Tregu i kapitalit mbetet në një fazë të hershme të zhvillimit. Mikrofinancimi ka fituar vrull në vitet e fundit<sup>10</sup>, por mangësitë në kornizën ligjore që rregullon institucionet mikrofinanciare pengojnë rritjen dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të industrisë.

### Funksionimi i tregut të punës

---

<sup>10</sup> Përkundër të zgjerimit të sektorit mikrofinanciar, norma e interesit për kredi ishte rreth 18%, që është gati tre më e lartë se norma e kredive bankare.

**Pavarësisht disa përparimeve, tregu i punës vazhdon të vuajë nga pjesëmarrja shumë e ulët, papunësia e lartë dhe hendeqet e mëdha gjinore.** Rezultatet e Anketës së Fuqisë



Punëtore vazhdojnë të publikohen me vonesa të mëdha. Të dhënat më të fundit të disponueshme i referohen tremujorit të fundit të vitit 2022. Në përputhje me rimëkëmbjen e vazhdueshme të aktivitetit ekonomik, shkalla e punësimit u rrit në 34%, nga 31.7% në tremujorin e fundit të vitit 2021. Ndërkohë, shkalla e papunësisë ka rënë ndjeshëm nga 19% në 11.8%, ndërsa shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ka rënë nga 39.2% në 38.5% në të

njëjtën periudhë. Ka vazhduar hendeuku i gjerë ndërmjet normave të punësimit të meshkujve dhe femrave (50.8% respektivisht 17.1%). Në 3 muajt e fundit të vitit 2022, pjesëmarrja e të rinjve (15-24 vjeç) që nuk janë në punësim, arsim apo trajnim u ul disi në 33.7%, nga 34.8% në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Për të përmirësuar situatën, qeveria miratoi planin shumëvjeçar të zbatimit të garancisë për të rinjtë dhe janë duke u zhvilluar reforma të vazhdueshme në shërbimet publike të punësimit. Të dhënat e administratës tatimore sugjerojnë se punësimi zyrtar në sektorin privat dhe publik u rrit për 4.9% në vitin 2022. Në dhjetor të vitit 2022, numri i punëkërkuësve të regjistruar ra për 1.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Pavarësisht disa përfitimeve të fundit nga formalizimi, një sistem i përgjithshëm i orientuar keq i asistencës sociale krijon pengesa për t’iu bashkuar punësimit formal.** Në vitin 2022, shpenzimet për transfere dhe subvencione arritën në rreth 12% të BPV-së, nga të cilat shpenzimet për asistencën sociale që synon varfërinë ishin më pak se 0.5%. Transferet sociale të bazuara në kategori, siç është skema e pensioneve të veteranëve të luftës, minojnë qëndrueshmërinë dhe drejtësinë e sistemit të përfitimeve sociale. Mungesa e përfitimeve sociale dhe përfitimeve të tjera në punësimin formal – duke pasur parasysh mungesën e strukturave për t’i ofruar ato – dekurajon shumë punëdhënës dhe punonjës informal nga formalizimi i marrëveshjeve të punës. Sipas vlerësimeve, 40% e fuqisë punëtore nuk është e deklaruar ose është më pak se shifrat aktuale. Pagat dhe remitancat relativisht të larta të sektorit publik rrisin pagat e rezervuara, duke kufizuar ofertën e punës, ndërsa mungesa e vendeve të punës nxit emigrimin e të rinjve. Rritja e produktivitetit të sektorit privat do të përmirësonte konkurrencën e eksportit, do të rriste mundësitë e punësimit dhe do të mundësonte paga më të larta. Mungesa e ambienteve të kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit pengon punësimin e femrave.

### 2.3.2. Kapaciteti për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit

Kosova është në **fazën fillestare** dhe ka arritur **progres të kufizuar** sa i përket kapacitetit për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut në BE. Sistemi arsimor nuk ofron njohuri të mjaftueshme për shkathtësitë e nevojshme kyçe dhe nuk është në përputhje adekuate me nevojat e tregut të punës. Është arritur njëfarë progresi në përmirësimin e infrastrukturës. Sektori i energjisë mbetet pengesë kryesore për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe kriza e vazhdueshme energjetike potencoi urgjencën për të siguruar një furnizim të besueshëm dhe të pastër me energji dhe diversifikimin e burimeve të energjisë. Kosova ka arritur njëfarë progresi në digjitalizimin e ekonomisë. Ndryshimet strukturore po përparojnë ngadalë pasi ekonomia mbetet shumë e varur nga firmat e vogla dhe mikro firmat, të cilat nuk mund të konkurrojnë

ndërkombëtarisht. Në të njëjtën kohë, struktura e eksportit është diversifikuar, ndonëse ende dominohet nga metalet bazë. Hapja tregtare u rrit pasi eksportet dhe importet u rritën fuqishëm. Rekomandimet e vitit 2022 nuk janë zbatuar plotësisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme.

Për të përmirësuar konkurrencën dhe për të mbështetur rritjen afatgjatë, Kosova duhet në veçanti:

- të përmirësojë cilësinë e arsimit në të gjitha nivelet dhe të harmonizojë arsimin, veçanërisht programet e arsimit të lartë dhe arsimit dhe aftësimin profesional, me nevojat e tregut të punës duke bashkëpunuar ngushtë me komunitetin e biznesit;
- të forcojë sigurinë energjetike dhe të rrisë stimujt për efikasitet të energjisë në sektorin rezidencial dhe privat dhe të rrisë pjesëmarrjen e burimeve të ripërtëritshme në prodhimin e energjisë sipas mënyrës me kosto efikase;
- të avancojë mbështetjen e përshtatur financiare dhe jo-financiare për NVM-të për të përmirësuar kapacitetin e tyre konkurrues dhe eksportin..

### Arsimi dhe inovacioni

**Është arritur njëfarë progresi në reformimin e sistemit arsimor dhe përafrimin e tij me nevojat e tregut të punës.** Shpenzimet publike për arsimin arritën në 4.1% të BPV-së në vitin 2021 (në rënie nga 4.6% në vitin 2020 dhe 4.3% në vitin 2019), që është gjerësisht në përputhje me mesataren e BE-së. Megjithatë, sa i përket rezultateve, Kosova ka performancë më të keqe. Shkalla e regjistrimit të fëmijëve në edukimin e hershëm është 6.7%, më e ulëta në rajon, ndërsa në arsimin fillor dhe të mesëm shkalla e regjistrimit të kombinuar prej 88.1% është shumë e ngjashme me atë të moshatarëve të rajonit. Për të adresuar pjesëmarrjen e pamjaftueshme në edukimin në fëmijëri të hershme, qeveria ka miratuar projektligjin për arsimin e hershëm, i cili gjendet në Kuvend për miratim. Mungesa e materialeve mësimore cilësore (përfshirë mungesën e burimeve digjitale) në shkolla dhe mungesa e trajnimit fillestar dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësimit kanë ndikim negativ në cilësinë e arsimit. Materialet mësimore janë përshtatur në përputhje me testin e Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) 2022<sup>11</sup>, pasi që Kosova shënoi renditjen e saj më të ulët ndonjëherë në vitin 2018. Rezultatet e nxënësve të Kosovës ishin më të ulëta se mesatarja e OBZHE-së në lexim me ekuivalentin e 5 viteve të shkollimit dhe në matematikë për pak më shumë se 4 vite. Sistemi arsimor nuk është i orientuar për të zhvilluar shkathtësitë e nevojshme kyçe dhe nuk është në përputhje adekuate me nevojat e tregut të punës. Strategjia e arsimit 2022-2026, e miratuar në tetor të vitit 2022, synon të rrisë cilësinë e arsimit parauniversitar dhe në veçanti të harmonizojë arsimin dhe aftësimin profesional. Ajo njeh gjithashtu plotësisht nevojën për të zhvilluar një sistem informacioni dhe parashikimi në kohë reale për nevojat e tregut të punës, si dhe një metodologji të standardizuar për kërkimin e tregut të punës. Ky angazhim ende nuk është kthyer në veprim. Në shtator të vitit 2022, Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) iu dha statusi i anëtarit të asociuar të Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA). Agjencia aktualisht është në proces aplikimi për anëtarësim në ENQA dhe Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë. Kosova miratoi Ligjin për AKA-në, i cili synon për të rrisë pavarësinë operacionale të agjencisë dhe transparencën e emërimeve të drejtuesve.

**Performanca e Kosovës mbetet pas në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit.** Kjo është e vërtetë për qeverisjen e politikave, sistemin e kërkimit publik, lidhjet publiko-private, inovacionin në firma dhe burimet njerëzore për inovacion; Kosova në përgjithësi ka një nga

<sup>11</sup> Rezultatet e testit PISA 2022 do të publikohen në dhjetor 2023.



rezultatet më të ulëta në rajonin e Ballkanit Perëndimor<sup>12</sup>. Ndarja e buxhetit për kërkim dhe zhvillimi prej 0.1% të BPV-së, është shumë më poshtë se 0.7% e BPV-së që kërkohet me ligj (krahasuar me një mesatare prej 2.2% në BE), veçanërisht për inovacionin e biznesit. Ka një fragmentim kronik në zbatimin e politikës së inovacionit dhe nuk ka koordinim të përgjithshëm ndërmjet ministrive të linjës dhe agjencisë për mbështetjen e NVM-ve, KIESA-s. Në vitin 2022, Këshilli Kombëtar i Shkencës i Kosovës arriti me sukses të zhvillojë Programin Kombëtar të Shkencës si dokumentin kryesor strategjik për shkencë dhe kërkim. Kosova ka përfunduar me sukses negociatat me BE-në për t'u bërë anëtare e asociuar me të drejta të plota e programit Horizon Europe, edhe pse ka nevojë për përmirësimin e performancës në marrjen e granteve.

### Kapitali fizik dhe cilësia e infrastrukturës

**Investimet e huaja direkte (IHD) nuk kanë çuar në rritje të produktivitetit të brendshëm.** Kosova ka tërhequr kryesisht investime në fusha me ndikim të kufizuar në produktivitet, siç janë ndërtimtaria dhe pronat e paluajtshme, të cilat përfaqësojnë 80% të investimeve të huaja direkte (FDI)<sup>13</sup>. Në vitin 2022, 67% përkatësisht 7% e të gjitha flukseve hyrëse të IHD-ve u drejtuan në pasuri të paluajtshme përkatësisht aktivitete financiare dhe të sigurimeve. Për më tepër, IHD-të janë të kufizuara në një pjesë të vogël të vendeve, përkatësisht shteteve ku ekziston një diasporë e madhe dhe e vendosur mirë e Kosovës. IHD-të e orientuara nga eksporti kanë qenë shumë të pakta dhe shifrat e përgjithshme janë relativisht të ulëta, duke kaluar shifrën prej 300 milionë euro vetëm një herë në 7 vitet e fundit.

**Kosova ka arritur progres të kufizuar në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, duke vonuar zbatimin e projekteve të mëdha.** Qeveria ka paraqitur një kërkesë për kredi tek BERZH-i dhe EIB për Rrugën 7 *Autostradën e Paqes*. Punimet për rehabilitimin e Linjës Hekurudhore 10 kanë vazhduar me ritme të ngadalta, ku segmenti i parë pritet të përfundojë në tremujorin e parë të vitit 2024. Punimet në segmentin e dytë kanë nisur në fund të vitit 2022, ndërsa punimet përkatëse të sinjalizimit dhe telekomit nuk kanë filluar ende. Sistemi i transportit ende përballet me një sërë sfidash sa i përket sigurisë, mirëmbajtjes joadekuate dhe kapaciteteve të dobëta administrative të institucioneve rregullatore.

**Furnizimi i paqëndrueshëm dhe i padiversifikuar me energji dhe sektori jashtëzakonisht i brishtë i energjisë mbeten pengesat kryesore për zhvillimin ekonomik të Kosovës.** Qëndrueshmëria e furnizimit me energji është ende nën mesataren për Evropën dhe Azinë Qendrore. Pavarësisht disa përmirësimeve, Kosova renditet e 90<sup>-ta</sup> në botë për lehtësinë e marrjes së energjisë elektrike<sup>14</sup>. Mungesa e sigurisë energjetike sjell kosto të konsiderueshme për biznesin dhe përfaqëson një nga pengesat më të mëdha për tërheqjen e investimeve të huaja direkte me cilësi të lartë. Kërkesa dhe konsumi për energji vazhdojnë të rriten me shpejtësi dhe janë dyfishuar që nga viti 2000. Kosova gjithashtu vuan nga humbje të larta teknike dhe komerciale në rrjetet e shpërndarjes dhe transmissioinit për shkak të infrastrukturës së dobët (rreth 20%).

**Prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë mbështetet shumë në termocentralet me qymyr.** Më shumë se 90% e energjisë elektrike prodhohet nga dy termocentralet e linjtit të vjetruara, jo të besueshme dhe shumë ndotëse, të cilat qeveria planifikon t'i rinovojë. Burimet e energjisë së ripërtëritshme përbëjnë pak më shumë se 5% të furnizimit me energji elektrike. Shpërndarja e burimeve të ripërtëritshme pritet të përshpejtohet përmes strategjisë kombëtare të energjisë 2022-2031 të sapomiruar dhe ligjit për energji të ripërtëritshme që do të miratohet nga

<sup>12</sup> OBZHE(2021), *Konkurrueshmëria në Evropën Juglindore – një perspektivë e politikës 2021*.

<sup>13</sup> FMN (2023), *Republika e Kosovës, Dokument i Çështjeve të Përzgjedhura*.

<sup>14</sup> Banka Botërore (2020b), *Të bërit biznes 2020: Krahasimi i Rregullores së Biznesit në 190 ekonomi*.

Kuvendi në TM3-2023. Projektligji parashikon një proces konkurrues tenderimi për të mbështetur projektet e energjisë së ripërtëritshme, duke zëvendësuar sistemin e mëparshëm të tarifave nxitëse. Në maj të vitit 2023, Kosova lansoi një pilot ankand për 100 MW të energjisë solare. Ka pasur një rritje të investimeve në energjinë e ripërtëritshme dhe tashmë janë planifikuar disa projekte për zhvillimin e burimeve të rëndësishme të energjisë së erës dhe asaj solare. *(Shih gjithashtu Kapitullin 15 – Energjia).*


**Transformimi digjital i ekonomisë po avancohet gradualisht, por digjitalizimi i shërbimeve publike ende është në një fazë të hershme.** 100% e familjeve në mbarë vendin tani kanë qasje në infrastrukturën fikse të komunikimeve elektronike me brez të gjerë. Depërtimi i internetit me qasje fiks vlerësohet të jetë 125% e ekonomive familjare, krahasuar me 89% në BE, dhe depërtimi i telefonisë celulare është rreth 95% e popullsisë. Kosova ka një sektor të vogël por me rritje të shpejtë të TIK-ut, veçanërisht në eksportin e zhvillimit të softuerit, zhvillimin e aplikacioneve për telefona inteligjentë dhe dizajnimin e faqeve të internetit. Duhet bërë më shumë për të trajnuar punëtorë të kualifikuar në këtë sektor, ku kërkesa për punonjës tejkalon ofertën. Që nga 1 korriku i vitit 2021, Kosova është angazhuar në mënyrë konstruktive në dialogun rajonal të nivelit të lartë për transformimin digjital dhe zbatimin e Marrëveshjes Rajonale për Roaming. Pavarësisht disa përmirësimeve në zbatimin e programeve të tregtisë elektronike, duket se ka pak përparim në rritjen e përdorimit të praktikave të tregtisë elektronike nga NVM-të. Strategjia e Agjendës Digjitale që mbulon periudhën deri në vitin 2030 është dorëzuar për konsultim publik. Dokumenti i politikave pritët të sigurojë një kornizë gjithëpërfshirëse për transformimin digjital, duke përfshirë teknologjitë 5G dhe transformimin digjital të bizneseve dhe shërbimeve publike.

#### Struktura sektoriale dhe sipërmarrëse

**Spektori i shërbimeve vazhdon të dominojë ekonominë sa i përket BPV-së dhe punësimit.** Struktura sektoriale e vlerës së shtuar bruto (VSHB) tregon një rritje të qëndrueshme të pjesëmarrjes së tregtisë me shumicë dhe pakicë në gati 14% në vitin 2022, nga 12.5% në vitin 2018. Kjo është pasuar nga një rritje e lehtë e pjesëmarrjes së bujqësisë (7.4% në vitin 2022, nga 6.5% në vitin 2018). Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja e aktiviteteve të pasurive të paluajtshme në VSHB ra për 1.2 pikë përqindje në 5.9% krahasuar me vitin 2018, e pasuar nga tkurrja e kontributeve nga administrata publike dhe arsimiti. Pavarësisht rënies së lehtë krahasuar me vitin 2018, sektori i shërbimeve vazhdoi të dominojë aktivitetin ekonomik në vitin 2022, duke siguruar rreth 45% të VSHB-së. Kontributi i ndërtimitarisë mbeti praktikisht i pandryshuar në rreth 8% krahasuar me 5 vite më parë, ndërsa punësimi në sektor ra në 11% në vitin 2022, nga 11.9% në vitin 2018. Për të njëjtën periudhë, përqindja e të punësuarve në sektorin e shërbimeve u rrit lehtë nga 70% në 73%.

**Spektori privat i Kosovës dominohet nga firma shumë të vogla me qasje të vështirë në financa.** Edhe pse NVM-të përfaqësojnë mbi 99% të ndërmarrjeve të regjistruara, pothuajse të gjitha janë mikro firma që punësojnë 1-9 punonjës, ndërsa përqindja e kompanive më të mëdha (10-249 punonjës) është më pak se 1%. NVM-të dhe bizneset e drejtuara nga familja përbëjnë 80.4% (2020) të punësimit në bizneset jofinanciare (dukshëm mbi mesataren e BE-së prej 65.2%) dhe gjenerojnë 81% të vlerës totale të shtuar të vendit. Qasja në financa mbetet pengesë për rritjen për shkak të kërkesave strikte të bankave për kredi, duke prekur kryesisht ndërmarrjet më të vogla. Brenda gati 7 viteve, portofoli i Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) ka arritur vlerën kumulative të kredive të miratuara prej rreth 550 milionë euro, ndërsa vlera e garantuar nga Fondi ka arritur në 290 milionë euro, të shpërndara në gati 13,000 kredi.

## Integrimi ekonomik në BE-në dhe konkurrueshmëria e çmimeve



**Gjatë 5 viteve të fundit, BE-ja ka mbetur partneri më i madh tregtar i Kosovës, ndërsa pjesëmarrja e vendeve të CEFTA-s ka rënë.** Në vitin 2022, BE-ja përbënte 42.4% të importeve totale të mallrave të Kosovës, pak më e ulët se në vitin 2018, ndërsa pjesëmarrja e partnerëve të CEFTA-s ra për rreth 8 pp në 17.7%. Nga ana tjetër, përqindja e mallrave të importuara nga Turqia u rrit në gati 15%, duke u rritur për gati 5 pp në vitin 2018. Pjesëmarrja e BE-së në eksportet e mallrave të Kosovës u rrit në 33.9% në vitin 2022, nga 27.5% në vitin 2018, ndërsa përqindja e vendeve të CEFTA-s u ra në 36.2% nga 47.2%. Ndër partnerët e CEFTA-s, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria janë destinacionet kryesore për eksportet e mallrave të Kosovës. Pjesëmarrja e metaleve bazë<sup>15</sup> në eksportet e mallrave ra në 23.1% në vitin 2022, nga 34.1% në vitin 2018, por ato ende përbëjnë pjesën më të madhe të eksporteve të mallrave. Përqindja e artikujve të ndryshëm të prodhuar u rrit ndjeshëm në rreth 20% në vitin 2022, nga 4% në vitin 2018.

**Hapja tregtare u përmirësua ndjeshëm në vitin 2022, në përputhje me performancën e qëndrueshme të tregtisë së mallrave dhe shërbimeve.** Në përgjithësi, hapja tregtare (d.m.th. vlera totale e eksporteve dhe importeve) u rrit në 109.2% të BPV-së në vitin 2022, nga 98.6% në vitin 2021 dhe 86.3% në vitin 2018. Përmirësimi ka ndodhur si për tregtinë e mallrave ashtu edhe për atë të shërbimeve. Rritja e eksporteve të mallrave (21.8%) në vitin 2022 ishte nxitur kryesisht nga produktet minerale si dhe nga plastika, goma dhe artikujt e tyre të prodhuar. Eksportet e shërbimeve vazhduan të rriten fuqishëm, me 31.3% në terma nominalë, të nxitura kryesisht nga turizmi i diasporës nga Evropa Perëndimore. Krahas shërbimeve të udhëtimit, të cilat aktualisht kanë pjesëmarrjen më të madhe të eksporteve të shërbimeve (74.4%), zhvillime pozitive ka pasur edhe në eksportet e telekomunikacionit dhe shërbimeve kompjuterike dhe informative. Importet e mallrave u rritën me shpejtësi (20.4%) kryesisht për shkak të importeve më të larta të energjisë.

**Shtetet anëtare të BE-së mbeten investitorët kryesorë në Kosovë.** Flukset neto të IHD-ve u rritën për 88% në vitin 2022, kryesisht si pasojë e investimeve të konsiderueshme të diasporës në pasuri të paluajtshme, të pasuara nga aktivitetet financiare dhe të sigurimit. Koncentrimi i

<sup>15</sup> Kjo është pjesërisht për shkak se Ferronikeli (eksportuesi më i madh i Kosovës) ndaloi prodhimin në tremujorin e fundit të vitit 2021 për shkak të çmimeve më të larta të energjisë.

madh në këta sektorë (rreth 75% e flukseve të IHD-ve) kontribuon pak në përmirësimin e kapaciteteve të eksportit. Pjesëmarrja e BE-së në stokun neto të IHD-ve të Kosovës arriti në 40.5% në vitin 2022, nga 32.1% në vitin 2018. Pjesëmarrja e Gjermanisë dhe Zvicrës (dy vende me diaspora të mëdha nga Kosova), u rrit në 17.5% përkatësisht 16.4% në vitin 2022, nga 11.8% dhe 11.4% në vitin 2018.

## 2.4. PROKURIMI PUBLIK, STATISTIKAT DHE KONTROLI FINANCIAR

### Kapitulli 5: Prokurimi publik

*Rregullat e BE-së sigurojnë që prokurimi publik i mallrave, shërbimeve dhe punëve në çdo Shtet Anëtar është transparent dhe i hapur për të gjitha kompanitë e BE-së mbi bazën e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë.*

Kosova ndodhet **ndërmjet njëfarë niveli të caktuar dhe të moderuar të përgatitjes** në fushën e prokurimit publik. Ajo ka arritur **progres të kufizuar** në këtë fushë. Prokurimi publik mbetet i prirur ndaj parregullsive dhe i cenueshëm ndaj korrupsionit si gjatë vetë procesit të prokurimit ashtu edhe në zbatimin e mëvonshëm të kontratës. Nuk është arritur progres në miratimin e ligjit të ri të prokurimit publik. Pasi që rekomandimet e vitit të kaluar nuk janë zbatuar, ato mbeten kryesisht të vlefshme.

Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

- të miratojë ligjin e ri për prokurimin publik dhe ligjin e ri për koncesionet në përputhje me *acquis* të BE-së; të përgatisë legjislacionin përkatës zbatues dhe të sigurojë zbatimin e duhur të tyre;
- të shtojë kapacitetet dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjitha institucioneve të prokurimit publik dhe autoriteteve kontraktuese;
- të sigurojë që Organi Shqyrtues i Prokurimit të jetë plotësisht funksional dhe të mbetet funksionalisht i pavarur; duhet gjithashtu të forcojë kapacitetin e Organit dhe të sigurojë që procesi i tij i rishikimit të jetë në kohë, efektiv dhe transparent.

#### Struktura institucionale dhe harmonizimi ligjor

Korniza ligjore për prokurimin publik është pjesërisht në përputhje me *acquis* për prokurimin publik të BE-së të vitit 2014. Ligji i ri për prokurimin publik është ende në pritje të miratimit nga qeveria për më shumë se dy vjet. Autoritetet nuk kanë filluar ende të hartojnë legjislacionin zbatues. Ligji i ri për partneritetin publiko-privat është gjithashtu në pritje të miratimit nga qeveria.

Prioritetet strategjike në fushën e prokurimit publik, përfshirë aktivitetet në këtë fushë, janë tashmë pjesë e strategjisë së re të menaxhimit të financave publike 2022-2026 dhe planit të saj të veprimit 2022-2024, të cilat janë miratuar në fund të dhjetorit të vitit 2022.

Agjencia Qendrore e Prokurimit, që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, kryen blerjet të centralizuara në emër të qeverisë qendrore. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik është përgjegjës për koordinimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik. Organi Shqyrtues i Prokurimit shqyrton të gjitha pretendimet për shkelje të ligjit për prokurimin publik dhe shqyrton ankesat e ofertuesve. Pavarësia funksionale e Organit duhet të pasqyrohet në ligjin e ri. Është po ashtu e rëndësishme të sigurohet një dhe bashkëpunim më i mirë në mes të këtyre institucioneve, siç janë Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës. Bashkëpunimi në

ketë fushë do të ndihmonte në zbulimin e çdo manipulimi të ofertave dhe zvogëlimin e rreziqeve nëpërmjet planifikimit dhe hartimit të kujdesshëm të tenderëve.

### Implementimi dhe kapaciteti zbatues

**Tregu i prokurimit publik** në Kosovë u vlerësua të jetë 6.5% e BPV-së në vitin 2022, krahasuar me 5.6% të BPV-së në vitin 2021. Deri në qershor 2023, sistemi i prokurimit elektronik të vendit kishte regjistruar rreth 14 400 biznese dhe rreth 16 300 përdorues aktivë. Në vitin 2022, janë nënshkruar 10 290 kontrata publike, krahasuar me 9 892 në vitin 2021. Për sa i përket vlerës, kontrata me vlerë 559 milionë euro janë nënshkruar në vitin 2022, krahasuar me kontratat me vlerë afër 430 milionë euro në vitin 2021. Një sasi e konsiderueshme e aktiviteteve të prokurimit publik (21.80%) janë kryer përmes procedurës me negociim pa prokurim formal dhe proces tenderimi. Vlera e kontratave të nënshkruara me procedurë të negociuar pa publikim është 78,56 milionë euro ose 14.05%.

Sa i përket **monitorimit të dhënies së kontratave dhe zbatimit**, në vitin 2022, 78.2% e kontratave janë dhënë me procedurë të hapur dhe 94.34% e kontratave publike janë dhënë sipas kriterit të çmimit më të ulët, me vetëm 5.66% (ose 31.6 milionë euro) duke përdorur raportin më të mirë çmim-cilësi. Përdorimi i raportit më të mirë çmim-cilësi duhet të inkurajohet më tej në përputhje me direktivat e BE-së për prokurimin publik. Ende nuk është siguruar ndërveprueshmëria ndërmjet sistemit të prokurimit elektronik dhe sistemeve të tjera relevante të TI-së të qeverisë për të rritur transparencën (siç është me Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës) për të gjurmuar pagesat.

**Kapaciteti e autoriteteve kontraktuese për të menaxhuar proceset e prokurimit publik** ndryshon. Nevojiten përmirësime në kërkimin e tregut, në procesin e vlerësimit të tenderëve si dhe në zbatimin dhe monitorimin e kontratave. Nevojiten përmirësime të mëtejshme në hartimin e specifikacioneve teknike për të mbështetur më mirë cilësinë, efikasitetin dhe transparencën e prokurimit. Ekziston rreziku i keqmenaxhimit dhe korrupsionit për shkak të zbatimit të kufizuar, llogaridhënies së pamjaftueshme menaxheriale, kontrollit të pamjaftueshëm të cilësisë dhe kapacitetit të kufizuar të menaxhimit të kontratave. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik organizoi trajnime për të përmirësuar kapacitetet e autoriteteve kontraktuese për të përdorur raportin ndërmjet çmimit dhe cilësisë më të mirë si kriter për dhënien e kontratës. Për më tepër, komisioni ka mbajtur seminare mbi përdorimin e moduleve për menaxhimin e kontratave dhe për vlerësimin e performancës së kontraktorëve. Sistemi i prokurimit elektronik duhet të përditësohet për të siguruar funksionalitet të plotë.

Prokurimi i centralizuar është i detyrueshëm për agjencitë me më pak se 50 punonjës dhe për 14 kategori mallrash dhe shërbimesh të listuara. Agjencia Qendrore e Prokurimit vazhdon të ketë mungesë të personelit. Kosova duhet të përmirësojë planifikimin e saj të prokurimit dhe të zvogëlojë përdorimin e procedurave të negociuarat të prokurimit. Për të zbutur rreziqet e keqpërdorimit dhe mashtrimit, është e rëndësishme të sigurohet transparencë e plotë, të sigurohet arsyetim i qëndrueshëm për të shpjeguar vendimin për dhënien e kontratës dhe të ruhen gjurmët e auditimit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit do të përfitonte nga staf më i kualifikuar, veçanërisht në lidhje me ekspertët shqyrtues dhe ligjorë, për të siguruar vendime në kohë dhe cilësore për ankesat.

Nuk ka pasur zhvillime në fushën e **integriteti dhe luftën kundër konfliktit të interesit**. Kosova ka një kod të etikës për prokurimin publik, por nuk e monitoron respektimin e këtij kodi Trajnime të specializuara profesionale dhe etike duhet t'u ofrohen të gjitha autoriteteve kontraktuese. Përpjekje të mëtejshme janë duke u zhvilluar si për sistemet e prokurimit ashtu edhe për mbikëqyrjen e auditimit të pushtetit lokal. Komunat gjithnjë e më shumë po publikojnë kontratat e tyre të prokurimit.

## Sistemi efikas i mjeteve juridike

Legislacioni i Kosovës për **të drejtën e mjeteve juridike** është gjerësisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Ankesat për të konkuruar çmimet e prokurimit mund të bëhen përmes platformës së prokurimit elektronik. Pas dorëheqjes së një anëtari të bordit, Bordi i Organit Shqyrtues të Prokurimit është sërish i paplotë, edhe pse vazhdon të funksionojë. Kosova duhet të sigurojë që Organi Shqyrtues i Prokurimit të bëhet plotësisht funksional dhe të mbetet funksionalisht i pavarur. Kapaciteti i Organit duhet të forcohet dhe procesi i rishikimit të tij duhet të menaxhohet me kohë, në mënyrë efektive dhe transparente. Janë paraqitur gjithsej 820 ankesa dhe Bordi ka trajtuar 732 raste në vitin 2022 dhe 88 raste në vitin 2023.

## **Kapitulli 18: Statistikat**

*Rregullat e BE-së kërkojnë nga shtetet anëtare të nxjerrin statistika në bazë të pavarësisë profesionale, paanshmërisë, besueshmërisë, transparencës dhe konfidencialitetit. Ekzistojnë rregulla të përbashkëta për metodologjinë, nxjerrjen dhe shpërndarjen e informacionit statistikor.*

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në fushën e statistikave. Është arritur **njëfarë progresi** gjatë periudhës raportuese, veçanërisht në përmirësimin e: metodologjisë së mbledhjes së të dhënave; transmetimin e të dhënave në Eurostat; dhe zbatimin e rekomandimeve të vlerësimit të kolegëve nga Eurostat. Komunikimi ndërmjet institucioneve të ndryshme statistikore është përmirësuar, por koordinimi në nivel teknik dhe përdorimi i të dhënave administrative në dispozicion mbetet i pamjaftueshëm. Kosova gjithashtu ka përmirësuar frekuencën e rezultateve të saj statistikore. Disa statistika për energjinë, statistikat sociale dhe statistikat afatshkurtra në sektorin e shërbimeve tani dërgohen në Eurostat për çdo muaj, ndërsa më parë dërgoheshin çdo tre muaj. Regjistrimi i vonuar i popullsisë dhe banesave tani është planifikuar të bëhet mes 1 nëntorit dhe 31 dhjetorit.

Rekomandimet e vitit të kaluar janë përmbushur pjesërisht dhe mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

- të finalizojë përgatitjet për regjistrimin e popullsisë dhe banesave dhe zbatimin e tij duke siguruar detaje operacionale dhe mbulim të plotë të territorit;
- të shtojë numrin e produkteve statistikore dhe të dërgojë këto produkte më shpesh në Eurostat;
- të plotësojë vendet e zbrazëta ekzistuese dhe të rrisë kapaciteteve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Sa i përket **infrastrukturës statistikore**, korniza ligjor është gjerësisht në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane. Megjithatë, zbatimi i kësaj kornize duhet të forcohet. Për këtë qëllim, Kosova duhet: (i) të mbajë rolin udhëheqës për Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK); (ii) të përmirësojë qeverisjen statistikore dhe koordinimin ndërmjet institucioneve kryesore statistikore; (iii) dhe të sigurojë qasje më të mirë në burimet administrative të të dhënave. ASK-ja duhet të vazhdojë të zbatojë rekomandimet e vlerësimit të kolegëve nga Eurostat, veçanërisht në lidhje me rritjen e kosto-efektivitetit të Agjencisë, forcimin e menaxhimit të cilësisë dhe forcimin e marrëdhënieve me përdoruesit e të dhënave. ASK-ja duhet gjithashtu të plotësojë pozitat e zbrazëta. Efikasiteti i sistemeve të brendshme, proceseve dhe menaxhimit të deleguar mbetet sfidë. Transmetimi i të dhënave në Eurostat vazhdon të përmirësohet. Pavarësisht përmirësimeve në shpërndarjen e statistikave të saj të bazuara në rrjet, Agjencia duhet të forcojë marrëdhëniet e saj aktive me përdoruesit e të dhënave dhe akademinë. Kosova vazhdon të përdorë klasifikimin evropian të aktiviteteve ekonomike

(NACE Rev.2). Regjistrat ekzistues (bujqësi, biznesi dhe ekonomitë familjare) përditësohen rregullisht, por regjistri i popullsisë duhet të përmirësohet. ASK-ja ka përmirësuar qasjen e publikut në disa të dhëna ekzistuese administrative, siç janë të dhënat nga Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë. Në mars të vitit 2023, Agjencia nënshkroi një memorandum të mirëkuptimit me Zyrën e Statistikave Çeke duke vendosur një kornizë për bashkëpunim dhe procedura për shkëmbimin e informacionit dhe ekspertizës në fushën e statistikave zyrtare. Agjencia nuk përpilon sistematikisht të dhëna të ndara sipas gjinisë. Kosova ende nuk ka Indeks të Barazisë Gjinore.

Lidhur me **statistikat makroekonomike**, Kosova ka bërë disa përmirësime të lehta dhe përafrimi i mëtejme me Sistemin Evropian të Llogarive (ESA) 2010 është në proces. Edhe pse Agjencia përpilon llogaritë kombëtare vjetore dhe tremujore, mospërputhjet metodologjike në këto llogari duhet të adresohen. Periudha raportuese ka pasur disa përmirësime: (i) përpilimi eksperimental i BPV-së sipas qasjes së të ardhurave (për 2011-2019); (ii) përpilimi i Llogarive të Sektorit Jo-Financiar (2015-2021) që do t+i transmetohet Eurostatit në shtator 2023; dhe (iii) Tabelat e Furnizimit dhe Përdorimit (2013-2016) që pritet të dërgohen në Eurostat në tetor 2023.

Llogaritë tremujore sektoriale dhe llogaritë rajonale nuk përpilohen rregullisht. Numri i tabelave të transmetimit të ESA 2010 të dërguara në Eurostat është rritur dhe përmirësuar. Sa i përket statistikave të financave të qeverisë (SFG) dhe procedurës së deficitit të tepërt (PDT), puna e mëtejshme metodologjike pritet të zhvillohet në përputhje të plotë me ESA 2010. Kosova duhet të vazhdojë përpjekjet për të përmirësuar mbulimin dhe afatin kohor të tabelave të PDT-së si dhe të fillojë plotësimin e pyetësorit në lidhje me tabelat e PDT-së. Pasi tabelat për llogarinë financiare tremujore për qeverinë e përgjithshme dhe borxhin tremujor për qeverinë e përgjithshme iu transmetuan Eurostatit për herë të parë në vitin 2023, Kosova tani ofron grupin e plotë të tabelave të kërkuara SFG-së. Megjithatë, nevojiten ende përpjekje për të përmirësuar aspekte të ndryshme cilësore të tabelave.

Statistikat mujore për tregtinë ndërkombëtare të mallrave dorëzohen në Eurostat. Të dhënat e bilancit të pagesave përpilohen nga Banka Qendrore dhe janë përgjithësisht në përputhje me *acquis* të BE-së; të dhënat vjetore dhe tremujore për bilancin e pagesave dorëzohen në Eurostat. ASK-ja publikon statistikat tremujore të financave të qeverisë. Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit publikohet rregullisht në faqen e internetit të ASK-së dhe i transmetohet Eurostat-it. Nuk është arritur progres në zgjerimin e punës duke shtuar të dhëna për Paritetet e Fuqisë Blerëse (PFB).

**Statistikat** strukturore për **bizneset** dhe disa statistika afatshkurtra janë pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Megjithatë, disponueshmëria e të dyja këtyre llojeve të statistikave është e kufizuar dhe atyre u mungon dallimi ndërmjet investimeve publike dhe private ose sipas sektorëve. Vetëm një grup statistikash afatshkurtra (për lejet ndërtimore) i është dërguar Eurostatit. Statistikat e industrisë nxjerrën gjerësisht në përputhje me rregulloren përkatëse të BE-së. Statistikat afatshkurtra të sektorit të shërbimeve nxjerrën çdo tremujor. Statistikat e sektorit të ndërtimit nuk janë kryesisht të disponueshme; vetëm indeksi i kostos së ndërtimit nxjerrët çdo tremujor. Statistikat e industrisë për mallrat e prodhuara (anketimi PRODCOM) për vitin 2021 u publikuan në dhjetor të vitit 2022. Statistikat e filialeve të huaja nuk janë në dispozicion. Statistikat e turizmit dhe statistikat e transportit ende nuk janë në përputhje me *acquis* të BE-së, ndërkohë që statistikat për zhvillim dhe inovacion nuk nxjerrën në baza të rregullta. Statistikat për teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK) për ekonomitë familjare kanë filluar në vitin 2018 dhe tani publikohen rregullisht (rezultatet për vitin 2022 janë publikuar në tetor të vitit 2022). Statistikat e TIK-ut për vitin 2021 për ndërmarrjet u publikuan në nëntor të vitit 2022.

Në fushën e **statistikave sociale**, vetëm statistikat demografike janë kryesisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Përgatitjet për regjistrimin e ardhshëm të popullsisë janë duke vazhduar: në korrik të vitit 2022, Kuvendi miratoi Ligjin për regjistrimin e popullsisë dhe banesave. Në gusht 2023, qeveria vendosi që regjistrimi të bëhet nga 1 nëntori deri më 31 dhjetor 2023 dhe ndau 10 milionë euro për këtë. Statistikat për të ardhurat dhe kushtet e jetesës (anketimi i rregullt EU-SILC) nxjerrën çdo vit. Grupi i fundit i statistikave për SILC për Kosovën ishte për vitin 2020 dhe u publikua në dhjetor të vitit 2022. Statistikat për mbrojtjen sociale dhe tregun e punës nxjerrën vetëm pjesërisht. Kosova kryen anketën vjetore dhe tremujore të fuqisë punëtore dhe afati kohor i publikimit të rezultateve të kësaj ankete është përmirësuar. Kosova ende nuk ka nxjerrë statistika për indeksin e kostos së punës, strukturën e të dhënave të të ardhurave dhe vendet e lira të punës. Statistikat e arsimit për periudhën 2022/2023 janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të klasifikimit të arsimit (ISCED 2011). Statistikat e shëndetit publik dhe krimin nuk janë ende në përputhje me standardet e BE-së.

Për **statistikat bujqësore**, ASK-j ka publikuar të dhëna për kulturat vjetore bujqësore, prodhimtarinë blegtorale dhe statistikat e pemëtarisë. Anketa e ekonomive bujqësore zhvillohet rregullisht dhe përputhet me standardet e *acquis*. Anketa e ardhshme e strukturës së fermave nuk është planifikuar deri në vitin 2025. Indekset e çmimeve bujqësore dhe llogaritë ekonomike për bujqësinë nxjerrën në baza të rregullta. Bilanci i ofertës dhe indeksi i punës në bujqësi ende nuk nxjerrën në baza të rregullta. Statistikat e bujqësisë dërgohen në Eurostat përmes sistemit të TI-së të BE-së për statistika, Sistemimit Informativ Elektronik për Administrimin dhe Menaxhimin e Skedarëve të të Dhënave (EDAMIS).

**Statistikat e energjisë dhe mjedisit** janë pjesërisht në përputhje me *acquis*. Gjatë periudhës raportuese, ASK-ja ka zvogëluar kornizën kohore për publikimin e rezultateve të bilancit të energjisë (duke publikuar të dhënat çdo muaj e jo çdo tre muaj që nga mesi i vitit 2022). Në këtë mënyrë, agjencia ka rritur numrin e produkteve statistikore të dërguara në Eurostat. Në prill 2023, pjesëmarrja e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në konsumin e përgjithshëm të energjisë elektrike ishte 17,32%. Statistikat e konsumit të energjisë janë mbledhur për sektorët e banimit, shërbimeve dhe transportit por rezultatet nuk publikohen rregullisht. Mungesa e treguesve të eficiencës së energjisë është pengesë për raportimin e kursimeve të energjisë. Statistikat për mbeturinat dhe ujin nxjerrën rregullisht. Statistikat për emetimet e gazrave serrë nuk publikohen rregullisht. Statistikat e tjera mjedisore, siç janë llogaritë e emetimeve në ajër, taksat mjedisore, shpenzimet për mbrojtjen e mjedisit dhe bilancet e rrjedhës materiale nuk janë nxjerrë ende.

## **Kapitulli 32: Kontrolli financiar**

*BE promovon reformën e sistemeve të qeverisjes kombëtare për të përmirësuar llogaridhënien menaxheriale, menaxhimin e shëndoshë financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe auditimin e jashtëm të fondeve publike. Rregullat e kontrollit financiar mbrojnë më tej interesat financiare të BE-së kundër mashtrimit në menaxhimin e fondeve të BE-së dhe mbrojnë euron nga falsifikimi.*

Ekziston **njëfarë niveli të përgatitjes** në këtë fushë. Kosova ka arritur **progres të kufizuar** gjatë periudhës raportuese duke miratuar strategjinë e re të MFP 2022-2026 dhe planin e saj të veprimt. Zbatimi i të dyjave duhet të përshpejtohet. Kosova duhet të harmonizojë më tej legjislacionin e saj të kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP) me praktikat më të mira të BE-së. Përveç kësaj, zbatimi i llogaridhënies menaxheriale, duke përfshirë (i) delegimin e përgjegjësive vendimmarrëse; (ii) adresimin e masave efektive të kontrollit të brendshëm; dhe (iii) përcjelljen sistematike të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm mbeten prioritetet kryesore. Mbikëqyrja parlamentare e menaxhimit të fondeve publike nuk është



efikase. Për shkak se rekomandimet e vitit paraprak nuk ishin zbatuar plotësisht, Kosova në vitin e ardhshëm duhet:

- të zbatojë me efikasitet strategjinë e re të MFP-së 2022-2026, dhe veprimet e saj në lidhje me KBFP-në dhe auditimin e jashtëm;
- të hartojë dhe miratojë Ligjin e ri për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit bazuar në praktikatat më të mira të BE-së dhe të harmonizojë këtë ligj të ri me Ligjin për KBFP;
- të përmirësojë përgjegjësitë menaxheriale të përdoruesve buxhetorë si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal;
- të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës (ZKAK) dhe Kuvendit duke: (i) përmirësuar kontrollin parlamentar të zbatimit të buxhetit; dhe (ii) zbatuar dhe përcjellë në mënyrë të vazhdueshme dhe efikase rekomandimet të auditimit të ZKAK-së.

### Kontrolli i brendshëm financiar publik

Kosova ka arritur njëfarë progresin në përmirësimin e **kornizës strategjike për KBFP**, pasi ka miratuar strategjinë e re të MFP 2022-2026 dhe planin e saj të veprimit. Kosova duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të siguruar koordinimin ndërinstitucional dhe për të përmirësuar kornizën e saj për monitorim dhe raportim. Bërja e përmirësimeve në këtë kornizë do të çojë në një qasje më të qëndrueshme dhe koherente në zbatimin e standardeve të kontrollit të brendshëm. Ka filluar puna për hartimin e ligjit të ri për MFP dhe përgjegjësitë. Ky ligj i ri duhet të harmonizohet me legjislacionin e KBFP-së.

Zbatimi efikas i **përgjegjësisë menaxheriale** mbetet sfidë për përdoruesit buxhetorë si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Kosova ka nevojë të sigurojë zbatimin e qëndrueshëm të standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe t'ua delegojë më mirë kompetencat menaxhuese subjekteve publike. Procesi për racionalizimin e agjencive qeveritare po zhvillohet ngadalë dhe nuk është i mjaftueshëm për të sjellë ndonjë përmirësim. Zbatimi i Rregullores për menaxhimin financiar dhe kontrollin mbetet joefikas, dhe linjat e delegimit dhe përgjegjësisë nuk janë ende të integruara në kulturën administrative të përdoruesve të buxhetit. Ligji për organizimin dhe funksionimin e administratës dhe agjencive të pavarura, i cili përcakton linjat e përgjegjësisë ndërmjet njësive shpenzuese të nivelit të parë dhe organeve vartëse, nuk zbatohet në mënyrë konsistente. (*Shih seksionin për RAP-in*).

Korniza ligjore lidhur me **kontrollin e brendshëm** në masë të madhe është e harmonizuar me standardet ndërkombëtare, por nuk po zbatohet mjaftueshëm. Menaxhimi dhe kontrolli financiar si dhe mbikëqyrja e buxhetit duhet të përmirësohen, duke ndjekur praktikatat më të mira të BE-së. Në vitin 2022, ka vazhduar procesi i zhvillimit dhe miratimit të regjistrave të menaxhimit të rrezikut në nivel qendror dhe lokal. Megjithatë, inkorporimi i këtyre masave në proceset e kontrollit financiar dhe menaxhimit mbetet i pamjaftueshëm.

Lidhur me **praktikat e auditimit të brendshëm**, nevojiten përpjekje të mëtejshme për zbatimin efikas të standardeve të auditimit të brendshëm në sektorin publik. Shumica e njësive të auditimit të brendshëm kanë mungesë të stafit me përvojë dhe të kualifikuar. Komitetet e auditimit të brendshëm nuk janë efikas dhe nuk funksionojnë siç duhet dhe rekomandohet që të rishqyrtohet roli dhe baza ligjore e tyre. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për ngritjen e aftësive të përdoruesve të buxhetit, në mënyrë që të mund të përdorin mjetet metodologjike të auditimit të brendshëm në mënyrë të qëndrueshme dhe koherente. Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm është i kufizuar në praktikë. Metodologjia e sigurimit të cilësisë ende

nuk është zbatuar sistematikisht. Udhëzimi Administrativ për programin e trajnimit dhe certifikimit të auditorëve të brendshëm në sektorin publik është përditësuar, por nuk është miratuar ende. Prandaj, ka vonesa në fillimin e programit kombëtar për certifikimin e auditorëve të brendshëm në sektorin publik. Nevojiten përpjekje të mëtijshme për të ofruar trajnime të vazhdueshme për auditorët e brendshëm, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal.

**Njësia Qendrore e Harmonizimit** ofron udhëzime metodologjike dhe koordinon zhvillimin në sektorin publik të auditimit të brendshëm dhe menaxhimit dhe kontrollit financiar. Megjithatë, kapacitetet e saj mbeten të pamjaftueshme, veçanërisht në monitorimin dhe raportimin e funksionimit të sistemit të përgjithshëm të kontrollit të brendshëm. Qeveria ka miratuar raportin vjetor të KBFP-së 2022, por struktura dhe fushëveprimi i tij mund të përmirësohen më tej dhe rekomandimet e tij mund të zbatohen në mënyrë më sistematike.

Nuk ka asnjë bazë ligjore në ligjin për KBFP në lidhje me luftimin e korrupsionit dhe nuk ka asnjë mekanizëm për të monitoruar numrin e rasteve të hetuara, të ndjekura penalisht dhe që i nënshtrohen vendimeve gjyqësore si rezultat i auditimeve ose inspektimeve të brendshme.

#### Auditimi i jashtëm

Ligji për Auditorin e Përgjithshëm dhe **Zyra Kombëtare e Auditimit** e Kosovës (ZKAK) janë në masë të madhe të harmonizuar me standardet e përcaktuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit. Megjithatë, rishikimi i mëtijshëm i kornizës ligjor nevojitet për të përmirësuar funksionin e auditimit të jashtëm në sektorin publik, për shembull për të rritur pavarësinë financiare dhe operacionale të ZKAK-së dhe për të hequr detyrimin e saj për të kryer auditime financiare vjetore të të gjitha organizatave që marrin buxhet nga shteti. Këto ndryshime ligjore janë të një rëndësie vendimtare për përmirësimin e kapaciteteve dhe cilësisë dhe ndikimit të punës së auditimit të ZKAK-së. ZKAK ka **kapacitetet institucionale** për të kryer detyrat e saj, me 164 punonjës nga të cilët 82% janë staf auditimi, dhe 18% janë punonjës që ofrojnë shërbime të tjera mbështetëse profesionale. Kosova ka vazhduar të zbatojë planin zhvillimor strategjik 2022-2025.

Në vitin 2022, u vu re njëfarë progresi pasi plani vjetor i auditimit ishte përmbushur plotësisht, me 133 auditime të kryera, duke përfshirë 3 auditime të përputhshmërisë dhe 15 auditime të performancës. Sa i përket **ndikimit të punës së auditimit**, subjektet e audituara nuk zbatojnë në mënyrë efektive rekomandimet e ZKAK-së. Nga 606 rekomandimet e auditimit të dhëna nga ZKAK në vitin 2020, 50% janë zbatuar plotësisht, 5% janë zbatuar pjesërisht dhe 45% nuk janë zbatuar. Edhe pse bashkëpunimi ndërmjet ZKAK-së dhe Kuvendit është përmirësuar, kontrolli parlamentar i përgatitjes dhe zbatimit të përgatitjes së buxhetit duhet të përmirësohet. Në vitin 2022, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar 23 raporte, dy më pak se në periudhën e mëparshme raportuese. Transparenca dhe llogaridhënia e menaxhimit të fondeve publike duhet të sigurohet përmes mekanizmave monitorues efikas nga ekzekutivi dhe Kuvendi, duke përfshirë shqyrtimin e rekomandimeve të auditimit të ZKAK-së.

#### Mbrojtja e interesave financiare të BE-së

Sa i përket **përafrimit me *acquis***, legjislacioni kombëtar nuk është ende i harmonizuar me Konventën për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe ky harmonizim do të kërkojë ndryshime në ligjin penal. Kosova gjithashtu nuk e ka krijuar ende shërbimin e **koordinimit kundër mashtrimit** (AFCOS) dhe strategjia kundër mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së nuk është hartuar ende. Pasi që autoritetet e Kosovës nuk menaxhojnë drejtpërdrejt fondet e BE-së, parregullsitë nuk i raportohen Komisionit përmes Sistemit të Menaxhimit të Parregullsive. Përderisa nuk ka ende një historik solid për bashkëpunimin me Komisionin gjatë hetimeve, Policia e Kosovës siguron bashkëpunim në baza ad-hoc.

### Mbrojtja e euros nga falsifikimi

Sa i përket **përafrimit me *acquis***, ka një harmonizim deri në një masë të caktuar me rregulloret e BE-së për sistemin e luftës kundër falsifikimit të euros. Kodi Penal e konsideron vepër penale falsifikimin e valutës dhe Ligji për Bankën Qendrore rregullon luftën kundër falsifikimit. Kosova ka një Rregullore për operacionet me parave të gatshme që i detyron institucionet financiare të trajtojnë dhe të tërheqin nga qarkullimi të gjitha kartëmonedhat dhe monedhat euro të dyshuara si të falsifikuara dhe t'i dorëzojnë ato në polici. Agjencia për Forenzikë është përgjegjëse për analizën teknike të kartëmonedhave dhe monedhave të dyshuara si të falsifikuara. Ajo ka lidhur një marrëveshje me Komisionin Evropian për monedhat, por jo edhe për kartëmonedhat me Bankën Qendrore Evropiane. Në vitin 2022, nga 2 162 kartëmonedha të dyshuara të vlerësuara nga agjencia, 718 u konfirmuan si të falsifikuara, dhe nga 12 028 monedha, 10 979 u konfirmuan si të falsifikuara. Nuk ekziston një sistem elektronik i përbashkët për shkëmbimin, procesimin, analizën dhe raportimin e rasteve me Bankën Qendrore dhe Agjencinë. Kosova duhet të ndërtojë kapacitetet e institucioneve kyçe për të përdorur mjete metodologjike dhe për të shkëmbyer të dhëna me autoritetet kombëtare dhe ndërkombëtare. Të gjitha institucionet përkatëse për luftimin e valutës së falsifikuar marrin pjesë në programin Pericles IV të BE-së.

### **3. MARRËDHËNIET E FQINJËSISË SË MIRË DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL**

Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimi rajonal përbëjnë një pjesë thelbësore të procesit të integrimit evropian të Kosovës. Ato kontribuojnë në stabilitetin, pajtimin dhe një klimë të favorshme për adresimin e çështjeve të hapura dypalëshe dhe trashëgimisë të së kaluarës.

Kosova ka vazhduar me angazhimin e saj në një sërë nismash të bashkëpunimit rajonal, siç janë Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), Komuniteti i Kapaciteti i Energjisë, Komuniteti i Transportit, Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP) dhe Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC)<sup>16</sup>

**Samiti BE-Ballkani Perëndimor** u zhvillua për herë të parë në dhjetor të vitit 2022 në rajon, në Tiranë. Samiti u fokusua në mbështetjen për rajonin në fushat e energjisë dhe migracionit, si dhe në bashkëpunimin për të rinjtë, roaming, korsitë e gjelbra dhe progresin e përgjithshëm në zbatimin e Planit Ekonomik dhe të Investimeve..

Sa i përket **Tregut të Përbashkët Rajonal**, u arrit një përparim politik në Samitin e Procesit të Berlinit në Berlin në nëntor të vitit 2022, ku liderët miratuan tri marrëveshje për mobilitet në lidhje me kualifikimet në arsimin e lartë, kualifikimet profesionale dhe lëvizjen e lirë me letërnjoftime. Kosova ka ratifikuar të tri marrëveshjet e mobilitetit dhe ka depozituar instrumentet përkatëse të njoftimit. Një numër vendimesh të rëndësishme të miratuara në nivel teknik brenda CEFTA-s mbeten të bllokuara.

Kosova në përgjithësi mban marrëdhënie të mira bilaterale me vendet e tjera në zgjerim dhe shtetet fqinje anëtare të BE-së.

Marrëdhëniet dypalëshe të Kosovës me **Shqipërinë** mbeten të mira në përgjithësi. Në korrik të vitit 2022, Presidenti Meta zgjodhi Kosovën si destinacion të vizitës së tij të fundit zyrtare para se të përfundonte mandatin e tij si president. Në gusht të vitit 2022, Presidenti Begaj bëri vizitën e tij të parë zyrtare në Kosovë dhe Presidentja e Kosovës Osmani priti përsëri Presidentin Begaj

---

<sup>16</sup> Kosova është anëtare e CEFTA-s. Kosova ka marrëveshje të tregtisë së lirë (MTL) me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Kroacinë, Bosnje dhe Hercegovinën dhe Turqinë. Kosova ka disa Programe të Sistemit të Përgjithësuar të Preferencave (GSP) me SHBA-në, Japoninë dhe Norvegjinë.

në Prishtinë në shkurt 2023. Kuvendet e Shqipërisë dhe Kosovës mbajtën mbledhjen e parë të përbashkët në nëntor të vitit 2022.

Nuk ka pasur asnjë ndryshim në marrëdhëniet zyrtare të Kosovës me **Bosnjën dhe Hercegovinën**, e cila nuk e njeh pavarësinë e Kosovës. Të dy palët mbajnë një regjim të rreptë vizash. Takime dypalëshe u zhvilluan herë pas here në margjinat e samiteve rajonale dhe shumëpalëshe. Iniciativa për thjeshtimin e procedurës së vizave për të gjithë qytetarët e Kosovës është ende në pritje.

Kosova ka mbajtur marrëdhënie të ngushta me **Malin e Zi**. Gjatë gjithë periudhës raportuese, u zhvilluan disa takime në nivel të kryeministrave dhe ministrave të jashtëm në margjinat e ngjarjeve ndërkombëtare dhe rajonale. Marrëdhëniet dypalëshe u përmirësuan me vizitën zyrtare të Presidentes së Kosovës në Mal të Zi në shkurt të vitit 2023 dhe vizitën e Kryeministrit të Malit të Zi në Kosovë në prill të vitit 2023.

Kosova ka vazhduar të ketë marrëdhënie të mira në përgjithësi me **Maqedonia e Veriut**, dhe Presidentja e Kosovës Osmani zhvilloi një vizitë zyrtare në prill të vitit 2023. Kontakte të tjera ndërmjet liderëve politikë u zhvilluan në margjinat e ngjarjeve ndërkombëtare dhe rajonale.

Kosova ka vazhduar të mbajë marrëdhënie të mira me **Turqinë**, duke përfshirë sektorët politikë, ekonomikë dhe kulturorë. Kryeministri i Kosovës Kurti vizitoi Turqinë në shkurt të vitit 2023. Kosova ofroi 36 trupa të Forcës së Sigurisë së Kosovës për një operacion ndërkombëtar humanitar në përgjigje të tërmetit shkatërrues të 6 shkurtit 2023.

**Gjeorgjia, Republika e Moldavisë dhe Ukraina** nuk kanë marrëdhënie zyrtare me Kosovën, pasi që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Parlamenti i Moldavisë, megjithatë, para Samitit të Komunitetit Politik Evropian më 1 qershor 2023, ndryshoi ligjin për vizitorët nga vendet e treta duke i lejuar përfaqësuesit e Kosovës të marrin viza për pjesëmarrje në takimet ndërkombëtare të mbajtura në Moldavi.

#### 4. NORMALIZIMI I MARRËDHËNIEVE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

Dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka vazhduar gjatë periudhës raportuese me takime të rregullta në nivel liderësh dhe kryenegociatorësh. Pas muajsh negociatash intensive dhe me mbështetjen e partnerëve kryesorë, palët arritën një Marrëveshje për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënieve në Bruksel më 27 shkurt 2023 dhe ranë dakord për Aneksin e Zbatimit të saj në Ohër, Maqedoni të Veriut, më 18 mars 2023. Si pjesë e Marrëveshjes, palët potencuan se Marrëveshja dhe Aneksi i Zbatimit do të bëhen pjesë integrale e proceseve përkatëse të anëtarësimit në BE të Kosovës dhe Serbisë.<sup>17</sup>

<sup>17</sup> Aneksi i Zbatimit të Marrëveshjes për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë: Ky Aneks përbën një pjesë integrale të Marrëveshjes. Kosova dhe Serbia angazhohen plotësisht të respektojnë të gjitha nenet e Marrëveshjes dhe këtë Aneks, dhe të zbatojnë të gjitha detyrimet e tyre përkatëse që rrjedhin nga Marrëveshja dhe ky Aneks në mënyrë të përshtatshme dhe në mirëbesim.

Palët kanë parasysh se Marrëveshja dhe Aneksi i Zbatimit do të bëhen pjesë integrale e proceseve përkatëse të anëtarësimit të Kosovës dhe Serbisë në BE. Palët vënë në dukje se menjëherë pas miratimit të Marrëveshjes dhe këtij Aneksi, ndërmjetësuesi i BE-së do të fillojë procesin për të ndryshuar standardet e Kapitullit 35 për Serbinë për të pasqyruar detyrimet e reja të Serbisë që rrjedhin nga Marrëveshja dhe ky Aneks. Agjenda e Grupit Special të Kosovës për Normalizim do të pasqyrojë në mënyrë të barabartë obligimet e reja të Kosovës që rrjedhin nga Marrëveshja dhe ky Aneks.

Palët bien dakord të miratojnë Deklaratën për Personat e Pagjetur, siç është negociuar në kuadër të Dialogut të lehtësuar nga BE-ja, si çështje urgjente.

Për të zbatuar nenin 7, Kosova fillon menjëherë negociatat në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja për vendosjen e aranzhimeve dhe garancive specifike për të siguruar një nivel të duhur të vetë-menaxhimit për komunitetin serb në Kosovë, në përputhje me marrëveshjet e mëparshme përkatëse të dialogut të përcaktuara nga ndërmjetësuesi i BE-së.

Palët bien dakord të krijojnë një Komitet të Përbashkët Monitorues, të kryesuar nga BE, brenda 30 ditëve. Zbatimi i të gjitha dispozitave do të sigurohet dhe mbikëqyret nga Komiteti i Përbashkët i Monitorimit.

Për të zbatuar nenin 9, BE-ja do të organizojë një konferencë të donatorëve brenda 150 ditëve për të krijuar një paketë investimi dhe ndihme financiare për Kosovën dhe Serbinë. Asnjë disbursim nuk do të ndodhë para se BE-ja të përcaktojë se të gjitha dispozitat e Marrëveshjes janë zbatuar plotësisht.

Kosova dhe Serbia pajtohen që të gjitha nenet do të zbatohen në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.

Rendi i paragrafëve të këtij Aneksi nuk cenon rendin e zbatimit të tyre.

Kosova dhe Serbia pajtohen të mos bllokojnë zbatimin e asnjë prej neneve.

Të gjitha diskutimet në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes do të zhvillohen në kuadër të Dialogut të ndërmjetësuar nga BE.

Kosova dhe Serbia pranojnë se çdo mosrespektim i detyrimeve të tyre nga Marrëveshja, ky Aneks ose Marrëveshjet e Dialogut të kaluar mund të ketë pasojë të drejtpërdrejta negative për proceset e tyre përkatëse të anëtarësimit në BE dhe ndihmën financiare që marrin nga BE-ja.

Si Kosova ashtu edhe Serbia nuk kanë filluar ende zbatimin e detyrimeve të tyre përkatëse që rrjedhin nga Marrëveshja, të cilat janë të detyrueshme për palët dhe janë pjesë e rrugëve të tyre evropiane. Palëve u kërkohet të fillojnë të angazhohen në mënyrë më konstruktive dhe të fillojnë zbatimin pa vonesa mëtejshme ose parakushte. Kjo përfshin themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe (A/BKS). Kosova pritet të fillojë procesin që çon në themelimin e A/BKS bazuar në propozimin evropian që u është paraqitur palëve më 21 tetor 2023 dhe Serbia pritet të mbështesë këtë proces dhe të fillojë paralelisht me përmbushjen e obligimeve të tyre kryesore nga Marrëveshja. Formalitetet, duke përfshirë edhe miratimin, nuk duhet të pengojnë progresin në zbatim. Palët gjithashtu kanë për detyrë të zbatojnë plotësisht të gjitha Marrëveshjet e Dialogut të kaluar. Konstruktiviteti i palëve do të vlerësohet bazuar në performancën e tyre të zbatimit. Më 26 tetor 2023, Këshilli Evropian shprehu keqardhje për mungesën e zbatimit nga të dyja palët të Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit dhe aneksit të zbatimit të saj, si dhe marrëveshjeve të tjera të arritura në dialogun e ndërmjetësuar nga BE, të udhëhequr nga Përfaqësuesi i Lartë dhe i mbështetur nga Përfaqësues Special i BE-së. Normalizimi i marrëdhënieve është kusht thelbësor në rrugën evropiane të të dyja palëve dhe të dyja rrezikojnë të humbasin mundësi të rëndësishme në mungesë të progresit.<sup>18</sup>

Përkundër lidhjes së Marrëveshjes për Rrugën drejt Normalizimit, Dialogu është penguar gjatë gjithë periudhës raportuese nga një sërë zhvillimesh dhe krizash negative në veri të Kosovës të shkaktuara nga veprimet e njëjës ose të të dyja palëve. Kosova ka kryer një sërë veprimesh të tilla në veri të Kosovës, duke përfshirë praninë e shtuar të policisë speciale të Kosovës dhe shpronësimin e tokës, të cilat kanë krijuar pakënaqësi të gjerë në mesin e popullatës lokale serbe të Kosovës dhe kanë ndikuar negativisht në Dialog. Dorëheqja masive e serbëve të Kosovës nga institucionet e Kosovës – policia, gjyqësori dhe administrata – në nëntor të vitit 2022, bllokimet e rrugëve në veri të Kosovës si reagim ndaj arrestimeve të serbëve të Kosovës në dhjetor të vitit 2022, si dhe bojkoti i zgjedhjeve të parakohshme lokale në prill të vitit 2023 nga serbët e Kosovës, e dëmtoi edhe më shumë Dialogun dhe e përkeqësoi atmosferën negative lidhur më të. Si rezultat i largimit të serbëve të Kosovës nga të gjitha institucionet e Kosovës në nëntor të vitit 2022, zgjedhjet e pjesshme u mbajtën në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës më 23 prill 2023. Ndërsa zgjedhjet u mbajtën në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës, jo të gjitha partitë dhe komunitetet e shfrytëzuan të drejtën e tyre demokratike për të marrë pjesë dhe për të votuar në zgjedhje, duke rezultuar në një pjesëmarrje rekord të ulët, e cila nuk ofron zgjidhje politike afatgjatë për këto komuna.

Ndonëse nuk kishte pasur progres në zbatimin e Udhërrëfyesit për Energjinë të miratuar në qershor të vitit 2022, marrëveshja tentative në gusht 2023 ndërmjet kompanive komerciale KEDS dhe Elektroserver për fushëveprimin e funksioneve shënon potencialisht një hap të rëndësishëm përpara në zbatimin e Udhërrëfyesit. Partitë pritet tani të mundësojnë në mënyrë të shpejtë nënshkrimin e marrëveshjeve komerciale dhe teknike të mbetura mes dy kompanive, për të siguruar që banorët që jetojnë në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës të fillojnë të paguajnë për energjinë elektrike që konsumojnë.

Gjatë periudhës raportues, palët ranë dakord dhe miratuan deklaratën politike për Personat e Pagjetur në maj 2023. Palët inkurajohen të fillojnë menjëherë me zbatimin e deklaratës dhe, si hap i parë, të bien dakord për Termat e Referencës për Komisionin e Përbashkët që do të krijohet sipas deklaratës.

Sa i përket gjendjes aktuale të zbatimit të marrëveshjeve të kaluara të dialogut:

---

<sup>18</sup> <https://www.consilium.europa.eu/media/67627/20241027-european-council-conclusions.pdf>

- Tërheqja e serbëve të Kosovës nga institucionet e Kosovës në nëntor të vitit 2022 dhe bojkotimi i zgjedhjeve lokale në veri të Kosovës në prill të vitit 2023, shkelin detyrimet e Serbisë për dialogun dhe paraqesin një kthim prapa serioz nga Serbia për të vepruar në përputhje me “Marrëveshjen e parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve” të prillit të vitit 2013 dhe shkelje direkte të Marrëveshjes për Drejtësinë të vitit 2015. Serbisë i kërkohet të inkurajojë serbët e Kosovës që të kthehen menjëherë në institucione dhe Kosovës i kërkohet të mundësojë që ky kthim të ndodhë. Që nga nëntori i vitit 2022, asnjëra palë nuk ka ndërmarrë asnjë hap në këtë drejtim. Rekrutimi i kadetëve të rinj të policisë serbe të Kosovës, i ndërmarrë nga Policia e Kosovës, megjithëse i mirëpritur, nuk ka ndjekur procedurat në përputhje me marrëveshjet e Dialogut.
- Ende nuk është bërë progres i mëtijshëm në zbatimin e Marrëveshjes së gushtit të vitit 2015. Ndonëse BE-ja mirëpret prezantimin e projekt statutit të parë të A/BKS-së në Dialogun e Nivelit të Lartë në maj të vitit 2023, drafti i paraqitur nuk është në përputhje me Marrëveshjet përkatëse të Dialogut. Propozimi evropian për themelimin e A/BKS-së në Kosovë iu paraqit palëve më 21 tetor 2023. Formalitetet, duke përfshirë edhe miratimin, nuk duhet të pengojnë progresin në zbatim. Kosovës dhe Serbisë tani i kërkohet që të angazhohen në mënyrë konstruktive në krijimin e A/BKS-së pa vonesa, parakushte apo pengesa të mëtijshme. Ky detyrim është pjesë e zbatimit të Marrëveshjes për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënieve, të cilën palët pritet ta avancojnë, pa vonesë ose parakushte, siç u bë thirrje nga Këshilli Evropian në tetor 2023. Çështja e strukturave të drejtuara nga Serbia duhet të trajtohet në të njëjtin kontekst.
- Punimet në urën e Mitrovicës kanë përfunduar prej kohësh dhe Serbia pritet të angazhohet në mënyrë konstruktive për të lejuar që ura të hapet pa pengesa për qarkullimin e automjeteve; Çdo vendim për hapjen e urës duhet të miratohet dhe të koordinohet në Dialog.
- Sa i përket marrëveshjeve të dialogut teknik (2011-2012), disa nga to nuk janë ose janë vetëm pjesërisht duke u zbatuar. Deri në gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme, të dyja palët duhet të mbeten të përkushtuara për zbatimin e vazhdueshëm të marrëveshjes për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e Kosovës në forumet rajonale dhe të mos bllokojnë punën e forumeve rajonale për mosmarrëveshjet bilaterale. Zbatimi i marrëveshjeve për kadastrin dhe pranimit të diplomave universitare është ende në pritje për shkak të moszbatimit nga Serbia. Serbia po ashtu ende nuk e ka trajtuar çështjen e zhvendosjes së strukturave doganore administrative serbe me emërtim të Kosovës që operojnë brenda Serbisë, nuk ka ndërprerë lëshimin e dokumentacionit ose vendosjen e vulave me emërtim që bie ndesh me marrëveshjen përkatëse;
- Lidhur me MIK-un, Pikat e Përbashkëta të të Përkohshme të Kalimit Kufitar (PPK) ndërmjet Kosovës dhe Serbisë vazhdojnë të jenë funksionale. Vetëm dy nga gjashtë PPK-të e përhershme janë themeluar (Merdare dhe Mutivodë). Serbia ende nuk ka krijuar PPK të përhershme për pritje në anën e saj (Jarinje/Rudnicë, Konçul-Dheu i Bardhë dhe Depçe/Muçibabë), gjë që çoi në pezullimin e fondeve të BE-së për këtë projekt në korrik të vitit 2018. Përveç kësaj, Serbia duhet të angazhohet në mënyrë konstruktive për të mundësuar ndërtimin e PPK-së së tretë të organizuar nga Kosova në veri të Kosovës në Tabaviqe/Bërnjak. Nga Serbia nevojiten përpjekje shtesë për mbylljen e rrugëve dhe rrugëve anësore ilegale për të siguruar përdorimin ekskluziv të pikave të kalimit zyrtar për mallrat dhe personat që hyjnë ose dalin nga Kosova. Serbia gjithashtu duhet të mundësojë rifillimin e takimeve të përbashkëta teknike të MIK-ut në të gjitha nivelet.

- Lidhur me lirinë e lëvizjes, pas muajve të tensioneve, Kosova dhe Serbia ranë dakord në nëntor të vitit 2022 që Serbia të ndalojë lëshimin e targave të reja me emërtimet e qyteteve të Kosovës, ndërsa Kosova do të pezullojë çdo veprim të mëtejshëm në lidhje me ri-regjistrimin e automjeteve. Zbatimi i plotë i marrëveshjeve për lirinë e lëvizjes është ende në pritje. Kjo kërkon gjithashtu që palët të gjejnë një zgjidhje të përhershme për çështjen e targave në përputhje me marrëveshjet përkatëse të Dialogut. Mungesa e një zgjidhjeje të tillë ka vazhduar të shkaktojë tensione në veri të Kosovës gjatë periudhës raportuese.
- Të dyja palët duhet të respektojnë plotësisht Marrëveshjen e Telekomit dhe të mos vënë në rrezik zbatimin e saj të suksesshëm deri me tani. Kosova duhet të sigurojë që MTS d.o.o të ketë licencë biznesi për funksionet që janë rënë dakord si pjesë e Marrëveshjes për t'i mundësuar kompanisë të vazhdojë ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile dhe fikse. MTS d.o.o duhet të angazhohet në mënyrë konstruktive dhe në përputhje me ligjin e Kosovës për të mundësuar që kjo të ndodhë.
- Procesimi i kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike është ndërprerë nga Serbia. Serbia duhet të rifillojë menjëherë përpunimin, në përputhje me Marrëveshjen përkatëse të Dialogut.
- Të dyja palët duhet të respektojnë në mënyrë më konsekuente Marrëveshjet për Vizitat Zyrtare. Kosova duhet të lejojë vizitat e kryenegociatorit serb dhe zyrtarëve të tjerë të qeverisë serbe kur ato lajmërohen dhe të zhvillohen në përputhje me Marrëveshjet, gjë që nuk ka qenë gjithmonë rasti gjatë periudhës raportuese.

Në përgjithësi, Kosova ka mbetur e angazhuar në Dialog, por duhet të demonstrojë përkushtim më serioz, të investojë më shumë përpjekje dhe të bëjë kompromise për të çuar përpara procesin e normalizimit. Kosova duhet të mbajë zotimet e saj të Dialogut dhe të angazhohet për zbatimin e plotë të të gjitha marrëveshjeve të dala nga Dialogu dhe Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënieve. Duke ecur përpara, Kosova gjithashtu duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme thelbësore për të shmangur veprimet që minojnë stabilitetin dhe retorikën që nuk është e favorshme për dialog. Kosova gjithashtu duhet të krijojë një mjedis të favorshëm për arritjen e Marrëveshjes së normalizimit ligjërish të detyrueshëm me Serbinë. Kosova pritet të angazhohen në mënyrë më konstruktive për të mundësuar që negociatat për Marrëveshjen gjithëpërfshirëse të normalizimit ligjërish të detyrueshme të fillojnë dhe të tregojnë fleksibilitet për të arritur progres të shpejtë dhe konkret. Arritja e një marrëveshjeje të tillë është urgjente dhe vendimtare për t'i mundësuar Kosovës dhe Serbisë të avancojnë në rrugët e tyre evropiane. Një kërkesë e rëndësishme për negociatat lidhur me Marrëveshjen gjithëpërfshirëse ligjërish të detyrueshme është që palët të zbatojnë Marrëveshjen për Rrugën drejt Normalizimit me shpejtësi dhe efikasitet dhe pa asnjë kusht apo pengesë.

Periudha raportuese u karakterizua me kriza të shumta dhe incidente të dhunshme në veri të Kosovës. Kriza më e rëndë gjatë periudhës raportuese ndodhi më 24 shtator 2023, kur Policia e Kosovës u sulmua nga persona të armatosur rëndë, të cilët u zunë në mes të një operacioni të madh të kontrabandës së armëve, duke lënë një polic të vdekur dhe tre të plagosur. Gjatë operacionit, sulmuesit kishin marrë peng disa pelegrinë teksa ishin barrikaduar në Manastirin Ortodoks Serb të Banjskës, të cilin e lanë pas duke ikur. Gjatë hetimeve që po zhvillohen për ngjarjet janë sekuestruar sasi të mëdha armësh të nivelit ushtarak. Në ditët në vijim, nënkryetari i Listës Serbe përmes avokatit të tij, njoftoi se ai e kishte përgatitur dhe koordinuar sulmin. Ai u mor në pyetje nga autoritetet serbe, u ndalua pak kohë dhe u lirua, por pasaporta e tij u konfiskua. Në ditët pas sulmit, Serbia rriti praninë e saj ushtarake në afërsi të Kosovës, e cila më pas u reduktua. Autorët e sulmit duhet të kapen dhe të sillen menjëherë para drejtësisë dhe pritet që Serbia të bashkëpunojë plotësisht dhe të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm në këtë drejtim. Sulmi nuk duhet të shërbejë si justifikim për asnjë palë për të larguar vëmendjen

nga dialogu i ndërmjetësuar nga BE. Kosova dhe Serbia duhet të vazhdojnë përpjekjet e qëndrueshme për depërshkallëzim, si dhe të sigurojnë mbajtjen e zgjedhjeve të reja në veri të Kosovës sa më shpejt të jetë e mundur, me pjesëmarrjen aktive të serbëve të Kosovës.

Para kësaj, një tjetër përshkallëzim serioz ndodhi në maj të vitit 2023 kur kryetarët e sapozgjedhur shqiptarë të Kosovës u vendosën në ndërtesat komunale në veri të Kosovës, kundër rekomandimit të qartë të bashkësisë ndërkombëtare, që shkaktoi protesta të serbëve të Kosovës. Disa u kthyen në dhunë dhe çuan në sulme të papranueshme dhe të paprovokuara kundër qytetarëve, ushtarëve të KFOR-it, forcave të rendit dhe përfaqësuesve të mediave, të cilat ende nuk janë dënuar dhe për të cilat ende nuk është vepruar nga Serbia. Disa arrestime të serbëve të Kosovës nga Policia e Kosovës në lidhje me përfshirjen e tyre të pretenduar në dhunën e 29 majit në Zveçan, të cilat nuk iu ishin përmbajtur në mënyrë sistematike dhe të plotë kërkesave ligjore, janë shqetësues.

Për të gjetur një rrugëdalje nga cikli i krizave, palët pritet të plotësojnë kërkesat e BE-së, sipas deklaratave të Përfaqësuesit të Lartë në emër të BE-së të 3 qershorit 2023.<sup>19</sup> dhe 19 shtatorit<sup>20</sup> lidhur me depërshkallëzim e situatës në terren, duke mundësuar zgjedhje të reja të parakohshme me pjesëmarrje të pakushtëzuar të serbëve të Kosovës dhe kthim në dialog dhe zbatim të të gjitha marrëveshjeve. Këshilli Evropian u shpreh më 26 tetor 2023 se dështimi për të depërshkallëzuar tensionet do të ketë pasoja<sup>21</sup>.

## 5. STANDARDET EVROPIANE

### GRUPIMI 2: TREGU I BRENDSHËM

Ky grup mbulon: lëvizjen e lirë të mallrave (Kapitulli 1); lirinë e lëvizjes për punëtorët (Kapitulli 2); të drejtën e themelimit dhe lirinë për të ofruar shërbime (Kapitulli 3); lëvizjen e lirë të kapitalit (Kapitulli 4); të drejtën e shoqëritë tregtare (Kapitulli 6); të drejtën e pronësisë intelektuale (Kapitulli 7); politikën konkurrencës (Kapitulli 8); shërbimet financiare (Kapitulli 9), dhe mbrojtje e konsumatorëve dhe shëndetit (Kapitulli 28).

Ky grup është kyç për përgatitjet e Kosovës për kërkesat e tregut të brendshëm të BE-së dhe është i një rëndësie të madhe për integrimin dhe rritjen e përsheptuar, duke përfshirë zhvillimin e tregut të përbashkët rajonal. Kosova ka një nivel të përgatitjes në shumicën e fushave të tregut të brendshëm, përkatësisht në fushat e lëvizjes së lirë të punëtorëve, të drejtën e shoqërive tregtare dhe konkurrencës. Ajo ndodhet ndërmjet njëfarë niveli të caktuar dhe të moderuar të përgatitjes në fushën e lëvizjes së mallrave. Kosova është mesatarisht e përgatitur për të drejtën e themelimit dhe lirinë për të ofruar shërbime, lëvizjen e lirë të kapitalit, të drejtën e pronësisë intelektuale dhe shërbimet financiare. Kosova është në fazën e hershme të përgatitjes për politikën e konsumatorit dhe mbrojtjen e shëndetit. Gjatë periudhës raportuese, Kosova ka arritur njëfarë progresi në të gjitha fushat, përveç lëvizjes së lirë të punëtorëve, të drejtës së shoqërive tregtare, politikës së konkurrencës, shërbimeve financiare dhe politikës së konsumatorit, dhe mbrojtjes së shëndetit, ku është arritur një progres i kufizuar.

### Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave

<sup>19</sup> <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2023/06/03/statement-by-the-high-representative-on-behalf-of-the-eu-on-kosovo-and-latest-developments/>

<sup>20</sup> <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2023/09/19/belgrade-pristina-dialogue-statement-by-the-high-representative-on-behalf-of-the-european-union-on-expectations-from-serbia-and-kosovo/>

<sup>21</sup> <https://www.consilium.europa.eu/media/67627/20241027-european-council-conclusions.pdf>



*Lëvizja e lirë e mallrave siguron që shumë produkte të mund të tregtohen lirshëm në të gjithë BE-në bazuar në rregullat dhe procedurat e përbashkëta. Kur produktet rregullohen nga rregullat kombëtare, parimi i lëvizjes së lirë të mallrave i pengon ato të krijojnë barriera të pajustificuara për tregtinë.*

Kosova ndodhet **ndërmjet njëfarë niveli të caktuar dhe të moderuar** të përgatitjes në fushën e lëvizjes së mallrave. Është arritur **njëfarë progresi** me miratimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe me përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit të Kosovës me *acquis* të BE-së mbi mbikëqyrjen e tregut dhe njohjen reciproke. Përafrimi i mëtejshëm me *acquis* të BE-së është i nevojshme në këtë fushë dhe Kosova duhet të rrisë numrin e stafit dhe të përmirësojë aftësitë e stafit në fushën e infrastrukturës së cilësisë (veçanërisht në vlerësimin konformitetit dhe mbikëqyrjen e tregut).

Pasi që disa rekomandime të vitit të kaluar mbeten të vlefshme, Kosova duhet në veçanti:

- të shtojë kapacitetin zbatues për vlerësimin e konformitetit dhe organet e mbikëqyrjes së tregut;
- të fillojë zbatimin e Ligjit të ri për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe Ligjit për inspektimet dhe të miratojë aktet nënligjore përkatëse;
- të fillojë zbatimin e kërkesave të Rregullores Evropiane për regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve (REACH).

#### Parimet e përgjithshme

Kosova ka filluar hartimin e kornizës ligjore për **prodhimin, shpërndarjen dhe tregtimin e produkteve industriale**. Ka miratuar Ligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve, i cili harmonizon rregullat në fushën e mbikëqyrjes së tregut. Gjithashtu ka miratuar Ligjin për inspektimet e përgjithshme. Megjithatë, kjo vetëm pjesërisht e përafron Kosovën me *acquis* përkatës të BE-së, dhe legjislacioni përkatës zbatues ende duhet të miratohet.

#### Zona e paharmonizuar

Kosova ka filluar shqyrtimin e legjislacionit të saj për t'iu përmbajtur kërkesave për eliminimin e barrierave në tregti dhe për të siguruar përafrimin me detyrimet sipas **neneve 34-36** të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE). Kosova po punon për të përafruar më tej legjislacionin për njohjen reciproke të mallrave. Ekziston një pikë specifike kontakti për njoftim që monitoron ministrinë dhe organet e tjera lidhur detyrimin e tyre për të njoftuar. Kosova ende kërkon që produktet të etiketohen me flamurin e vendit të origjinës, gjë që nuk është në përputhje me *acquis* të BE-së.

#### Zona e harmonizuar: infrastruktura cilësore

**Agjencia Kosovare për Standardizim** ende nuk është anëtare e asnjërës prej organizatave evropiane apo ndërkombëtare të standardizimit. Aplikimi i saj për anëtarësim në Komitetin Evropian për Standardizim (CEN) dhe Komitetin Evropian për Standardizim Elektroteknik (CENELEC) është ende në pritje. Sistemi informativ i menaxhimit të standardeve të qeverisë së Kosovës është një platformë online pjesërisht në përputhje me atë të CEN/CENELEC dhe organeve të tjera ndërkombëtare të standardizimit. Ky sistem duhet të zhvillohet në mënyrë që të jetë në përputhje me sistemin CEN/CENELEC dhe t'ia mundësojë Kosovës të miratojë standarde të reja më shpejt, duke e bërë atë të përshtatshëm për bizneset.

Drejtoria e **Akreditimit** të Kosovës (DAK) duhet të miratojë legjislacionin zbatues për ta ndihmuar atë të jetë më efektive në punën e saj. Drejtoria ka kryer akreditimin e 9 laboratorëve testues dhe 9 organeve inspektuese gjatë periudhës raportuese. Aktualisht, në Kosovë

ekzistojnë 53 organe të akredituara për vlerësimin e konformitetit (34 laboratorë testues dhe 19 organe inspektuese). Ka ende nevojë për të përmirësuar kapacitetin teknik dhe shkathhtësitë për testimin e aftësive të këtyre organeve të akredituara të vlerësimin të konformitetit.

Agjencia e **Metrologjisë** së Kosovës ndihmon në sigurimin e përafrimit të mëtejshëm me *acquis* të BE-së dhe zbatimin dhe zhvillimin e sistemeve dhe standardeve të menaxhimit të cilësisë për laboratorët e kalibrimit. Kosova aktualisht është ende në pritje të anëtarësimit të asociuar në Asociacionin Evropian të Instituteve Kombëtare të Metrologjisë (EURAMET).

Lidhur me **mbikëqyrjen e tregut**, përgjegjësitë e Inspektoratit të Tregut janë rritur që nga harmonizimi i rregullave të inspektimit në vitin 2022. Riorganizimi i Inspektoratit dhe ngritja e sistemit të inspektimit elektronik është ende në proces. Kosova gjithashtu filloi përgatitjen e një Ligji të ri për mbikëqyrjen e tregut dhe përputhshmërinë e produkteve që është në harmoni me *acquis* më të fundit të BE-së duke miratuar një plan të veprimit. Ligji i ri për sigurinë e përgjithshme të produkteve është miratuar në prill të vitit 2023 dhe është duke u zbatuar, duke marrë parasysh kërkesat teknike për produktet dhe vlerësimin e konformitetit.

Gjatë periudhës raportuese, Inspektorati i Tregut ka kryer 2 830 kontrolle për sigurinë e produkteve, ka shqiptuar 311 gjoba, ka procesuar 195 raste dhe ka konfiskuar 5 705 copë mallra të dëmshme.

#### Fusha e harmonizuar: legjislacioni sektorial

Lidhur me **legjislacionin e produkteve me ‘qasje të re dhe globale’**, Kosova ka miratuar legjislacionin me qëllim të përafrimit me *acquis* të BE-së për shpërndarësit e aerosolit, pajisjet nën presion, pajisjet e gazit, pajisjet mbrojtëse personale dhe produktet e ndërtimit. Nevojitet përafrim i mëtejshëm me legjislacionin tjetër të ri të kornizës legjislative.

Në lidhje me legjislacionin e produkteve të **‘qasjes së vjetër’**, Kosova duhet të fillojë zbatimin e Ligjit të saj për kimikatet me qëllim të përafrimit me Rregulloren BE-së për regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve (REACH) dhe Rregulloren e BE-së klasifikimin, etiketimin dhe paketimin (CLP). Përafrim i mëtejshme është e nevojshme për plehurat artificial dhe detergjentet. Kosova nuk është përafëruar me *acquis* të BE-së lidhur me mjetet motorike, automjetet me dy ose me tri rrota, traktorët (bujqësor, pyjor) ose emetimet e makinerive të lëvizshme jo-rrugore.

Kosova nuk ka arritur asnjë progres lidhur me **masat procedurale** gjatë periudhës raportuese. Legjislacioni i Kosovës mbetet pjesërisht i përafëruar me *acquis* të BE-së në fushën e armëve të zjarrit, etiketimit të tekstilit, çmimeve të produkteve mjekësore, objekteve **kulturore** të hequra në mënyrë të paligjshme nga një shtet anëtar i BE-së dhe produkte të mbrojtjes.

Inspektoratet përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut dhe sigurinë e produkteve janë të prirur kah korrupsioni. Kompetencat e tyre duhet të identifikohen qartë dhe nuk duhet të mbivendosen. Duhet të ketë staf të mjaftueshëm për sa i përket numrit dhe cilësisë.

#### **Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punëtorëve**

*Shtetasit e një shteti anëtar të BE-së kanë të drejtë të punojnë në një shtet tjetër anëtar dhe duhet t’u ofrohen të njëjtat kushte pune dhe sociale si punëtorët e tjerë.*

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në fushën e lëvizjes së lirë të punonjësve dhe të arritur **progres të kufizuar** gjatë periudhës raportuese, veçanërisht në koordinimin e sigurimeve sociale. Kosova është në negociata të vazhdueshme për marrëveshjet bilaterale për sigurimet sociale me Slloveninë dhe ka filluar negociatat me Kroacinë në vitin 2022.

Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

- të vazhdojë negociatat dhe arritjen e marrëveshjeve të reja dypalëshe për sigurimet sociale, veçanërisht me shtetet anëtare të BE-së;
- të fillojë punën në përgatitjen për t'iu bashkuar Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Punësimit (EURES) pas anëtarësimit.

Lidhur me **lëvizjen e lirë të punëtorëve**, shtetasit e BE-së dhe anëtarët e familjeve të tyre nuk kanë të drejtë të punojnë në Kosovë pa leje pune. Gjatë periudhës raportuese, Agjencia Kosovare e Punësimit ka lëshuar 202 leje pune afatshkurtra (në vitin 2021, 209), nga të cilat 114 ishin për shtetas të BE-së (në vitin 2021, 157).

Lidhur me **koordinimin e sigurimeve sociale**, Kosova tashmë ka në fuqi marrëveshje dypalëshe për sigurimet sociale me Belgjikën dhe Holandën, si dhe me Zvicrën dhe Shqipërinë. Këto marrëveshje sigurojnë që periudhat e punës në Kosovë nga shtetasit e këtyre vendeve (ose periudhat e punës në këto vende nga qytetarët e Kosovës) do të merren parasysh për të drejtën për përfitime të sigurimeve sociale. Negociatat për një marrëveshje të ngjashme janë duke vazhduar me Slloveninë. Në vitin 2022, Kosova filloi negociatat për një marrëveshje të ngjashme edhe me Kroacinë.

Nuk ka legjislacion në fuqi për të mbrojtur të drejtat e pensionit suplementar të punonjësve të lëvizshëm që kanë punuar në vendet tjera ose në shtetet anëtare të BE-së.

### **Kapitulli 3: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve**

*Personat fizikë dhe juridikë të BE-së kanë të drejtë të vendosen në çdo shtet anëtar dhe të ofrojnë shërbime ndërkufitare. Për disa profesione të rregulluara, ekzistojnë rregulla për njohjen reciproke të kualifikimeve. Rregullat e BE-së për shërbimet postare fokusohen në përmirësimin e cilësisë së shërbimit universal, hapjen graduale të tregut ndaj konkurrencës dhe krijimin e një rregullatori të pavarur.*

Kosova mbetet e **mesatarisht përgatitur** në këtë fushë dhe ka arritur **njëfarë progresi**. Kosova ka filluar zbatimin e planit të saj pesëvjeçar të veprimit për t'iu bërë ligjet e saj sektoriale në përputhje me Direktivën e Shërbimeve të BE-së. Pika e kontaktit të vetëm nuk është plotësisht funksionale. Tregu postar i Kosovës tashmë është hapur për konkurrencë në vitin 2022 dhe korniza ligjore është duke u harmonizuar me *acquis* postare të BE-së. Duhet më shumë përpjekje për ta përafëruar Kosovën me *acquis* të BE-së për njohjen e kualifikimeve profesionale.

Meqenëse shumica e rekomandimeve të vitit të kaluar nuk janë adresuar, në vitin e ardhshëm Kosova duhet:

- të heqë barrierat e identifikuar për të drejtën e themelimit dhe lirinë për të ofruar shërbime dhe të zbatojë planin e veprimit për t'iu bërë ligjet sektoriale në përputhje me Direktivën e Shërbimeve të BE-së;
- të kompletojë përafërimin e Kosovës me *acquis* postare të BE-së sa i përket Rregullores për shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për të monitoruar dhe siguruar pajtueshmërinë me rregullat e reja në tregun postar;

→ të përafrojë legjislacionin me *acquis* të BE-së për njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale, duke përfshirë Direktivën për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe me Direktivën për testin e proporcionalitetit para miratimit të rregullores së për profesionet.

Lidhur me të **drejta e themelimit dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve**, Kosova ka përafruar pjesërisht legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së për shërbimet. Gjatë periudhës raportuese, autoritetet krijuan një grup punues për të monitoruar dhe koordinuar zbatimin e planit të veprimit pesë-vjeçar për ta përafruar legjislacionin sektorial me *acquis* të BE-së për shërbimet. Grupi punues miratoi udhëzimet e monitorimit, diskutoi progresin dhe organizoi ngritjen e kapaciteteve për të vlerësuar përputhshmërinë e organeve të tij qeveritare me Ligjin për Shërbimet. Nevojitet një mekanizëm gjurmues për të monitoruar progresin në këtë fushë. Për të siguruar që rregullat e saj janë të harmonizuara me standardet e përcaktuara në Direktivën e Shërbimeve të BE-së, Kosova duhet të rrisë koordinimin ndërinstitucional ndërmjet departamenteve ligjore të ministrive të linjës, agjencive dhe organeve të tjera publike dhe profesionale. Nëse kompanitë e huaja dëshirojnë të ofrojnë shërbime në Kosovë, ato aktualisht janë të detyruara të themelojnë një zyrë. Kjo pengon lirinë e tyre për të ofruar shërbime. Për të korrigjuar këtë dhe probleme të tjera në këtë sektor, autoritetet kanë zhvilluar një analizë të tri fusha të shërbimeve: ligjore, shëndetësore dhe të TIK-ut për të identifikuar pengesat e mundshme në lirinë e ofrimit të shërbimeve.

Pika e kontaktit të vetëm të Kosovës është përgjegjëse për licencimin e auditorëve dhe kompanive të auditimit dhe tani ka filluar të zgjerojë rolin e saj në licencimin e gjeodetëve dhe kontabilistëve. Numri i profesioneve të regjistruara përmes pikës së kontaktit të vetëm duhet të rritet në vitet e ardhshme dhe platforma shoqëruese online duhet të shndërrohet në një pikë ofrimi të shërbimeve për përdoruesit, përfshirë edhe regjistrimin e shoqërive. Edhe pse bizneset dhe publiku tashmë mund kenë qasje online në platformën e pikës së kontaktit të vetëm, ata marrin vetëm informacione të përgjithshme për fillimin e një biznesi, pa opsione ndërveprueshmërie dhe për rrjedhojë pa ndonjë dobi reale për përdoruesin përfundimtar.

Në fushën e **shërbimeve postare**, Kosova ka arritur progres të mirë në përafrimin rregullator me Direktivën e Shërbimeve Postare, pasi zona e rezervuar për ofruesin e shërbimit universal është shfuqizuar në vitin 2022. Janë miratuar akte nënligjore për zbatimin e ndarjes kontabël dhe llogaritjen e kostos neto të shërbimit universal, në përputhje me Direktivën e Shërbimeve Postare. Ekziston një ofrues i shërbimit universal dhe 26 operatorë të tjerë postarë aktiv në tregun postar. Autoriteti rregullator kombëtar është ligjërisht i ndarë dhe funksionalisht i pavarur nga operatorët postarë, por ka burime të kufizuara dhe ka nevojë për fuqizim për të monitoruar dhe siguruar përputhjen me rregullat e reja në tregun postar. Kosova ende duhet të përafrojë legjislacionin e saj me Rregulloren për shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare.

Ligji për **profesionet e rregulluara** përcakton gjerësisht kërkesat, kushtet dhe kriteret për ushtrimin e një profesioni të rregulluar. Divizioni për Profesionet e Rregulluara në kuadër të Ministrisë së Arsimit duhet të forcohet dhe të plotësohet me personel për t'u bërë funksional. Kosova duhet të fillojë të identifikojë të gjitha profesionet e rregulluara në vend dhe të hartojë një listë të detajuar të profesioneve të rregulluara.

#### **Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit**

*Në BE, kapitali dhe investimet duhet të jenë në gjendje të lëvizin pa kufizime me rregulla të përbashkëta për pagesat ndërkufitare. Bankat dhe operatorët e tjerë ekonomikë zbatojnë rregulla të caktuara për të mbështetur luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*

Kosova është **mesatarisht e përgatitur** në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit. Gjatë periudhës raportuese, Kosova ka arritur **njëfarë progresi** duke miratuar Ligjin për zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare të shënjestruara dhe Ligjin për byronë shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificuar. Disa nga rekomandimet nga raporti i mëparshëm mbeten për t'u adresuar.

Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

- të shtojë përpjekjet për të përafuar më tej kornizën ligjor me Direktivën 2 të BE-së për Shërbimet e Pagesave;
- të shtojë përpjekjet për të luftuar krimin ekonomik dhe financiar dhe të harmonizojë Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit me *acquis* të BE-së;
- të forcojë bashkëpunimin ndërinstitucional në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar dhe forcimi i efektivitetit të konfiskimeve të pasurisë dhe të ardhurave të krimit.

Banka Qendrore e Kosovës ka licencuar një institucion të parave elektronike. Megjithatë, ekzekutimi i pagesave kryhet kryesisht në para të gatshme dhe transferet e parave janë kryesisht të kufizuara në institucionet financiare tradicionale. Ka mundur të bëhet më shumë punë në këtë fushë për të reduktuar kostot e transaksioneve dhe për të lehtësuar qasjen e klientëve pa llogari dhe atyre që janë të pakënaqur me shërbimet.

Sa i përket **sistemeve të pagesave**, Kosova duhet të përafrojë më tej legjislacionin e saj me Direktivën 2 të BE-së për Shërbimet e Pagesave. Korniza aktual e vendit për tregtinë elektronike vuan nga mangësitë rregullatore, siç është sistemi i dobët i pagesave elektronike. Kjo punë e përafritimit me Direktivën 2 të BE-së për Shërbimet e Pagesave duhet të mbështetet nga futja në përdorim dhe inkurajimi i metodave të reja të pagesave elektronike përmes zgjidhjeve inovative që janë më efikase dhe më pak të kushtueshme. Kosova nuk është anëtare e Unioni Ndërkombëtar të Telekomunikacionit, dhe kjo mund të pengojë zhvillimin e sistemeve ndërkombëtare të pagesave në vend.

Ligji për parandalimin e **pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit (PPP/LFT)** duhet të përafrohet më tej me Direktivën e katërt dhe të pestë për parandalimin e pastrimit të parave. Në vitin 2022, Kuvendi miratoi Ligjin për zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare të shënjestruara, i cili adreson mangësitë e identifikuara nga Raporti i Vlerësimit të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit për vitin 2018. Ligji përcakton masat që duhen marrë dhe gjithashtu identifikon autoritetet kompetente dhe procedurat për propozimin, miratimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare të shënjestruara. Këto sanksione kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftimin e terrorizmit; financimin e terrorizmit; dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë. Ligjin për byronë shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificuar, aktualisht në Gjykatën Kushtetuese, parashikon dënime për pasurim të paligjshëm në sistemin juridik të brendshëm dhe parashikon konfiskimin civil të pasurisë së caktuara pa dënime të mëhershme. Në funksion të rritjes së transparencës së personave juridikë dhe marrëveshjeve, në korrik të vitit 2022, qeveria miratoi një koncept dokument për rregullimin e regjistrimit të pronësisë përfutuese dhe një udhëzim i përmirësuar është miratuar nga Njësia e Inteligjencës Financiare e Kosovës (NJIF) për obligimet kundër PPP/LFT-së të profesionistëve ligjorë.

Numri i raporteve të transaksioneve të dyshimta në Kosovë u rrit në 947 në vitin 2022, me një rritje prej 3% nga viti 2021. Edhe pse Kosova ka arritur njëfarë progresi në luftën kundër krimit

financiar, ende ekziston nevoja për të forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional në luftën kundër krimin ekonomik dhe financiar. (*Shih gjithashtu Kapitullin 24 - Drejtësia, liria dhe siguria*).

## **Kapitulli 6: E drejta e kompanive**

*BE-ja ka rregulla të përbashkëta për formimin, regjistrimin dhe kërkesat për shpalesje të një kompanie, me rregulla plotësuese për kontabilitetin dhe raportimin financiar, dhe auditimin ligjor.*

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në fushën e së drejtës të shoqërive tregtare. Kosova ka arritur **progres të kufizuar** në përafrimin e mëtejshëm me *acquis* të BE-së për të drejtën e shoqërive tregtare dhe po përgatit një ligj të ri për shoqëritë tregtare për t'u përafruar më gjerësisht me *acquis* të BE-së. Meqenëse rekomandimet e vitit 2022 ishin adresuar vetëm pjesërisht, ato mbeten kryesisht të vlefshme.

Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

- të miratojë projektligjin për shoqëritë tregtare për t'u përafruar më tej me *acquis* të BE-së për të drejtën e shoqërive tregtare, duke përfshirë *acquis* më të fundit të BE-së (inkurajimi i angazhimit afatgjatë të aksionarëve, Direktiva për përdorimin e mjeteve dhe proceseve digjitale në kompani dhe Direktiva për operacionet ndërkufitare të kompanisë);
- të përafrohet më tej me *acquis* të BE-së për raportimin e kompanive dhe forcimin e strukturave institucionale të auditimit-mbikëqyrjes dhe pavarësisë/objektivitetit profesional të auditorëve dhe firmave të auditimit si dhe financimin e tyre të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm.

Sa i përket **së drejtës të shoqërive tregtare dhe qeverisjes korporative**, Kosova është duke përgatitur një projektligj të ri për shoqëritë tregtare. Kjo synon të përafrojë më tej kornizën ligjor të vendit me *acquis* të BE-së për të drejtën e shoqërive tregtare, veçanërisht për kërkesat minimale të kapitalit, të drejtat e aksionarëve (përfshirë inkurajimin e angazhimit afatgjatë të aksionarëve), përvetësimin e kompanive, aspektet e shpalesjes së informacionit për kompanitë dhe degët e tyre, Direktivën për përdorimin e mjeteve digjitale dhe Direktivën për operacionet ndërkufitare (bashkimet, ndarjet, konvertimet) dhe Direktivën për barazinë gjinore në bordet e drejtorëve. Kodi i Qeverisjes Korporative të Kosovës, i miratuar në qershor të vitit 2021, pasqyron standardet ndërkombëtare të përcaktuara në Parimet e OBZHE-së për Qeverisje Korporative.

Kosova ka përfunduar vlerësimin e infrastrukturës teknike të nevojshme për të siguruar ndërveprueshmërinë e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës me Sistemin e Ndërlidhjes së Regjistrimit të Bizneseve të BE-së (BRIS) dhe tani duhet të sigurohet që kushtet për këtë lidhje janë përmbushur. Koordinimi dhe shkëmbimi i pamjaftueshëm i të dhënave ndërmjet Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe Këshillit Kosovar për Raportim Financiar ende ndikon në raportimin dhe publikimin me kohë të dokumenteve kontabël. Agjencia nuk publikon ende informacione për kompanitë në disa situata ligjore (p.sh. në procedurat e falimentimit) dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor për publikimin e dokumenteve kontabël në regjistrin e bizneseve.

Lidhur me **raportimin e kompanive**, Ligji për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin është vetëm pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Kosova duhet të përafrohet me rregullat më të fundit të BE-së që mbulojnë raportimin e qëndrueshmërisë korporative. Ligji kërkon që **auditimet ligjore** të kryhet duke ndjekur standardet përkatëse ndërkombëtare të auditimit. Kompanitë e mëdha duhet të dorëzojnë dhe publikojnë pasqyrat e tyre financiare të audituara në Këshillin Kosovar për Raportim Financiar (KKRF), ndërsa mospërputhja rrezikon sanksione ligjore. Të gjitha pasqyrat financiare të dorëzuara publikohen në ueb faqen e

Këshillit. Kosova ende duhet të sigurojë financim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm për Bordin Mbikëqyrës të Auditimit Publik, i cili është emëruar nga KKRF si degë e tij ekzekutive përgjegjëse për mbikëqyrjen e këtij sektori. Kjo e ka penguar atë të ushtrojë plotësisht kompetencat e tij mbikëqyrëse dhe funksionet e zbatimit.

## **Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale**

*BE ka harmonizuar rregullat për mbrojtjen ligjore të të drejtave të pronësisë intelektuale (DPI), të drejtave të autorit dhe të drejtave të të përafërta. Rregullat për mbrojtjen ligjore të DPI-ve përfshijnë për shembull, patentat dhe markat tregtare, modelet, shpikjet bioteknologjike dhe farmaceutikën. Rregullat për mbrojtjen ligjore të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta mbulojnë, për shembull, librat, filmat, programet kompjuterike dhe transmetimet.*

Kosova është **mesatarisht e përgatitur** për të drejtat e pronësisë intelektuale. Është arritur **njëfarë progresi** në harmonizimin e kornizës ligjore të brendshëm me *acquis* të BE-së. Kanë hyrë në fuqi ligjet e reja për patentat, markat tregtare, dizajnin industrial, topografite e produkteve gjysmëpërçuese dhe sekretet tregtare. Qeveria miratoi Ligjin e ri për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta (dhe legjislacionin përkatës në lidhje me sistemin e menaxhimit të të drejtave kolektive në fushën e të drejtës së autorit për veprat letrare dhe pamore). Ky ligj i ri synon gjithashtu përafrohet me Direktivën për transmetimin e caktuar online të organizatave transmetuese dhe ritransmetimet e programeve televizive dhe radiofonike për të mbuluar transmetimet online si dhe me Direktivën për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta në tregun e vetëm. Kosova gjithashtu ndërmori hapa për të zbatuar më mirë të drejtat e pronësisë intelektuale dhe industriale duke themeluar Gjykatën Komerciale e cila ka mandat që të zgjidhë rastet dhe kontestet në këtë fushë. Rekomandimet e vitit të kaluar janë implementuar pjesërisht.

Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

- të krijojë një sistem funksional të menaxhimit kolektiv duke forcuar organizatat ekzistuese të menaxhimit kolektiv në fushën e muzikës dhe audiovizuele dhe duke ndihmuar në krijimin një organizatë shtesë të menaxhimit kolektiv në fushën e veprave letrare dhe pamore;
- të miratojë legjislacionin zbatues si rezultat i miratimit të ligjeve të pronësisë industriale (patentat, markat tregtare, dizajni industrial, topografite e produkteve gjysmëpërçuese dhe sekretet tregtare).

Kosova ka arritur njëfarë progresi në aspektin e përafrimit legjislativ, kështu që mund të fillojë të garantojë njëfarë niveli të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe komerciale ekuivalente me atë të aplikuar në BE dhe në përputhje me MSA-në.

Në fushën e **të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta**, është miratuar projektligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta, i cili synon të përafrojë legjislacionin e Kosovës me Direktivat për menaxhimin kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta dhe për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta në tregun e vetëm digjital. Kosova ende nuk ka krijuar një sistem funksional të menaxhimit kolektiv në fushën e veprave letrare dhe artistike.

Organi kryesor përgjegjës është Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (ZDADP). Ajo mbetet në nivel të ulët të kapacitetit administrativ, me vetëm tre zyrtarë. Strategjia kombëtare e Kosovës për forcimin e sistemit të së drejtës së autorit (2019-2023) përmbante plane për të krijuar dy divizione në kuadër të Zyrës për të Drejtat e Autorit, një për promovimin dhe edukimin dhe një për menaxhimin dhe mbikëqyrjen kolektive të së drejtave së autorit. Asnjëri prej këtyre organeve nuk është krijuar ende për të mbështetur zbatimin e rregullave aktuale dhe për të siguruar kompensimin e mbajtësve të së drejtave.

Në lidhje me **të drejtat e pronësisë industriale**, Agjencia për Pronësi Industriale e Kosovës ka nevojë për restrukturim dhe staf shtesë. Kosova ka pasur legjislacion në fuqi që nga viti 2022 për ‘topografite’ e gjysmëpërçuesve, patentat, dizajnet, sekretet tregtare dhe markat tregtare. Gjatë periudhës raportuese, Kosova gjithashtu ka miratuar legjislacionin përkatës zbatues për regjistrimin e patentave, markave tregtare dhe dizajneve industriale. Veçanërisht, në korrik të vitit 2022, Kosova miratoi Ligjin për markat tregtare dhe shtatë udhëzime administrative. Kosova ende nuk e ka miratuar strategjinë për pronësinë industriale për periudhën 2022-2026.

Këshilli Shtetëror për Pronësi Intelektuale dhe Task Forca kundër Piraterisë janë përgjegjës për **zbatimin** e të drejtave të pronësisë intelektuale në Kosovë. Në këtë fushë, Kosova duhet të përmirësojë kapacitetin dhe koordinimin ndërmjet institucioneve politikëbërëse dhe institucioneve të zbatimit të ligjit për të zbatuar në mënyrë efektive të drejtat e pronësisë intelektuale. Procedurat e gjata për trajtimin e kërkesave dhe mungesa e zbatimit të vendimeve të marra, janë kufizimet a kryesore për zbatimin efektiv të kornizës ligjore për DPI.

Në vitin 2022, Task Forca konfiskoi rreth 800 copë materiale pirate. Me iniciativë të Inspektoratit të Tregut janë konfiskuar 3 760 mallra. Gjithashtu u sekuestruan rreth 1 000 kopje të materialeve që cenonin të drejtat e autorit, duke përfaqësuar një rritje prej 233% krahasuar me një vit më parë. Gjithsej 4 062 copë të tekstit dhe 63 makineri janë penguar të hyjnë në treg, pasi nuk kanë pasur emër tregtar dhe janë vlerësuar si potencialisht të destinuara dhe të falsifikueshme për tregun e brendshëm. Agjencia për Pronësi Industriale ka lëshuar 7 269 dokumente zyrtare që përfshijnë vendime për regjistrimin e të drejtave, ftesa për pagesë dhe njoftime të tjera për aplikantët që të plotësojnë kërkesat e tyre për të drejtat e pronësisë.

Në vitin 2022, Njësia e Doganave të Kosovës për DPI ka iniciuar 612 raste hetimore, duke konfiskuar 968 980 copë mallra false në vlerë totale prej 10.6 milionë euro, që paraqet një rritje në krahasim me vitin e kaluar.

Kosova themeloi Gjykatën Komerciale të specializuar në çështjet komerciale dhe gjykata ka mandat të zgjidhë rastet dhe kontestet në fushën e të drejtave të pronësisë industriale dhe të drejtave të autorit.

## **Kapitulli 8: Politikat e konkurrencës**

*Rregullat e BE-së mbrojnë konkurrencën e lirë. Këto përfshijnë rregullat e antitrustit kundër marrëveshjeve kufizuese ndërmjet kompanive dhe abuzimit me pozitën dominuese, si dhe përfshijnë rregulla për përqendrimet ndërmjet kompanive të cilat do të pengonin ndjeshëm konkurrencën efektive. Rregullat e BE-së përcaktojnë gjithashtu sistemin e kontrollit të ndihmës shtetërore. Qeveritë lejohen të japin ndihmë shtetërore vetëm nëse plotësohen kushtet kufizuese, me qëllim të parandalimit të prishjes së konkurrencës.*

Kosova **ka njëfarë niveli të përgatitjes** në politikën e konkurrencës dhe ka arritur **progres të kufizuar** në këtë kapitull. Ka rishikuar kornizën ligjore për antitrustin dhe bashkimet, por nuk ka arritur progres në ndihmën shtetërore. Kontrolli dhe zbatimi i ndihmës shtetërore nuk ekziston dhe është pezulluar, pasi rastet as nuk trajtohen dhe as zbatohen pa miratimin e Komisionit për Ndihmë Shtetërore, mandati i të cilit ka skaduar në mars të vitit 2022. Duhet t'i jepet përparësi themelimit urgjent të një Komisionit funksional të Ndihmës Shtetërore. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të përafuar dhe zbatuar legjislacionin si në fushën e antitrustit ashtu edhe në bashkimet dhe ndihmën shtetërore. Pasi që rekomandimet nga raporti i mëparshëm mbeten kryesisht të vlefshme, Kosova duhet:

→ të përmbushë urgjentisht detyrimet e MSA-së, duke përfshirë krijimin e një Komisioni funksional të Ndihmës Shtetërore;



- të harmonizojë më tej kornizën legjislativ për antitrustin, bashkimet dhe ndihmën shtetërore dhe të sigurojë zbatimin e saj;
- të sigurojë kapacitetin funksional dhe pavarësinë operacionale të autoriteteve të konkurrencës dhe të ndihmës shtetërore dhe të rrisë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet të gjitha palëve të interesit, duke përfshirë ministrinë, rregullatorët dhe gjyqësorin;

### Antitrusti dhe bashkimet

**Korniza legjislativ** për antitrustin dhe bashkimet është kryesisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Në vitin 2022, Kosova miratoi Ligjin e ri për mbrojtjen e konkurrencës; megjithatë, nevojiten ndryshime të mëtejshme duke përfshirë nenet katër dhe gjashtë për të siguruar përafrimin e tij *acquis* të BE-së. Legjislacioni zbatues duhet të përafrohet me ligjin e ri dhe me *acquis* të BE-së, pasi që versioni aktual nuk është më i vlefshëm dhe i zbatueshëm.

Lidhur me **kornizën institucionale**, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) është përgjegjës për zbatimin e kornizës ligjore dhe Komisioni Kosovar i Konkurrencës (KKK) vepron si organ vendimmarrës. KKK u bë përsëri funksional pas emërimit në qershor të vitit 2022. Është forcuar bashkëpunimi në mes të AKK-së dhe rregullatorëve të tjerë të sektorit, si dhe është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik dhe Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Në **kapacitetin të saj për të zbatuar konkurrencën**, AKK vepron si agjenci e pavarur që i raporton Kuvendit të Kosovës, dhe që miraton vendime përmbarimore dhe përbëhet nga 18 anëtarë. KKK gjithashtu emërohet nga Kuvendi, vepron si organ kolegjal që udhëheq punën e AKK-së dhe përbëhet nga pesë anëtarë me dy pozita të lira.

Sa i përket **zbatimit**, në vitin 2022, AKK ka nxjerrë 10 vendime në sektorët e zhvillimit të softuerit, sigurimit, shërbimeve mjekësore, telekomunikacionit dhe tregjeve financiare. AKK ka filluar katër studime të tregut, duke përfshirë tregjet për grurë, miell, gaz, vaj për gatim, benzinë, sheqer, vaj, produkte të transportit, çimento dhe pelet.

Kosova nuk ka arritur progres në zbatimin e rregullave të konkurrencës duke shqiptuar gjopa apo mjete juridike pas vendimeve të marra nga AKK-ja. Numri i rasteve mbetet i ulët dhe deri më tani, AKK nuk ka kryer asnjë inspektim të paparalajmëruar dhe asnjëherë nuk është përdorur ndonjë program i masave zbutëse. Ndërprerjet në funksionimin e KKK-së kanë çuar në një numër të madh të rasteve të pazgjidhura.

Trajnimi për gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës për aspektet thelbësore të ligjit të konkurrencës ka vazhduar në vitin 2022. Rritja e ndërgjegjësimit të gjyqtarëve për zbatimin e ligjit të konkurrencës mbetet thelbësore, për të shmangur gjykimet kontradiktore nga shkallë të ndryshme gjyqësore.

### Ndihma shtetërore

**Korniza legjislativ** për ndihmën shtetërore është kryesisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Megjithatë, nuk është arritur progres gjatë periudhës raportuese për ta ndryshuar më tej. Projekt Rregullorja për ndihmën horizontale duke përfshirë përjashtimet në bllok dhe ndihmën rajonale, ndonëse e përgatitur, nuk është miratuar ende. Ngjashëm më këtë, Projektligji për Ndihmën Shtetërore edhe pse i përgatitur si projekt nuk është miratuar.

Sa i përket **kornizës institucionale**, Departamenti për Ndihmë Shtetërore i Ministrisë së Financave është përgjegjës për vlerësimin e propozimeve për ndihmë shtetërore, hartimin e raporteve të vlerësimit për Komisionin për Ndihmë Shtetërore (KNSH) dhe përditësimin e inventarit të ndihmës shtetërore. KNSH vepron si organ vendimmarrës dhe përbëhet nga pesë anëtarë.

Sa i përket **kapaciteti zbatues**, nuk mund të raportohet ndonjë progres pasi mandati i Komisionit për Ndhimë Shtetërore skadoi në mars të vitit 2022 dhe asnjë komision i ri nuk është krijuar nga qeveria, duke vënë në pritje të gjithë kontrollin mbi ndihmën shtetërore.

Lidhur me **zbatimin**, KNSH filloi vlerësimin e nëntë masave të mbështetjes shtetërore në vitin 2022, nga të cilat vetëm një u njoftua nga ofruesi. Duke qenë se nuk ka Komision për Ndhimë Shtetërore, asnjë vendim nuk u miratua në vitin 2022. Nuk është paraqitur asnjë raport vjetor për miratimin e ndihmës shtetërore.

### Liberalizimi

Ndërmarrjet publike i nënshtrohen Ligjit për Konkurrencën dhe Ligjit për Ndhimën Shtetërore. Kosova ka monopole të natyrës tregtare brenda kuptimit të nenit 37 të TFBE-së Duhet të rritet ndërgjegjësimi për të zbatuar rregullat e ndihmës shtetërore për aktivitetet e institucioneve qendrore dhe ndërmarrjeve publike.

### **Kapitulli 9: Shërbimet financiare**

*Rregullat e BE-së synojnë të sigurojnë konkurrencë të ndershme dhe stabilitetin e institucioneve financiare, përkatësisht bankave, sigurimeve, pensioneve suplementare, shërbimeve të investimeve dhe tregjeve të letrave me vlerë. Ato përfshijnë rregulla për autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e këtyre institucioneve.*

Kosova është **mesatarisht e përgatitur** në fushën e shërbimeve financiare. Ajo ka arritur **progres i kufizuar** në zbatimin e rekomandimeve të vitit të kaluar për shkak të mungesës së kapaciteteve. Të gjitha rekomandimet e mëparshme të pazbatuara plotësisht mbeten të vlefshme. Vendi duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për t'u përafuar me *acquis* për shërbimet financiare, duke u fokusuar në prioritetet e identifikuara.

Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

- të forcojë kornizën e e qeverisjes së Bankës Qendrore duke emëruar dy Zëvendës Guvernatorët e Bankës;
- të shtojë përpjekjet e saj për të zbatuar masat e Solvencës II dhe të vazhdojë me rritjen e rolit mbikëqyrës në sektorin e sigurimeve;
- të avancojë më tej përafrimin me versionet e rishikuara të Direktivës për Kërkesat e Kapitalit dhe Rregullores për Kërkesat e Kapitalit (CRR/CRD), Direktivës për Rikuperimin dhe Zgjdhjen e Bankës (BRRD) dhe Direktivën e Skemës së Garancisë së Depozitave (DGSD).

Lidhur me **bankat dhe konglomeratet financiare**, Banka Qendrore ka vazhduar të përafrojë kornizën e saj ligjore me kërkesat e Basel III për menaxhimin e kapitalit dhe rrezikut. Ajo ka miratuar rregullore në lidhje me raportin e mbulimit të likuiditetit dhe vlerësimin e rrezikut të likuiditetit të bankës. Përkundër sfidave ekonomike globale, sektori financiar mbetet i qëndrueshëm për shkak të niveleve të larta të kapitalizimit të sektorit bankar me pronësi të huaj. Në përgjithësi, niveli i kapitalizimit të bankave ka mbetur i qëndrueshëm dhe shumë mbi nivelin minimal të kërkuar të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 12%. Ndonëse rreziku kreditor mbetet i përmbajtur, duhet t'i kushtohet fokus vlerësimit të rreziqeve nga zgjerimi i shpejtë i kredisë në segmentin e individëve, në veçanti kreditimi hipotekar.

Në lidhje me çështjet e qeverisjes, gjatë periudhës raportuese Banka Qendrore e Kosovës është përballur me sfida në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të saj. . Pozita e Guvernatorit të Bankës Qendrore kishte mbetur e lirë për disa muaj para se të plotësohej në korrik. Dy pozitat e Zëvendës Guvernatorëve mbeten të lira. Parimet e transparencës dhe përzgjedhjes së bazuar

në merita duhet të respektohen. Çdo ndikim politik në emërimet brenda Bankës cenon besimin e publikut në këtë shërbim. Kosova ende nuk ka krijuar një autoritet të pavarur të rikuperimit dhe zgjidhjes. Banka Qendrore është duke punuar në përditësimin e rregulloreve për t'i harmonizuar ato me Direktivën për Rikuperimin dhe Zgjidhjen e Bankës (BRRD) I dhe II, me të cilat Kosova nuk është përafuar plotësisht. Ndryshimet në Ligjin për Bankat, për t'ia caktuar këtë funksionin e rikuperimit dhe zgjidhjes Bankës Qendrore, duhet të sigurojnë që autoriteti të ketë pavarësi funksionale. Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë (FSDK) ka formuar grupin punues për ndryshimin e Ligjit për sigurimin e depozitave. Ndryshime duhet të synojnë të përafrojnë Direktivën e Skemës së Sigurisë së Depozitave. Banka Qendrore duhet të sigurojë që konsumatorët janë të mbrojtur në mënyrë adekuate për të parandaluar praktikatat e padrejta bankare.

Në lidhje me **sigurimet dhe pensionet profesionale**, Kosova vazhdoi të zbatojë masat e Solvencës I dhe filloi zbatimin gradual të Solvencës II. Ka përmirësime për t'u theksuar në lidhje me nivelet e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe likuiditetit të sektorit të sigurimeve dhe rritjen e rolit mbikëqyrës të Bankës Qendrore në industrinë e sigurimeve. Përkundër opinionit të paraqitur nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, çmimet në tregun e sigurimeve të detyrueshme nga autopërgjegjësia mbeten fikse, pasi që procesi i liberalizimit të çmimeve për autopërgjegjësinë ndaj palëve të treta ende nuk ka filluar dhe modeli i ri i bazuar në rrezik për përshatjen e tarifave të sigurimit të veturave nuk është vënë në funksion.

Pavarësisht njëfarë progresi lidhur me **automjetet e pasiguruara dhe të paregjistruara**, Kosova vazhdon të mbetet jashtë sistemit të kartonit të gjelbër. Si rezultat, kërkohet sigurim për automjetet me targa të huaja që hyjnë në Kosovë dhe automjetet me targa të Kosovës që dalin nga Kosova. Kjo vazhdon të paraqesë një barrë financiare.

Gjatë periudhës raportuese, Bordi Drejtues i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) ka qenë jofunksional për pesë muaj, pasi mandati i anëtarëve të Bordit ka skaduar në shkurt 2023, derisa është bërë emërimi i ri i anëtarëve në korrik 2023.

**Tregjet e letrave me vlerë dhe shërbimet e investimeve** mbeten në fazat e hershme të zhvillimit, pasi që pjesa më e madhe e aktivitetit përqendrohet në tregun e bonove të qeverisë, të cilat janë nxjerrë në ankand nga Banka Qendrore. Rregullorja për riblerjen e letrave me vlerë me Bankën Qendrore mundëson tregtimin e letrave me vlerë ndërmjet bankave komerciale në tregun sekondar. Kjo synon të ndihmojë bankat e pranueshme që të menaxhojnë likuiditetin e tyre në mënyrë efikase në një periudhë afatshkurtër. Në periudhën raportuese nuk ka pasur zhvillime sa i përket menaxhimit të mjeteve dhe asetëve.

Sa i përket **financave digjitale dhe të qëndrueshme**, Kosova duhet të kryejë punë të mëtejshme për të përfshirë faktorë të qëndrueshëm si në politikatat dhe objektivat strategjike bankare ashtu edhe ato jo-bankare, dhe për të zbatuar një kornizë rregullative financiare që mbështet investimet private drejt aktiviteteve të qëndrueshme/të gjelbra. Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK) mund të garantojë deri në 80% të portofolit të kredive të institucioneve financiare për NMVM-të në fushat siç janë eficientia e energjisë dhe bujqësia e qëndrueshme. FKGK ka lëshuar deri në 303 milionë euro garanci që nga korriku 2023.

## **Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe siguria e produkteve**

*Rregullat e BE-së mbrojnë interesat ekonomike të konsumatorëve dhe në lidhje me sigurinë e produkteve, imitimet e rrezikshme dhe përgjegjësinë për produktet me defekt. BE-ja siguron gjithashtu standarde të larta të përbashkëta për kontrollin e duhanit, gjakut, indeve, qelizave dhe organeve, si dhe medikamenteve për përdorim njerëzor dhe veterinar. BE-ja ka gjithashtu rregulla për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar dhe në*

*përgatitjen dhe reagimin ndaj kërcënimeve shëndetësore ndërkufitare, duke përfshirë sëmundjet ngjitëse.*

Kosova është në një **fazë të hershme të përgatitjes** në këtë fushë. Është arritur **progres i kufizuar** në përgjithësi përmes miratimit të Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve, megjithatë ligji për mbrojtjen e konsumatorëve ende nuk është miratuar. Kosova ka arritur përputhshmëri me Certifikatën Digjitale të BE-së për COVID. Meqenëse rekomandimet e vitit të kaluar nuk janë zbatuar pjesërisht, ato mbeten kryesisht të vlefshme.

Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet:

- të miratojë ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve;
- të rrisë burimet njerëzore dhe financiare dhe sistemet e nevojshme për zbatimin e reformave në sektorin e shëndetësisë, veçanërisht duke zbatuar sistemin elektronik të informacionit të shëndetit publik dhe përmirësimin e qasjes dhe të rezultateve shëndetësore për ata që janë në situatat më të ndjeshme;
- të sigurojë zbatimin rigoroz të kontrollit të duhanit në përputhje me *acquis* përkatëse të BE-së dhe detyrimet ndërkombëtare.

### Mbrojtja e konsumatorit

**Korniza legislative** e Kosovës është përafuar pjesërisht me *acquis* të BE-së. Në tetor 2022, qeveria miratoi projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit, i cili përafuron ligjin ekzistues për mbrojtje të konsumatorit me ndryshimet më të fundit në legjislacionin e BE-së për konsumatorin, të prezantuara me Direktivën (BE) 2019/2161. Megjithatë, miratimi përfundimtar është ende në pritje. Zbatimi i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit mbetet i kufizuar. Mbetet për t'u krijuar një platformë e integruar për harmonizimin e procesit të ankesave. Banka Qendrore ka një divizion që trajton shumicën e ankesave të konsumatorëve për shërbimet financiare, në vitin 2022 janë trajtuar 644 ankesa, më pak se në vitin 2021.

Në lidhje me **sigurinë e produkteve**, Kosova ka miratuar ligjin të ri për sigurinë e përgjithshme të produkteve të paraparë për t'u përafuar plotësisht me *acquis* të BE-së. Gjatë periudhës raportuese, Inspektorati i Tregut ka kryer 2 830 kontrolle për sigurinë e produkteve, ka shqiptuar 311 gjopa, ka procesuar 195 raste dhe ka konfiskuar 5 705 copë mallra të dëmshme.

Sa i përket **çështjeve që nuk ndërlidhen me sigurinë**, ligji për mbrojtjen e konsumatorit trajton interesat ekonomike të konsumatorëve. Dobësia e organizatave për të drejtat e konsumatorëve mbetet sfidë.

### Shëndeti publik

Në politikën e **shëndetit publik**, cilësia e kujdesit shëndetësor mbetet shqetësuese. Projektligji për shëndetin dhe projektligji për sigurimin shëndetësor, që synojnë të drejtojnë reformat në sektorin shëndetësor, nuk janë ndryshuar. Strategjia e re e Sektorit të Shëndetësisë 2023-2030 është hartuar dhe ende nuk është miratuar. Shpenzimet për shëndetësinë arrijnë në rreth 3% të BPV-së, që është e dyta më e ulëta në rajon dhe më shumë se tri herë më e ulët se mesatarja e BE-së prej rreth 11%. Kosova ka ndarë një nivel rekord të lartë të buxhetit për sektorin shëndetësor në vitin 2023 (rreth 300 milionë euro), një rritje prej rreth 15.6% krahasuar me vitin 2022. Financimi i shëndetësisë bazohet kryesisht në shpenzimet historike dhe nuk ka tregues të bazuar në performancë. Përgjegjësia institucionale e ofruesve të shëndetit publik mbetet e ulët. Nuk ka stimuj për të përmirësuar produktivitetin, efikasitetin dhe cilësinë në sektor. Pavarësisht një rrjeti relativisht të fuqishëm të institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor që ofrojnë shërbime falas, shpenzimet nga xhepi mbeten shumë të larta. Kosova ka sistemin e informacionit **shëndetësor elektronik** (e-shëndeti), bazuar në treguesit kryesorë

evropianë të shëndetit, që mundëson komunikimin virtual ndërmjet përdoruesve/pacientëve dhe mjekëve të përgjithshëm, ofron shërbime këshillimi dhe nxjerrë të dhëna për pranimet, lirimet dhe transferimet e pacientëve. Megjithatë, ai nuk përdoret nga të gjitha institucionet shëndetësore dhe funksionalitetet tjera (që mbulojnë patologjinë, radiologjinë, transfuzionin e gjakut, vaksinimin dhe ndërhyrje të tjera) mbeten për t'u shtuar.

Jetëgjatësia në Kosovë në lindje mbetet më e ulëta në rajon; **sëmundjet jo-ngjitëse** janë shkaku kryesor i vdekjeve, veçanërisht sëmundjet kardiovaskulare dhe kanceri. Rreth 33% e shkaqeve të vdekjes janë raportuar gabimisht ose nuk janë diagnostikuar. Promovimi i shëndetit dhe programet parandaluese për sëmundjet jo-ngjitëse janë të dobëta; depistimi për gjendje kronike (si diabeti dhe hipertensioni) nuk kryhet sistematikisht. Nuk ka pasur progres në zbatimin e planit të veprimit për promovimin e shëndetit apo planeve strategjike për kujdesin shëndetësor të nënës dhe fëmijës. Vdekshmëria e fëmijëve mbetet problem serioz, 16 fëmijë nga 1000 lindje të gjalla vdesin, numër ky që është tri herë më i lartë se mesatarja e BE-së. Në vitin 2022, qeveria bëri përpjekje për të përmirësuar shëndetin e nënës dhe fëmijës. Ajo ka zgjeruar programet e vizitave në shtëpi në të gjitha komunat dhe ka ndarë burime shtesë për këtë (3.4 milionë euro). Edhe pse shumica e treguesve në sistemin e informacionit të shëndetit publik janë të përafuara me Treguesit Kryesor Evropian, sistemi është vetëm pjesërisht funksional. Prandaj, shfrytëzimi i tij për zhvillimin e politikave, kërkim dhe vendimmarrje është i kufizuar.

Sa i përket **shëndetin mendor**, janë miratuar disa udhëzime klinike. Shërbimet e shëndetit mendor vazhdojnë të jenë shërbime të integruara. Ligji i vitit 2013 për **kontrollin e duhanit** nuk është duke u zbatuar në mënyrë gjithëpërfshirëse, megjithëse ka pasur një rritje të dukshme të inspektimeve për pirjen e duhanit në vende publike në Prishtinë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023.

Legjislacioni për **gjakun, indet, qelizat dhe organet** është pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Përafrimi i plotë me *acquis* të BE-së mbetet sfidë, dhe Kosovës vazhdon t'i mungojnë kapacitetet e nevojshme administrative, infrastrukture, financiare dhe njerëzore në këtë fushë.

Sa i përket **sëmundjeve të rënda ngjitëse dhe kërcënimeve serioze shëndetësore ndërkufitare**, Kosova ka arritur njëfarë progresi në forcimin e kapaciteteve të saj për mbikëqyrje dhe raportim të të dhënave në Organizatën Botërore të Shëndetësisë. Kuvendi ka miratuar ligjin për sëmundjet ngjitëse në përputhje me rekomandimet e ECDC-së dhe *acquis* të BE-së në gusht 2023. Imunizimi rutinor po përmirësohet, megjithatë, normat e mbulimit janë ende më të ulëta se nivelet e para-COVID-19 dhe aktualisht qëndrojnë mes 87-89%.

Gjatë periudhës raportuese, autoritetet shëndetësore në Kosovë vazhduan të menaxhojnë pandemisë **COVID-19**, dhe ka arritur progres të mëtejshëm në mbikëqyrjen, hetimin e rasteve, gjurmimin e kontakteve dhe menaxhimin e rasteve. Në korrik të vitit 2022, Kosova ka arritur përputhshmëri me Certifikatën Digjitale të BE-së për COVID. Numri i rasteve pozitive ka rënë në mënyrë progresive, pas rritjes gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2022. Shkalla e vaksinimit ka rënë ndjeshëm gjatë periudhës raportuese. Janë finalizuar hapësirat dhe pajisjet e reja për të siguruar ruajtjen e duhur të vaksinave.

Legjislacioni për **të drejtat e pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar** është përafuar pjesërisht me *acquis* të BE-së Për shërbimet e specializuara shëndetësore që nuk janë të disponueshme në Kosovë, pacientët mund të përfitojnë nga fondi i sigurimeve shëndetësore për shërbime shëndetësore jashtë vendit. Megjithatë, fondi aktualisht shërben vetëm si agjent pagesash, në vend të zhvillimit të proceseve të standardizuara të miratimit dhe monitorimit. Ai nuk angazhohet në asnjë negociim të kontratave me spitalet jashtë vendit. Një pozicion i tillë pasiv ka sjellë rrezik të konsiderueshëm financiar për fondin e sigurimeve shëndetësore.

Kosova ka një program për **depistim të kancerit**. Megjithatë, pavarësisht disa përparimeve, depistimi i kancerit nuk kryhet në mënyrë sistematike. Shërbimet kryesore të diagnostikimit dhe trajtimit të kancerit ofrohen në nivelin e kujdesit shëndetësor terciar në një qendër klinike.

Kosova nuk ka arritur ndonjë progres në miratimin e planit të veprimit për **të ushqyerit dhe aktivitetin fizik**. Legjislacioni për **barnat për përdorim njerëzor dhe barnat për përdorim veterinar** është pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Lista e barnave esenciale për të cilat shpenzimet mbulohen nga qeveria nuk është përditësuar ende. Niveli i mbulimit të kostove për produktet medicinale nga lista esenciale mbetet rreth 70%, dhe mbi 90% për materialet konsumuese në kujdesin parësor shëndetësor.

**Pabarazitë shëndetësore** mbeten çështje serioze. Shtyrja e vazhdueshme e vënies në funksion të skemës së sigurimeve të përgjithshme shëndetësore ka bërë që pagesat nga xhepi të mbeten shumë të larta. Kjo ndikon në qasjen në shërbimet esenciale shëndetësore për ata që janë në situata të ndjeshme, siç janë ata që jetojnë në varfëri, në zonat rurale dhe personat që i përkasin komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Vlerësohet se pothuajse një e treta e popullsisë së Kosovës ka qasje të kufizuar në shërbimet e kujdesit shëndetësor. Shkalla e imunizimit rutinor të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë është vetëm sa gjysma e fëmijëve të tjerë.

### **GRUPIMI 3: KONKURRUESHMËRIA DHE RITJIA GJITHËPËRFSHIRËSE**

Ky grup mbulon: transformimin digjital dhe mediat (Kapitulli 10); tatimet (Kapitulli 16); politikë ekonomike dhe monetare (Kapitulli 17); politikë sociale dhe punësimin (Kapitulli 19); politikën industriale (Kapitulli 20), shkencën dhe kërkimin (Kapitulli 25); arsimin dhe kulturën (Kapitulli 26); dhe bashkimin doganor (Kapitulli 29).

Kosova është mesatarisht e përgatitur në fushën e doganave, si dhe në politikën e ndërmarrjeve dhe atë industriale. Ka njëfarë niveli të përgatitjes në fushën e taksave, transformimit digjital dhe mediave, si dhe arsimit dhe kulturës, dhe është në një fazë të hershme të përgatitjes në fushat e politikës sociale dhe punësimit, si dhe shkencës dhe kërkimit. Gjatë periudhës raportuese, është arritur njëfarë progresi në shumicën e fushave të këtij grupimi, progres i kufizuar në transformimin digjital dhe mediat.

#### **Kapitulli 10: Transformimi digjital dhe mediat**

*BE-ja mbështet funksionimin pa probleme të tregut të brendshëm për komunikimet elektronike, tregtinë elektronike dhe shërbimet audiovizuale. Rregullat mbrojnë konsumatorët dhe mbështesin disponueshmërinë Kapaciteti i universale të shërbimeve moderne.*

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në fushën e transformimit digjital dhe mediave. Kosova ka arritur **progres të kufizuar** duke përafuar më tej kornizën e saj legjislative me *acquis* të BE-së, veçanërisht me miratimin e ligjit për sigurinë kibernetike. Megjithatë, nevojitet ende përafrim dhe implementim i mëtejshëm në fushën e politikave audiovizuale. Kosova është angazhuar në mënyrë konstruktive në dialogun rajonal të nivelit të lartë për transformimin digjital dhe zbatimin e Marrëveshjes Rajonale për Roaming. Në shtator të vitit 2022, Kosova ishte nikoqir i Samitit Digjital të Ballkanit Perëndimor në Prishtinë. Një zgjidhje të qëndrueshme duhet gjetur për financimin e transmetuesit publik dhe sigurimin e pavarësisë së tij editoriale. Qeveria miratoi Agjendën Digjitale 2030. Burimet buxhetore për sigurinë kibernetike mbeten të pamjaftueshme.

Rekomandimet e raportit të fundit kryesisht nuk janë adresuar dhe mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

→ të përfundojë përafrimin e legjislacionit të Kosovës me Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike, Direktivën e BE-së për Sigurinë e Rrjetit dhe Informacionit

(NIS2) dhe Paketën e Veglave të BE-së për sigurinë kibernetike 5G, dhe të rishikojë Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave në përputhje me Direktivën për Shërbimet Mediale Audiovizuale;

- të sigurojë që rregullatorëve të telekomit dhe mediave t'u jepen resurse të përshtatshme për t'i përmbushur mandatet e tyre në mënyrë të pavarur dhe për të zhvilluar një zgjidhje për financimin e qëndrueshëm të transmetuesit të shërbimit publik;
- të zbatojë portabilitetin e numrave për të siguruar përdorimin efektiv të burimeve të numeracionit dhe nxitjen e konkurrencës;

Në fushën e **komunikimeve elektronike dhe teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK)**, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2022, 97.9% e familjeve kishin qasje në internet (krahasuar me 96.1% në vitin 2021). Mbulimi me brez të gjerë të Kosovës tani është 100%. Në vitin 2022, përqindja e individëve që blejnë ose porosisin mallra dhe shërbime në internet (brenda tre muajve të fundit) ishte 51%, krahasuar me 23,1% në vitin 2021. Korniza legjislativë e Kosovës për reduktimin e kostos së brezit të gjerë është përafruar me *acquis* të BE-së dhe zbatimi po përparon, me përfundimin e atlasit të brezit të gjerë dhe pikës së vetme të informacionit. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për përafrimin me Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike për të garantuar lirinë e ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike. Kosova ende duhet të përfundojë procesin e hartimit të Koncept Dokumentit për Kodin e Komunikimeve Elektronike.

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare miratoi Planin e Lëshimit të Frekuencave, duke përfshirë të gjitha brezat frekuencor me vlerë të rëndësishme ekonomike. Në vjeshtën e vitit 2022, Kosova filloi pilotimin e qasjes 5G. Autoriteti Rregullator përfundoi procesin e caktimit të brezave 800MHz dhe 3.5GHz për të mundësuar vendosjen e teknologjisë 5G. Kosova ka miratuar rregulloren për bartshmërinë e numrave për abonentët e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike. Burimet ekzistuese të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare mbeten të kufizuara dhe joproporcionale me përgjegjësitë e tij.

Përafrimi me Aktet e Shërbimeve Digjitale dhe Aktin e Tregjeve Digjitale duhet të rritet, për të ofruar parashikueshmëri për komunitetin e biznesit.

Kosova ka arritur njëfarë progresi në fushën e **transformimit digjital**, pasi që ka miratuar Agjendën Digjitale 2030. Ligji për sigurinë kibernetike, i cili është pjesërisht i përafruar me Direktivën NIS, ishte miratuar më 2 shkurt 2023. Strategjia dhe plani i veprimit lidhur me Ligjin për sigurinë kibernetike duhet të miratohen. Kosova ka zhvilluar aftësitë themelore në sigurinë kibernetike; ajo duhet të shtojë përpjekjet për të siguruar mekanizmat e duhur operacional, kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore për të vepruar në mënyrë efektive në kontekstin e hapësirës kibernetike. Portali e-qeverisja është funksional: platforma ofron mbi 150 shërbime plotësisht të digjitalizuara. Kosova duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të finalizuar dhe miratuar Strategjinë për e-Qeverisje. Kosova duhet përafrohet me *acquis* të BE-së për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik. Kosova gjithashtu duhet të përafrohet me Kornizën Evropiane të Ndërveprueshmërisë dhe Aktin e Evropës Ndërvepruese.

Sa i përket **politikave audiovizuale**, ndryshimi i shumëpritur i Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media (KPM) është vonuar edhe më tej. Ky proces duhet të kryhet në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente, me konsultime kuptimplote me palët kryesore të interesit. KPM nuk arriti të bëjë ndonjë përparim në kalimin në sistemin digjital për t'u përafruar me standardet e BE-së. Aktualisht, KPM-së i burimet adekuate njerëzore dhe financiare për të

ushtruar kompetencat e veta në mënyrë të pavarur. Komisioni gjithashtu duhet të sigurojë se është transparent dhe gjithëpërfshirës në vendimmarrjen e tij, duke përfshirë konsultimin publik më të qëndrueshëm. Për shkak të mungesës së informacionit mbi pronësinë e mediave dhe shpërndarjen e fondeve për reklama, KPM nuk vendos sanksione efektive ndaj transmetuesve dhe nuk u ndërmorën ndërhyrje të rëndësishme përmbarimore. Ligji aktual për KPM-në ofron kompetenca të mjaftueshme rregullatore, zbatuese dhe monitoruese për të siguruar pluralizëm dhe konkurrencë në treg. Ndryshimi, aktualisht në proces, duhet të përafrojë më tej ligjin me Direktivën e Shërbimeve Mediale Audiovizuale për të shtrirë kompetencat e tij në mediat audiovizuale online.

Rishikimi i Ligjit aktual për Radiotelevizionin e Kosovës (RTK) ka filluar në vitin 2019, por procesi ka ngecur. Projektligji përfshin një model financimi për RTK-në, pavarësia editoriale e së cilës është e dobët, pasi ai ende mbështetet në financimin e drejtpërdrejtë të qeverisë, ku Kuvendi e përcakton buxhetin e tij çdo vit. Emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm të ri përmes një procesi të hapur dhe të bazuar në merita është një zhvillim pozitiv. Bordi duhet të sigurojë që në pozita drejtuese të emërohen individë të pavarur dhe profesionistë pa lidhje me partitë politike.

## Kapitulli 16: Tatimet

*Rregullat e BE-së për tatimin mbulojnë tatimin mbi vlerën e shtuar, akcizat dhe aspektet e tatimit të korporatave. Ato gjithashtu mbulojnë bashkëpunimin ndërmjet administratave tatimore, përfshirë shkëmbimin e informacionit për të parandaluar evazionin fiskal.*

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në fushën e tatimeve. Ajo ka arritur **njëfarë progresi** në zbatimin e inspektimeve tatimore të bazuara në rrezik në disa sektorë me rrezik të lartë dhe digjitalizimin e shërbimeve. Rritja e masave të pajtueshmërisë dhe formalizimit kanë çuar në rritjen e të ardhurave tatimore.

Rekomandimet në raportin e mëparshëm nuk janë adresuar plotësisht. Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

- të vazhdojë me përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit tatimor duke përfshirë tatimin në të ardhurat personale (TAP) dhe tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) me *acquis* të BE-së;
- të sigurojë zbatimin më sistematik të kontrolleve tatimore të bazuara në rrezik dhe të finalizojë strategjinë e re për luftimin e ekonomisë informale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit financiar (2023-2026);
- të rrisë bashkëpunimin me institucionet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore për të siguruar gjykimin në kohë të rasteve të evazionit fiskal dhe mashtrimit, me theks në sektorët me rrezik të lartë.

Është arritur progres i mirë gjatë periudhës në lidhje me **mbledhjen, zbatimin dhe respektimin e taksave**. Në periudhën qershor 2022 dhe prill 2023, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka mbledhur të hyra në vlerë prej 728.7 milionë euro, 16.7%, që janë më të larta se e njëjta periudhë e një viti më parë. Gjatë periudhës raportuese ATK gjithashtu ka rritur aktivitetet për të luftuar ekonominë joformale, duke rritur numrin e vizitave të përputhshmërisë, auditimeve dhe hetimeve të rasteve të dyshuara të evazionit fiskal. Këto aktivitete rezultuan në të ardhura shtesë prej 181.5 milionë euro për periudhën qershor 2022 - maj 2023, 17% më të larta se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Në lidhje me **tatimin indirekt**, sistemi i TVSH-së është gjerësisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Kosova zbaton një normë standarde prej 18% dhe një normë të reduktuar prej 8%. Ligji



për TVSH-në duhet ende të harmonizohet më tej me *acquis* të BE-së. Duhet të krijohet korniza ligjor dhe procedurat për zbatimin e tatimeve për tregtinë elektronike. Në lidhje me **tatimin direkt**, nuk është arritur progres në ndryshimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale, apo për të hequr dispozitat kontradiktore dhe për ta përafuar atë më tej me *acquis* BE-së.

Sa i përket **bashkëpunimit administrativ dhe ndihmës së ndërsjellë**, Kosova nuk ka qenë në gjendje t'i bashkohet kornizës gjithëpërfshirëse të OBZHE-së mbi bazën e erozionit dhe zhvendosjen e fitimit (BEPS) për shkak të çështjeve të statusit. Kosova ka traktate për tatim të dyfishtë në zbatim me 11 shtete anëtare të BE-së (Austri, Kroaci, Luksemburg, Hungari, Letoni, Maltë, Slloveni, Gjermani, Finlandë, Belgjikë dhe Irlandë).

Sa i përket **kapacitetit operacional dhe digjitalizimit**, Administrata Tatimore ka arritur progres në lidhje me cilësinë e shërbimeve, veçanërisht me përdorimin e shërbimeve elektronike. Kjo reflektohet edhe në Mjetin e Vlerësimit Diagnostik të Administratës Tatimore 2022 (vlerësimi TADAT). Në drejtim të thjeshtimit dhe përmirësimit të ofrimit të shërbimeve të saj, Administrata Tatimore duhet të forcojë më tej kapacitetet profesionale, veçanërisht në inspektimin/kontrollin tatimor dhe të përmirësojë efektivitetin e funksioneve të kontrollit tatimor. Administrata Tatimore është duke zbatuar Strategjinë e saj 2022-2026. Ajo planifikon të rrisë mbledhjen e të ardhurave; të forcojë pajtueshmërisë vullnetare; të forcojë qasjen dhe ekspertizën në menaxhimin e tatimpaguesve të mëdhenj; të ndërtojë sisteme dhe mjete moderne të TI-së; dhe të forcojë programin e inspektimit. Ka një pengesë të konsiderueshme lidhur me zhvillimin e sistemit të ri të TI-së për administratën tatimore. Administrata Tatimore ka intensifikuar veprimet e saj lidhur me përputhshmërinë tatimore sipas qasjes së bazuar në rrezik. Pavarësisht të hyrave më të larta të evidentuara nga proceset e kontrollit tatimor, Kosova duhet të forcojë zbatimin e qasjes të bazuar në rrezik. Cilësia e të dhënave dhe shkëmbimi i të dhënave nëpër agjenci të ndryshme për administrimin e tatimeve mbetet sfidë.

## **Kapitulli 17: Politikat ekonomike dhe monetare**

*Rregullat e BE-së kërkojnë pavarësinë e bankave qendrore dhe i ndalojnë ato të financojnë drejtpërdrejt sektorin publik. Shtetet anëtare koordinojnë politikat e tyre ekonomike dhe i nënshtrohen mbikëqyrjes fiskale, ekonomike dhe financiare.*

Kosova është **mesatarisht e përgatitur** në fushën e politikës ekonomike dhe monetare. Është arritur **njëfarë progresi** në mbledhjen dhe transmetimin e të dhënave në Eurostat, megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të adresuar mospërputhjet metodologjike në llogaritë kombëtare. Banka Qendrore është përballur me sfida në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të saj. Pas një periudhe zbrazëtie disa mujore, në korrik 2023, Kuvendi zgjodhi guvernatorin të ri. Kuvendi miratoi gjithashtu ligjin për pagën minimale, duke përjashtuar pensionet e veteranëve të luftës, në përpjekje për të siguruar pajtueshmërinë me kufirin ligjor të zbatueshëm për shpenzimet për pensionet e veteranëve të luftës.

Rekomandimet e vitit 2022 nuk janë adresuar plotësisht dhe për këtë arsye mbeten të vlefshme. Kosova në veçanti duhet:

- të forcojë qeverisjen e Bankës Qendrore duke përfunduar procedurën për zgjedhjen e Zëvendës Guvernatorëve të saj;
- të rrisë kapacitetet raportuese për statistikën financiare qeveritare sipas ESA 2010 dhe të sigurojë monitorimin e rregullt të standardeve;
- të përmirësojë cilësinë e parashikimeve makroekonomike në procesin buxhetor.

Kosova nuk ka **politikë monetare** të pavarur dhe nuk ka mjete standarde të politikës monetare në dispozicion, pasi që përdor euron si a mjet ligjor, duke lënë politikën fiskale si instrumentin

kryesor të politikës makroekonomike. Përdorimi i euros nga Kosova është plotësisht i ndryshëm nga anëtarësimi në eurozonë.

Banka Qendrore e Kosovës (BQK) është autoriteti i vetëm përgjegjës promovimin dhe ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar në Kosovë dhe për të kontribuar në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Ligji për Bankën Qendrore dhe Kushtetuta përcaktojnë pavarësinë e saj funksionale dhe institucionale, ua ndalojnë organeve të saj vendimmarrëse të japin dhe të marrin udhëzime nga autoritetet qeveritare. Ligji ndalon gjithashtu financimin monetar të sektorit publik dhe siguron që ky i fundit të mos ketë qasje të privilegjuar në institucionet financiare.

Banka Qendrore e Kosovës po përballët me sfida në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të saj. Mandati i Guvernatorit përfundoi në mars të vitit 2023 dhe pozita kishte mbetur e lirë derisa Kuvendi të emëroi guvernatorin e ri në korrik. Edhe pse u rekrutua staf i ri, Banka Qendrore duhet të sigurojë që funksionet e saj thelbësore, duke përfshirë mbikëqyrjen bankare dhe ruajtjen e stabilitetit financiar, të kenë staf adekuat. Bankës i duhet ende të zbatojë reforma në lidhje me strukturën e saj të qeverisjes korporative në mënyrë që të përmirësojë llogaridhënien e saj.

Sa i përket **politikës ekonomike**, Kosova duhet të përafrohet më tej me kërkesat e Direktivës së BE-së për kornizat buxhetore. Në korrik, Kuvendi miratoi ligjin për pagës minimale, duke përjashtuar nivelin e pensioneve të veteranëve të luftës nga paga minimale në përpjekje për të siguruar pajtueshmërinë me kufijtë ekzistues ligjorë të shpenzimeve. Edhe pse rregullat fiskale janë të përcaktuara mirë në legjislacion, kërkohen përpjekje të mëtejshme për të siguruar përputhjen e plotë të tyre.

Gjatë periudhës raportuese, **kapacitetet operacionale** të Ministrisë së Financave u përmirësuar. Në veçanti, është përmirësuar modelimi, planifikimi dhe parashikimi makro-fiskal, si dhe vlerësimi i ndikimit fiskal të politikave të reja dhe iniciativave legjislative të qeverisë. Kosova është në fazat e hershme të prezantimit të buxhetimit të bazuar në programe. Janë ndërmarrë disa hapa për të lidhur më mirë politikën afatmesme me procesin e planifikimit buxhetor. Megjithatë, nevojitet vullnet i fortë politik dhe bashkëpunim ndërinstitucional për të transformuar buxhetin në një mjet për planifikimin e politikave dhe për të forcuar kornizën buxhetore afatmesme.

Gjatë periudhës raportuese është arritur progres në afatin kohor dhe plotësinë e **të dhënave të llogarive kombëtare vjetore** të nxjerra sipas metodologjisë së Sistemit Evropian të Llogarive (ESA) 2010. Është arritur njëfarë progresi edhe në statistikave të deficitit dhe borxhit qeveritar, por puna e mëtejshme pritet të jetë në përputhje të plotë me metodologjinë e ESA 2010. Kosova duhet të bëjë përpjekje për të përmirësuar mbulimin dhe afatin kohor të tabelave të njoftimit të Procedurës së Deficitit të Tepërt (PDT) dhe të fillojë plotësimin e pyetësorit në lidhje me tabelat e PDT-së. Pasi tabelat për llogaritë tremujore financiare për qeverinë e përgjithshme iu transmetuan Eurostatit për herë të parë në vitin 2023, Kosova tani ofron grupin e plotë të tabelave aktualisht të kërkuara të Statistikave Financiare të Qeverisë (SFQ). Megjithatë, nevojiten ende përpjekje për të përmirësuar aspekte të ndryshme cilësore të tabelave.

**Programi i Reformës Ekonomike (PRE) 2023-2025** është dorëzuar më kohë. Ekziston një shkallë e konsiderueshme e pasigurisë rreth kornizës makroekonomike dhe fiskal të paraqitur në PRE. PRE parashikon një përshpejtim të fuqishëm të aktivitetit ekonomik në periudhën 2023-2025, që është mbi trendin historik. Një rikthim i fuqishëm i pritshëm në investimet publike shihet si një shtytës kryesor i rritjes, por për të realizuar këtë ambicie, pengesat për ekzekutimin e investimeve publike duhet të adresohen në mënyrë efektive. Ka rreziqe të tjera të konsiderueshme negative për këtë perspektivë, veçanërisht që ndërlidhën me çmimet më të larta se sa pritej të energjisë dhe ushqimeve pas luftës së agresionit të Rusisë kundër Ukrainës

dhe krizës së shkaktuar energjetike. Udhëzimi i politikave të vitit 2022 është zbatuar vetëm pjesërisht. Reformat strukturore të paraqitura në PRE pasqyrojnë planin e qeverisë për të adresuar pengesat ndaj konkurrencës dhe rritjes gjithëpërfshirëse në periudhën afatmesme. Megjithatë, zbatimi i masave strukturore shpesh është vonuar dhe përmirësimet nuk janë materializuar. Në mënyrë të ngjashme, nevojiten përpjekje shtesë për të përmirësuar parashikimet makro-fiskale që mbështesin buxhetin dhe lidhjen ndërmjet kornizës makro-fiskale dhe planifikimit të reformës strukturore.

## **Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësimi**

*Rregullat BE-së në fushën sociale përfshijnë standardet minimale për ligjin e punës, barazinë, shëndetin dhe sigurinë në punë dhe mosdiskriminimin. Ato gjithashtu promovojnë përfshirjen sociale dhe mbrojtjen sociale dhe dialogun social në nivel evropian.*

Kosova është në një **fazë të hershme të përgatitjes** në këtë fushë. Është arritur **njëfarë** progresi gjatë periudhës raportuese, veçanërisht në përgatitjet për zbatimin e Garancisë Rinore dhe në sigurimin e fondeve për shërbimet sociale dhe intensifikimin e inspektimeve në sektorët e punës me rrezikshmëri më të lartë. Megjithatë, shkalla e aksidenteve me fatalitet në punë mbetet e lartë.

Rekomandimet e vitit të kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe mbeten të vlefshme. Në periudhën e ardhshme, Kosova në veçanti duhet:

- të vazhdojë implementimin e Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore për t'u përgatitur për pilotimin e skemës; të miratojë ndryshimet në Ligjin e Punës për ta përafuar me *acquis* të fundit të BE-së, në veçanti në lidhje me mosdiskriminimin në punësim dhe pushimin prindërore;
- të vazhdojë intensifikimin e inspektimit në sektorët e punës me rrezikshmëri më të lartë, dhe të zbatojë rregullat për shëndetin dhe sigurinë në punë për të siguruar uljen e aksidenteve në vendin e punës;
- të vazhdojë me reforma të thella në fushën e skemave të ndihmës sociale për të garantuar shënjestrim dhe ndikim më të mirë dhe për të përmirësuar qasjen në shërbimet sociale, veçanërisht për fëmijët.

Kosova ka shtyrë ndryshimet në legjislacionin e **punës dhe shëndetin dhe sigurinë në punë**, të cilat janë të nevojshme për t'u përafuar më tej me *acquis* të BE-së, duke përfshirë edhe Direktivën e BE-së për balancën e jetës dhe punës. Ligji i vitit 2014 për sigurimin shëndetësor që parashikon të drejtën dhe detyrimin për të pasur të *paketë bazë* të detyrueshme të sigurimit shëndetësor për të gjithë qytetarët, nuk është zbatuar. Inspektorati i Punës ka intensifikuar inspektimet, por me ndikim të kufizuar në parandalimin e aksidenteve. Gjatë vitit 2022, janë shënuar 349 aksidente në punë, nga të cilat 15 kanë rezultuar me fatalitet. Inspektorati i Punës po rritet: në vitin 2022 janë rekrutuar 12 inspektorë të rinj. Inspektorati i Administratës Tatimore ndërmori veprime për zyrtarizimin e vendeve të punës dhe së bashku me Inspektoratin e Punës dhe Organizatën Ndërkombëtare të Punës, lansoi një fushatë për promovimin e të drejtave të punës.

Sa i përket **dialogut social**, dialogu trepalësh dhe dypalësh mbetet i kufizuar. Gjatë vitit 2022, Këshilli Ekonomiko-Social mandatoi Komisionin e tij për të negociuar Marrëveshjen e re të Përgjithshme Kolektive. Partnerët socialë kanë miratuar planin e punës për vitin 2022 dhe 2023. Më 14 qershor 2022, Kuvendi miratoi në lexim të parë rritjen e pagës minimale në 264 euro (nga 170 euro) në muaj, por miratimi përfundimtar është në pritje. Kapaciteti i partnerëve social mbetet i kufizuar.

Sa i përket **politikës së punësimit**, Kosova ka vazhduar hartimin e e strategjisë së re të punësimit dhe tregut të punës 2023-2028, politikën e re të punësimit 2022-2024, dhe një koncept dokument që rregullon fushën e punësimit. Strategjia e fundit sektoriale (2018-2020), ndonëse me objektiva modeste, pati një shkallë shumë të ulët zbatimi.

Norma e përgjithshme e aktivitetit qëndroi në 38.6% në vitin 2022, një rënie e lehtë krahasuar me 39.3% në vitin 2021. Normat e **papunësisë** në vitin 2022 ishin 12.6% (20.7% në vitin 2021). Normat janë më të larta te femrat, 16.5% (25% në vitin 2021), sesa te meshkujt, 11% (19% në vitin 2021). Treguesit që ende shkaktojnë më shumë shqetësime janë shkalla e lartë e pasivitetit, 61.4% (60.8% në vitin 2021) dhe papunësia e të rinjve 21.4% (38% në vitin 2021). Papunësia është edhe më e lartë (mbi 90%) në komunitetin rom dhe ashkali. Anëtarët e këtyre komuniteteve zakonisht punojnë në sektorin informal, duke mbajtur punë të pasigurta, me kualifikim të ulët dhe me status të ulët.

Papunësia e të rinjve mbetet e lartë (21.4% në vitin 2021), veçanërisht te femrat (27%). Presionet demografike, modeli i rritjes së papunësisë, prirja drejt emigrimit dhe arsimimi i dobët janë faktorët kyç në pozitën e pasigurt të të rinjve. Një publikim i fundit tregon se që nga viti 2018 ka pasur ndryshime të dukshme në kategoritë e të rinjve që nuk janë të përfshirë në punësim, arsim apo trajnim. Normat për ata me arsim fillor ishin nën 30%, normat e të rinjve me arsim të mesëm u rritën, me një ritëm të moderuar, në pak më shumë se 40%, ndërsa normat për të rinjtë me arsim universitar u rritën nga rreth 30% në mbi 50%. Kosova ka vazhduar përgatitjet për zbatimin **Garancisë Rinore**, në përputhje me planin e zbatimit të miratuar në nëntor të vitit 2022. Që nga viti 2023, autoritetet po punojnë për të siguruar kushte për pilotimin e Garancisë Rinore në dy komuna dhe për ndryshimin e legjislacionit përkatës, ristrukturimin e mekanizmave kyç të shërbimit (shërbimet publike të punësimit) dhe përsheptimin e disa reformave të vonuara në trajnimin e arsimit profesional.

Kosova po e ristrukturon **Agjencinë e Punësimit** në mënyrë që të realizohet plani i zbatimit të Garancisë Rinore. Procedurat menaxhuese dhe operacionale, si dhe menaxhimi i të dhënave janë ende të dobëta. Sistemi i informacionit të tregut të punës për të mbështetur hartimin e politikave dhe planifikimin e bazuar në fakte është i vjetruar dhe i mungon kapaciteti operacional në fushat kritike. Mungesa e burimeve njerëzore në shërbimet publike të punësimit është shqetësimi më i madh.

Nuk ka pasur zhvillime në lidhje me përgatitjet për **Fondin Social Evropian**. (*Shih Kapitullin 22 - Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore*). Në lidhje me **përfshirjen dhe mbrojtjen sociale**, shpenzimet e Kosovës për mbrojtje sociale arrijnë në 6% të BPV-së, por më pak se 0.5% e BPV-së ndahet për më të privuarit pasi pjesa më e madhe e shumës shpenzohet për pensionet e veteranëve të luftës. Më 4 prill 2023, Kuvendi ka ratifikuar një marrëveshje me Bankën Botërore për të kryer reforma të thella në sistemin e ndihmës sociale. Kosova nuk ka bërë progres në sigurimin e ndarjes së fondeve për shërbimet sociale. Projektligji për financat e pushtetit lokal nuk është pjesë e planit legjislativ të vitit 2023, duke ngritur shqetësime për qëndrueshmërinë e financimit të shërbimeve sociale. Për vitin 2023, fondi qeveritar i dedikuar për OJQ-të e licencuara për të ofruar shërbime sociale u rrit për 50% (nga 1 milion euro në 1.5 milion euro); kjo nuk adreson plotësisht situatën e financimit për ofrimin e shërbimeve sociale cilësore në nivel lokal. Komunitat duhet të bëjnë përpjekje për të përmirësuar planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve, mbledhjen e të dhënave dhe kujdesin e integruar. Kujdesi për të moshuarit mbetet çështje serioze. Rreth 18% e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë (me 45 euro në muaj, ku 5.1% për qind e popullsisë jeton nën kufirin e varfërisë ekstreme). Fëmijëve nga familjet e varfra dhe atyre me nevoja të veçanta, u mungon qasja e barabartë në shërbimet jetike dhe cilësore shëndetësore dhe arsimore. Fëmijët përfaqësojnë gjysmën e atyre që përfitojnë asistencë sociale, por më pak se 10% e tyre janë me

nevoja të veçanta. Fëmijëve me aftësi të kufizuara ju mungojnë shërbimet adekuate shëndetësore dhe rehabilituese, shërbimet sociale dhe pajisjet ndihmëse nga institucionet shtetërore. Shumica e tyre nuk kanë qasje të duhur në objektet arsimore. Rreth 9% e fëmijëve janë të përfshirë në punë, prej të cilëve 5.6% punojnë në kushte të rrezikshme, çështje kjo që është veçanërisht e dukshme në mesin e komunitetit rom dhe ashkali.

Kosova duhet të intensifikojë përpjekjet për të adresuar **diskriminimin ndaj grave në punësim dhe politika sociale**, veçanërisht gjatë procedurave të punësimit, avancimit dhe pagesës. Ndarja e pabarabartë e përgjegjësive të shfaqura në pushimin e lehonisë, pushimin prindëror ndërmjet grave dhe burrave pengon punësimin e grave. Gratë përballen me diskriminim edhe kur janë shtatzënë ose dëshirojnë të kenë fëmijë; prandaj është e rëndësishme që ndërprerja e periudhës së provuesë për shkak të shtatzënisë të trajtohet si diskriminim i drejtpërdrejtë. Nevojiten trajnime si për inspektorët e punës ashtu edhe për gjyqtarët për të trajtuar më mirë çështjen e diskriminimit me bazë gjinore. Në vitin 2022, shkalla e papunësisë për popullsinë e moshës 15-64 vjeçare ishte 18.4% për gratë dhe 49.4% për burrat, duke rezultuar në një hendek shumë të lartë në punësimin gjinor prej 31 pikë përqindjeje. Qasja e kufizuar në kujdesin ndaj fëmijëve dhe marrëveshjet fleksibile të punës, si dhe rregulloret që dekurajojnë rekrutimin e grave mbeten barriera të rëndësishme. Sfidat tjera me të cilat përballen gratë, veçanërisht në zonat rurale, janë mungesa e kujdesit për të moshuarit, diskriminimi në qasjen në pronë dhe dhuna me bazë gjinore.

## **Kapitulli 20: Politika e ndërmarrjeve dhe ajo industriale**

*Politika industriale e Be-së forcon konkurrencën, lehtëson ndryshimin strukturor dhe inkurajon një mjedis të përshtatshëm ndaj bizneseve që stimulon ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të).*

Kosova është **mesatarisht e përgatitur** në fushën e politikës ekonomike dhe monetare. Ka arritur **progres të mirë**, pasi që qeveria ka miratuar Strategjinë për zhvillim industrial dhe mbështetje të biznesit 2030, e para e këtij lloji. Kuvendi miratoi në lexim të parë Ligjin për investime të qëndrueshme dhe Ligjin për parqet teknologjike dhe industriale. Ligjet parashikojnë themelimin e dy agjencive të reja të dedikuara për investimet dhe nxitjen e eksportit dhe mbështetjen e biznesit dhe ndërmarrësisë. Performanca operationale e Agjencisë ekzistuese për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) gjithashtu u përmirësua gjatë periudhës. .

Rekomandimet e vitit të kaluar janë zbatuar vetëm pjesërisht dhe mbeten të vlefshme. Në periudhën e ardhshme, Kosova në veçanti duhet:

- të implementojë strategjinë për zhvillim industrial dhe mbështetjen e biznesit dhe shtyllën e rritjes së qëndrueshme ekonomike të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2021-2030;
- të përmirësojë kapacitetet e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT);
- të përfundojë ristrukturimin e Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) në agjenci të veçanta të promovim të investimeve dhe mbështetje të NVM-ve, si dhe të siguroj që të dyja të kenë burime të mjaftueshme.

Për sa i përket **politikës së ndërmarrjeve dhe asaj industriale**, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka përgatitur një strategji ambicioze për zhvillimin e industrisë dhe mbështetjen e biznesit 2030. Ajo synon të përmirësojë mjedisin e biznesit në Kosovë, të promovojë zhvillimin industrial, të adresojë deficitin tregtar, të krijojë vende pune, si dhe të sigurojë efikasitet të burimeve dhe një ekonomi më rrethore. Ministria ka përgatitur një analizë gjithëpërfshirëse të nënsektorëve kryesorë në sektorin e prodhimit për t'i përdorur

në përmirësimin e politikave dhe veprimeve të saj. Në funksion të zgjerimit të energjisë solare në politikën e emetimeve të karbonit, janë planifikuar stimuj për përdorimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme në industri; miratimi i tyre pritet në vitin 2023.

Kuvendi ka miratuar në lexim të parë dy ligje për nxitjen e investimeve dhe nxitjen e zhvillimit të sektorit privat: Ligjin për Parqet Teknologjike dhe Industriale dhe Ligjin për Investime të Qëndrueshme. Ky i fundit parashikon ristrukturimin e Agjencisë ekzistuese për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) në një Agjenci për Përkrahjen e Ndërmarrjeve në kuadër të MINT-it, dhe të Agjenci për Investime dhe Eksport (AIE) në kompetencë të Zyrës së Kryeministrit. Me përcaktim të qartë të përgjegjësive, të dy agjencitë mund të jenë më efikase në ofrimin e mbështetjes për ndërmarrjet aktive dhe tërheqjen e investitorëve të rinj. KIESA është përballur prej kohësh me kapacitete të kufizuara për të zbatuar mandatin e saj të gjerë. Pavarësisht kësaj, KIESA ka përmirësuar fuqishëm performancën e saj në vitin 2022, duke rritur investimet e huaja direkte (IHD) për 43.6% gjatë periudhës janar-shtator 2022 dhe duke rritur pjesëmarrjen e firmave kosovare në panairët ndërkombëtare.

Një koncept dokument për ndërmarrjet publike i miratuar në vitin 2023 parasheh rishikimin e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe legjislacionin zbatues. Ministria e Ekonomisë ka iniciuar ndryshime të politikave që mbulojnë ndërmarrjet publike për t'u përafuar me legjislacionin e ri për Fondin Sovran. Në qershor 2023, qeveria miratoi Ligjin për Fondin Sovran.

Në zonën e **instrumenteve të politikave**, KIESA organizoi një numër të madh aktivitetesh pavarësisht mangësive të kapaciteteve. Agjencia kishte vështirësi në përmbushjen e objektivave të saj, në veçanti për të mundësuar zbatimin e shërbimeve dhe programeve para dhe pas kujdesit dhe promovimin e lidhjeve ndërmjet ndërmarrjeve shumëkombëshe dhe NVM-ve.

Kosova nuk ka një proces të rregulluar për të trajtuar **ankesat dhe ruajtjen e investimeve** të investitorëve. Një proces i tillë në dispozicion do të zbatonte parimet e mekanizmit të reagimit të investimeve sistematike, siç propozohet nga Banka Botërore. Rrjedha e fragmentuar dhe joefikase e informacionit ndërmjet institucioneve shtetërore mbetet sfidë, e cila nga ana tjetër paraqet pengesa për NVM-të për t'u qasur në shërbimet e disponueshme të përkrahjes së biznesit dhe për të marrë leje dhe licenca. Kur aplikojnë për mbështetje të qeverisë, NVM-ve u kërkohet të paraqesin dokumente dhe informacione të tepërta, gjë që zgjat kohën e aplikimit.

Ligji për përcaktimin e kornizës ligjore për Gjykatën Komerciale u miratua në shkurt të vitit 2022 dhe gjykata u bë plotësisht funksionale dhe filloi shqyrtimin e çështjeve në gusht të vitit 2022. Edhe pse që nga viti 2022 legjislacioni për investimet e huaja përfshin trajtim të barabartë të shtetasve dhe ndërmarrjeve vendore dhe të huaja, shtetasit dhe ndërmarrje e huaja ende hasin sfida në praktikë, për shembull gjatë regjistrimit të të drejtave pronësore.

Kosova ka rritur ndjeshëm numrin e shërbimeve në dispozicion në platformën e saj të qeverisjes elektronike dhe ka filluar përgatitjet për të thjeshtuar dhe digjitalizuar lejet dhe licencat në platformën e qeverisjes elektronike. Procedurat e licencimit të biznesit janë të qarta dhe të centralizuara. Kosova vazhdon reformat për të ulur barrën administrative për bizneset. Punëtorët e vetëpunësuar përballen me barrë të ulët tatimore dhe NVM-të e inkorporuara përfitojnë nga stimujt e tatimit mbi të ardhurat korporative. Thjeshtimi i administratës tatimore dhe zhvillimi i shërbimeve digjitale kanë ulur kostot e pajtueshmërisë tatimore për NVM-të.

Mungesa e kredisë lehtësisht të qasshme dhe të përballueshme shërben si pengesë për zhvillimin e NVM-ve. Përveç kësaj, NVM-të dhe korporatat vuajnë nga kapaciteti i ulët për të përgatitur projekte të besueshme për shkak të informalitetit në praktikën e kontabilitetit, qeverisjes së dobët korporative dhe cilësisë së menaxhimit, përveç çështjeve të integritetit. Deri në vitin 2022, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) ishte zgjeruar dhe tani mundëson

kredi në vlerë prej 270 milionë euro për 8 871 ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në sektorët e prodhimit, shërbimeve, bujqësisë dhe tregtisë, përfshirë firmat fillestare dhe bizneset në pronësi të femrave. Më 11 maj 2023, Kosova nënshkroi Marrëveshjen e Asociimit për pjesëmarrje në “Programin e Tregut Unik” (PTU) të BE-së.

## **Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimet shkencore**

*BE-ja ofron mbështetje të konsiderueshme për kërkimin dhe inovacionin. Të gjitha shtetet anëtare mund të marrin pjesë në programet e kërkimit dhe inovacionit të BE-së dhe të përfitojnë prej tyre, veçanërisht kur ka ekselencë shkencore dhe investime solide në kërkimin dhe inovacionin.*

Kosova është në **fazën e hershme të përgatitjes** në fushën e shkencës dhe kërkimit. Është arritur **njëfarë progresi** gjatë periudhës raportuese: Kosova ka përmirësuar ndjeshëm performancën e saj në programin kornizë të BE-së për kërkim dhe inovacion.

Pasi që rekomandimet e raportit të mëparshëm nuk ishin adresuar plotësisht, Kosova duhet në veçanti:

- të zbatojë plotësisht programin kombëtar të shkencës, duke përfshirë prioritizimin dhe promovimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit, sigurimin e shpenzimeve më të larta për kërkim dhe inovacion, dhe përpjekjen për të stimuluar investimet nga sektori privat duke zhvilluar strategjinë e specializimit inteligjent;
- të vazhdojë përpjekjet për rritjen e pjesëmarrjes në programin e BE-së Horizonti;
- të përdorë sistemin aktual të informacionit kërkimor të sapokrijuar për të ofruar të dhëna të besueshme për numrin e studiuësve, përqindjen e BPV-së të shpenzuar për kërkim dhe inovacion, dhe për performancën në lidhje me prioritetet e Zonës Evropiane të Kërkimit.

Pavarësisht njëfarë progresi në politikën e **kërkimit dhe inovacionit**, Kosovës i mungon një qasje strategjike për zhvillimin, prioritizimin dhe promovimin e aktiviteteve kërkimore. Ka pasur njëfarë progresi në këtë drejtim pasi që Këshilli Kombëtar i Shkencës zhvilloi programin kombëtar të shkencës si dokument kryesor strategjik për shkencë dhe kërkim. Ai identifikon fushat me prioritet për zhvillim ekonomik dhe social për periudhën e ardhshme gjashtëvjeçare. Përveç kësaj, ai përfshin modele të reja financimi dhe krijimin e një fondi për inovacione.

**Strategji e specializimit inteligjent** duhet të zhvillohet me prioritet. Sistemi aktual i informacionit kërkimor është zhvilluar dhe duhet të vihet në përdorim. Ai mbledh sistematikisht të dhëna kërkimore, shkencore dhe inovative, të cilat duhet të përdoren për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në prova. Grumbullimi i kompetencave për shkencën, arsimin, teknologjinë dhe inovacionin në një ministri të vetme është një zhvillim i mirëpritur. Kjo duhet të mbështesë kapacitetet koordinuese dhe administrative për të planifikuar, zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar politikat e kërkimit dhe inovacionit.

Sektori i kërkimit dhe inovacionit është pothuajse krejtësisht i pafinancuar, ku shpenzimet publike për kërkim arrijnë në vetëm 0.1% të BPV-së, pavarësisht objektivit prej 0.7% të BPV-së të paraparë me ligj. Financimi i kërkimit shkencor përmes ndarjes së buxhetit për institucionet e arsimit të lartë është i paqartë pasi që buxheti për kërkimin shkencor dhe inovacionin nuk është i ndarë nga buxheti për universitetet. Cilësia e programeve të përgatitjes së studentëve pasuniversitar në karrierë kërkimore mbetet e pakënaqshme. Financimi i masave mbështetëse të inovacionit nevojitet urgjentisht për të mbështetur rimëkëmbjen ekonomike. Kosova inkurajohet të shfrytëzojë mundësitë e vëna në dispozicion nga Instituti Evropian i Inovacionit dhe Teknologjisë.

Kosova për herë të parë u bë pjesë e plotë e programit **Horizon Europe** në vitin 2021. Pas një fillimi të ngadaltë, shifrat paraprake për vitin 2022 tregojnë një rritje të konsiderueshme të performancës nga komuniteti i kërkimit dhe inovacionit, ku pesë projekte kanë marrë fonde të përgjithshme nga BE-ja në vlerën prej 0.8 milionë euro.

## Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura

*BE-ja mbështet bashkëpunimin në arsim dhe kulturë përmes programeve të financimit dhe koordinimit të politikave të shteteve anëtare përmes metodës së hapur të koordinimit'. BE-ja dhe shtetet anëtare duhet gjithashtu të parandalojnë diskriminimin dhe të sigurojnë arsim cilësor për fëmijët e punëtorëve migrantë, duke përfshirë ata me prejardhje të pafavorshme.*

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në fushën e arsimit dhe kulturës. Gjatë periudhës raportuese është arritur **njëfarë progresi**, veçanërisht me anëtarësimin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim në Asociacionin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, dhe me miratimin e Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditimi dhe Ligjit për edukimin në fëmijërinë e hershme. Megjithatë, cilësia e arsimit ka ende nevojë për përmirësim në aspektin e kualifikimeve dhe aftësimin të mësimdhënësve dhe rezultateve të të nxënësve. Kuvendi duhet të miratojë legjislacionin kyç për arsimin e lartë.

Meqenëse rekomandimet e vitit të kaluar janë zbatuar vetëm pjesërisht, Kosova duhet në veçanti:

- të hartojë një udhërrëfyes për zbatimin e reformave kyçe të sistemit arsimor, duke përfshirë rekomandimet në kuadër të Diagnostifikimit të Arsimit të Shpejtë të ETF-së;
- të finalizojë implementimin e kornizës së re kurrikulare për arsimin bazë, të bëjë rishikimin e teksteve ekzistuese dhe të ofrojë trajnime të qëndrueshme për mësimdhënësit; të zbatojë sistematikisht mekanizmat e sigurimit të cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit;
- të përmirësojë qeverisjen e AAP-së dhe të rrisë cilësinë e arsimit dhe aftësimin profesional për profesionet e kërkuara në funksion të Garancisë Rinore.

Shpenzimet publike të Kosovës për arsim në vitin 2022 qëndruan në 4.1% të BPV-së (13,3% e buxhetit të përgjithshëm). Edhe pse shuma si përqindje e BPV-së është e krahasueshme me vendet e BE-së, ajo është dukshëm më e ulët për **shpenzime për kokë banori**. Prandaj, Kosova duhet të rrisë fondet për studentët *për kokë banori* dhe për investime në arsim cilësor. Formula e financimit e përdorur për ndarjen e buxhetit parauniversitar për çdo komunë është në rishikim, pasi që ajo aktuale nuk është mjaft e saktë. Gjatë vitit 2022, pothuajse dy të tretat e shkollave në zonat rurale (63%) kanë funksionuar me ndërrime të shumëfishta. Si pasojë, nxënësit marrin nuk ndjekin numrin e mjaftueshëm të orëve mësimore.

Në vitet e fundit, Kosova ka arritur progres të konsiderueshëm në **rritjen e qasjes në arsimin parafillor dhe fillor**. Gjithsesi duhet të bëjë më shumë për të rritur në mënyrë të barabartë mbulimin e arsimit parashkollor dhe të mesëm. Në vitin shkollor 2021/2022, arsimin fillor dhe të mesëm të ulët e kanë vijuar 224 429 nxënës: një rënie prej 18% krahasuar me 273 649 nxënës në vitin 2014/2015. Mesatarisht, normat (bruto) të regjistrimit në arsimin fillor dhe të mesëm janë shumë të ngjashme me ato në rajon dhe relativisht të larta: 88.1% e fëmijëve ndjekin arsimin parafillor por jo më shumë se 2 deri në 2.5 orë në ditë në institucionet publike. Në institucionet private, kohëzgjatja është 7 deri në 8 orë në ditë. Në vitin 2020/2021, shkalla e përfshirjes në arsimin fillor ishte 101.2%. Pjesëmarrja e fëmijëve në arsimin dhe kujdesin parashkollor mbetet e ulët, në 6.7%, shumë nën mesataren në rajon dhe mesataren e OBZHE-së (mbi 36%). Vetëm 46.2% e fëmijëve parashkollorë janë vajza, ndërsa numri i fëmijëve romë,



ashkali dhe egjiptianë të përfshirë në sistemin e edukimit në fëmijëri të hershme është i ulët. Ligji i ri për arsimin parashkollor është miratuar nga Kuvendi më 10 korrik 2023; është duke u zhvilluar kurrikula fillore për edukimin në fëmijëri të hershme. Shkalla e regjistrimit bruto në arsimin e lartë vazhdon të ulët dhe aktualisht është 49.4%, pothuajse 30% më e ulët se pesë vite më parë, por nivelet e ulëta të diplomimit mbeten shqetësuese.

Kosova miratoi strategjia e arsimit 2022-2026, e cila përfshin planet për digjitalizimin e shkollave, duke u fokusuar në mësimin digjital, platformat, përmbajtjen, përmirësimin dhe mbështetjen e mësimdhënësve, lidhjen, pajisjet dhe mbështetjen institucionale. Për implementim të suksesshëm, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHTI) duhet të sigurojë burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare. Ristrukturimi i MASHTIT është ende në pritje. Ristrukturimi i MASHTIT është ende në pritje.

**Cilësia e arsimit** mbetet e dobët, siç dëshmohet nga dy vlerësimet e fundit të OBZHE-së për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA), ku Kosova renditet e e dyta përkatësisht e treta nga fundi. Kosova mori pjesë në Trendët në Studimin Ndërkombëtar të Matematikës dhe Shkencës 2019 (TIMSS), dhe në Studimin e Progresit Ndërkombëtar për Lexim 2021 (PIRLS) dhe PISA 2022. Në TIMSS 2019, Kosova ishte në mesin e dhjetë shteteve me rezultatet më të dobëta. Megjithatë, Kosova i është bashkuar ICILS 2023 (Studimi Ndërkombëtar për Njohuritë në TIK) i cili mund të ndihmojë në monitorimin e synimeve në lidhje me kompetencat digjitale të nxënësve dhe gjithashtu të monitorojë progresin drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së.

Kosova po merr pjesë në grupet punuese të Zonës Evropiane të Arsimit 2021-2025. Këto grupe punuese nxisin bashkëpunimin ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe me vendet kandidatë, me qëllim që të ndërtojnë sisteme kombëtare arsimore dhe trajnuese më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe të përgatisin të rinjtë e tyre për tranzicionin e gjelbër dhe digjital.

Reformat po ngecin për shkak të mungesës së teksteve të përshtatshme, materialeve mësimore dhe skemave të zhvillimit të qëndrueshëm profesional për mësimdhënësve. Një çështje tjetër është mospërputhja mes rezultatit të arsimit dhe kërkesave për shkathtësi. Ligji për inspektoratin e arsimit nuk zbatohet siç duhet për shkak të numrit të pamjaftueshëm të inspektorëve.

Institucionet e **arsimi i lartë** (IAL) duhet të investojnë më shumë në zbatimin e dokumenteve të tyre strategjike dhe planeve të veprimit. Integriteti akademik mbetet problem. Ministria ka miratuar një vendim për përputhshmërinë e punimeve shkencore dhe publikimeve të personelit akademik me etikën në kërkimin shkencor, duke i detyruar mbajtësit e programeve të ngarkojnë kërkimet e tyre në platforma të indeksuara para akreditimit të programeve të tyre. Ajo gjithashtu ka zhvilluar platformën e re të Sistemit Informativ i Kosovës për Kërkime Shkencore (KRIS) që kërkon regjistrimin e të gjithë hulumtuesve. Gjatë periudhës raportuese, MASHTI ka hartuar udhërrëfyesin për financimin e bazuar në performancë të IAL-ve publike. Të gjitha IAL-të publike janë në përputhje të plotë me standardet e akreditimit. Përveç Universitetit të Prishtinës, të gjitha universitetet publike varen financiarisht nga buxheti i shtetit. Kosova duhet të miratojë ligjin e ri për arsimin e lartë që do të forconte autonominë dhe integritetin akademik të institucioneve të arsimit të lartë dhe do të përmirësonte sigurimin e cilësisë. Problem mbetet përfshirja e kufizuar e studentëve në proceset vendimmarrëse në nivel universitar. Strategjia e sapomiruar për arsimin e Kosovës 2022-2026 pritet të adresojë çështjet e lartpërmendura. Në vitin 2022, Agjencia e Kosovës për Akreditimi (AKA) u bë anëtare e asociuar e Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Kosova ka miratuar Ligjin për Agjencinë për Akreditim, që synon të rrisë pavarësinë e saj operative dhe transparencën e emërimeve të drejtuesve të AKA-së.

Më shumë se gjysma e nxënësve të shkollave të mesme të larta regjistrohen në shkolla për **arsim dhe aftësim profesional** (AAP). Statistikat për vitin akademik 2022/2023 tregojnë se nga 67 373 nxënës të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë, 35 568 nxënës janë të regjistruar në shkollat e arsimit profesional, krahasuar me 31 805 nxënës të regjistruar në gjimnaze. Profilet e AAP-së të ofruara nga shkollat profesionale nuk bazohen në standarde profesionale, dhe shpesh nuk janë të përshtatura mirë me kërkesat e tregut të punës. Financimi për arsimin profesional nuk është rritur gjatë viteve të fundit. Vetëm 9.6% e buxhetit të përgjithshëm të arsimit ndahet për AAP.

**Të mësuarit e bazuar në punë**, i integruar në kurrikulën aktuale të AAP-së, nuk ofrohet sistematikisht. Kurrikulat e përdorura aktualisht të bazuara në lëndë nuk janë të orientuara drejt zhvillimit të shkathtësive profesionale. Në përgjithësi shkollave u mungojnë kushtet, shkathtësitë e mësimdhënësve, pajisjet, materialet dhe bashkëpunimi i strukturuar me bizneset për të zhvilluar shkathtësitë praktike të nxënësve. Gjatë periudhës raportuese, Kosova miratoi planin e zbatimit të Garancisë Rinore, duke e bërë edhe më urgjente prezantimin e reformave të nevojshme në AAP. Ai përfshin si masat parandaluese për ta bërë arsimin dhe AAP-në më të rëndësishme ashtu edhe masat për të zgjeruar ofertat për të rinjtë që nuk janë të përfshirë në punësim, arsim apo trajnim (NEET).

Kosova duhet të **rrisë qasjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsim**. Vlerësohet se 38 000 fëmijë me aftësi të kufizuara nuk ndjekin shkollën. Problemet kryesore përfshijnë mungesën e përkufizimeve të përshtatshme të formave të ndryshme të aftësisë së kufizuar, qasjen pa pengesa në shkolla dhe mbështetjen e duhur, dhe numrin e ulët të mësimdhënësve dhe asistentëve të kualifikuar. Pavarësisht zhvillimeve pozitive me vendimin e qeverisë për rritjen e numrit të asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta në 100 në vit, të paktën deri në vitin 2024, cilësia e arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara është e ulët. Shkalla e braktisjes së shkollës mbetet më e lartë në mesin e fëmijëve rom dhe ashkali, megjithëse statistikat nuk janë të besueshme. Gjatë periudhës raportuese, janë organizuar trajnime për arsimin gjithëpërfshirës, të drejtat e njeriut dhe të pakicave dhe për politikën dhe kornizën ligjore përkatëse të Kosovës për 25 zyrtarë komunalë (14 gra dhe 11 burra) nga 22 komuna.

Në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, Fondacioni Evropian i Trajnimeve ka kryer një diagnozë të arsimit të shpejtë të bazuar në prova të tërë sistemit arsimor duke adresuar tri fusha kryesore tematike: pabarazinë, financimin dhe qeverisjen. Analiza kishte për qëllim të identifikonte çështjet kryesore dhe veprimet për të përmirësuar cilësinë dhe ofrimin e shërbimeve arsimore në përgjithësi. Fondacioni ka hartuar një sërë rekomandimesh që autoritetet e Kosovës t'i marrin në konsideratë. Këto rekomandime përfshijnë: (i) ngritjen e mekanizmave të duhur të monitorimit dhe vlerësimit; (ii) përmirësimin e bashkëpunimit ndërministror; (iii) ngritjen e kapaciteteve institucionale, veçanërisht për menaxhim financiar; dhe (iv) përcaktimin e prioriteteve në Strategjinë e Arsimit.

Kosova përfiton nga dimensionin ndërkombëtar in programit **Erasmus+** 2021-2027. Në vitin 2022, rreth 480 anëtarë të stafit të arsimit të lartë dhe 650 studentë nga Kosova u përzgjedhën për të ndërmarrë një periudhë mobiliteti në shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e treta të ndërlidhura me programin, ndërsa institucionet e arsimit të lartë të Kosovës pritjet të presin 375 anëtarë të stafit dhe 225 studentë nga Evropa.

Sa i përket kulturës, Kosova duhet të vazhdojë përpjekjet për të përmbushur standardet e Konventës së UNESCO-s të vitit 2005 për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore. Nuk ka pasur progres në hartimin e ligjit për trashëgiminë kulturore, duke reflektuar zotimet e tij sipas Shtojcës V të Planit të Ahtisaarit. Këshilli Zbatues dhe Monitorues duhet të rifillojë takimet dhe të identifikojë zgjidhjet e përbashkëta që duhet të arrihen ndërmjet Kosovës dhe Kishës Ortodokse Serbe.

Ministria e **Kulturës**, Rinisë dhe Sportit (MKRS) ka përgjegjësinë për përgatitjen dhe zbatimin e politikave publike, hartimin e akteve ligjore dhe miratimin e legjislacionit zbatues në fushën e kulturës, rinisë, sportit, të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta. MKRS është në një fazë të hershme për të zhvilluar strategjinë kulturore. MKRS duhet të shtojë përpjekjet e saj për përmirësimin e statusit të komunitetit artistik, qeverisjen dhe çështjet buxhetore të institucioneve publike kulturore. Gjatë periudhës raportuese, Ministria ka ndarë 500 000 euro për ndërtimin e Qendrës Kulturore Hebraike që do të shërbejë për organizimin e ekspozitave lidhur me historinë e komunitetit hebre. MKRS mund të rrisë përkushtimin e saj drejt zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve teknike në aftësitë specifike të trashëgimisë kulturore duke siguruar arsimim të mëtutjeshëm të studentëve në këtë fushë dhe duke ofruar trajnime profesionale.

Kosova aktualisht merr pjesë në programin Creative Europe. Nevojiten më shumë përpjekje për të rritur numrin e përfituesve të kulturës në thirrjet në lidhje me kulturën me partnerët evropianë. Kosova ende duhet të shtojë përpjekjet për të përafëruar legjislacionin e saj afatshkurtër me Direktivën e BE-së për Shërbimet Mediale Audiovizuale, në mënyrë që të marrë pjesë edhe në rrjetin e MEDIA-s.

## **Kapitulli 29: Unioni Doganor**

*Të gjithë shtetet anëtare janë pjesë e unionit doganor të BE-së dhe ndjekin të njëjtat rregulla dhe procedura doganore. Kjo kërkon harmonizim legjislativ, kapacitet adekuat implementues dhe zbatues si dhe qasje në sistemet e përbashkëta të kompjuterizuara doganore.*

Kosova është **mesatarisht e përgatitur** në fushën e doganave. Gjatë periudhës raportuese, ka arritur **njëfarë progresi** pasi që ka tarifatat e vendosura për eksportuesit/importuesit në терминаlet doganore të brendshme, ka hapur një zyrë doganore në Portin e Durrësit (Shqipëri) ka rritur numrin e operatorëve të autorizuar ekonomikë dhe ka zbatuar masat doganore, për shembull për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale (DPI). Dogana e Kosovës ka vazhduar luftën kundër narkotikëve dhe aktiviteteve tjera të kontrabandimit. Pasi që jo të gjitha rekomandimet nga raporti i kaluar janë adresuar, në vitin e ardhshëm, Kosova duhet në veçanti:

- të vazhdojë me përafrimin e mëtejshëm me Kodin Doganor të Bashkimit dhe *acquis* për akcizën, duke përfshirë miratimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave;
- Dogana e Kosovës duhet të forcojë kapacitetin e saj administrativ dhe profesional dhe të sigurojë që të zbatohen proceset e transferimeve dhe përzgjedhjes të bazuara në merita dhe transparencë.
- të heq të gjitha tarifave që u ngarkohen eksportuesve/importuesve në терминаlet doganore publike dhe private të brendshme.

Në fushën e **legjislacionit doganor**, Kodi i Doganave dhe i Akcizave i sapo hartuar, i cili është në përputhje me Kodin Doganor të Bashkimit, mbetet ende për t'u miratuar nga qeveria.

Për shkak të çështjeve të njohjes, nuk është arritur progres në aplikimin e Kosovës për t'u bërë vëzhguese sipas Konventës të Transitit të Përbashkët. Sa i përket rregullave të origjinës, Kosova vazhdon të zbatojë Konventën Pan-Euro Mesdhetare (PEM). Kapaciteti i Doganës së Kosovës vazhdon të shkëmbejë sistematikisht të dhëna për lëvizjen ndërkufitare të mallrave ndërmjet ekonomive të Ballkanit Perëndimor. Kosova po merr pjesë në programin e BE-së për 'Doganat' për bashkëpunim në fushën e doganave.

**Legjislacioni** për masat doganore që rregullon të drejtat e pronësisë intelektuale (DPI) dhe kontrollet e eksportit për mallrat kulturore është në përputhje me *acquis* të BE-së.

Dogana e Kosovës ka vazhduar të arrijë progres të mirë në **lehtësimin e tregtisë**. Dogana e Kosovës ka dhënë edhe pesë certifikata shtesë për operatorët ekonomikë të autorizuar, duke e çuar numrin e përgjithshëm në dhjetë operatorë të autorizuar ekonomik.

Ka njëfarë progresi në lidhje me uljen e tarifave për eksportuesit/importuesit **terminalët e brendshme doganore**. Tarifat e importit janë hequr tërësisht në terminalin doganor të Pejës, ndërsa terminali i Trepçës aplikon tarifa të reduktuara. Të gjitha terminalët e tjera doganore aplikojnë tarifa të plota.

Dogana e Kosovës duhet të forcojë kapacitetin e saj **administrativ dhe operacional**, duke siguruar që të zbatohen proceset e transferimeve dhe përzgjedhjes të bazuara në merita dhe transparencë. Në këtë drejtim, ajo duhet të përditësojë legjislacionin e saj sekondar për përshkrimet vendeve të punës. Dogana e Kosovës duhet të vazhdojë të zbatojë planin e saj strategjik afatmesëm (2019-2023).

Gjatë periudhës raportuese, Dogana e Kosovës së bashku me Policinë e Kosovës kanë zbuluar dhe konfiskuar sasi të konsiderueshme të narkotikëve në vlerë prej disa milionë eurove. Dogana e Kosovës ka kryer 42 inspektime në terren. Dogana e Kosovës, autoritetet e tjera të zbatimit të ligjit dhe institucionet e linjës bashkëpunojnë mirë për të luftuar ekonominë informale dhe mashtrimin doganor.

Dogana e Kosovës ka iniciuar tri raste që përfshijnë katër doganierë të dyshuar për korrupsion, prej të cilëve 12 zyrtarë janë shkarkuar dhe një është arrestuar. Korniza ligjore për hetimin e kontrolleve të deklaratave të pasurisë të plotësuara nga zyrtarët doganorë ende nuk është zhvilluar.

#### **GRUPIMI 4: AGJENDA E GJELBËR DHE LIDHJA E QËNDRUESHME**

Ky grup përfshin: transportin (Kapitulli 14); energjinë (Kapitulli 15); rrjetet trans-evropiane (Kapitulli 21); dhe mjedisin dhe ndryshimet klimatike (Kapitulli 27).

Kosova është në një fazë të hershme ose ka njëfarë niveli të përgatitjes në fushat që kanë të bëjnë me Agjendën e Gjellbër dhe lidhjen e qëndrueshme. Kosova vazhdon të marrë pjesë aktivisht në takimet e Komunitetit të Transportit dhe Komunitetit të Energjisë. Gjatë periudhës raportuese, është arritur njëfarë progresi në sektorin e energjisë. Kosova ka miratuar një strategji ambicioze për energji, e cila përfshin një rritje të pjesëmarrjes në burimet e energjisë së ripërtëritshme, dhe ka lansuar ankandin e parë solar. Kosova mbetet shumë e varur nga thëngjilli. Në sektorin e transportit është arritur progres i kufizuar me miratimin e strategjisë së transportit multimodal, ndërsa progres i kufizuar është arritur në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike.

Kosova duhet të rrisë ndjeshëm ambiciet e saj dhe kapacitetet administrative për të zbatuar siç duhet standardet e BE-së për transport, energji dhe mjedis. Strategjitë, planet e veprimit dhe legjislacioni në këta sektorë duhet të jenë më konsistente dhe në përputhje me parimet dhe objektivat e Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor dhe me Planin Ekonomik dhe Investimeve.

#### **Kapitulli 14: Politikat e transportit**

*BE-ja ka rregulla të përbashkëta për standardet teknike dhe të sigurisë, për standardet sociale, ndihmat shtetërore dhe liberalizimin e tregut në transportin rrugor, hekurudhat, rrugët ujore të brendshme, transportin e kombinuar, aviacionin dhe transportin detar.*

Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjes në këtë fushë. Ka arritur **progres të kufizuar**, veçanërisht me miratimin e strategjisë së transportit multimodal.

Meqenëse shumica e rekomandimeve të vitit të kaluar nuk janë adresuar, ato mbeten të vlefshme; Kosova duhet:

- të investojë në mirëmbajtjen dhe inspektimet e rrugëve, të organizojë fushata parandaluese dhe të krijojë një mekanizëm monitorues sistematik për mbledhjen e të dhënave të aksidenteve dhe të vazhdojë përafrimin me *acquis* të BE-së për tregut hekurudhor, dhe në veçanti, Ligjin për siguri dhe interoperabilitet;
- të miratojë dhe zbatojë planin e veprimit 2023-2025 të strategjisë së transportit multimodal; të përafrojë rregulloren e aviacionit të Kosovës me Marrëveshjen për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit;
- të miratojë strategjinë e sistemit inteligjent të transportit (SIT) dhe planin e saj të veprimit; të sigurojë kapacitete dhe burime të mjaftueshme për zbatimin e saj dhe të vazhdojë përpjekjet për përafrim me *acquis* të BE-së për të drejtat e pasagjerëve në të gjitha llojet e transportit.

**Sa i përket çështjeve të transportit**, Kosova ka marrë pjesë në mënyrë proaktive në aktivitetet e Komunitetit të Transportit. Në janar 2023, qeveria miratoi Strategjinë e Transportit Multimodal, ndërsa miratimi i planit të veprimit është ende në pritje. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përafuar dhe zbatuar *acquis* të BE-së në të gjitha fushat e sektorit, me fokus sigurinë dhe duke përfshirë elementë të Strategjisë për Mobilitet Inteligjent dhe të Qëndrueshëm. Kosova duhet të marrë masa konkrete për të përshpejtuar zbatimin me qëllim të përmbushjes së afatet e përcaktuara në pesë Planet e Veprimit të Komunitetit të Transportit (transport hekurudhor, rrugor, siguri rrugore, transport ujor dhe multimodalitet). Kosova ka arritur progres të kufizuar në zbatimin e Shtojcës 1 të Traktatit të Komunitetit të Transportit. Kapacitetet operative dhe administrative të organeve përmbarimore mbeten të pamjaftueshme. Kosova duhet të ngritë kapacitetet ekzistuese për të përmirësuar koordinimin dhe për të siguruar zbatimin e duhur, me kohë dhe profesional të të gjitha projekteve infrastrukturore. Kosova duhet të fillojë të përmirësojë qëndrueshmërinë e klimës së transportit dhe përdorimin e lëndëve djegëse alternative, në përputhje me Agjendën e Gjelbër dhe Strategjinë për Mobilitet Inteligjent dhe të Qëndrueshëm për Ballkanin Perëndimor. Për aglomeratet më të mëdha të transportit, duhet të zhvillohen plane të qëndrueshme të mobilitetit urban në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale duke ndjekur praktikën e BE-së.

Sa i përket **transportit rrugor**, Kosova duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për t'u përafuar me BE-në *acquis*. Për hera e parë, Kosova ka ndarë një buxhet për periudhën 2022-2024 për të krijuar Sistemin e Menaxhimit të Aseteve Rrugore. Kosova duhet të zbatojë rekomandimet për themelimin e Agjencisë për Sigurinë Rrugore, duke përfshirë zhvillimin e sistemit kombëtar për mbledhjen e vazhdueshme të të dhënave të aksidenteve rrugore. Sistemi aktual i mbledhjes së të dhënave të aksidenteve rrugore nuk është në përputhje me Strukturën e të Dhënave të Përbashkëta të Aksidenteve (CADaS) dhe përmirësimi i sistemit nuk është parashikuar ende. Kosova duhet të vazhdojë ngritjen e ndërgegjegjësimit për të arritur rezultate më të mira në përputhje me objektivin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe Bashkimit Evropian (BE) për të zvogëluar përgjysmë numrin e vdekjeve dhe lëndimeve në aksidente rrugore deri në vitin 2030. Kosova duhet gjithashtu të zbatojë rekomandimet e raportit të projektit të Asistencës Teknike për Konektivitetin në Ballkanin Perëndimor - CONNECTA - për të përmirësuar cilësinë e rrjetit rrugor dhe për të zbatuar veprimet siç janë përcaktuar në planin rajonal të veprimit të Traktatit të Komunitetit të Transportit për sigurinë rrugore. Projekt akti nënligjor për përafrimin e Direktivës 2008/69/EC për menaxhimin e sigurisë së infrastrukturës rrugore dhe akti nënligjor për inspektimet teknike periodike në rrugë duhet të finalizohen pa vonesa të mëtejshme. Krijimi i një sistemi/modeli për të rritur kapacitetin e inspektorëve dhe

auditorëve të sigurisë rrugore duhet të jetë prioritet.

Kosova ka arritur njëfarë progresi në zbatimin e **acquis për transportin hekurudhor**, me zbatimin e pjesshëm të planit të veprimit të Komunitetit të Transportit për hekurudhat. Tregu i shërbimeve të transportit hekurudhor është i hapur dhe funksional. Megjithatë, legjislacioni për hekurudhat ende duhet të përafrohet plotësisht me tregun dhe shtyllat teknike të paketës së katërt hekurudhore. Kosova ka hartuar një kontratë shumëvjeçare për mirëmbajtje; miratimi përfundimtar është në pritje. Edhe pse marrëveshja e vitit 2021 për kalimin e përbashkët të kufirit hekurudhor është në fuqi për më shumë se 2 vite, stacioni i përbashkët hekurudhor me Maqedoninë e Veriut nuk është ende funksional. Kosova duhet të sigurojë finalizimin e diskutueshëm të marrëveshjes financiare 2020-2024 ndërmjet menaxherit të infrastrukturës, Infrakos, dhe autoriteteve përkatëse.

Sa i përket **transportin ajror**, Kosova është pjesë e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA) dhe gjithashtu mbulohet nga marrëveshjet e qiellit të vetëm evropian. Sektori vazhdon të përballet me një numër sfidash që dalin nga mosanëtarësimi i Kosovës në disa organizata ndërkombëtare të aviacionit civil. KFOR/NATO ende menaxhon dhe koordinon hapësirën e sipërme ajrore të Kosovës. Problem mbeten mangësitë institucionale të Agjencisë së Shërbimeve të Navigimit Ajror dhe Autoritetit të Aviacionit Civil, si dhe mungesa e të ardhurave nga menaxhimi i hapësirës së sipërme ajrore. Çështjet e vazhdueshme të menaxhimit të stafit në Autoritetin e Aviacionit Civil mbeten të pazgjidhura dhe mund të kenë ndikim negativ në funksionimin e Autoritetit. Riorganizimi i tij i ardhshëm dhe reformat administrative duhet të pasqyrojnë parimet e reformës së administratës publike, si dhe rrethanat dhe kërkesat specifike të sektorit të aviacionit. Nevojiten më shumë përpjekje për të vazhduar përafrimin me pikat e mbetura të fazës së parë të ECAA-së. Kosova ka arritur njëfarë progresi me fazën e dytë të kërkesave të ECAA-së, në çështjet e sigurisë së aviacionit.

Në lidhje me **transportin e kombinuar**, miratimi i Strategjisë së Transportit Multimodal përcakton objektivin për një infrastrukturë të transportit që funksionon mirë, e cila është e integruar në rrjetin TEN-T dhe mundëson ofrimin e shërbimeve të transportit multimodal. Megjithatë, programi 3-vjeçar i zbatimit të Strategjisë ende nuk është miratuar.

Kosova duhet të shtojë përpjekjet e saj për të zbatuar **acquis** të BE-së për **të drejtat e pasagjerëve** në të gjitha llojet e transportit. Ndërkohë që ka arritur progres të kufizuar në zbatimin e disa aspekteve të Rregullores së BE-së për të drejtat e pasagjerëve në transportin hekurudhor, kërkohen përpjekje të mëtejshme për të arritur pajtueshmërinë gjithëpërfshirëse.

## **Kapitulli 15: Energjia**

*Politika energjetike e BE-së mbulon furnizimin me energji, infrastrukturën, tregun e brendshëm të energjisë, konsumatorët, energjinë e ripërtëritshme, eficiencën e energjisë, energjinë dhe sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimi.*

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në fushën e energjisë. Kosova ka arritur **njëfarë progresi**, veçanërisht me miratimin e Strategjie të re ambicioze për Energjinë në mars 2023, lansimin e ankandit të parë solar në maj 2023 dhe përmes investimeve të mëtejshme në eficiencën energjetike të ndërtesave publike dhe rezidenciale në përputhje me planin e veprimit të Paketës së Mbështetjes Energjetike. Kosova mbetet shumë e varur nga qymyri, i cili përveç që është burim dominues i gazrave serrë, shkakton rreziqe serioze për shëndetin dhe mjedisin. Objektivat e vendosura në Strategjinë e re të Energjisë dhe në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) do të duhet të përafrohen me objektivat për energjinë dhe klimën e Komunitetit të Energjisë 2030. Ky plan (PKEK) duhet të miratohet deri në fund të qershorit të vitit 2024, në përputhje me objektivat për energjinë dhe klimën e Komunitetit të Energjisë 2030, duke marrë

parasysh rekomandimet e nxjerra nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Kosova duhet të përafrojë legjislacionin e saj me Paketën e Integritit të Energjisë Elektrike të Komunitetit të Energjisë. Implementimi dhe zbatimi i legjislacionit për efikasitet të energjisë duhet të përmirësohen. Kosova duhet t'i përmbush pa vonesë obligimet e saj sipas marrëveshjes për lidhje me ENTSO-E.

Pasi që rekomandimet nga raporti i kaluar janë adresuar vetëm pjesërisht, në vitin e ardhshëm, Kosova duhet në veçanti:

- të vazhdojë me përmirësimin e aspekteve mjedisore që ndërlidhen me termocentralin Kosova B dhe punimet për dekomisionimin e pjesëve jofunksionale të termocentralit Kosova A;
- të vazhdojë me shpërndarjen e fondit të efikasitetit të energjisë dhe zbatimi i mbështetjes për ndërtesat e banimit dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme; dhe
- të miratojë Ligjin për burimet e energjisë së ripërtëritshme dhe të nënshkruajë një marrëveshje të drejtpërdrejtë me ofruesin e shërbimit për përdorimin e regjistrit elektronik kombëtar për lëshimin, anulimin dhe tregtimin e garancive të origjinës.

Kosova ka arritur njëfarë progresi sa i përket **sigurisë së furnizimit**. Integrimi i tregut të energjisë elektrike me Shqipërinë avancoi me lansimin e Bursës Shqiptare të Energjisë (ALPEX) dhe inaugurimin e suksesshëm të tregut paraprak në Shqipëri. ALPEX mori licencë për të operuar me tregun paraprak në Kosovë dhe lansimi pritej në shtator 2023. Lidhja e tregut mes Shqipërisë dhe Kosovës është paraparë të bëhet paralelisht me lansimin e tregut paraprak në Kosovë. Kosova ende nuk ka arritur progres në ristrukturimin e Marrëveshjes ekzistuese të Furnizimit me Shumicë në mes të Kompanisë së Furnizimit me Energji Elektrike të Kosovës (KESCO) dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Heqja graduale e marrëveshjes për furnizim masiv do të kontribuojë në hapjen e konkurrencës dhe likuiditetit në treg, në dobi të konsumatorëve të energjisë në Kosovë.

Operatori Kosovar i Transmisionit (KOSTT) ka vazhduar tërheqjen e energjisë elektrike nga rrjeti evropian për të balancuar kërkesën në mënyrë të paautorizuar. KOSTT-it i mungojnë burimet financiare të nevojshme për të mbuluar humbjet në të cilat kontribuojnë faturat e papaguara të energjisë elektrike në veri të Kosovës. Furnizimi me energji elektrike për verin e Kosovës sigurohet përmes devijimeve që shkelin Marrëveshjen e Koneksionit me ENTSO-E. KOSTT duhet të adresojë urgjentisht problemin e devijimeve në frekuencë në zonën e kontrollit të Kosovës, pasi që operatori i sistemit të transmisionit (OST) është përgjegjës për përmbushjen e obligimeve sipas Marrëveshjes për Koneksion me ENTSO-E.

Edhe pse Elektroserver mori licencë për furnizim në qershor të vitit 2022, pas miratimit të Udhërrëfyesit për Energjinë si pjesë e Dialogut të lehtësuar nga BE-ja, lidhja e një kontrate komerciale ndërmjet kompanisë së shpërndarjes KEDS dhe Elektroserverit mbetet në pritje. Pas ndarjes së operatorit të sistemit të transmisionit të Kosovës KOSTT nga blloku i kontrollit të Serbisë, operatori serb i sistemit të transmisionit të energjisë elektrike EMS nuk ka përcaktuar kapacitetet neto të transmisionit dhe alokimin e kapaciteteve në interkoneksionin me Kosovën.

Në mars të vitit 2023, Kosova miratoi **Strategjinë** ambicioze **për Energji** duke vendosur një vizion të qartë për dekarbonizimin dhe duke parashikuar një rritje të konsiderueshme të burimeve të energjisë së ripërtëritshme në përzierjen e energjisë elektrike dhe miratoi programin e zbatimit të saj në shtator. Kosova duhet të sigurojë zbatim efikas dhe dinamik të komponentëve të ndryshëm të strategjisë për energji dhe të arrijë objektiva ambicioze. Kosova është varet nga termocentralet e vjetruar, jo të besueshme dhe shumë ndotëse me djegie të linjitet, të cilat janë burime të emetimit të gazrave serrë dhe shkaktojnë rreziqe serioze për

shëndetin dhe mjedisin. Kosova duhet të punojë në dekomisionimin e pjesëve jofunkionale të termocentralit Kosova A. Në vitin 2024, pritet që Kosova të nisë punimet për të përmirësuar performancën mjedisore të termocentralit Kosova B dhe për të sjellë nivelet e emetimit të pluhurit dhe oksidit të azotit në përputhje me standardet e BE-së. Kosova tashmë është duke shkelur kërkesat e Komunitetit të Energjisë për reduktimin e emetimeve të gazrave serrë; korniza ligjore gjithashtu duhet të përafrohet me Direktivat e BE-së për impiantet e mëdha me djegie dhe emetimet industriale.

Strategjia e re për energji e Kosovës nuk parasheh zhvillimin e **infrastrukturës së gazit**. Studimi i fizibilitetit për gazsjellësin Kosovë-Maqedonia e Veriut dhe masterplani i gazit kanë përfunduar por nuk ka asnjë vendim për investime në infrastrukturën e gazit.

Në lidhje me **tregun e brendshëm të energjisë**, nuk ka progres me hapjen e mëtejshme të tregut me pakicë. Në praktikë, të gjithë konsumatorët përveç atyre në tension të lartë vazhduan të furnizohen me çmim të rregulluar. Për të siguruar pajtueshmërinë me Paketën e Tretë të Energjisë dhe kërkesat më të fundit të Paketës së Integritit të Energjisë Elektrike të Komunitetit të Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energji të Kosovës (ZRRE) duhet ende të zbatojë liberalizimin e tregut me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë. Më 30 mars 2023, Bordi i ZRRE-së miratoi të hyrat maksimale të lejuara për operatorët e rregulluar dhe rriti tarifat e reja të energjisë elektrike për të gjitha kategoritë e konsumatorëve për 15.4%. Qeveria është duke përcaktuar konsumatorët në gjendje të vështirë për të paguar energjinë sipas rekomandimeve të Bankës Botërore, në mënyrë që të përfitojnë jo vetëm përfituesit e asistencës sociale, por edhe konsumatorët e tjerë në situata të ndjeshme; këta të fundit do të përfitojë edhe nga Paketa e BE-së për Mbështetjen e Energjisë. Kosova ka dorëzuar draft Planin e saj Kombëtar të Energjisë dhe Klimës në Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë më 10 korrik 2022. Plani përfundimtar do të miratohet deri në fund të qershorit 2024.

**Sa i përket burimeve të ripërtëritshme**, deri në fund të vitit 2022, Kosova ka regjistruar 276.2 MW prodhim të energjisë elektrike të ripërtëritshme, 128 MW nga hidrocentralet e vogla, 137 MW nga era, 10 MW nga energjia solare dhe 1.2 MW nga biomasa. Kosova duhet të mobilizojë investime të reja në burimet të energjisë së ripërtëritshme për të arritur objektivat e Strategjisë së Energjisë dhe Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor. Kosova gjithashtu duhet të bëjë më shumë përpjekje për të miratuar kornizën ligjore për burimet e ripërtëritshme. Në maj të vitit 2023, Kosova filloi ankandin për parkun e parë të energjisë solare prej 100 MW. Procedurat e dhënies së lejeve duhet të thjeshtohen dhe racionalizohen për të mundësuar vendosjen më të shpejtë të burimeve të ripërtëritshme. Kosova duhet të nënshkruajë një marrëveshje të drejtpërdrejtë me ofruesin e shërbimeve për përdorimin e regjistrimit elektronik kombëtar për lëshimin, anulimin dhe tregtimin e garancive të origjinës, siç parashikohet në projektin rajonal për garancitë e origjinës të zbatuar në Komunitetin e Energjisë dhe në përputhje me standardet e BE-së.

Zinxhiri i furnizimit me biomasë/lëndë drusore, kritik për funksionimin e termocentralit të instaluar të ngrohjes dhe të kogjenerimit në Gjakovë, nuk është krijuar ende. Për të siguruar zinxhirin e furnizimit me lëndë drusore, Kosova ka nevojë për një plan të përmirësuar të menaxhimit të pyjeve dhe subvencione të dedikuara për sanim të pyjeve. Për shkak të shqetësimeve mbi ndikimin e tyre mjedisor, zhvillimi i hidrocentraleve të vogla vazhdoi të përballej me rezistencë të fuqishme publike. Në përputhje me *acquis* për koncesionet dhe mjedisin, zhvillimi i hidrocentraleve të reja duhet të shoqërohet gjithmonë me vlerësimet e duhura të ndikimit mjedisor dhe social. Strategjia e re për energji e Kosovës nuk parasheh zhvillimin e kapaciteteve të reja hidroenergjetike.

Mund të vërehet progres i mirë në zbatimin e fondit të **efiçencës së energjisë**. Kosova ka vendosur procedurat operative për subvencionimin e masave të efiçencës së energjisë në



sektorin rezidencial, duke përfshirë banesat sociale. Modeli financiar për investimet në sektorin rezidencial në bazë kthyesë është në zhvillim e sipër. Për të rritur efikasitetin e energjisë siç parashihet në Strategjinë për Energji, Kosova duhet të mobilizojë më shumë financime dhe të forcojë kapacitetet e institucioneve për të zbatuar dhe monitoruar kursimet. Ligji për efikasitetin e energjisë dhe ligji për performancën energjetike të ndërtesave duhet të përafrohen me direktivat e reja siç kërkohet nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Kosova duhet të zbatojë menjëherë certifikimin e performancës energjetike të ndërtesave dhe të miratojë Strategjinë për Renovimin e Ndërtesave dhe Planin për ndërtesat me konsum afër zero të energjisë.

Kapacitetet e Agjencisë për **Siguri Bërthamore dhe Mbrojtje nga Rrezatimi** mbeten të dobët, Kosova ende nuk ka gjetur zgjidhje për trajtimin dhe ruajtjen e përkohshme të mbeturinave radioaktive në përputhje me standardet e BE-së.

## **Kapitulli 21: Rrjetet trans-evropiane**

*BE-ja promovon rrjetet trans-evropiane (TEN) në fushat e transportit, telekomunikacionit dhe energjisë për të forcuar tregun e brendshëm dhe për të kontribuar në rritje dhe punësim.*

Në fushën e rrjeteve trans-evropiane (TEN), Kosova ka **një nivel të përgatitjes**. Kosova ka arritur **progres të kufizuar** në zhvillimin e rrjeteve të transportit dhe energjisë, zbatimin e planeve të veprimit të Komunitetit të Transportit për lehtësimin rrugor, të sigurisë rrugore, hekurudhore dhe transportit, si dhe funksionalizimin e shkëmbimit të përbashkët të energjisë me Shqipërinë.

Pasi që rekomandimet nga viti i kaluar janë adresuar vetëm pjesërisht, në vitin e ardhshëm, Kosova duhet:

- të implementojë projektet në pritje të koneksionit dhe të forcojë kapacitetet institucionale dhe administrative për zbatimin e projekteve strategjike të infrastrukturës;
- të përmirësojë kapacitetin e autoritetit rregullator të komunikimeve elektronike dhe postare për të zbatuar rregulloret e tregut të telekomunikacionit.

Progresi në Rrjetin e Transportit Trans-evropian (TEN-T) është i kufizuar për shkak të mungesës së kapaciteteve ndërinstitucionale për zbatimin e projekteve infrastrukturore. Të gjitha investimet në infrastrukturën e transportit duhet të bazohen në analiza realiste të kostos/përfitimit dhe të jenë në përputhje me standardet e BE-së për prokurimin publik, ndihmën shtetërore dhe vlerësimet e ndikimit mjedisor. U bë një rishikim i rrjetit bazë dhe gjithëpërfshirës indikativ i TEN-T. Marrëveshje përkatëse e nivelit të lartë për hartat indikative për TEN-T në Ballkanin Perëndimor u nënshkrua në korrik 2023. Hartat e ndryshuara për korridorin e ri evropian të Ballkanit Perëndimor do të jenë pjesë e Rregullores së rishikuar të TEN-T, e cila është aktualisht në negociatë mes bashkë-ligjvënësve të BE-së.

Në vitin 2022, qeveria paraqiti kërkesën për kredi në BERZH dhe BEI për segmentin e “Autostradës së Paqes” (pjesë e Linjës 7). Megjithatë, negociatat ende nuk kanë përfunduar. Punimet hekurudhore në korridorin Orient/East-Med (lindja hekurudhore 10) që lidh Fushë Kosovën dhe Mitrovicën me Maqedoninë e Veriut vazhduan me ritëm të ngadaltë. Punimet në segmentin e dytë janë duke vazhduar, ndërsa tenderimi për sinjalizimin dhe telekomin është vonuar. Kosova dhe Shqipëria do të kryejnë një studim të fizibilitetit për një lidhje hekurudhore mes Durrësit dhe Prishtinës.

Kosova ka arritur njëfarë progresi në hapjen e tregut hekurudhor. Mbeten pengesa, siç janë njohja reciproke e licencave të drejtuesve të trenave, korniza institucional dhe njohja e certifikatave të sigurisë dhe autorizimeve të automjeteve. Kosova duhet të rishikojë më tej

ligjin për hekurudhat dhe të finalizojë ligjin e ri të sigurisë dhe interoperabilitetin hekurudhor duke përfshirë tregun dhe shtyllat teknike që dalin nga pakoja e katërt hekurudhore.

Në lidhje me **rrjetet energjetike**, ka përfunduar Studimi i Fizibilitetit për Gazsjellësin Kosovë-Maqedoni Veriore dhe Masterplani i Gazit për Kosovën. Qeveria nuk parasheh zhvillimin e infrastrukturës së gazit në Kosovë. Në Strategjinë e re për Energji, qeveria planifikon të konsiderojë investime të përbashkëta në termocentrale me gaz natyror me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë. Është arritur progres drejt avancimit të integritetit të tregut të energjisë elektrike me Shqipërinë. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX), që përfshin Kosovën, u lansua në prill 2023.

Sa i përket **rrjeteve të telekomunikacionit**, kapaciteti institucional i autoritetit rregullator të komunikimeve elektronike dhe postare duhet ende të forcohet.

## **Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimi klimatik**

*BE-ja promovon veprim të fortë klimatik, zhvillim të qëndrueshëm dhe mbrojtje të mjedisit. Rregullat e BE-së përmbajnë dispozita që adresojnë ndryshimet klimatike, cilësinë e ujit dhe ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, ndotjen industriale, kimikatet, zhurmën dhe mbrojtjen civile.*

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, Kosova është në një **fazë të hershme të përgatitjes**. Gjatë periudhës raportuese, Kosova ka arritur **progres të kufizuar** me miratimin, në mars 2023, të Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes. Kosova duhet të rrisë angazhimin e saj politik dhe kapacitetin administrativ për të adresuar çështjet që kanë të bëjnë me degradimin e mjedisit dhe ndryshimet klimatike, si dhe për të përmirësuar implementimin dhe zbatimin e legjislacionit të saj. Këto përpjekje duhet të përafrohen me qëllimet e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Rekomandimet nga raporti i mëparshëm nuk janë zbatuar.

Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

- të rrisë mbulimin e grumbullimit të mbeturinave, të zbatojë gjerësisht reduktimin, ndarjen, riciklimit dhe ripërdorimin e mbetjeve; të trajtojë në mënyrë efektive çështjen e deponive të paligjshme; të vë në funksion masat e ekonomisë rrethore për reduktimin e mbetjeve, të zhvillojë dhe miratojë planet e menaxhimit të integruar ndërkomunal të mbetjeve; dhe të përcaktojë sistemin e zgjeruar të përgjegjësisë së prodhuesve; të intensifikojë punën për reduktimin e ndotjes industriale nëpërmjet implementimit dhe zbatimit të ligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes;
- të harmonizojë dhe fillojë me zbatimin e dispozitave ligjore për përgjegjësinë mjedisore, dëmin dhe krimin; të zbatojë parimin ndotësi paguan dhe të rrisë ndërgjegjësimin e publikut për mbrojtjen e mjedisit;
- të zbatojë strategjinë për ndryshime klimatike dhe planin e veprimit për ndryshimet klimatike; të përgatisë një udhërrëfyes për përafrimin me Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe *acquis* për klimën; të miratojë planin kombëtar të energjisë dhe klimës, në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë, dhe të finalizojë hartimin e strategjisë afatgjatë të de-karbonizimit dhe të përgatitet për përafrim me Sistemin e Tregtimit të Emetimeve të BE-së (ETS).

### Mjedisi

Sa i përket çështjeve **horizontale**, Kosova duhet të marrë përgjegjësi dhe të gjitha masat e nevojshme në sektorin e mjedisit dhe për këtë qëllim të rrisë kapacitetet e autoriteteve mjedisore në nivel qendror dhe lokal, të zbatojë reformat strukturore dhe të sigurojë bashkëpunimin

ndërinstitucional. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të rishikuar dhe miratuar strategjitë, planet e veprimit dhe legjislacionin përkatës për të siguruar koherencë me objektivat e Agjendës së Gjellbër. Miratimi i Strategjisë për Mbrojtje të Mjedisit dhe Zhvillim të Qëndrueshëm 2022-2030 është vonuar ende. Ka sfida për zbatimin e kornizës strategjike për shkak të mungesës së fondeve të mjaftueshme, kapaciteteve të ulëta administrative dhe teknike dhe mbështetjes së madhe në mbështetjen e donatorëve. Kosova duhet të përafrojë mbrojtjen e saj mjedisore me Direktivën për përgjegjësi mjedisore. Kosova ka miratuar legjislacionin për inspektimet, por kapacitetet inspektuese dhe zbatimi duhet të përmirësohen. Kosova kohët e fundit ka miratuar Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social; megjithatë, duhet të ndryshojë Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit Strategjik. Kosova duhet të konsultohet në mënyrë domethënëse me shoqërinë civile në këtë fushë të politikave, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin e publikut dhe institucioneve të saj për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.

**Cilësia e ajrit**, veçanërisht ndotja, vazhdon të jetë një kërcënim i madh për shëndetin. Edhe pse ka përfunduar identifikimi i detajuar i burimeve të ndotjes së ajrit, Kosova duhet të zbatojë masat adekuate për të përmirësuar dhe frenuar ndotjen e ajrit. Kosova nuk vepron në përputhje me kufijtë e emetimeve të përcaktuara sipas planit të saj kombëtar për reduktimin e shkarkimeve, miratimi i të cilit është vonuar. Kosova duhet të fillojë përgatitjen e zbatimit të Direktivës së re për Tavanin Kombëtar të Emetimeve. Masat për ndalimin e përdorimit të qymyrit për ngrohje duhet të zbatohen në mënyrë efektive. Kosova ofroi për herë të parë subvencione për investime në burime më eficiente dhe më pak ndotëse. Duhet të miratohen planet e cilësisë së ajrit për zonat ku nivelet e ndotësve tejkalojnë vlerat e caktuara. Monitorimi në kohë reale, identifikimi i burimeve të ndotjes së ajrit dhe raportimi i cilësisë së ajrit janë përmirësuar paksa.

Ka një lloj progresi në përafrimin e legjislacionit për **menaxhimin e mbetjeve** me *acquis* të BE-së, por paqëndrueshmëria e sistemit duhet të adresohet më tej. Ndërsa korniza ligjor është pjesërisht e përafuar me *acquis* të BE-së, ajo duhet të përfshijë përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit dhe parimin ndotësi pagan. Në gusht të vitit 2022, Kosova miratoi Ligjin për Mbeturina, duke u përafuar me Direktivën Kornizë për Mbeturina. Implementimi dhe zbatimi i legjislacionit për menaxhimin e mbeturinave ka ngecje, me progresin e vetëm të dukshëm në menaxhimin e mbetjeve organike, ku 18 nga 38 komuna që kanë iniciuar sisteme të kompostimit të brendshëm dhe disa kanë zbatuar masa pilot për ndarjen e mbetjeve të grumbullimit të fraksioneve dhe reduktimin e mbetjeve organike. Pjesa më e madhe e mbeturinave ende përfundojnë në deponi, të cilat nuk menaxhohen siç duhet ose nuk kategorizohen si deponi të paligjshme të mbeturinave. Megjithatë, numri i deponive të paligjshme ka rënë në mënyrë të vazhdueshme (nga 1489 në vitin 2020, 1189 në vitin 2021 në 763 në vitin 2022). Kosova duhet të rrisë kapacitetet dhe të vendosë objektiva realiste të riciklimit për të zbatuar menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe ekonominë rrethore. Në mars të vitit 2023, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka lansuar Udhërrëfyesin e Ekonomisë Rrethore; megjithatë, kuptimi i përgjithshëm i konceptit është ende në një fazë të hershme. Kapaciteti i institucioneve qendrore dhe lokale, duke përfshirë inspektimet, për të përmbushur përgjegjësitë e tyre duhet të forcohet. Liqeni i depozitimit të hirit të thëngjillit i operuar nga Ndërmarrja Elektroenergjetike e Kosovës dhe deponia e Mirashit në Obiliq mbeten të hapura, pavarësisht ndikimit të tyre negativ në mjedis. Qeveria zgjodhi lokacionet për deponinë e re për menaxhimin rajonal të mbeturinave dhe depozitimin e mbeturinave të rrezikshme në Prishtinë; megjithatë, ajo duhet të zhvillojë procedurat e vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social.

Kosova ka arritur progres të kufizuar në përafrimin e legjislacionit për **ujerat** me *acquis* të BE-së. Mekanizmi monitorues i Strategjisë së Ujërave 2017-2036 dhe zbatimi i Ligjit për

Ujërat kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme. Kosova duhet të vendosë urgjentisht sistemet e monitorimit me të dhëna në dispozicion të publikut. Zonat e mbrojtjes së ujërave duhet të përmirësohen më tej. Autoritetet rajonale të pellgjeve lumore duhet të bëhen funksionale urgjentisht. Plani i menaxhimit për pellgun e Drinit të Bardhë duhet të miratohet dhe përgatitja e planeve të tjera të menaxhimit të pellgjeve lumore duhet të përshpejtohet. Çdo hidrocentral i vogël duhet të ndërtohet në përputhje të plotë me legjislacionin mjedisor dhe t'i nënshtrohet vlerësimeve të duhura mjedisore. Përgatitja e hartave të rrezikut nga përmblytjet dhe rreziqet ka arritur progres të mirë. Ujërat e zeza dhe shkarkimet e patrajuara mbeten burimet kryesore të ndotjes së ujit, veçanërisht në lumenj. Planifikimi dhe ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të zeza në qytetet e mëdha po shkon mirë, por identifikimi i aglomerateve dhe zonave të ndjeshme në përputhje me Direktivën e Trajtimit të Ujërave të Zeza Urbane mbetet i dobët. Reduktimi i humbjeve të ujit dhe mbledhja e qarkullimit duhet të intensifikohet.

Kosova nuk ka arritur asnjë progres lidhur me **mbrojtjen e natyrës**. Strategjia për Mjedis dhe Zhvillim të Qëndrueshëm 2022-2031 ende nuk është miratuar. Planet e detajuara rregullative për dy parqet kombëtare janë ri-hartuar në plane të pjesshme që mbulojnë zona më të vogla. Plani i veprimit 2016-2020 për biodiversitetin duhet të zbatohet plotësisht. Zonat e përcaktuara vazhdojnë të jenë të ndotura dhe jo mirë të mirëmbajtura, dhe aktivitetet ilegale siç janë ndërtimi, gjuetia dhe prerja e pyjeve duhet të adresohen më tej. Masat efektive janë të nevojshme për të siguruar mbrojtjen e specieve të rrezikuara në mënyrë serioze. Edhe pse Kosova ka ndërmarrë hapa për të filluar inventarizimin e habitateve dhe specieve natyrore, përcaktimi i vendeve potenciale të Natura 2000 është në një fazë shumë të hershme. Kosova ka arritur njëfarë progresi në pylltari, kryesisht në planifikim dhe menaxhim, pasi ka miratuar legjislacionin përkatës dytësor. Strategjia për pyjet dhe ligji për pyjet nuk janë miratuar ende. Shpyllëzimi dhe prerja e paligjshme e pyjeve mbeten çështje shqetësuese.

Kosova ka arritur progres të kufizuar në përafrimin me *acquis* për **ndotjen industriale** dhe menaxhimin e rrezikut. Në mars të vitit 2023, Kuvendi miratoi Ligjin për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes. Progresi në zbatimin e legjislacionit për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes dhe llogaridhënien e ndotësve është shumë i ngadaltë. Mbetjet e rrezikshme të minierave, shkarkimet industriale në lumenj dhe deponitë industriale vazhdojnë të përbëjnë kërcënim serioz për tokën, ujin dhe shëndetin. Duhet të konsiderueshme për t'u përafruar me *acquis* të BE-së dhe për ta zbatuar atë, veçanërisht në lidhje me Direktivën për Emetime Industriale dhe Seveso III. Ky proces kërkon kapacitet të forcuar për të zbatuar legjislacionin në nivel qendror dhe lokal. Gjithashtu, janë të nevojshme fushata ndërgjegjësimi të publikut, trajnimi i industrisë së prekur dhe dhënia e lejeve të integruara për reduktimin e emetimeve të dëmshme industriale.

Nuk kishte asnjë progres lidhur me **kimikatet**, prandaj përafrimi me *acquis* të BE-së dhe zbatimi i legjislacionit mbetet në nivel të ulët. Kosova nuk është palë e Konventës së Roterdamit. Ajo duhet të zbatojë më tej kornizën rregullator për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme. Kosova ka arritur njëfarë progresi në ofrimin e informacionit për palët e interesit; megjithatë, nevojiten më shumë përpjekje për të krijuar një qendër për kontrollin e helmeve kimike.

Nuk ka pasur asnjë progres në lidhje me rregulloren për **zhurmë** në periudhën raportuese.

Kosova nuk është pjesë e Mekanizmit të **Mbrojtjes Civile** të Bashkimit, por mund të përfitojë nga disa aktivitete të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit, të disponueshme për përfituesit e Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA) dhe përfitimet nga programet rajonale të mbrojtjes civile sipas të njëjtit Instrument. Kosova inkurajohet të marrë pjesë në aktivitetet e Mekanizmit, siç janë trajnimet, shkëmbimi i ekspertëve, projektet e

parandalimit dhe gatishmërisë, ushtrimet, rishikimet nga kolegët dhe misionet këshilluese. Në përmirësimin e kapaciteteve të saj për menaxhimin e fatkeqësive, Kosova duhet të zhvillojë legjislacionin, qeverisjen dhe kornizën financiare në lidhje me gatishmërinë, të zhvillojë një plan gjithëpërfshirës të investimeve për gatishmëri dhe reagim, të përmirësojë koordinimin ndërmjet autoriteteve përgjegjëse në fatkeqësitë në shkallë të gjerë dhe të forcojë qeverisjen dhe procedurat në lidhje me zhvillimin e vlerësimit kombëtar të rrezikut. Koordinimi ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal duhet të përmirësohet. Kosova nuk ka arritur progres në lidhje me vlerësimin e nevojave për rrezikun e fatkeqësive; ajo nuk ka zhvilluar strategjinë e rikuperimit e as nuk ka përgatitur plane për reagim ndaj fatkeqësive. Kosova duhet të fillojë procesin e instalimit të Shërbimeve Trans-Evropiane për Telepatikë ndërmjet Administratave (TESTA) si parakusht për instalimin e Sistemit të Përbashkët të Komunikimit dhe Informacionit për Emergjencat (CECIS).

### Ndryshimet klimatike

Zbatimi i strategjisë për ndryshimet klimatike 2019-2028 dhe planit të veprimit për 2021-2023 është shumë i kufizuar. Kosova ende nuk e ka miratuar ligjin për ndryshimet klimatike. Plani kombëtar për energji dhe klimë duhet të miratohet në fund të qershorit të vitit 2024 (*Shih Kapitullin 15 – Energjia*). Qeveria duhet të nisë hartimin e Strategjisë së De karbonizimit, duke përfshirë veprimet që lidhen me energjinë, bujqësinë, pylltarinë dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik. Këshilli Kombëtar për Ndryshimet Klimatike i rithemeluar mori masa konkrete për të integruar veprimet klimatike dhe për të rritur ndërgjegjësimin publik. Raportimi i inventarit të emetimeve të gazrave serrë për vitin 2020 nuk është ende në dispozicion. Korniza strategjike dhe legjislative duhet të përafrohet me objektivat strategjike të BE-së që rrjedhin nga Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Kosova duhet të përgatitet për harmonizim me *acquis* për klimën sipas modifikimeve të rëndësishme të sjella nga pakoja Fit për 55. Kosova duhet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për krijimin e një mekanizmi për çmimin e karbonit, në përputhje me ETS të BE-së, për të avancuar zbatimin e *acquis* të BE-së dhe për t'u përgatitur në mënyrë adekuate për Mekanizmin e Rregullimit të Kufirit të Karbonit të BE-së, që hyn në fuqi në fazën e tij transitore. që nga 1 tetori 2023. Kapacitetet administrative dhe inspektuese në këtë sektor duhet të forcohen ndjeshëm dhe duhet të zbatohen reforma strukturore. Ngritja e ndërgjegjësimit duhet të rritet. Kosova nuk është anëtare e OKB-së dhe *de facto* nuk është nënshkruar i Konventës Kornizë të OKB-së për Ndryshimet Klimatike; prandaj, ajo nuk ka kontribut të përcaktuar në nivel kombëtar sipas Marrëveshjes së Parisit të vitit 2015. Zbatimi i plotë i strategjisë së saj për ndryshimet klimatike duhet të shërbejë si udhërrëfyes për arritjen e objektivave të Marrëveshjes.

### **GRUPIMI 5: BURIMET, BUJQËSIA DHE KOHEZIONI**

Ky grup mbulon: bujqësinë dhe zhvillimin rural (Kapitulli 11); sigurinë ushqimore, politikë veterinarë dhe fitosanitare (Kapitulli 12); peshkatarinë dhe akuakulturën (Kapitulli 13); politikë rajonale dhe koordinimin e instrumenteve strukturore (Kapitulli 22); dhe dispozitat financiare dhe buxhetore (Kapitulli 33).

Është duke u zhvilluar sistemi për zbatimin e politikës së zhvillimit bujqësor dhe rural. Kosova ka njëfarë niveli të përgatitjes në këtë fushë. Në mars të vitit 2023, Kuvendi miratoi Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural si dhe Ligjin për pylltari. Legjislacioni për organizmat e modifikuar gjenetikusht dhe mbrojtjen e bimëve duhet të përafrohet me *acquis* të BE-së. Në kapitullin 12, Kosova ka arritur progres të kufizuar. Kosova ka zhvilluar programe për mbikëqyrjen dhe eliminimin e sëmundjeve të kafshëve, si dhe ka përgatitur legjislacionin dytësor; megjithatë, nevojitet më shumë progres. Kosova duhet të miratojë programin për bujqësi dhe zhvillim rural 2022-2027 dhe Ligjin për tokën bujqësore. Kapaciteti administrativ i ministrisë dhe agjencive

duhet të forcohet ndjeshëm me burime adekuate njerëzore dhe financiare. Duhet të fillojë një dialog politik me BE-në për orientimin strategjik të bujqësisë së Kosovës sa më shpejt që të jetë e mundur. Masat që inkurajojnë komasacionin e tokës janë të pamjaftueshme. Kosova duhet të bëjë më shumë përpjekje për të zbatuar *acquis* përkatës për peshkatarinë dhe akuakulturën.

## Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural

*Politika e përbashkët bujqësore e BE-së mbështet fermerët dhe siguron sigurinë ushqimore të Evropës. Ajo ndihmon në trajtimin e ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve kombëtare; mirëmban zonat rurale dhe peizazhet në të gjithë BE-në; dhe mban gjallë ekonominë rurale duke promovuar vende pune në bujqësi, industri agrourbore dhe sektorë të ndërlidhur. Kjo kërkon sisteme të fuqishme të menaxhimit dhe kontrollit. Ekzistojnë gjithashtu rregulla të përbashkëta të BE-së për standardet e marketingut, politikën e cilësisë dhe bujqësinë organike.*

Kosova ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në bujqësi dhe zhvillim rural. Ka pasur **progres të kufizuar** me miratimin e Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural, ndërsa programi për bujqësi dhe zhvillim rural 2022-2027 mbetet për t'u miratuar. Është miratuar edhe Ligji për Pylltarinë.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk janë përmbushur plotësisht dhe për këtë arsye mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

- të kryejë një vlerësim cilësor të pagesave direkte dhe programeve të zhvillimit rural të parashikuara në kornizën financiare 2014-2020; të miratojë Ligjin për tokën bujqësore dhe programin për zhvillim bujqësor dhe rural 2022-2027;
- të marrë masa urgjente dhe efektive për ndalimin e humbjes së tokës bujqësore dhe zbatimin e legjislacionit për planifikim hapësinor;
- të ndërmarrë veprime efektive drejt zhvillimit të bujqësisë organike dhe sektorëve të politikave të cilësisë.

Sa i përket **çështjeve horizontale**, në vitin 2022, buxheti për pagesa direkte dhe zhvillim rural u rrit në 58.1 milionë euro, 59% më i lartë se në vitin 2021. Në vitin 2022, programi i bujqësisë dhe zhvillimit rural i dha prioritet investimeve në diversifikimin rural; ii gjithashtu ofroi mbështetje për prodhimin primar bujqësor dhe për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore. Masat mbështetëse duhet të sillen në përputhje me *acquis* të BE-së.

Kosova është ende në proces të krijimit të sistemit bujqësor i cili përfshin sistemin e integruar të administrimit dhe kontrollit (IACS), një rrjet i të dhënave të kontabilitetit të fermave (FADN) dhe sistemin e informacionit të tregut bujqësor.

Ligj për **organizata e tregut të përbashkët e (OTP)** mbetet për t'u miratuar.

Sa i përket **zhvillimit rural**, Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural u miratua në mars 2023. Megjithatë, programi për bujqësi dhe zhvillim rural 2022-2027 ende nuk është miratuar.

Sa i përket **politikës së cilësisë**, Kosova ka shënuar progres me regjistrimin e parë të një treguesi gjeografik.

Operacionet e certifikimit dhe kontrollit të **bujqësisë organike** kryhen nga katër organizatat tona ndërkombëtare.

Plan i veprimi për mbrojtjen e tokës bujqësore, që përfshin Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe autoritetet lokale, për të adresuar humbjen dhe degradimin e vazhdueshëm të tokës bujqësore ende nuk është miratuar.

## Kapitulli 12: Siguria ushqimore, politika veterinare dhe fitosanitare

*Rregullat higjienike të BE-së për prodhimin e ushqimit sigurojnë një nivel të lartë të sigurisë ushqimore. Shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve dhe siguria e ushqimit me origjinë shtazore ruhen së bashku me cilësinë e farërave, materialit mbrojtës të bimëve, mbrojtjen nga organizmat e dëmshëm dhe ushqimin e kafshëve.*

Kosova ndodhet **ndërmjet njëfarë niveli të caktuar dhe mesatar të përgatitjes** në fushën e sigurisë ushqimore, politikës veterinare dhe fitosanitare. Gjatë periudhës raportuese, Kosova ka arritur **progres të kufizuar**, pasi ka përgatitur dhe miratuar legjislacionin e nevojshëm dytësor, si dhe ka zhvilluar programe të mbikëqyrjes dhe eliminimit në lidhje me sëmundjet e kafshëve dhe programet e kontrollit të qenve endacakë. Është krijuar sistemi i kontrollit të ushqimit dhe i menaxhimit të gjurmueshmërisë si dhe sistemi i menaxhimit të informacionit laboratorik për laboratorët e sigurisë ushqimore dhe veterinare.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë përmbushur vetëm pjesërisht dhe për këtë arsye mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

- të sigurojë me kohë mjetet dhe burimet e nevojshme për funksionimin efektiv të sistemit të kontrollit të ushqimit dhe menaxhimit të gjurmueshmërisë dhe sistemit të menaxhimit të informacionit laboratorik të zhvilluar me mbështetjen e BE-së pasi që ato janë instrumentale në sigurimin e përputhshmërisë së produkteve ushqimore të prodhuara ose të tregtuara nga Kosova me sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve, mirëqenia e kafshëve dhe standardet e shëndetit të bimëve, që janë parakusht për një sektor konkurrues agror;
- të marrë vendim për një model për funksionimin e sistemit të grumbullimit të bimëve dhe nënprodukteve shtazore të riprodhimit dhe të fillojë e funksionimin e impiantit të riprodhimit;
- të forcojë mbikëqyrjen dhe kontrollin e sëmundjeve të kafshëve nëpërmjet zbatimit të përmirësuar të programeve të kontrollit dhe mbikëqyrjes së sëmundjeve, duke përfshirë marrjen e përgjegjësisë për financimin e plotë të fushatave të vaksinimit oral kundër tërbimit që do të kryhen nga vjeshta 2023 e tutje.

Kosova ka avancuar më tej në fushën e kontrollit dhe gjurmueshmërisë së ushqimit si dhe në sistemin e menaxhimit të informacionit laboratorik të menaxhuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë. Përveç kësaj, ka përgatitur një analizë të boshllëqeve në lidhje me legjislacionin që mbulon fushat e shëndetit të kafshëve, mirëqenies së kafshëve, sigurisë ushqimore dhe fitosanitare, si dhe strategjinë dhe planin e veprimit për hartimin e legjislacionit që mungon. Pavarësisht transferimit të 75 inspektorëve nga komunat, burimet financiare dhe njerëzore të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës mbeten të pamjaftueshme për zbatimin e plotë të *acquis* të BE-së në këtë fushë. Ndërsa laboratorit u shqimit dhe veterinarisë vazhdoi testimin dhe mori pjesë në testimin e aftësisë me laboratorët referent të BE-së, ende nuk ka progres në marrjen e akreditimit ndërkombëtar.

Është arritur njëfarë progresi i kufizuar në **politikën veterinare**. Kosova ka zhvilluar programe të mbikëqyrjes dhe eliminimit të sëmundjeve të kafshëve dhe në tetor të vitit 2022 ka miratuar Programin dhe Planin e Veprimit për Kontrollin e Qenve Endacakë. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë nuk ka zhvilluar ende apo filluar zbatimin e një sistemi gjithëpërfshirës të monitorimit dhe kontrollit të sëmundjeve, në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe kërkesat e Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve.

Planifikimi dhe zbatimi afatgjatë i programeve për **eliminimin e sëmundjeve endemike** në Kosovë kërkon përmirësim të mëtejshëm. E njëjta gjë vlen edhe për kontrollet e shëndetit të

kafshëve në nivel ferme, transportin e kafshëve dhe tregjet e bagëtive. Mungesa e burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare, si dhe mungesa e programeve të trajnimit dhe edukimit gjatë shërbimit, kanë penguar zbatimin adekuat të programeve në këto fusha.

Nuk është arritur asnjë progres në lidhje me **shëndetin e kafshëve**. Përderisa programi shumëvjeçar i kontrollit dhe mbikëqyrjes së sëmundjeve të kafshëve duhet të miratohet dhe zbatohet më tej, Kosova vazhdoi fushatat e vaksinimit për eliminimin e tërbimit. Marrja e përgjegjësive të plota për këto fushata nga vjeshta 2023, dhe vazhdimi i fushatave të vaksinimit dy herë në vit, është ende e nevojshme për të qenë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga *acquis* të BE-së.

Kosova nuk ka arritur progres në sistemin e grumbullimit dhe asgjësimit të **nënprodukteve shtazore**. Kjo nuk është ende funksionale pavarësisht ekzistencës së një fabrike të re dhe të pajisur të riprodhimit. Kosova ende nuk ka vendosur për modelin operativ dhe procedurat për impiantin e riprodhimit dhe sistemin e grumbullimit, si dhe për afatin kohor për funksionalizimin e tij.

Është arritur njëfarë progresi në **identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve**, përmes një fushate për vendosjen e mikroçipave për qentë me pronarë. Raportimi i ulët i lëvizjeve të kafshëve mbetet një sfidë. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ende nuk ka miratuar masa për të zbatuar rregulloren përkatëse në nivel të tregut blegtoral, thertoreve dhe transportit. Kosova nuk ka arritur progres në identifikimin e **masave të përputhshmërisë** në fushat e sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve.

**Në lidhje me vendosjen në treg të ushqimeve, ushqimeve për kafshë dhe nënprodukteve shtazore**, është arritur njëfarë progresi gjatë periudhës raportuese. Gjithashtu, Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve (PKMM) për vitin 2022 u plotësua dhe iu dorëzua Komisionit për vlerësim dhe komentet/korrigjimet u adresuan në përputhje me rrethanat.

Kosova ka arritur njëfarë progresi në **politikën fitosanitare**. Janë përgatitur procedurat standarde të veprimit dhe dokumentacioni i nevojshëm shoqërues i kërkuar për monitorimin e 18 dëmtuesve me prioritet të lartë (organizmave karantinë). Përafrimi ende nuk është siguruar për ushqimin e ri dhe për **organizmat e modifikuar gjenetiki**.

### **Kapitulli 13: Peshkataria dhe akuakultura**

*Politika e përbashkët e peshkatarisë përcakton rregulla për menaxhimin e peshkatarisë, mbron burimet e gjalla të detit dhe kufizon ndikimin mjedisor të peshkatarisë. Kjo përfshin përcaktimin e kuotave të kapjes, menaxhimin e kapacitetit të flotës, rregullat për kontrollin dhe inspektimin, rregullat për tregjet dhe akuakulturën, si dhe mbështetjen për peshkatarinë dhe komunitetet bregdetare. Më tej, ajo promovon një akuakulturë të qëndrueshme.*

Kosova mbetet në **fazën e hershme** të përgatitjes në këtë kapitull dhe nuk ka arritur **asnjë progres** në këtë fushë. Pasi që asnjë rekomandimet nga raporti i kaluar nuk janë zbatuar, në vitin e ardhshëm, Kosova duhet:

- të miratojë një strategji shumëvjeçare kushtuar akuakulturës;
- të përafrojë më tej politikën e tregut me *acquis*;
- të krijojë një inventar të llojeve të peshqve.

Kosova nuk ka vijë bregdetare, ka peshkim dhe akuakulturë të brendshme, prandaj *acquis* për kuotat e peshkimit, inspektimi dhe kontrolli është i zbatueshëm vetëm pjesërisht. *Acquis* për peshkimi mbulon gjithashtu operacionet e peshkimit dhe akuakulturës së brendshme.

Miratimi i strategjisë shumëvjeçare kushtuar akuakulturës dhe përafrimin e legjislacionit për



akuakulturën me *acquis* është në pritje.

Kosova duhet të fokusohet në krijimin e një **politike të tregut** dhe mbledhjes së të dhënave në përputhje me *acquis* të BE-së si dhe një inventari të llojeve të peshkut. Gjithashtu duhet të përforcojë ndjeshëm kapacitetin administrativ për menaxhimin e politikave, inspektimin dhe kontrollin.

## **Kapitulli 22: Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore**

*Politika rajonale është mjeti kryesor i BE-së për reduktimin e pabarazive rajonale dhe investimin në rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse socio-ekonomike. Ajo funksionon përmes “menaxhimit të përbashkët” ndërmjet Komisionit dhe Shteteve Anëtare të BE-së. Zbatimi i programeve të politikës së kohezionit kërkon kapacitete të përshtatshme administrative në nivel të programit dhe projektit, krijimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të shëndoshë financiar dhe gjithashtu përmbushjen e elementeve të tjera të *acquis* të BE-së, siç janë legjislacioni mjedisor ose i prokurimit publik.*

Kosova mbetet në **fazën e hershme të përgatitjes** në lidhje me politikën rajonale dhe koordinimin e instrumenteve strukturore. Gjatë periudhës raportuese, Kosova ka arritur **njëfarë progresi** në këtë fushë, kur miratoi Ligjin për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet:

- të miratojë Planin e Veprimit për Zhvillim Rajonal 2023-2025;
- të përmirësojë kapacitetet administrative dhe teknike në të gjitha strukturat operative të IPA-së;
- të zhvillojë më tej aktivitete që rrjedhin nga ligji si një hap drejt parimeve të politikës rajonale dhe të kohezionit të BE-së; të sigurojë zbatimin e kornizës ligjore dhe strategjike për zhvillimin rajonal, të përmirësojë programin lokal dhe rajonal, si dhe kapacitetin e planifikimit dhe implementimit të projekteve.

Kosova ka arritur njëfarë progresi në përafrimin e strategjisë së saj ekzistuese dhe **kornizës legjislative** për menaxhim dhe kontroll financiar publik me *acquis* të BE-së. Baza ligjore, përkatësisht Ligji për Zhvillim Rajonal të Balancuar, i miratuar në korrik 2023, dhe Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Zhvillimin Rajonal 2020-2030, i miratuar në qershor 2023, përmirësojnë politikën e zhvillimit rajonal.

Agjencia e Statistikave në bashkëpunim me EUROSTAT-in ende nuk ka harmonizuar rajonet statistikore me ato ekonomike. Buxheti për zhvillim rajonal në vitin 2022 është 4.2 milionë euro.

**Korniza institucionale** për menaxhimin e fondeve të BE-së nuk është përcaktuar ende. Në të njëjtën kohë, strukturat për menaxhim programeve dhe projekteve kombëtare të zhvillimit rajonal janë funksionale. Në lidhje me **kapacitetet administrative**, kërkohen përpjekje të konsiderueshme për të caktuar më shumë burime njerëzore dhe për të rritur kapacitetet e tyre, veçanërisht në planifikimin dhe menaxhimin e fondeve të BE-së. Në lidhje me **menaxhimin, kontrollin dhe auditimin financiar**, ministrinë kanë krijuar shërbime të brendshme funksionale. Autoriteti kombëtar i auditimit kryen menaxhimin dhe auditimin financiar qendror.

**Programimi** fokusohet në projektet kombëtare të zhvillimit rajonal dhe asistencën e ardhshme të IPA-së. Aktualisht, nuk ka projekte të financuara nga IPA për zhvillimin rajonal. Në fushën e **monitorimit dhe vlerësimit**, vazhduan aktivitetet e rregullta në fushën e programeve dhe projekteve të zhvillimit rajonal.

Gjatë periudhës raportuese, Kosova ka zbatuar **programet e bashkëpunimit ndërkufitar** me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi. Sa i përket programeve të bashkëpunimit ndërkombëtar, Kosova për shkak të çështjeve të statusit nuk merr pjesë në programet e bashkëpunimit transnacional dhe ndër-rajonal që mbulojnë Ballkanin Perëndimor.

## **GRUPIMI 6: MARRËDHËNIET E JASHTME**

Në fushën e tregtisë, Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjes. Është arritur progres i kufizuar gjatë periudhës raportuese. Është arritur përmirësim në zvogëlimin e deficitit tregtar të Kosovës, megjithatë Kosova ende nuk ka miratuar një politikë tregtare gjithëpërfshirëse dhe as nuk ka ratifikuar Protokollin Shtesë të CEFTA-s për lehtësimin e tregtisë dhe tregtinë e shërbimeve.

### **Kapitulli 30: Marrëdhëniet e jashtme**

*BE-ja ka një politikë të përbashkët tregtare ndaj vendeve të treta, bazuar në marrëveshje shumëpalëshe dhe dypalëshe dhe masa autonome. Ekzistojnë gjithashtu rregulla të BE-së në fushën e ndihmës humanitare dhe politikave zhvillimore.*

Kosova është në **fazën e hershme të përgatitjes** në fushën e marrëdhënieve të jashtme. Është arritur **progres** i kufizuar gjatë periudhës raportuese. Kosova ka arritur progres në zbatimin e planit të veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal, veçanërisht duke ratifikuar tri “marrëveshjet e procesit të Berlinit” për lëvizjen e lirë dhe njohjen reciproke të kualifikimeve. Kosova duhet të përmbahet nga marrja e masave të mëtejshme të njëanshme tregtare pa arsyetim dhe konsultim paraprak me Komisionin, në përputhje me zotimet e saj të MSA-së. Mosmarrëveshjet në lidhje me përfaqësimin e Kosovës kanë bërë që qeveria të bllokojë mekanizmat vendimmarrës në CEFTA. Kosova ende nuk ka krijuar një politikë humanitare dhe zhvillimore.

Pasi që nuk janë zbatuar të gjitha rekomandimet nga raporti i mëparshëm, një pjesë e rekomandimeve mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

- të zbatojë angazhimet sipas Planit të Veprimit 2021-2024 të Tregut të Përbashkët Rajonal; të ratifikojë dhe zbatojë Protokollin Shtesë 5 të CEFTA-s për lehtësimin e tregtisë dhe Protokollin Shtesë 6 për tregtinë e shërbimeve; dhe të finalizojë negociatat dhe të miratojë Protokollin Shtesë 7 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- të miratojë Rregulloren për themelimin e pikës hetimore për lehtësimin e tregtisë;
- të fillojë procesin për krijimin e politikës zhvillimore dhe të ndihmës humanitare.

Sa i përket **politikës së përbashkët tregtare**, Kosova ende nuk ka miratuar një politikë gjithëpërfshirëse tregtare apo nuk ka ratifikuar Protokollin Shtesë të CEFTA-s për lehtësimin e tregtisë dhe tregtinë e shërbimeve.

Më 8 nëntor 2022, Kuvendi miratoi Ligjin për masat e përkohshme të produkteve themelore në raste të veçanta të destabilizimit të tregut, i cili i dha qeverisë autoritetin për të vendosur kufizime tregtare, kontrolle të çmimeve dhe masa racionale në raste emergjente. Zbatimi i këtij ligji të ri është pezulluar pasi partitë opozitare e referuan atë në Gjykatën Kushtetuese, me arsyetimin se paraqet shkelje të dispozitave kushtetuese për tregun e lirë. Gjykata ende nuk ka marrë vendim.

Qeveria mbështet Tregun e Përbashkët Rajonal (TPR) si bazë për një marrëveshje rajonale të tregtisë së lirë. Kosova vazhdon të arrijë progres në zbatimin e masave teknike të planit të veprimit CRM 2021-2024, veçanërisht në lidhje me korsitë e gjelbra. Gjatë periudhës raportuese, Kosova ka miratuar tri ligje të rëndësishme për CRM: për ratifikimin e

Marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve profesionale për mjekë, stomatologë dhe arkitektë; për ratifikimin e Marrëveshjes së Ballkanit Perëndimor për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë; dhe për ratifikimin e Marrëveshjes për lirinë e lëvizjes me letërnjoftime në Ballkanin Perëndimor.

Megjithatë, mosmarrëveshjet në lidhje me përfaqësimin dhe emërtimin e Kosovës në CEFTA po pengojnë progresin në fushat tjera, veçanërisht në lëvizjen e lirë të punëtorëve. Këto mosmarrëveshje kanë bërë që qeveria të bllokojë edhe mekanizmat vendimmarrës në CEFTA-s, për miratimin e buxhetit dhe emërimin e drejtorit të ri që ende janë në pritje për shkak të mungesës së konsensusit. Kosova, së bashku me të gjithë pjesëmarrësit në CRM, duhet të luajë rol konstruktiv dhe të përmbushë zotimet e përbashkëta të përcaktuara në planin e veprimit. Në qershor 2023, Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës (MPB) nxori një *“masë të përkohshme të sigurisë operationale”* duke bllokuar hyrjen në Kosovë të mallrave dhe pakove postare serbe. Kjo masë duket se nuk është në përputhje me angazhimet e Kosovës sipas CEFTA-s dhe bie ndesh me frymën e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Kjo masë është vendosur nga Kosova pas arrestimit të tre policëve të Kosovës nga autoritetet serbe në mesin e qershorit. Policët u liruan përfundimisht në fund të qershorit.

Ekziston nevoja për të rritur kapacitetet e departamentit të tregtisë. Nevojat janë si në numrin e stafit ashtu edhe në ngritjen e kapaciteteve të tyre për t'u përballur me detyra komplekse. Vonesat në qasjen në bazat e të dhënave tregtare të Doganës së Kosovës dhe në statistikave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës kanë ndikuar negativisht në efikasitetin e departamentit të tregtisë.

Ligji i Kosovës për **mallra me përdorim të dyfishtë** mbetet në përputhje me rregulloret e BE-së. Kosova ka përditësuar listën e saj të mallrave me përdorim të dyfishtë në përputhje me Rregulloren e deleguar të Komisionit të BE-së 2023/66 të datës 21 tetor 2022.

Sa i përket **marrëveshjeve dypalëshe me vendet e treta** për bashkëpunim ekonomik/tregtar/teknik, Kosova ka një numër të Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë (MTL) me vendet e zgjerimit dhe vendet e treta. Kosova ka arritur marrëveshje për partneritet tregtar dhe bashkëpunim me Mbretërinë e Bashkuar dhe takimi i parë i Këshillit të Partneritetit është mbajtur në dhjetor të vitit 2022. Në qershor të vitit 2022, shtetet EFTA dhe Kosova nisën zyrtarisht negociatat për tregtinë e lirë. Mes gushtit dhe dhjetorit të vitit 2022, pati dy raunde negociatash, me progres të mirë në të gjitha fushat.

Ka pasur disa zhvillime në fushat e **politikës zhvillimore dhe ndihmës humanitare**. Pasi që Kosova është përfituese e programeve të ndihmës, ajo nuk ofron ndihmë humanitare për vendet e treta në mënyrë sistematike. Nuk ka agjenci për ndihmë zhvillimore. Kosova inkurajohet të fillojë procesin e krijimit të kornizës ligjore që mbulon bashkëpunimin ndërkombëtar dhe politikën zhvillimore si dhe ndihmën humanitare, në përputhje me politikën dhe parimet e BE-së, dhe të ndërtojë struktura të dedikuara administrative. Në kontekstin e luftës së agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, Kosova u zotua të presë deri në 5000 refugjatë dhe 20 gazetarë nga Ukraina. Kosova gjithashtu premtoi ndihmë për Turqinë dhe Sirinë pas tërmetit në shkurt 2023.

## SHTOJCA I – MARRËDHËNIET NDËRMJET BE-SË DHE KOSOVËS

**Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA)** BE-Kosovë është në fuqi që nga prilli i vitit 2016. Kjo marrëveshje gjithëpërfshirëse ofron një kornizë për dialogun politik dhe mbulon bashkëpunimin në sektorë të ndryshëm. Që nga viti 2016, janë mbajtur pesë takime të Këshillit të Stabilizim-Asociimit dhe shtatë cikle takimesh të nënkomisioneve. Kosova merr pjesë në dialogun ministror ndërmjet ministrave të ekonomisë dhe financave të BE-së dhe vendeve kandidatë dhe kandidatë potenciale, duke synuar t'i ndihmojë këto të fundit të përmbushin gradualisht kriteret e anëtarësimit ekonomik dhe të jenë më të përgatitura për reformat ekonomike, konkurrencën dhe krijimin e vendeve të punës.

Më 31 mars 2023, qeveria miratoi Programin Kombëtar për Integrimin në BE 2023-2027 të, i cili pastaj u miratua nga Kuvendi më 15 qershor 2023. Për të udhëhequr më tej zbatimin e reformave në kuadër të MSA-së, në nëntor të vitit 2016, Komisioni dhe Kosova miratuan **Agjendën e Reformës Evropiane (ERA)**. Ajo përshkruan veprimet me prioritet në fushat e qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit, konkurrencës, investimeve, zhvillimit të qëndrueshëm, punësimit, arsimit dhe shëndetësisë. Në vitin 2021, Kosova miratoi fazën e dytë të ERA-s (ERA II) përmes një plani të veprimit të dedikuar. Kosova duhet të kishte zbatuar prioritetet e identifikuar të ERA II brenda një periudhe dyvjeçare, deri në mesin e vitit 2023.

Qeveria paraqiti kërkesë për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit më 15 dhjetor 2022.

Në lidhje me **liberalizimi i vizave** për Kosovën, Rregullorja përkatëse është miratuar më 9 mars nga Këshilli dhe më 18 prill 2023 nga Parlamenti Evropian. Rregullorja ua mundëson mbajtësve të pasaportave biometrike të Kosovës të udhëtojnë në BE pa viza për një periudhë prej 90 ditësh brenda çdo periudhe 180 ditore, duke filluar nga 1 janari 2024..

Mbështetja dypalëshe e BE-së për Kosovën në kuadër të **Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimi II (IPA II)** në periudhën 2014-2020 arriti në 562 milionë euro dhe përfshinte, ndër të tjera, operacionet e mbështetjes buxhetore për reformën e administratës publike, menaxhimin e financave publike dhe rimëkëmbjen socio-ekonomike.

Ndihma e BE-së për Kosovën për COVID arriti në 68 milionë euro. Si pjesë e reagimit më të gjerë ndaj COVID-19, BE vuri në dispozicion një skemë të Asistencës Makro Financiare prej 100 milionë euro në formë të një kredie shumë të favorshme për të mbështetur ekonominë lokale.

Rregullorja e IPA III për periudhën financiare 2021-2027<sup>22</sup> vazhdon të ofrojë mbështetje financiare për rajonin dhe gjithashtu do të financojë Planin Ekonomik të Investimeve (PEI) për Ballkanin Perëndimor. Programet vjetore IPA 2021, 2022 dhe 2023 përfshijnë një kontribut të BE-së në shumën prej rreth 201 milionë euro. Sipas PIE-së, Kosova përfiton 312 milionë euro, duke gjeneruar investime të mobilizuara prej 940 milionë euro.

Në Samitin BE-BB në Tiranë në dhjetor të vitit 2022, Komisioni parashtroi një **Paketë të Mbështetjes Energjetike** prej 1 miliard euro për Ballkanin Perëndimor për të adresuar nevojat imediate, afatshkurtra dhe afatmesme në rajon në kontekstin e krizës energjetike dhe të luftës së agresionit rus kundër Ukrainës. Kosova do të përfitojë 75 milionë euro nga financimi i IPA 2023 nga kjo paketë.

Kosova vazhdon të përfitojë nga mbështetja në kuadër të programeve nga shumë vende dhe ato rajonale të IPA-s. Përveç kësaj, Kosova merr pjesë në tri **programe të bashkëpunimit ndërkufitar**, dhe përfiton, me mbështetjen e IPA-s, nga pjesëmarrja në disa programe të BE-

---

<sup>22</sup> Gazeta Zyrtare L 330, 20.9.2021

së. Që nga viti 2018, Kosova iu bashkua **programeve** të mëposhtme të **BE-së**: Erasmus+, Programi i Tregut Unik, Programi Qytetarët, Barazia, të Drejtat dhe Vlerat, Evropa Kreative, Doganat, Fiscalis dhe Horizon Europe. Për të lehtësuar progresin në procedurat e lejeve, Kosova po merr pjesë si vëzhguese në një pilot projekt në kuadër të Instrumentit të Mbështetjes Teknike.

Kosova dhe **Europoli** kanë forcuar bashkëpunimin e tyre. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Punës kornizë në korrik të vitit 2020, ekzistojnë tri marrëveshje/protokolle shtesë: Memorandumi i Mirëkuptimit për Linjën e Sigurt të Komunikimit përmes SIENA-s, Marrëveshja për dërgimin e Zyrtarëve Ndërlidhës dhe Marrëveshja për shkëmbimin dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Lidhja SIENA është plotësisht funksionale. Që nga 15 marsi 2023, Policia e Kosovës ka zyrtarin e parë ndërlidhës me Europolin në Hagë.

Që nga viti 2008, **Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX)** ka ndihmuar autoritetet e Kosovës në krijimin e institucioneve të qëndrueshme dhe të pavarura të sundimit të ligjit. Sipas mandatit aktual të vazhduar deri më 14 qershor 2025, Misioni vazhdon të ndër marrë aktivitete monitoruese dhe ka funksione të kufizuara ekzekutive.

**Frontex** është duke vendosur zyrtarë e tij në disa pika të kalimit kufitar në Kosovë bazuar në planet operative të dakorduara reciprokisht. Përveç kësaj, agjencia ofron mbështetje të tjera lidhur me menaxhimin kufitar, p.sh. udhëzime në procesin e krijimit të Qendrës Kombëtare të Koordinimit (QKK).

Deri më sot, sipas qeverisë, Kosova është njohur nga 117 vende, duke përfshirë 22 shtete anëtare të BE-së.

Pas luftës së agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, Kosova ka vazhduar të miratojë paketa sanksionesh kundër Rusisë dhe Bjellorusisë duke mbështetur ato të vendosura nga BE-ja dhe SHBA-ja. Ndër masat e marra ishte edhe pezullimi i aktiviteteve të transmetimit të kanaleve mediatike ruse në Kosovë dhe vendosja e kërkesës për vizë për qytetarët rusë. Sa i përket mbështetjes së Kosovës për Ukrainën, qeveria ndau 100 000 euro ndihmë humanitare dhe fonde të dedikuara për strehimin e 20 gazetarëve nga Ukraina. Kuvendi miratoi një rezolutë që shpreh gatishmërinë për të prituri deri në 5 000 refugjatë ukrainas.

Në lidhje me përshkallëzimin e situatës në veri të Kosovës në maj të vitit 2023, BE-ja i kërkoi Kosovës dhe Serbisë që menjëherë dhe pa kushte të ndërmarrin masa për depërshkallëzimin e situatës dhe për t'iu kthyer procesit të normalizimit të marrëdhënieve. Për shkak të mungesës së hapave vendimtarë për depërshkallëzimin nga Kosova, dhe në përputhje me Deklaratën e 3 qershorit, BE-ja vendosi të marrë një sërë masash.

Puna e organeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është ndaluar. Programimi i fondeve për Kosovën në kuadër të ushtrimit programor IPA 2024 është pezulluar tani për tani. Propozimet e paraqitura nga Kosova në kuadër të Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF) nuk janë dorëzuar për shqyrtim nga Bordi i WBIF-së. Për sa i përket mbështetjes së vazhdueshme, procedurat e prokurimit dhe nënshkrimi i kontratave të reja janë pezulluar. Kosova gjithashtu nuk u ftua në ngjarje të nivelit të lartë dhe vizitat dypalëshe u pezulluan, përveç atyre të fokusuara në adresimin e krizës në veri të Kosovës dhe atyre që kanë të bëjnë me integrimin rajonal të Ballkanit Perëndimor.

Këto masa janë të përkohshme dhe të hiqen varësisht nga hapat e besueshëm, vendimtar dhe me kohë të ndërmarrë nga autoritetet e Kosovës për depërshkallëzimin e situatës, për t'iu kthyer në Dialog dhe për të zbatuar zotimet e marra në këtë kontekst.

**TË DHËNA STATISTIKORE (deri më 31/08/2023)**
**Kosova**

<b>Të dhënat bazë</b>	Shënim	2010	2017	2018	2019	2020	2021
Popullsia (mijë)		2 208 s	1 784 s	1 799 s	1 796 s	1 782 s	1 798 s
Sipërfaqja totale e vendit (km <sup>2</sup> )	1)	10 908 w	10 905 w	10 905 w	10 905 w	10 905 w	10 905 w

<b>Llogaritë kombëtare</b>	Shënim	2010	2017	2018	2019	2020	2021
Bruto produkti vendor (BPV) (milion euro)		4 031	6 357	6 672	7 056	6 772	7 958
BPV (euro për kokë banori)		1 826 s	3 564 s	3 709 s	3 930 s	3 800 s	4 426 s
BPV për kokë banori (në standardet e fuqisë blerëse (SFB))		:	:	:	:	:	:
BPV për kokë banori (në SFB), në raport me mesataren e BE-së (BE-27 = 100)		:	:	:	:	:	:
Norma reale e rritjes së BPV-së: ndryshimi i vëllimit të BPV-së në krahasim me vitin e kaluar (%)		4,9	4,8	3,4	4,8	- 5,3	10,7
Rritja e punësimit (të dhënat e llogarive kombëtare), në krahasim me vitin e kaluar (%)		:	c	c	c	:	:
Rritja e produktivitetit të punës: rritja e BPV-së (në vëllim) për person të punësuar, në krahasim me vitin e kaluar (%)		:	c	c	c	:	:
Rritja e kostos së punës për njësi, në krahasim me vitin e kaluar (%)		:	c	c	c	:	:
**Ndryshim 3 vjeçar (T/T-3) në indeksin nominal të rritjes së kostos së punës për njësi (2015 = 100)		:	c	c	c	:	:
Produktiviteti i punës për person të punësuar: BPV (në SFB) për person të punësuar në raport me mesataren e BE-së (BE-27 = 100)		:	:	:	:	:	:
Vlera e shtuar bruto sipas sektorëve kryesorë							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (%)		11.5	9.2	8.1	9.0	8.9	8.6
Industria (%)		23.5	24.1	24.2	23.4	24.1	23.6
Ndërtimi (%)		9.3	10.1	10.4	10.1	9.3	10.6
Shërbimet (%)		55.6 s	56.5 s	57.2 s	57.5 s	57.7 s	57.2 s
Shpenzimet e konsumit final, si pjesë e BPV-së (%)		105.7	91.1	91.9	92.6	98.8	95.9
Formimi i kapitalit fiks bruto, si pjesë e BPV-së (%)		31.0	30.0	31.7	31.0	29.7	32.9
Ndryshimet në inventarë, si pjesë e BPV-së (%)		2.1	4.7	4.6	3.5	3.7	3.1
Eksportet e mallrave dhe shërbimeve, në raport me BPV-në (%)		21.7	27.3	29.1	29.3	21.7	33.4
Importet e mallrave dhe shërbimeve, në raport me BPV-në (%)		60.5	53.1	57.3	56.4	53.9	65.2
Formimi i kapitalit fiks bruto nga sektori i qeverisë së përgjithshme, si përqindje e BPV-së (%)		:	:	:	:	:	:

<b>Biznesi</b>	Shënim	2010	2017	2018	2019	2020	2021
Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2015 = 100)		:	:	:	:	:	:
Numri i ndërmarrjeve aktive (numri)		29 710 pw	34 355 w	31 028 pw	34 615 w	40 056 w	45 468 w

Norma e themelimeve: numri i ndërmarrjeve të themeluara në periudhën e referencës (t) pjesëtuar me numrin e ndërmarrjeve aktive në t (%)		13.9 pw	8.7 w	4.8 pw	:	:	:
Norma e mbylljeve: numri i ndërmarrjeve të mbyllura në periudhën e referencës (t) pjesëtuar me numrin e ndërmarrjeve aktive në t (%)		5.3 w	4.2 w	3.7 pw	4.2 w	2.6 w	:
Personat e punësuar në NVM si përqindje e të gjithë personave të punësuar (brenda ekonomisë së biznesit jofinanciar) (%)		:	78.8 sw	78.4 psw	9.6 sw	8.6 sw	7.7 sw
Vlera e shtuar nga NVM-të (në ekonominë e biznesit jofinanciar) (milion euro)		:	:	:	:	:	:
Vlera totale e shtuar (në ekonominë e biznesit jofinanciar) (milion euro)		:	:	:	:	:	:

#### Norma e inflacionit dhe çmimet e shtëpive

	Shënim	2010	2017	2018	2019	2020	2021
Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK), ndryshim në raport me vitin e kaluar (%)		:	1.5 d	1.1 d	2.7 d	0.2 d	3.4 d
**Ndryshimi vjetor në indeksin e çmimeve të shtëpive të zhvlerësuara (2015 = 100)		:	:	:	:	:	:

#### Bilanci i pagesave

	Shënim	2010	2017	2018	2019	2020	2021
Bilanci i pagesave: totali i llogarisë rrjedhëse (milion euro)		- 516.1	- 348.6	- 508.8	- 399.5	- 472.2	- 694.6
Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: bilanci tregtar (milion euro)		- 1 741.6	- 2 464.2	- 2 737.7	- 2 840.2	- 2 573.2	- 3 567.0
Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: shërbimet neto (milion euro)		176.0	827.3	855.8	926.0	391.6	1 034.9
Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: bilanci neto për të ardhurat primare (milion euro)		67.0	127.4	113.1	160.6	164.0	150.9
Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: bilanci neto për të ardhurat sekondare (milion euro)		982.5	1 161.0	1 260.0	1 354.1	1 545.4	1 686.2
Bilanci neto për të ardhurat primare dhe sekondare: nga të cilat transfere të qeverisë (milion euro)		319.5	199.7	226.1	236.6	276.6	233.7
**Mesatarja lëvizëse 3-vjeçare e bilancit të llogarisë rrjedhëse në raport me BPV-në (%)		:	- 7.6	- 7.1	- 6.3	- 6.8	- 7.1
**Ndryshim pesë vjeçar në pjesëmarrjen e eksporteve botërore të mallrave dhe shërbimeve (%)		:	28.3	37.6	37.0	14.9	49.4
Bilanci neto (hyrës - dalës) i investimeve të huaja direkte (IHD) (milion euro)		331.1 w	212.0 w	225.8 w	188.4 w	286.6 w	320.4 w
Investimet e huaja direkte (IHD) jashtë vendit (milion euro)		37.4 w	43.4 w	46.3 w	66.2 w	59.1 w	100.3 w
nga të cilat IHD të ekonomisë raportuese në vendet e BE-27 (milion euro)		:	14.1 w	13.0	6.1	16.5	26.5
Investimet e huaja direkte (IHD) në ekonominë raportuese (milion euro)		368.5 w	255.4 w	272.1 w	254.6 w	345.7 w	420.7 w
nga të cilat IHD të vendeve të BE-27 në ekonominë raportuese (milion euro)		:	86.1 w	58.7	158.6	152.1	215.6
**Pozicioni neto i investimeve ndërkombëtare, në raport me BPV-në (%)		9.2 w	- 1.8 w	- 6.1 w	- 5.8 w	- 12.3 w	- 11.6 w
Norma e ndryshimit nga viti në vit në fluksin bruto të remitançave (në valutë kombëtare) nga punëtorët migrantë (%)		14.5 sw	11.9 s	12.0 s	12.1 s	14.5 s	14.5 s

#### Financat publike

	Shënim	2010	2017	2018	2019	2020	2021
Deficiti/suficiti i qeverisë së përgjithshme, në raport me BPV-në (%)		:	- 0.8 w	- 1.0 w	- 0.5 w	- 5.2 w	:
Borxhi bruto i qeverisë së përgjithshme në raport me BPV-në (%)		5.9 ew	16.6 ew	17.1 ew	17.5 w	21.8 w	:
Të ardhurat totale të qeverisë, si përqindje e BPV-së (%)		26.8 w	30.2 w	30.1 w	31.5 w	32.6 w	:

Shpenzimet totale të qeverisë, si përqindje e BPV-së (%)		28.9 w	28.9 w	29.6 w	30.5 w	34.4 w	:
--	--	--------	--------	--------	--------	--------	---

<b>Treguesit financiarë</b>	Shënim	2010	2017	2018	2019	2020	2021
Borxhi i jashtëm bruto i gjithë ekonomisë, në raport me BPV-në (%)		34.0 sw	32.9 sw	30.5 sw	31.2 sw	37.2 sw	37.4 sw
Borxhi i jashtëm bruto i gjithë ekonomisë, në raport me totalin e eksporteve (%)		157.0 w	120.2 w	105.0 w	106.4 w	171.2 w	111.9 w
Oferta e parave: M1 (kartëmonedhat, monedhat, depozitat njëditore, milion euro)		:	:	:	:	:	:
Oferta e parave: M2 (M1 plus depozitat me maturim deri në dy vite, milionë euro)		:	:	:	:	:	:
Oferta e parave: M3 (M2 plus instrumentet e tregtueshme, milionë euro)		:	:	:	:	:	:
Kredia totale nga institucionet financiare monetare për rezidentët (e konsoliduar) (milion euro)		1 458.7 w	2 629.5 w	2 939.2 w	:	:	:
**Ndryshimi vjetor në detyrimet e sektorit financiar (%)		:	:	:	:	:	:
**Rrjedha e kredisë private, e konsoliduar, në raport me BPV-në (%)		:	:	:	:	:	:
**Borxhi privat, i konsoliduar, në raport me BPV-në (%)		:	:	:	:	:	:
Normat e interesit: norma e parave ditore, në vit (%)		:	:	:	:	:	:
Norma e interesit të kredisë (një vit), në vit (%)	2)	14.63 w	6.83 w	6.65 w	6.51 w	6.21 w	5.96 w
Norma e interesit të depozitave (një vit), në vit (%)	2)	3.70 w	1.04 w	1.31 w	1.46 w	1.49 w	1.33 w
Kurset e këmbimit të euros: mesatarja e periudhës (1 euro = ... valutë kombëtare)		1 w	1 w	1 w	1 w	1 w	1 w
Indeksi i kursit efektiv të këmbimit i ponderuar sipas tregtisë, 42 vende (2015 = 100)		:	:	:	:	:	:
**Ndryshim 3 vjeçar (T/T-3) në indeksin e kursit efektiv të këmbimit të ponderuar sipas tregtisë, 42 vende (2015 = 100)		:	:	:	:	:	:
Vlera e aktiveve rezervë (përfshirë arin) (milion euro)		612.5 w	683.4 w	769.3 w	863.7 w	900.8 w	1 100.3 w

<b>Tregtia e jashtme e mallrave</b>	Shënim	2010	2017	2018	2019	2020	2021
Vlera e importit: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion euro)		2 158	3 047	3 347	3 497	3 297	4 684
Vlera e eksporteve: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion euro)		296	378	368	384	475	756
Bilanci tregtar: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion euro)		- 1 862	- 2 669	- 2 980	- 3 114	- 2 822	- 3 929
Kushtet e tregtisë (indeksi i çmimeve të eksportit / indeksi i çmimit të importit * 100) (numri)		100.0 sw	93.0 sw	91.0 sw	94.2 sw	92.6 sw	101.4 sw
Pjesa e eksporteve në vendet e BE-27 në vlerën e eksporteve totale (%)		45.2 s	22.0 s	27.5 s	33.2 s	34.5 s	31.5 s
Pjesëmarrja e importeve nga vendet e BE-27 në vlerën e importeve totale (%)		40.4 s	42.3 s	42.7 s	49.1 s	45.8 s	44.3 s

<b>Demografia</b>	Shënim	2010	2017	2018	2019	2020	2021
Shkalla bruto e ndryshimit natyror të popullsisë (shkalla e rritjes natyrore): numri i lindjeve minus vdekjet (për një mijë banorë)		13.3 b	8.2 e	7.7	6.9	7.4 ep	:
Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave dhe vdekjeve të fëmijëve nën moshën një vjeçare (për një mijë lindje të gjalla)		8.8	9.7	10.6	8.7	:	:
Jetëgjatësia në lindje: mashkull (vite)		:	:	:	:	:	:
Jetëgjatësia në lindje: femër (vite)		:	:	:	:	:	:



<b>Tregu i punës</b>	Shënim	2010	2017	2018	2019	2020	2021
Shkalla e aktivitetit ekonomik për personat e moshës 20-64 vjeçare: përqindja e popullsisë 20-64 vjeçare që është ekonomikisht aktive (%)		:	49.0 w	46.6 w	45.2 w	42.9 w	43.9 w
*Shkalla e punësimit për personat e moshës 20-64 vjeçare: përqindja e popullsisë së moshës 20-64 vjeçare që është e punësuar (%)		:	34.4 w	33.2 w	34.2 w	32.3 w	35.1 w
Shkalla e punësimit të meshkujve për personat e moshës 20-64 vjeçare (%)		:	54.0 w	52.6 w	53.0 w	48.8 w	51.9 w
Shkalla e punësimit të femrave për personat e moshës 20-64 vjeçare (%)		:	14.6 w	14.1 w	15.6 w	16.0 w	18.5 w
Shkalla e punësimit për personat e moshës 55-64 vjeçare: përqindja e popullsisë së moshës 55-64 vjeçare që është e punësuar (%)		:	32.7 w	31.5 w	32.2 w	30.9 w	32.1 w
<b>Punësimi sipas sektorëve kryesorë</b>							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (%)		:	4.4 w	3.5 w	5.2 w	4.8 w	2.8 w
Industria (%)		:	17.4 w	14.3 w	15.1 w	16.3 w	14.8 w
Ndërtimi (%)		:	12.9 w	11.9 w	12.6 w	11.1 w	10.5 w
Shërbimet (%)		:	65.3 w	70.3 w	67.1 w	67.9 w	71.9 w
Personat e punësuar në sektorin publik si pjesëmarrje në punësimin total, personat e moshës 20-64 vjeçare (%)		:	28.4 w	30.8 w	27.6 w	28.7 w	28.3 w
Personat e punësuar në sektorin privat si pjesëmarrje në punësimin total, personat e moshës 20-64 vjeçare (%)		:	71.6 w	69.2 w	72.4 w	71.3 w	71.7 w
Shkalla e papunësisë: përqindja e fuqisë punëtore që është e papunë (%)		:	30.3 w	29.4 w	25.5 w	25.8 w	20.6 w
Shkalla e papunësisë së meshkujve (%)		:	28.5 w	28.3 w	22.4 w	23.4 w	18.9 w
Shkalla e papunësisë së femrave (%)		:	36.4 w	33.3 w	34.4 w	32.2 w	24.9 w
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë: përqindja e fuqisë punëtore të moshës 15-24 vjeçare që është e papunë (%)		:	52.7 w	55.4 w	49.4 w	49.1 w	38.0 w
Shkalla e papunësisë afatgjatë: përqindja e fuqisë punëtore që ka qenë e papunë për 12 muaj ose më shumë (%)		:	21.7 w	17.2 w	16.2 w	18.4 w	14.5 w
Shkalla e papunësisë për personat (25-64 vjeçar) që kanë përfunduar më së shumti arsimin e mesëm të ulët (nivelet ISCED 0-2) (%)		:	32.5 w	35.8 w	28.3 w	30.2 w	27.6 w
Shkalla e papunësisë për personat (25-64 vjeçar) që kanë përfunduar arsimin e lartë (nivelet ISCED 5-8) (%)		:	23.4 w	16.8 w	18.0 w	17.0 w	13.7 w

<b>Kohezioni social</b>	Shënim	2010	2017	2018	2019	2020	2021
Pagat dhe mëditjet nominale mesatare mujore (valuta kombëtare)		:	431 w	453 w	477 w	466 w	484 w
Indeksi i pagave dhe mëditjeve reale (indeksi i pagave dhe mëditjeve nominale pjesëtuar me indeksin e inflacionit) (2016 = 100)		:	:	:	:	:	:
Koeficienti GINI		:	:	44	46 w	45 w	:
Hendeku i varfërisë		:	:	47.4	55.3 w	46.6 w	:
*Të larguarit e hershëm nga arsimi dhe aftësimi: përqindja e popullsisë së moshës 18-24 vjeçare me arsim të mesëm të ulët që nuk është në arsim ose aftësim të mëtejshëm (%)		:	12.2 w	9.6 w	8.2 w	7.8 w	7.0 w

<b>Nivel i jetesës</b>	Shënim	2010	2017	2018	2019	2020	2021

Numri i veturave të pasagjerëve në raport me madhësinë e popullsisë (numri për një mijë banorë)		90.6 sw	153.6 sw	155.9 sw	162.2 sw	164.4 sw	:
Numri i abonimeve për telefona celularë në raport me madhësinë e popullsisë (numri për një mijë banorë)		:	1 200.7 ew	1 281.1 ew	1 266.4 ew	1 095.0 ew	1 072.0 ew
Depërtimit i brezit të gjerë celular (për 100 banorë)		:	65.4 ew	73.9 ew	78.4 ew	84.5 ew	88.4 ew
Depërtimit i brezit të gjerë fiks (për 100 banorë)		:	15 ew	18 ew	20 ew	21 ew	22 ew

<b>Infrastruktura</b>	Shënim	2010	2017	2018	2019	2020	2021
Dendësia e rrjetit hekurudhor (linjat në funksionim për mijë km <sup>2</sup> )	1)	30.3 sw	30.5 sw	30.5 sw	30.5 sw	30.5 sw	30.5 sw
Gjatësia e autoudhëve (kilometra)		w	108 w	119 w	137 w	137 w	137 w

<b>Inovacioni dhe kërkimi</b>	Shënim	2010	2017	2018	2019	2020	2021
Shpenzimet publike për arsimin në raport me BPV-në (%)		:	4.4 sw	4.5 sw	4.6 sw	4.6 sw	4.3 sw
*Shpenzimet e brendshme bruto për kërkim dhe zhvillim në raport me BPV-në (%)		:	:	:	:	:	:
Ndarjet buxhetore të qeverisë ose shpenzimet për kërkim dhe zhvillim (GBAORD), si përqindje e BPV-së (%)		:	:	:	:	:	:
Përqindja e familjeve që kanë qasje në internet në shtëpi (%)		:	88.8	93.2	93.2	96.4	:

<b>Mjedisi</b>	Shënim	2010	2017	2018	2019	2020	2021
*Indeksi i emetimeve të gazrave serrë, ekuivalent të CO <sub>2</sub> (1990 = 100)		:	:	:	:	:	:
Intensiteti energjetik i ekonomisë (kg ekuivalent naftë për 1 000 euro BPV me çmime konstante të 2015)		553.1	409.0	398.1	392.3	413.9	405.0
Energjia elektrike e prodhuar nga burime të ripërtëritshme në raport me konsumin bruto të energjisë elektrike (%)		1.4	3.6	4.2	5.2	5.3	5.4
Pjesëmarrja rrugore e transportit të brendshëm të mallrave (bazuar në ton-km) (%)		:	:	:	:	:	:

<b>Energjia</b>	Shënim	2010	2017	2018	2019	2020	2021
Prodhim i primar i të gjitha produkteve energjetike (mijë TOE)		1 861	1 793	1 822	1 849	1 901	1 937
Prodhim i primar i naftës së papërpunuar (mijë TOE)		0	0	0	0	0	0
Prodhim i primar i lëndëve djegëse të ngurta (mijë TOE)		1 612	1 412	1 428	1 503	1 562	1 591
Prodhim i primar i gazit (mijë TOE)		0	0	0	0	0	0
Importet neto të të gjitha produkteve energjetike (mijë TOE)		619 s	769 s	757 s	815 s	787 s	942 s
Konsumi bruto i energjisë së brendshme (mijë TOE)		2 517	2 569	2 585	2 669	2 665	2 888
Prodhim i bruto i energjisë elektrike (GWh)		5 168	5 918	5 915	6 351	6 711	6 892

<b>Bujqësia</b>	Shënim	2010	2017	2018	2019	2020	2021
-----------------	--------	------	------	------	------	------	------

Indeksi i vëllimit të prodhimit bujqësor të mallrave dhe shërbimeve (me çmimet e prodhimit) (2010 = 100)		100.0 w	112.4 w	108.3 w	119.0 w	100.0 w	95.7 w
Sipërfaqja bujqësore e shfrytëzuar (mijë hektarë)		406.9 e	417.0	419.5	421.0	421.1	421.2
Numri i bagëtimeve: gjedhe të gjalla (mijë krerë, fundi i periudhës)		:	259.7	259.7	257.7	261.4	260.5
Numri i bagëtimeve: derra të gjallë (mijë krerë, fundi i periudhës)		:	41.1	40.2	40.5	45.4	47.4
Numri i bagëtimeve: dele dhe dhi të gjalla (mijë krerë, fundi i periudhës)		:	210.7 s	209.8 s	216.3 s	241.7 s	241.4 s
Qumështi i papërpunuar i disponueshëm në ferma (mijë ton)		:	365.1	334.3	:	:	:
Prodhimi kulturave të vjela: drithëra (përfshirë orizin) (mijë ton)		430.5	477.9	441.8	459.4	529.1	504.4
Prodhimi kulturave të vjela: panxhar sheqeri (mijë ton)		:	:	:	:	:	:
Prodhimi kulturave të vjela: perime (mijë ton)		158.5	147.8	155.3	177.8	169.4	165.0

**Burimi: Eurostat dhe/ose autoritetet statistikore në Kosovë**

: = nuk është në dispozicion

b = ndërprerja në seri

c = vlera konfidenciale

d = përkufizimi ndryshon

e = vlera e parashikuar

n = vlera jo e rëndësishme

p = e përkohshme

s = vlerësimi i Eurostatit

w= të dhëna të ofruara nga dhe nën përgjegjësinë e autoritetit kombëtar statistikor dhe të publikuara mbi bazën "siç janë" dhe pa asnjë siguri në lidhje me cilësinë e tyre dhe respektimin e metodologjisë statistikore të BE-së

\* = Treguesi i Evropës 2020

\*\* = Treguesi i Procedurës së Çekuilibrit Makroekonomik (MIP).

**Fusnotat:**

1) Ndryshimi i sipërfaqes ndërmjet viteve 2016 dhe 2017 pasqyron matjet e bëra nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

2) Përfshin tarifën e disbursimit të vendosur nga bankat.

